



# KOHA PËR KRYEMINISTRIN E PARË SHQIPTAR

[www.bdi.mk](http://www.bdi.mk)

PROGRAMI 2020-2024  
ZGJEDHJE PARLAMENTARE 2020



**KOHA PËR  
KRYEMINISTRIN  
E PARË SHQIPTAR**

---

PROGRAM 2020-2024

---

ZGJEDHJE PARLAMENTARE 2020

# PËRMBAJTJA

|  |           |
|--|-----------|
| <b>POROSIA E KRYETARIT .....</b>   | <b>9</b>  |
| <b>PËRMBLEDHJE .....</b>   | <b>12</b> |
| <b>MISIONI YNË.....</b>  | <b>13</b> |
| DEKLARATA.....   | 14        |
| KONTEKSTI.....   | 17        |
| IDENTITETI.....  | 18        |
| VIZIONI.....   | 20        |
| MISIONI.....   | 21        |
| VLERAT .....   | 22        |
| PARIMET.....   | 24        |
| <b>U THA, U BË! .....</b>  | <b>27</b> |
| MARRËVESHJA PAQËSORE E OHRIT .....   | 28        |
| INTEGRIMET EUROATLANTIKE.....  | 28        |
| CILËSIA E JETËS.....   | 29        |
| <b>PËRCAKTIMET TONA .....</b>  | <b>33</b> |
| NË KONGRESIN E KATËRT ZGJEDHOR TË MBAJTUR MË 21 DHJETOR<br>2019 NË SHKUP, BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM MIRATOI PESË<br>REZOLUTA TË CILAT SHËRBEJNË SI ORIENTIM PËR VEPRIMTARINË<br>TONË VIJUESE POLITIKE DHE MBI BAZË TË TË CILAVE NDËRTOJMË<br>OFERTËN TONË PROGRAMORE..... | 34        |
| #1 INTEGRIM KONSENSUAL .....   | 36        |
| #2 VETING.....   | 38        |
| #3 ZHVILLIM DHE VENDE PUNE .....   | 40        |
| #4 JETESË CILËSORE .....   | 43        |
| #5 RINIA NË VEND TË PARË.....  | 47        |

|   |           |
|---|-----------|
| <b>ZOTIMET TONA.....</b>  | <b>49</b> |
| <b>#1 INTEGRIM KONSENSUAL .....</b>                                       | <b>50</b> |
| Integrimi vendor.....   | 50        |
| Shtet shumetnik.....  | 50        |
| Shoqëri e qytetarëve të barabartë.....                                    | 51        |
| Kohezion shoqëror .....   | 51        |
| Integrimi rajonal .....   | 51        |
| Fqinjësi e mirë dhe bashkëpunim rajonal.....                              | 51        |
| Shqiptarët për paqe dhe prosperitet në rajon.....                         | 52        |
| Integrimi në NATO .....   | 53        |
| Anëtare në NATO.....  | 53        |
| Partneritet strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....            | 54        |
| Integrimi në Bashkimin Evropian.....                                      | 54        |
| Anëtare në Bashkimin Evropian.....  | 54        |
| Marrëdhëniet ndërkombëtare.....   | 55        |
| Demokraci konsensuale.....  | 55        |
| Vendimmarrje konsensuale.....   | 55        |
| Bashkëqeverisje dhe bashkëpërgjegjësi .....                               | 56        |
| <b>#2 VETING.....</b>   | <b>57</b> |
| Vetingu si politikë dhe instrument .....                                  | 57        |
| Veting.....   | 57        |
| Transparencë.....   | 58        |
| Integritet .....  | 59        |
| Shtet i së drejtës .....  | 59        |
| Drejhtësi jo-selektive dhe profesionalizëm në gjyqësor dhe prokurori..... | 60        |
| Të drejtat dhe liritë e njeriut .....                                     | 61        |
| Luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar .....                  | 61        |
| Zero korrupsion .....   | 62        |
| Institucionalizim i vetingut .....  | 62        |
| Përforsim i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit .....    | 62        |
| Inkurajim për denoncime të rasteve .....                                  | 62        |
| Mbrojtja, rendi dhe siguria .....   | 63        |
| Mbrojtja nga kërcënimet globale .....                                     | 63        |

|  |           |
|--|-----------|
| Përmirësimi i rendit dhe qetësisë publike .....                            | 63        |
| Mbikëqyrje dhe kontroll efikas të zbatimit të ligjit.....                  | 63        |
| Qeverisje e mirë .....   | 64        |
| Qeverisje e përgjegjshme .....   | 64        |
| Administratë efikase dhe profesionale .....                                | 64        |
| Shoqëri Digjitale.....   | 65        |
| Edukim dhe zhvillimin e njohurive Digjitale .....                          | 65        |
| Shërbimet Digjitale.....   | 66        |
| Infrastruktura dhe siguria digjitale.....                                  | 66        |
| <b>#3 ZHVILLIM DHE VENDE PUNE .....</b>                                    | <b>68</b> |
| Rimëkëmbje ekonomike pas krizës së COVID19 .....                           | 69        |
| Përkrahje ekonomike qytetarëve dhe ndihma grupeve te ndjeshme sociale..... | 69        |
| Përkrahje e biznesit dhe mbrojtja e vendeve të punës .....                 | 70        |
| Politikë fiskale e qëndrueshme dhe stabilitet financiar .....              | 70        |
| Rimëkëmbje dhe rritje ekonomike në ‘normalitetin e ri’ pas Covid-19 .....  | 70        |
| Ekonomi e fortë dhe stabile.....   | 70        |
| Politika për rritje ekonomike .....  | 71        |
| Konvergenca ekonomike me Bashkimin Evropian.....                           | 71        |
| Politika fiskale të qëndrueshme.....                                       | 72        |
| Stabiliteti monetar dhe financiar .....                                    | 72        |
| Drejtësi në politikën tatimore .....                                       | 73        |
| Grumbullim efikas i të ardhurave publike .....                             | 73        |
| Rritja e transparencës tatimore .....                                      | 73        |
| Përmirësimi i shërbimeve për taksapaguesit .....                           | 73        |
| Shpërndarje e drejtë e ngarkesës tatimore .....                            | 74        |
| Buxhet konsensual dhe shpërndarje e drejtë e financave publike .....       | 74        |
| Sistem tatimor pro biznesit .....  | 74        |
| Transparenca e financave publike.....                                      | 75        |
| Siguri juridike, parashikueshmëri ligjore dhe institucione efikase .....   | 75        |
| Gjyqësor dhe administratë profesionale dhe efikase .....                   | 75        |
| Shërbime elektronike për biznes dhe parashikueshmëria ligjore .....        | 75        |
| Optimizim i institucioneve.....  | 76        |
| Sistem një-sportel për investitorë.....                                    | 76        |
| Luftë kundër korrupsionit dhe ekonomisë joformale .....                    | 76        |

|   |     |
|---|-----|
| Biznes i shkathët dhe konkurrues.....                                     | 77  |
| Stimulim të investimeve private.....                                      | 77  |
| Internacionalizim i biznesit.....   | 78  |
| Novacione dhe teknologji të reja.....                                     | 78  |
| Përkrahje e bizneseve të vogla dhe të mesme.....                          | 79  |
| Lehtësim i qasjes në financa.....   | 80  |
| Kapital njerëzor cilësor.....   | 80  |
| Edukim dhe trajnim cilësor gjatë gjithë jetës.....                        | 81  |
| Rritje e pjesëmarrjes dhe heqja e barrierave në tregun e punës.....       | 82  |
| Zvogëlim i varfërisë dhe kujdesi shëndetësor.....                         | 82  |
| Vende pune për të gjithë.....   | 82  |
| Krijimi i vendeve të reja të punës.....                                   | 83  |
| Integrimi i të rinjve në tregun e punës.....                              | 83  |
| Zhvillimi i politikës të grave sipërmarrëse.....                          | 84  |
| Zonat industriale dhe të gjelbra.....                                     | 84  |
| Ekonomi digjitale.....  | 84  |
| Investimi në lidhjen ‘Broadband’.....                                     | 84  |
| Rritja e sigurisë në internet, besimi dhe digjitalizimi i industrisë..... | 85  |
| Forcimi i ekonomisë dhe shoqërisë digjitale.....                          | 85  |
| Nxitja e kërkimit dhe novacionit.....                                     | 85  |
| Transport.....  | 85  |
| Infrastruktura rrugore.....   | 86  |
| Infrastruktura hekurudhore.....   | 89  |
| Energji e sigurt.....   | 89  |
| Rritja e kapaciteteve prodhuese dhe efikasitetit energjetik.....          | 90  |
| Energji ripërtëritëse.....  | 91  |
| Gasifikimi.....   | 92  |
| Bujqësia dhe zhvillimi rural.....   | 93  |
| Bujqësia.....   | 94  |
| Blegtoria.....  | 95  |
| Pylltaria.....  | 97  |
| Industria e përpunimit të ushqimit.....                                   | 97  |
| Zhvillimi dhe rimëkëmbja e zonave rurale.....                             | 98  |
| Ekstrakt.....   | 100 |
| Projekte.....   | 101 |
| IPA FONDET.....   | 102 |
| Zhvillim lokal dhe rajonal i balancuar.....                               | 106 |

|  |     |
|--|-----|
| Zhvillimi lokal.....                                   | 107 |
| Zhvillimi i balancuar rajonal .....                    | 110 |
| Projekte .....   | 110 |
| Turizëm gjithëpërfshirës.....                          | 114 |
| Mjedis jetësor i pastër dhe planifikimi hapësinor..... | 116 |
| Menaxhimi me ujërat.....                               | 117 |
| Menaxhimi me mbeturinat .....                          | 117 |
| Cilësia e ajrit.....                                   | 117 |
| Ndryshimet klimatike.....                              | 118 |
| Përgjegjësia shoqërore .....                           | 118 |
| Projekte.....  | 119 |
| Migrimi dhe diaspora .....                             | 122 |
| Migrimi.....   | 122 |
| Diaspora .....   | 123 |

#### **#4 JETESË CILËSORE ..... 125**

|   |     |
|---|-----|
| Arsim cilësor dhe modern.....   | 125 |
| Arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe i orientuar drejt “nxënësit”.....           | 125 |
| Edukim parashkollor .....   | 126 |
| Arsimi fillor dhe i mesëm.....  | 127 |
| Arsim i lartë, veprimtaria kërkimore-shkencore.....                             | 132 |
| Projekte kapitale në arsim.....   | 134 |
| Shëndetësi profesionale dhe moderne .....                                       | 140 |
| Organizimi i sistemit shëndetësor .....   | 140 |
| Kujdesi shëndetësor parësor - “Mjeku 24 orë afër qytetarit” .....               | 141 |
| Kujdesi shëndetësor dytësor.....  | 144 |
| Kujdesi shëndetësor klinik – Terciar.....                                       | 146 |
| Stomatologjia .....   | 148 |
| Fondi për sigurim shëndetësor .....   | 149 |
| Resurset njerëzore – “Mjek i lumtur – pacienti i lumtur” .....                  | 150 |
| Balancim ekonomik - “Të shëndetshëm, jemi të gjithë të barabartë” .....         | 152 |
| E-Shëndetësia – kompjuterizimi i sistemit shëndetësor.....                      | 153 |
| Kulturë përfaqësuese .....  | 154 |
| Politikat afatgjate dhe strategjike të BDI-së në kulturë.....                   | 154 |
| Prioritetet për mandatin 2020-2024.....   | 155 |
| Themelimi i Institucioneve kulturore.....                                       | 155 |
| Afirmimi dhe ndërkombëtarizimi i kulturës dhe artit shqiptar jashtë vendit .... | 157 |

|  |            |
|--|------------|
| Shoqëri solidare dhe politikat e mirëqenies sociale .....          | 158        |
| Paga dinjitoze dhe standard më të lartë jetësor .....              | 158        |
| Zvogëlim i varfërisë .....   | 159        |
| Mirëqenia sociale .....  | 160        |
| Balancë në raportin punë – jetë .....                              | 160        |
| Pensionet .....  | 161        |
| Pension i parakohshëm dhe stazhi i sigurimit .....                 | 162        |
| Mediat dhe Shoqëria civile .....                                   | 163        |
| Media të lira dhe të besueshme .....                               | 163        |
| Mediet në kohën tonë.....  | 163        |
| Mediet sociale dhe portalet.....                                   | 164        |
| Shoqëri civile aktive .....  | 165        |
| <b>#5 RINIA NË VEND TË PARË.....</b>                               | <b>166</b> |
| Rini aktive dhe vendimmarrëse .....                                | 167        |
| Pavarësimi ekonomik i të rinjve .....                              | 167        |
| Ulja e papunësisë rinore .....                                     | 168        |
| Vullnetarizmi rinor për zhvillim.....                              | 168        |
| Investime në sport dhe sportistë.....                              | 169        |
| <b>PROJEKTET TONA .....</b>  | <b>171</b> |
| <b>#1 INTEGRIM KONSENSUAL .....</b>                                | <b>172</b> |
| Demokraci konsensuale.....   | 172        |
| NATO .....   | 172        |
| Bashkimi Evropian .....  | 172        |
| Administrata Publike.....  | 172        |
| <b>#2 VETING.....</b>  | <b>173</b> |
| <b>#3 ZHVILLIM DHE VENDE PUNE .....</b>                            | <b>173</b> |
| Rimëkëmbje ekonomike pas COVID-19.....                             | 173        |
| Ekonomi dhe Financa .....  | 174        |
| Decentralizim Fiskal, Zhvillim Lokal dhe Rajonal i Balancuar ..... | 174        |
| Ndërmarrësia.....  | 174        |
| Turizëm .....  | 175        |
| Investime.....   | 175        |
| Energjetikë.....   | 176        |



|                                      |            |
|--------------------------------------|------------|
| Mjedisi Jetësor .....                | 176        |
| Transport.....                       | 176        |
| Bujqësi .....                        | 177        |
| <b>#4 JETË CILËSORE .....</b>        | <b>177</b> |
| Arsim.....                           | 177        |
| Shëndetësi .....                     | 178        |
| Kulturë.....                         | 178        |
| Mirëqenie Sociale .....              | 179        |
| <b>#5 RINIA NË VEND TË PARË.....</b> | <b>180</b> |

## POROSIA E KRYETARIT

Të dashur qytetarë, të nderuara motra dhe vëllezër!

Çdo gjë e ka një fillim. Çdo gjë fillon me një ëndërr. Të gjithë ne kemi ëndrrat tona, për fëmijët tanë, për vetën tonë, për vendin. Ne shqiptarët, kemi ëndërruar për liri, për barazi. Dhe luftuam që kjo ëndërr të bëhet e vërtetë. Sepse kur besojmë në diçka, ne jemi të gatshëm të sakrifikojmë gjithçka.

Si shqiptarë, ne kemi ditur gjithmonë se si të bashkohemi për qëllimet e përbashkëta, kur ka qenë e rëndësishme dhe vendimtare. Gjatë luftës, gjatë krizës dhe gjatë përpjekjeve tona të pandalshme për barazi dhe integrim. Kjo është arsyeja, pse ne bashkërisht kemi arritur shumë në historinë tonë si shqiptarë në Maqedoninë e Veriut.

Marrëveshja e Ohrit është duke u zbatuar. Gjuha shqipe tashmë gëzon një status të barabartë dhe formal ashtu si edhe flamuri jonë kombëtar. Marrëveshja e Prespës është nënshkruar dhe kushtetuta është ndryshuar. Ne jemi anëtar të plotë të NATO-s dhe po negociojmë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Shqiptarët sot mbajnë më shumë se kurrë pozicione kryesore si gjyqtarë të gjykatës supreme dhe kushtetuese, ministri dhe institucione kyçe dhe kryetar të parlamentit.

Sidoqoftë, kjo nuk mjafton. Tani është koha për vazhdim të ëndrës. Për ëndrra më të mëdha, sepse erdhi koha për të arritur edhe më shumë.

Maqedonia e Veriut është vendi ynë. Vendi për të cilin kemi luftuar.

Ne kemi një pjesë të barabartë në historinë, trashëgiminë, në ekonominë dhe në të ardhmen vendit tonë.

Tani është koha për barazi të plotë, për marrje të përgjegjësisë së plotë për të prirë!

Është koha për kryeministrin e parë shqiptar në Maqedoninë e Veriut!

Disa mund ta quajnë këtë ide të përealizueshme. Disa mund të edhe ta përqeshin besimin tonë në realizimin e ëndrës së shumë shqiptarëve. Kjo, megjithatë është diçka e mirë. Për shkak se ta mohosh një ëndërr të bën që të punosh akoma më shumë për ta realizuar.

Kur ëndërronim për lirinë në vitin 2001, po e njëjta kategori e njerëzve gjithashtu u tallën dhe ngritën flamurin e bardhë. Dhe nëse vetëm disa vjet

më parë do t'iu thoshim, se do të vinte dita, kur Kryetari i parlamentit të Maqedonisë së Veriut do të ishte shqiptar, shumë nuk do ta besonin ashtu siç nuk besojnë edhe sot.

Sigurisht, shumë njerëz nuk do të kishin besuar gjithashtu, se gjuha shqipe do të ishte një gjuhë zyrtare në Maqedoninë Veriore ose që flamuri do të valonte i lirë dhe që do të kishim tre universitete në gjuhën shqipe. Por ne, ca prej nesh, që synojnë të realizojnë ëndrrat, e dinim se mund t'ia dilnim. Ne e arritëm këtë së bashku. Siç do të bëjmë edhe tani.

Së bashku, ne do të shkruajmë historinë për ta bërë ardhmërinë. Së bashku mund t'i tregojmë botës, se Maqedonia e Veriut mund të jetë me të vërtetë një shoqëri, ku të gjithë mund të realizojnë ëndrrat e tyre dhe të ndjehen të barabartë. Një vend ku një shqiptar mund të bëhet Kryeministër dhe të jetë udhëheqës i denjë në miqësi dhe partneritet të garantuar dhe të përhershëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian.

Kjo është ajo që dua t'u mundësojë fëmijëve dhe nipërve e mbesave tona: Besimi se ne mund të arrijmë gjithçka që ëndërrojmë.

Dhe për këtë, duhet të bëhemi bashkë!

Kjo ide është shumë më e madhe se çdo parti apo cilido person. Kjo ide nuk ka të bëjë me BDI-në dhe sigurisht jo me mua. Unë jam këtu për t'ia vazhduar jetën procesit, që t'i prij konceptit, që të bëhem urë dhe të shtrij rrugën duke krijuar rrethanat për realizimin e ëndrrës dhe ju mbetet juve që ta zbatoni. Unë po mbjell, që ju të korrni. Unë po ëndërroj, që ju të realizoni. Unë po guxoj, që ju ta bëni.

Kur jemi bashkë, jemi shumë të fuqishëm.

Kjo është një kauzë kombëtare shqiptare. Kjo është ëndrra jonë kombëtare. Ëndrra e barazisë së plotë, ëndrra e një shoqërie që fjalët i kthen në vepra.

Kryeministri i parë shqiptar do të jetë një Kryeministër për të gjithë. Një Kryeministër i barazisë: vendeve të barabarta të punës, pagave të barabarta, të drejtave të barabarta, drejtësisë së barabartë. Për shqiptarët dhe të gjithë. Kryeministri i parë shqiptar do të udhëheqë një gjeneratë të re të politikës, duke përfaqësuar një shoqëri të barabartë dhe duke udhëhequr Maqedoninë e Veriut drejt një të ardhmeje të begatë si vend anëtar i NATO-s dhe i Bashkimin Evropian.

Një Kryeministër, i cili unifikon dhe që do të hapë një epokë të re jo vetëm në historinë shqiptare, por edhe në historinë e Maqedonisë së Veriut, madje edhe në historinë e Evropës.

Tani është koha. Është koha për t'u bashkuar, koha për të vepruar përsëri së bashku. Kjo është një thirrje për të gjitha partitë shqiptare dhe të gjithë qytetarët shqiptarë dhe të tjerët, për të mbështetur kauzën shqiptare, e cila është më e madhe se të gjithë ne.

Tani është koha për të shkruar së bashku historinë. Nuk është thjesht një ëndërr; është shansi ynë. është shansi ynë të ndërtojmë një shoqëri të re, në të cilën fëmijët tanë mund të arrijnë gjithçka që ëndërrojnë. Është koha për kryeministrin e parë shqiptar në Maqedoninë e Veriut.

Për ne, për fëmijët tanë dhe për kombin.

Mos e humbisni guximin për të ëndërruar, mos i shuani ëndrrat e juaja, besoni në veten tuaj dhe ëndrrat do të realizohen.

Prandaj, duke u bashkuar dhe rrethuar numrin 9, ju i bëni vendimtar përfaqësuesit tuaj në Kuvend në mënyrë që ta mundësojnë realizimin e ëndrrës dhe realizimin e shumë projekteve për të përmirësuar jetën tuaj edhe më tej.

Me respekt,  
Ali Ahmeti

## PËRMBLEDHJE

I/E nderuar, të nderuar qytetarë

Në rreshtat vijues ju ftojme që të njiheni nga afër me të arriturat e Bashkimit Demokratik për Integrim që nga viti 2002 gjer në vitin 2020, me programin vijues për mandatin 2020 - 2024, me përcaktimet tona programore e ideologjike, me vizionin tonë për një të ardhme të përbashkët të sigurt, të qëndrueshme dhe përparimtare.

Transparenca dhe llogaridhënia janë parime tona bazë të përgjegjësisë para jush.

Programi jonë përfshinë porosinë e të parit ndër ne, Kryetarit Ali Ahmeti, për të vijuar me frymën dhe përcaktimet tona ideologjike për barazi sociale, raport taksativ mbi punët kryesore të realizuara që nga viti 2002 deri në vitin 2020, shtjellim të pesë shtyllave dhe prioriteteve programore për periudhën para nesh, për të përfunduar me punët të cilat do t'i realizojmë bashkë me ju në mandatin vijues dhe për të cilat kërkojmë besimin tuaj.

Ky program përfshin vizionin tonë të ri për zhvillim të qëndrueshëm dhe të shpejtë, përmes politikave, reformave dhe projekteve konkrete të Bashkimit Demokratik për Integrim. Kjo platformë do të bëhet pjesë e Programit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për mandatin 2020 - 2024.

Pas rumbullakimit të suksesshëm të përpjekjeve tona për liri dhe barazi, koha është për drejtësi dhe zhvillim.

Gjatë këtyre viteve, konsistenca, qëndrueshmëria, përkushtimi, realizimi dhe fjala e mbajtur kanë shënuar bashkëpunimin tonë me ju dhe përmbushja e tërësishme e premtimeve tona programore kanë justifikuar besimin tuaj ndër vite.

Duke vlerësuar lartë besimin dhe mbështetjen që na keni dhënë deri tani, të përgjegjshëm për detyrimet që rrjedhin nga ai, zotohemi të vazhdojmë në realizimin e punëve që na presin përpara, bashkë me Ju!

Ju faleminderit!

**KOHA PËR  
KRYEMINISTRIN  
E PARË SHQIPTAR**



**MISIONI YNË**

## Deklarata

**Kongresi i katërt zgjedhor i  
Bashkimit Demokratik për Integrim  
Shkup, 21 dhjetor 2019**



Kongresi i katërt zgjedhor i Bashkimit Demokratik për Integrim në frymën e deklaratës themeluese të Bashkimit Demokratik për Integrim nga 5 qershori i vitit 2002, Marrëveshjes Paqësore të Ohrit dhe të udhëhequr nga idealet e Rilindësve shqiptar dhe amaneti i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare:

Konfirmon vlerat tona thelbësore si demokracia, liria, barazia, paqja dhe drejtësia si vlera që bashkërisht përbëjnë themelin e ndërtimit të një shoqërie progresive e cila ka demokracinë si parakusht,

Vlerëson si të suksesshme veprimtarinë e derisotme largpamëse dhe konsistente të Bashkimit Demokratik për Integrim të kalitur me shpirtin revolucionar, politikën burrështetase dhe reformat progresive,

Rikonfirmon se Bashkimi Demokratik për Integrim nuk është produkt i konjunkturave, interesave apo fraksioneve, por është vazhdimësi e një lëvizjeje kryengritëse dhe patriotike ndër dekada, si dhe rezultat i mobilizimit të përgjithshëm atdhedashës, që imponoi ndryshime rrënjësore drejt barazisë, demokratizimit të vendit dhe integritimit në NATO dhe Bashkimin Evropian,

Riafirmon misionin e jetësimit të idealit për liri, barazi dhe drejtësi si garancia e vetme e paqes, sigurisë dhe stabilitetit, mirëqenies dhe zhvillimit të shpejtë e gjithëpërfshirës,

Nënvizon vlerat të cilat janë mishërim i traditës dhe kulturës tonë si: dinjiteti, ndershmëria, liria, barazia, të drejtat e njeriut, solidariteti dhe respekti në përputhje të plotë me vlerat euro-amerikane.

Thekson parimet e suksesit të veprimtarisë politike dhe qeverisjes në vendin tonë shumetnik: legjitimiteti, partneriteti, demokracia, sundimi i ligjit, konsensusi, transparenca, konsistenca dhe llogaridhënia,

Rrjedhimisht, Delegatët e Kongresit konfirmojnë përkushtimin e angazhimit për liri dhe të drejta njerëzore, integrim konsensual, zhvillim të qëndrueshëm, rritje ekonomike si dhe vende të reja pune, drejtësi sociale, jetesë cilësore, mirëqenie, por edhe një shoqëri ku individët përpiqen së bashku për të mirën e përbashkët dhe ku rinia zë vendin e parë.

Delegatët vlerësojnë që demokracia pluraliste, transparente, përfaqësuese e diversiteteve dhe njëkohësisht pjesëmarrëse, me liri të shprehjes dhe me

media të pavarura duhet të ngadhënjejë në të gjitha fushat e jetës në mënyrë që t'u mundësojë qytetarëve vendimmarrjen për të mirën dhe interesin e përbashkët, duke promovuar drejtësi dhe solidaritet në shoqëri, nëpërmjet të qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, luftës së pa kompromis kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, llogaridhënies dhe transparencës.

Më pastaj, synojmë qasje gjithëpërfshirëse në ndërtimin e politikave që integrojnë konsensualisht të gjitha nivelet e qeverisjes duke mundësuar një vend, rajon dhe kontinent solidar midis njerëzve dhe vendeve.

Garantojmë përpjekje maksimale për mirëqenie qytetare duke siguruar progres social nëpërmjet të përfshirjes së çdo njeriu dhe çdo vendbanimi.

Kjo shoqëri, të cilën synojmë ta ndërtojmë mbi vlerat tona, nënkupton edhe një ekonomi e cila i përfaqëson ato dhe që nxit progres shoqëror për rritje të standardit jetësor, për jetesë cilësore, për mundësi të barabarta, për investime dhe për vende pune të reja.

Synojmë një ekonomi konkurruese, investime dhe novacione teknologjike që përshpejtojnë rritjen dhe zhvillimin, si dhe biznes të integruar në tregun rajonal, evropian dhe global, i shkathët të përballet me konkurrencën dhe sfidat e globalizimit.

Përqendrohemi në përgatitjen e ekonomisë dhe industrisë sonë për tranzicionin ambiental, për zhvillimin e tërësishëm digjital, ndërtimin e e-shtetit dhe për drejtësi dhe transparencë tatimore duke kundërshtuar evazionin, shmangien por edhe paparashikueshmërinë tatimore.

Vlerësojmë patjetërsueshmërinë e qasjes universale ndaj ajrit të pastër, ujit të pastër, energjisë së pastër dhe ushqimit cilësor.

Po ndërtojmë politika për t'i ruajtur burimet e vendit dhe ambientin duke krijuar qëndrueshmërinë ambientale për ta ruajtur të tashmen por edhe për ta siguruar për gjeneratat e ardhshme, duke u përkujdesur për të moshuarit dhe duke investuar te të rinjtë.

Angazhohemi për një shoqëri të fuqishme, të barabartë, të drejtë që garanton qasje të sigurt shtetërore dhe pa kompensim në arsim dhe shëndetësi cilësore, ndarje të barabartë të begatisë, zhvillim të barabartë rajonal, eliminim të varfërisë, jetë dinjitoze dhe përgjegjësi kolektive që rrjedh nga bindja jonë që vetëm bashkë jemi më të fortë, vetëm bashkë jemi më mirë.

Përqafojmë ndjenjën e përkatësisë nëpërmjet të përfshirjes së të gjithëve duke kundërshtuar përjashtimet e të tjerëve në një shoqëri kohezive dhe inkluzive ku shoqëria pranon vlerat individuale e kolektive dhe përqafor diversitetin dhe barazinë gjinore.



Pabarazia duhet të çrrënjohet dhe përqendrimi nga të paktët duhet të bëhet tek të shumtët duke ndërtuar shoqëri të mirëqenies, me shërbime publike dhe institucione të përgjegjshme dhe cilësore, me arsim, shëndetësi, rroga dhe pensione dinjitoze duke u përkujdesur për të gjitha kategoritë e shoqërisë.

Kongresi përsërit se vota e shqiptarëve kapitalizohet vetëm nëse është e përqendruar, ndërsa ndarja e potencialit votues shqiptar në më shumë parti e dëmton balancën midis peshës demografike dhe peshës politike të shqiptarëve, gjegjësisht, dobëson pozitat shqiptare në pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv si dhe rrezikon pushtetin vendor në komuna të caktuara.


Përkushtohemi që politikat tona t'i ndërtojmë në bashkëpunim dhe partneritet me shoqërinë civile, kontribuuesit shoqërorë, botën akademike, mediet, sindikatat, komunitetin euro-amerikan dhe me të gjithë ata që ndajnë vlerat dhe përcaktimet tona.

Përfundimisht, demokracia është vlerë themeluese dhe busull orientuese e Bashkimit Demokratik për Integrim. Përkushtohemi të mbrojmë dhe përmirësojmë demokracinë, të mbetemi në kursin euro-amerikan pa asnjë alternativë tjetër, të garantojmë pakthyeshmërinë e marrëveshjeve të Ohrit, Prespës dhe të fqinjësisë së mirë bashkë me ndryshimet kushtetuese, të zbatojmë sundim të drejtë të ligjit nëpërmjet të vetingut të tërësishëm të skenës politike, gjykatës dhe prokurorisë, të eliminojmë drejtësinë selektive, të krijojmë vende të reja pune dhe ndarje të barabartë, të mundësojmë një jetë cilësore me të gjitha elementet përcjellëse duke krijuar kështu kushte më të mira për të gjithë, si dhe rinia të ndërtojë të ardhmen dhe familjen e vet në vendin e vet.

Vizioni ynë është barazi e plotë për të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut, duke respektuar identitetin etnik dhe me jetë cilësore sipas standardeve më të larta si anëtar në NATO dhe Bashkimin Evropian. Ne duam të shohim vendin në paqe dhe prosperitet, bashkësitë etnike në harmoni dhe qytetarët të barabartë, me jetë cilësore dhe dinjitet në familjen Euro-Atlantike.

## Konteksti

- Shtet-formimi
- Demokratizimi
- Integrimi



Fryma e demokracisë perëndimore në vitet e 1990-ta e cila përfshiu vendet e regjimit socialist dhe komunist rrënoi sistemet moniste, me çka filloi tranzicioni politik, ekonomik dhe shoqëror. Krahas të gjitha sfidave që përmbante tranzicioni në ndërtimin e demokracisë dhe hapjen e tregut të lirë, vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore gjetën perspektivën e tyre euro-atlantike si mundësi të transformimit të shoqërisë sipas vlerave evropiane. Në këtë rrugëtim vendi ynë u përball me tre procese dhe sfida të ndërlikdhura: shtet-formimi, demokratizimi dhe integrimi.

**Shtet-formimi.** Me rënien e regjimit monist dhe në zanafillat e pluralizmit pas pavarësismit të Maqedonisë së Veriut, shtet-formimi u përball me tendencën majorizimit dhe nacionalizmit, nga njëra anë, dhe aspiratat për liri dhe barazi, nga ana tjetër. Promovimi i shtetit monoetnik, nga ana e elitës se shumicës imponoi agjendën e veprimit politik të elitës shqiptare kryesisht në realizim të të drejtave etnike dhe rivendosjen e statusit shtet-formues. Megjithatë, shterja e të gjitha mundësive politike gjatë viteve të 1990-ta, rezultoi me Kryengritjen e vitit 2001 për liri, barazi dhe demokraci.

**Demokratizimi.** Marrëveshja Paqësore e Ohrit në vitin 2001, ndërpreu konfliktin dhe i dha mundësi të re paqes në Maqedoninë e Veriut me garanci ndërkombëtare (ShBA, BE dhe NATO) duke u bazuar në vlerat për demokratizim të vendit me standardet Euro-Atlantike.

**Integrimi.** Perspektiva dhe qëndrueshmëria e paqes, stabilitetit dhe prosperitetit të vendit vazhdon të mbetet integrimi në NATO dhe Bashkimin Evropian. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës u hoqën barrierat politike në rrugën e integritit të vendit i cili duhet të realizohet me reforma që do të garantojnë funksionim të demokracisë, sundim të ligjit, liritë dhe të drejtat e njeriut, si dhe ekonomi konkurruese me standard më të lartë të jetesës.

## Identiteti



- **Revolucionar**
- **Burrështetas**
- **Reformator**

Bashkimi Demokratik për Integrim dallon nga subjektet tjera politike, sepse paraqet një lëvizje politike e cila përmban bashkimin autentik (origjinal) të disa brezave për të realizuar të drejtat kombëtare, politike dhe shoqërore. Idealet e Bashkimit Demokratik për Integrim janë idealet e Rilindësve tanë. Ato frymëzohen nga vlerat e lirisë, bashkimit, barazisë dhe prosperitetit. Bashkimi Demokratik për Integrim nuk është produkt i konjukturave, interesave, fraksioneve, por është vazhdimësi e një lëvizjeje kryengritëse dhe patriotike, që imponoi ndryshime rrënjësore në sistemin politik. Bashkimi Demokratik për Integrim është rezultat i mobilizimit të përgjithshëm dhe kontribut i secilit prej nesh dhe paraqet një pasuri historike dhe dinjitoze të shqiptarëve për sot dhe për të ardhmen. Rruga e Bashkimit Demokratik për Integrim është amanet i brezave që sakrifikuuan edhe jetët e tyre për jetë më dinjitoze. Bashkimi Demokratik për Integrim bart amanetin e brezave nga e kaluara në të ardhmen. Këto vlera që sollën ndryshimet janë investim për perspektivën e brezit të ri, i cili do të avancojë edhe më shumë shoqërinë shqiptare.

Identiteti ynë është i gërshetuar me shpirtin revolucionar, politikën burrështetase dhe veprimtarinë reformatore dhe progresive.

Revolucionar. Bashkimi Demokratik për Integrim paraqet vazhdimësi të lëvizjes revolucionare të bazuar në idealet e rilindësve me vlera të civilizimit përëndimor për liri dhe demokraci. Ajo u krijua si vazhdimësi e idealeve të brezave që i sfiduan dhe i luftuan regjimet majorizuese, diskriminuese dhe antidemokratike. Kryengritja e vitit 2001, që rezultoi me Marrëveshjen Paqësore të Ohrit, ishte kthesë që i hapi rrugë demokratizimit të shtetit, përmes ndryshimit të kushtetutës dhe vendosjes së parimeve bazë për njohjen e shqiptarëve si popull shtet-formues. Kryengritja e vitit 2001 në Maqedoni solli deri te ndryshimi rrënjësor i konceptit të deriatëhershëm të sistemit politik, që bazohej në modelin etnocentrik të shtetit.

Burrështetas. Veprimtari politike e bartësve të kryengritjes, patriotëve të përkushtuar, intelektualëve dhe demokratëve me qasje burrështetase që me Deklaratën politike të 5 Qershorit 2002 themeluan Bashkimin Demokratik për Integrim. Si forcë politike, Bashkimi Demokratik për Integrim dha

përgjigje për dilemat sfiduese për perspektivat e shqiptarëve: vendosja e modelit të shtetit shumetnik, demokratizimi dhe integrimi euroatlantik si alternativë e vetme për vendin. Asokohe, ne patëm guximin politik për të marrë përgjegjësinë për realizimin e obligimeve të Marrëveshjes Paqësore të Ohrit.

Reformator. Forcë politike progresive dhe reformuese me prurje të reja që në vazhdimësi ju prinë ndryshimeve në shoqëri për demokraci dhe zhvillim. Ne besuam fuqishëm se fryma, parimet dhe aspektet normative që burojnë nga ky dokument me garanci ndërkombëtare do të jenë përgjigje optimale e kohës për dilemat dhe sfidat e shoqërisë shqiptare. Ishim të vetëdijshëm se do të ballafaqohemi me shumë rezistencë, kundërshtim dhe pengesa. Por, kjo nuk na ndali dhe, gjatë gjithë kësaj periudhe, gati dy-dekadash, ishim të bindur se jemi në rrugë të drejtë dhe ju kemi prirë ndryshimeve. Këta hapa janë progresivë dhe të pakthyeshëm. Këto trende janë inkurajuese dhe optimiste për arritjen e qëllimit tonë. Krahas arritjeve dhe përparimit të deritashëm ka akoma punë për të bërë dhe ne jemi të bindur dhe të përkushtuar që të vazhdojmë reformat progresive.

## Vizioni

- Të barabartë
- Me standard të lartë
- Anëtarë në NATO dhe Bashkimin Evropian



Vizioni ynë është barazi e plotë për të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut, duke respektuar identitetin etnik dhe me jetë cilësore sipas standardeve më të larta si anëtarë në NATO dhe Bashkimin Evropian. Ne duam të shohim vendin në paqe dhe prosperitet, bashkësitë etnike në harmoni dhe qytetarët të barabartë, me jetë cilësore dhe dinjitet në familjen Euro-Atlantike.

## Misioni



- Liri
- Drejtësi
- Barazi
- Konsensualitet

Misioni ynë është përkushtim i plotë dhe i vazhdueshëm në jetësimin e idealit të lirisë, barazisë e drejtësisë, si dhe demokracisë e prosperitetit. Ideale këto të Rilindësve tanë që u bartën ndër breza me sakrifice, guxim dhe heroizëm. Realizimi i këtij misioni kalon në katër etapa: liri, drejtësi, barazi dhe konsensualitet.

**Liri.** Me triumfin e pluralizmit dhe demokracisë përkundrejt totalitarizmit dhe komunizmit, në vitet e 1990-ta, shqiptarët fituan lirinë e shprehjes, organizimit politik, protestave dhe shtrimin e kërkesave që nuk sollën drejtësi që do të reflektojë vullnetin e komuniteteve, shqiptarëve dhe maqedonasve por, mbi parimin e majorizimit imponohej sistem politik etnocentrik dhe pse kishim pluralizëm politik. Liria e brishtë dhe mohimi i të drejtave etnike rezultoi me Kryengritje në vitin 2001.

**Drejtësi.** Me Marrëveshjen Paqësore të Ohrit, nëpërmjet mekanizmit të shumicës së dyfishtë në parlament, përfaqësimin adekuat dhe të drejtë nëpër institucionet si dhe me decentralizimin dhe zgjerimin e gamës së të drejtave kolektive si arsimi në gjuhën amtare, kultivimi i veçorive etnike e kulturore dhe mos-diskriminimi, u krijuan mundësi për një drejtësi që merr parasysh shumë-kombësinë e vendit për t'ia hapur rrugën arritjes së barazisë ndërmjet komuniteteve.

**Barazi.** Përpjekjet tona për të shkuar përtej lirisë, drejtësisë (e cila kërkon angazhim të vazhdueshëm) deri tek barazia e tërësishme midis të gjithë qytetarëve dhe në mes të komuniteteve përcaktojnë implementimin e plotë dhe reflektimin e frymës së Marrëveshjes Paqësore të Ohrit në ndërtimin e sistemit të barabartë e të drejtë në një demokraci funksionale.

**Konsensualitet.** Demokracia funksionale e shtetit shumetnik do të arrihet në mënyrë më kuptimplote dhe efikase nëpërmjet demokracisë konsensuale dhe instalimit të mekanizmave për vendimmarrje konsensuale. Kjo është kryefjala në dekadën e ardhshme në veprimtarinë politike për të siguruar stabilitet të qëndrueshëm dhe integrim të plotë brenda vendit duke respektuar standardet në rrugëtimin Euro-Atlantik.

## Vlerat



- **Dinjiteti**
- **Ndershmëria**
- **Liria**
- **Barazia**
- **Të drejtat e njeriut**
- **Solidariteti**
- **Diversiteti**

Në realizimin e vizionit dhe misionit tonë, veprimtaria jonë politike në themel përmban vlerat të cilat janë mishërim i traditës dhe kulturës tone, vlera të cilat ngritën njerëzimin në pedestal dhe po të njëjtat janë sot të njohura edhe si vlera evropiane: dinjiteti, ndershmëria, liria, barazia, të drejtat e njeriut, solidariteti dhe diversiteti.

**Dinjiteti.** Qytetarë të respektuar dhe me dinjitet janë baza e shoqërisë së shëndoshë dhe mbi këtë ndërtojmë vlerat e demokracisë së mirëfilltë duke respektuar dinjitetin njerëzor.

**Ndershmëria.** Ndershmëria dhe përgjegjësia ndaj qytetareve është çelës i besueshmërisë, rrjedhimisht edhe parakusht i dinjitetit dhe çiltërsisë në veprimtarinë politike dhe në menaxhimin e institucioneve dhe resurseve publike, si dhe mbrojtje të pronës private.

**Liria.** E drejtë e pacenueshme e individit është zhvillimi në mënyrë të lire i personalitetit të tij dhe sjellja e vendimeve të lira mbi jetën e tij. Liria nënkupton të drejtat dhe obligimet. Secili që angazhohet për lirinë e tij duhet të njohë lirinë e bashkëqytetarëve të vet. Liria individuale është e plotë brenda ekzistimit të lirisë kolektive.

**Barazia.** Barazia mes njerëzve përben bazën e ndërtimit të një shoqërie të drejtë. Dallimet duhet të jenë bazë për ndërtim të shoqërive demokratike, gjithnjë duke respektuar parimin: të barabartë në dallime. Vetëm me shanse të barabarta për të gjithë mund të ndërtohet një shoqëri e barabartë.

**Të drejtat e njeriut.** Të drejtat e njeriut ashtu siç janë të definuara në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara duke vlerësuar individin si bazë e shoqërisë qytetare.

**Solidariteti.** Solidariteti nënkupton të qenit afër njëri-tjetrit, sepse individët dhe bashkësia varen nga një bashkëveprim i tillë. Prandaj, solidariteti duhet

vënë në veprim për të ndihmuar ata të cilët nuk kanë fuqi të mjaftueshme për të realizuar një jetë të dinjitetshme njerëzore.

**Diversiteti.** Shumë-kombësia e shoqërisë me diversitetin e vet pasuron trashëgiminë kulturore dhe njëherazi paraqet avantazh në integrimin rajonal dhe ndërkombëtar të vendit. Ne angazhohemi për rritje të respektit ndëretnik, ndërkulturor, ndërfetar edhe politik. Ne konsiderojmë se vetëm ndërtimi i parimeve të thella të respektit mund të stabilizojë shoqërinë tonë dhe të vendosë bazat e demokracisë së mirëfilltë.



## Parimet

- Legjitimiteti
- Partneriteti
- Demokracia
- Sundimi i ligjit
- Konsensusi
- Transparenca
- Llogaridhënia



Duke u mbështetur në vlerat tona, në realizimin e vizionit tonë, parimet e veprimtarisë politike do të jenë: legjitimiteti, partneriteti, demokracia, sundimi i ligjit, konsensusi, transparenca dhe llogaridhënia.

**Legjitimiteti.** Një qasje demokratike që do të i merr parasysh dallimet etnike dhe kulturore, si dhe do të respektojë lojalitetin e shumëfishtë të komuniteteve me përfaqësues legjitim.

**Partneriteti.** Politika jonë bazohet në partneritetin si formë e bashkëpunimit, si bashkëpërgjegjësi për të qeverisur dhe përkushtim për një ardhmëri më të begatë. Ne do të insistojmë që në proceset politike, ekonomike dhe shoqërore të përfshihen të gjitha resurset që ka vendi ynë, mbi bazë të partneritetit, çka do të mundësonte bashkimin e të gjitha energjive për të përmbushur interesat e të gjithëve. Forca jonë politike bazohet në partneritet të vazhdueshëm me qytetarët (votuesit).

**Demokracia.** Sovrani i veprimtarisë tonë politike është qytetari, ai i cili vendos me votën e tij për të ardhmen e vet dhe të shoqërisë. Vetëm me politika vizionare dhe devotshmëri do të arsyetojmë besimin dhe verdiktin e sovranit.

**Sundimi i ligjit.** Për të pasur një të ardhme të sigurt, të qetë dhe progresive, duhet të gjithë të jemi të barabartë para ligjit dhe drejtësia të jetë për të gjithë e njëjtë dhe e paanshme. Bashkimi Demokratik për Integrim nuk e njeh tolerancën si koncept në raport me ligjin.

**Konsensusi.** Vendimmarrja mbi parimet e dialogut, konsensusit dhe partneritetit paraqet bazën e një demokracie të qëndrueshme në një shtet shumetnik. Dialogu i mirëfilltë ndëretnik është garanci për kohezion dhe stabilitet në vend.

**Transparenca.** Politika është një proces i cili për bazë ka interesat publike. Idetë tona politike janë të hapura dhe të afërta me qytetarët. Duke u nisur nga ky parim ne angazhohemi për aplikimin e vetingut në veprimtarinë politike dhe institucionet shtetërore e publike si masë, në mes tjerash, për të luftuar kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe dukurive tjera negative, të cilat rrezikojnë shoqërinë dhe proceset e demokratizimit dhe integritetit.

**Llogaridhënia.** Përgjegjësia dhe llogaridhënia do të sigurohet duke njoftuar rregullisht për veprimtarinë dhe rezultatet e institucioneve dhe duke mbajtur përgjegjësi për punën e realizuar.

**KOHA PËR  
KRYEMINISTRIN  
E PARË SHQIPTAR**



**U THA, U BË!**

## Marrëveshja paqësore e Ohrit



- Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat
- Avancimi i administratës dhe njohja e arsimit
- Votimi i dyfishtë (parlament, gjyqësor dhe prokurori)
- Gjuha shqipe zyrtare (parlament, qeveri dhe administratë)
- Themelimi i Ministrisë për sistem politik dhe marrëdhënie ndëretnike
- Pozita kyçe të udhëhequra nga kuadro shqiptar
- Decentralizimi dhe komuna të zhvilluara më afër qytetarëve
- Përdorimi i flamurit kombëtar
- Institucionalizimi i vlerave kombëtare
- Investime kapitale në të gjitha sferat
- 24 orë program në gjuhën shqipe në radio dhe TV
- Muzeu “Alfabeti i Manastirit”
- Çmimi shtetëror “22 Nëntori”
- Teatri shqiptar në Shkup
- Ansambli i këngëve dhe valleve shqipe
- Buxhet konsensual në Qeveri

## Integrimet Euroatlantike

- Zgjedhëm çështjen e emrit
- Arritëm marrëveshje të fqinjësisë së mirë
- Anëtare në NATO
- Hapja e negociatave për aderim në BE
- Liberalizim i vizave për BE
- Hapja e dialogut të lartë para-qasës me BE-në
- Harmonizim i legjisllacionit
- Njohja e pavarësisë së Kosovës
- Lëvizje e qytetarëve pa pasaporta në Shqipëri dhe Kosovë
- Ulja e çmimeve të ‘roaming’ shërbimeve

## Cilësia e jetës

- **Infrastrukturë strategjike kombëtare**
- **Përfshirje më e madhe në arsim**
- **Universiteti Shtetëror i Tetovës dhe Universiteti Nënë Tereza në Shkup**
- **Biznesi shqiptar faktor në ekonomi**
- **Modernizim i shëndetësisë**
- **Zona teknologjike industriale dhe zhvillimore**
- **Liberalizim i tregut të energjisë**
- **Investime në shkolla, salla sportive, çerdhe, spitale, rrugë, infrastrukturë**

Bashkimi Demokratik për Integrim është dëshmuar si subjekti politik konsistent dhe më i qëndrueshëm, i cili vizionin e qartë të prezantuar në platformë politike para qytetarëve, me fuqinë e votës dhe përkrahjes së qytetarëve, e shndërron në vepra konkrete. Që nga viti 2002 e këtij kemi punuar me përkushtimin më të lartë në jetësimin e idealeve të brezave të kaluar dhe me admirimin më të lartë për brezat që vijnë drejt qëllimit për një jetë më të mirë. Vota e lirë e qytetarëve është e shenjtë dhe vota e dhënë për Bashkimin Demokratik për Integrim është investim, që garanton të ardhme më të mirë për shqiptarët dhe të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut.

Veprimtaria politike kryesisht u fokusua në tre shtylla: avancimi i të drejtave etnike deri te njohja e statusit shtet-formues të shqiptarëve, gjegjësisht, implementimi i Marrëveshjes Paqësore të Ohrit; Integrimet Euro-Atlantike; dhe përmirësimi i standardit jetësor.

**Implementim i Marrëveshjes Paqësore të Ohrit.** Me ndryshimet kushtetuese nga Marrëveshja Paqësore e Ohrit dhe me miratimin e një sërë ligjesh, rrrumbullakuam pjesën normative të Marrëveshjes Paqësore të Ohrit. Me ndryshimin dhe plotësimin e kornizës ligjore, mundësuaam përfaqësimin e drejtë dhe adekuat; votimin e dyfishtë; përdorimin zyrtarë të gjuhës shqipe në të gjitha nivelet dhe në të gjithë territorin; institucionalizuaam simbolet kombëtare (flamuri), vlerat etnike dhe kulturore shqiptare; figurat historike kombëtare; decentralizim i pushtetit dhe afrim i të njëjtit me qytetarët. Shqiptarët fituan të drejtën për përfaqësim të drejtë dhe adekuat në organet e pushtetit shtetëror dhe institucionet publike në të

gjitha nivelet. Në periudhën 2002-2018 përfaqësimi është rritur nga 2.5% në 19.2%, ndërsa në pozicione udhëheqëse janë 14.9%. Sipas raportit të fundit për ndjekjen e zbatimit të parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, përfaqësimi i shqiptarëve në vende të emëruar ose të zgjedhur është 23.2%. Një nga parimet kryesore të Marrëveshjes Paqësore të Ohrit është ndërtimi i mirëbesimit nëpërmjet vendimmarrjes konsensuale. Kjo bashkë me parimin e votimit të dyfishtë në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut dhe në këshillat komunale realizohet edhe nëpërmjet Komitetit për marrëdhënie ndëretnike dhe aplikohet edhe në institucionet tjera (Aneks C i Marrëveshjes Paqësore të Ohrit). Bashkimi Demokratik për Integrim, gjatë qeverisjes së vet ka punuar për reformim të pushtetit gjyqësor, për ta bërë atë më të besueshëm dhe më të pranueshëm për shqiptarët. Në vitin 2006, ne vendosëm votimin e dyfishtë edhe në zgjedhjen e gjykatësve dhe prokurorëve. Zyrtarizimi i gjuhës shqipe ka avancuar në vazhdimësi duke filluar përdorimin në administratë, parlament, qeveri dhe dokumentacion zyrtar si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror, shtetëror. Marrja e pozitave kyçe në shtet si Krye-parlamentar, Avokat i Shtetit, Avokat i Popullit, Ministër i Mbrojtjes, Ministër i Punëve të Brendshme, Krye-negociator për Integrimin në BE, Kryetar i Federatës së Futbollit, Kryetar i Gjykatës Supreme etj.

**Integritet Euro-Atlantike.** Ingranazhi i reformave për demokratizim të vendit dhe sigurim të një perspektive në paqe dhe prosperitet kanë qenë integritet Euro-Atlantike. Me nënshkrimin e Marrëveshjeve me Bullgarinë dhe Greqinë u tejkalua pengesa politike për anëtarësim në NATO dhe fillim të negociatave për aderim në Bashkimin Evropian. Gjatë kësaj periudhe arritëm statusin kandidat dhe liberalizim të vizave për BE. Gjithashtu, njohëm pavarësinë e Kosovës dhe mundësuam lëvizjen pa pasaporta me Shqipërinë dhe Kosovën.

**Cilësia e jetës.** Krijimi i vendeve të reja të punës (niveli i papunësisë është zvogëluar nga 31.9% në 17.5% për periudhën 2002-2019) dhe bruto prodhimi vendor për krye banori është rritur nga 2,000 euro në vitin 2002, në 4,900 euro në vitin 2018. Rritje e pagës minimale për 60% nga 9,000 denarë në 2017 në 14,500 denarë në 2020. Ulja e papunësisë rinore nga 48.5% në vitin 2006 në 35% në 2019. Rritje e vazhdueshme e pagës mesatare neto. Rritje e pagave në dy vitet e fundit, në arsim (për mbi 20%), shëndetësi (specialist me rritje 40%, mjek të përgjithshëm me 25% dhe infermiere me 20%), armatë dhe administratë. Jetëgjatësia është rritur nga 73.6 vjet në 2002 në 75.6 vjet në 2017. Përfshirja është rritur në arsim në përgjithësi, ndërsa në arsim të lartë nga 26.8% në vitin 2002 në 41.2% në vitin 2015, janë hapur shkolla të reja fillore dhe të mesme, si dhe themelimi i universiteteve

shtetërore në gjuhën shqipe – Universiteti i Tetovës dhe Universiteti Nënë Tereza, modernizim i shëndetësisë me klinika dhe pajisje të reja. Gjithashtu, është modernizuar infrastruktura strategjike, transporti, energjetika, zona teknologjike industriale, si dhe është rritur roli i biznesit shqiptar në ekonominë vendore dhe rajonale.


**KOHA PËR  
KRYEMINISTRIN  
E PARË SHQIPTAR**



**PËRCAKTIMET TONA**



## **NË KONGRESIN E KATËRT ZGJEDHOR TË MBAJTUR MË 21 DHJETOR 2019 NË SHKUP, BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM MIRATOI PESË REZOLUTA TË CILAT SHËRBEJNË SI ORIENTIM PËR VEPRIMTARINË TONË VIJUESE POLITIKE DHE MBI BAZË TË TË CILAVE NDËRTOJMË OFERTËN TONË PROGRAMORE**



Në frymën e deklaratës themeluese të Bashkimit Demokratik për Integrim nga 5 qershori i vitit 2002,

Në vijim të vendimeve të marra në Kongreset Zgjedhore të vitit 2005, 2009 dhe të vitit 2014,

Me konsideratë ndaj përgjegjësive dhe detyrimeve nga përcaktimet programore të miratuara në Kongresin e parë tematik të vitit 2015,

Duke riafirmuar përcaktimet politike dhe strategjike të shqiptarëve dhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut,

Të udhëhequr gjithnjë nga idetë rilindëse shqiptare, amaneti i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe ideali kombëtar shqiptar,

Të angazhuar për paqe, stabilitet, siguri dhe bashkëpunim në vend dhe rajon, marrëdhënie të shëndosha ndëretnike dhe ndër-fqinjësore, barazi të plotë dhe konsensualitet, vende të reja të punës, zhvillim ekonomik dhe mirëqenie shoqërore,

Duke u bazuar në arritjet e Bashkimit Demokratik për Integrim që nga themelimi më 5 qershor 2002 e deri më sot,

Duke theksuar objektivin kryesor strategjik dhe të përcaktuar pa asnjë mëdyshje dhe asnjë alternativë tjetër përveç integritimit në NATO dhe në Bashkimin Evropian,

Të udhëhequr nga parimet e përcaktuara në Rregulloren dhe ndryshimet e Statutit të Bashkimit Demokratik për Integrim të miratuar më 5 qershor 2014,

Në përputhje me vullnetin e shumicës absolute të popullit shqiptar të shprehur në të gjitha proceset zgjedhore që nga viti 2002 e deri më sot,

Nëpërmjet konfirmimit të vullnetit të palëkundur për të respektuar përcaktimet dhe vizionin politik të Bashkimit Demokratik për Integrim,

Me mirënjohjen më të sinqertë për të gjitha gjeneratat ndër vite që kanë

kontribuar në të gjithë veprimtarinë tonë të përbashkët,

Me respektin e përhershëm për dëshmorët, martirët, invalidët dhe familjet e tyre,

Nëpërmjet të zbatimit të suksesshëm të pjesës normative të Marrëveshjes Paqësore të Ohrit dhe duke përqafuar tërësisht frymën e saj në veprimtarinë tonë,

Kryesia e punës së Kongresit të katërt të Bashkimit Demokratik për Integrim të mbajtur më 21 dhjetor 2019 në Shkup ju propozoi delegatëve miratimin e Deklaratës për misionin në vijim si dhe të pesë rezolutave nga të cilat do të përcaktohen prioritetet programore vijuese të Bashkimit Demokratik për Integrim:

## #1 INTEGRIM KONSENSUAL



- # Integrimi në vend
- # Integrimi në rajon
- # Integrimi në NATO
- # Integrimi në Bashkimin Evropian
- # Demokracia konsensuale

Delegatët e kongresit të katërt zgjedhor të Bashkimit Demokratik për Integrim i vlerësojnë si të suksesshme politikat e deritanishme për vendimmarrje konsensuale dhe orientim integruar të vendit tonë.

Kongresi i Bashkimit Demokratik për Integrim konstaton se kryefjalët e veprimtarisë tonë politike që nga vet themelimi janë përqaftuar fuqishëm nga qytetarët dhe janë zbatuar me përpikëri, prandaj propozon mbindërtim të konceptit të konsensualitetit dhe të integritimit duke i bashkuar ato si të ndërsjella dhe komplementare.

Kongresi i Bashkimit Demokratik për Integrim propozon Rezolutë mbi integrimin konsensual tre-nivelesh që janë të përputhshme njëra me tjetrën dhe në kohezion të tërësishëm me Deklaratën Themeluese të Bashkimit Demokratik për Integrim si dhe paraqesin vazhdimësi të veprimtarisë së deritanishme të Bashkimit Demokratik për Integrim.

Kongresi konsideron që integrimi i brendshëm, ndër-shqiptar, rajonal dhe euroatlantik janë procese ngushtë të ndërlidhura dhe të kushtëzuara nga konsensualiteti shoqëror si procese jetike për të ardhmen e përbashkët.

Integrimi në një shoqëri qytetarësh dhe komunitetesh tërësisht të barabarta sigurohet nëpërmjet vendimmarrjes konsensuale të dy komuniteteve shumicë, bashkë edhe me komunitetet tjera, si dhe lojalitet të plotë të shtetit ndaj qytetarit si parakusht të lojalitetit të qytetarit ndaj shtetit.

Integrimi rajonal i vendeve të Evropës Juglindore është i domosdoshëm dhe arrihet në frymën euroatlantike të heqjes së kufijve dhe bashkimit të infrastrukturës, tregut, lëvizjes së lirë të qytetarëve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, si dhe respektit dhe njohjes së ndërsjellë në frymën e solidaritetit dhe demokracisë.

Kongresi rikonfirmon synimin tonë për integrim të natyrshëm ndër-shqiptar nëpërmjet të heqjes së kufijve me Prishtinën dhe Tiranën, lidhjes infrastrukturore, bashkëpunimit dhe komunikimit të ngushtë vëllazëror në të gjitha sferat shoqërore.

Kongresi konstaton që integrimi euroatlantik tashmë është në rrugë të drejtë nëpërmjet finalizimit të anëtarësimit në NATO si prioritet absolut i Bashkimit Demokratik për Integrim si dhe nëpërmjet të hapjes së bisedimeve aderuese me Bashkimin Evropian dhe gjithmonë në partneritet strategjik dhe bashkëpunim të ngushtë me aleatin tonë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Vendimmarrje konsensuale, bashkëqeverisje, barazia janë parakushte për integrim në të gjitha nivelet nëpërmjet marrjes së përgjegjësisë nga të gjithë përfaqësuesit legjitim.

Demokracia funksionale e shtetit shumetnik me standarde evropiane do të arrihet në mënyrë më kuptimplote dhe efikase nëpërmjet integritit përmes demokracisë konsensuale dhe instalimit të mekanizmave për vendimmarrje konsensuale në të gjitha nivelet dhe temat me interes strategjik dhe gjithëpërfshirës.

Delegatët e kongresit të katërt zgjedhor të Bashkimit Demokratik për Integrim konstatojnë që integrimi konsensual është kryefjala në periudhën vijuese të veprimtarisë sonë politike për të siguruar barazi, drejtësi, siguri, stabilitet të qëndrueshëm dhe integrim të plotë brenda vendit, rajonit dhe komunitetit euro-amerikan duke respektuar standardet e demokracive Euro-Atlantike.

Kongresi i Bashkimit Demokratik për Integrim i vlerëson Marrëveshjet e Ohrit, atë të Prespës si dhe për fqinjësi të mirë si të arritura të jashtëzakonshme në funksion të integritit konsensual dhe konstaton që nga këto marrëveshje kthim prapa nuk mund të ketë.

## #2 VETING



# Vetingu si politikë

# Vetingu si instrument

# Drejtësi jo-selektive

# Sundim i mirëfilltë i ligjit

# Luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

# Mbrojtja, rendi dhe siguria

Delegatët e Kongresit të katërt zgjedhor të Bashkimit Demokratik për Integrim konstatojnë gjendjen shqetësuese të pushtetit të tretë dhe vlerësojnë që pas realizimit të përcaktimeve për liri dhe barazi nga Deklarata Themeluese e Bashkimit Demokratik për Integrim, koha është për të adresuar drejtësinë selektive, parashikueshmërinë ligjore, sundimin e së drejtës dhe të ligjit në përgjithësi.

Kongresi i Bashkimit Demokratik për Integrim konstaton drejtësinë selektive në vend të frymëzuar nga politika, të aplikuar nga prokurorë dhe të zbatuar nga gjykatës me paragjykitime nga sisteme të kaluara, me bindje të vjetruara dhe me prirje korruptive.

Ligji duhet të jetë i njëjtë dhe i drejtë për çdo qytetar. Autoriteti dhe ndikimi i ligjit në shoqëri varet nga qasja e drejtë dhe jo-selektive e zbatuesit dhe ushtruesit të këtij autoriteti sepse liria në një shoqëri demokratike nënkupton nënshtrim ndaj ligjeve të cilat janë të zbatueshme tek çdo qytetar dhe e përcjellë me të drejtën e pacenuar individuale ndaj kufizimeve dhe ndalesave të lirisë.

Sundimi i ligjit nënkupton nënshtrim ndaj ligjit edhe të ligjvënësit, edhe të ligj-zbatuesit edhe të gjykatësit dhe prokurorit dhe paraqet parakusht absolut për barazi, por edhe për zhvillim ekonomik dhe kushte të barabarta për zhvillim të biznesit.

Delegatët e Kongresit të katërt zgjedhor të Bashkimit Demokratik për Integrim konfirmojnë vendosmërinë e tyre për të qeveris ligji e jo individit, por në mënyrë të barabartë, transparente, jo-selektive dhe me parashikueshmëri ligjore.

Kongresi i Bashkimit Demokratik për Integrim mbështet propozimin për veting që nënkupton kontrollin e dyfishtë të secilit anëtar të Bashkimit Demokratik për Integrim dhe të çdo partie tjetër, që merr rolin e shërbyesit

publik, çdo politikani, prokurori dhe gjykatësi në vend sepse integriteti i individit udhëheqës dhe i institucionit që udhëheq janë baza e një shoqërie të shëndoshë.

Kontrulli i parë siguron integritet dhe transparencë maksimale të secilit pretendent dhe ushtrues detyre publike duke mbledhur, analizuar dhe botuar të gjitha informacionet dhe të dhënat për secilin pretendent dhe bartës aktual të funksionit publik në mënyrë që qytetarët ose organi që e propozon, zgjedh apo emëron bartësin e funksionit, të vlerësojë integritetin dhe dinjitetin e bartësit ose kandidatit duke ulur mundësinë për korrupsion, krim, keqpërdorim të detyrës dhe rrënim të autoritetit dhe imazhit të institucionit.

Kontrulli i dytë nënkupton zbatimin e vetingut nëpërmjet të marrjes së masave institucionale pas konstatimit të parregullsive, mospërputhjes midis të ardhurave dhe pronës si dhe diskrepancave në karrierë gjatë kontrollit të parë ndaj kandidatëve dhe bartësve të funksioneve publike, prokurorëve dhe gjykatësve.

Rrjedhimisht, Delegatët e kongresit të katërt zgjedhor të Bashkimit Demokratik për Integrim vënë prioritetin mbi përmbushjen e detyrimeve nga kapitujt 23 dhe 24 të Acquis që përfshijnë gjyqësorin dhe të drejtat themelore, drejtësinë, lirinë dhe sigurinë.

Gjithashtu, Kongresi i Bashkimit Demokratik për Integrim mbështet rekomandimet e grupit të ekspertëve të lartë mbi çështjet sistemore të sundimit të ligjit të drejtuar nga Rajnhard Pribe në lidhje me mediet, zgjedhjet, gjykatat dhe prokurorinë, avokatin e popullit dhe ndjekjen e komunikimeve.

Delegatët e Kongresit janë të palëkundur në qëndrimin se mediet duhet të jenë të lira nga presioni politik, por edhe të distancohen nga partitë politike dhe grupet e interesit duke mos u vënë në shërbim të askujt përveç së të informimit të drejtë dhe me integritet, pa lajme të rreme dhe propagandë.

Njëkohësisht, ftojme institucionet gjyqësore që të rishqyrtojnë rastet e kontestuara seriozisht në opinion që kanë dëmtuar rëndë besueshmërinë e gjyqësorit duke konstatuar zbatimin e drejtësisë selektive që destabilizojnë shoqërinë dhe pamundëson barazinë.

### #3 ZHVILLIM DHE VENDE PUNE

- # Vende pune për të gjithë
- # Ekonomi e fortë dhe stabile
- # Infrastrukturë për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik
- # Zhvillimi rural, lokal dhe rajonal
- # Mjedis jetësor i pastër dhe planifikimi hapësinor



Kongresi i katërt zgjedhor i Bashkimit Demokratik për Integrim konstaton të arriturat e derisotme në drejtim të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat si një nga shtyllat kryesore të Marrëveshjes Paqësore të Ohrit dhe vlerëson që pas plotësimit të synimeve për liri dhe barazi, politikat tona të reja për integrim konsensual për një shoqëri kohezive, për veting të tërësishëm dhe ndërtimin e masave për jetesë cilësore nëpërmjet të përafrimit të standardeve, do të përqendrohemi me tërë potencialin tonë në sigurimin e mundësive të zhvillimit, hapjen e vendeve të reja të të punës dhe avancim të mirëqenies.

Kongresi gjithashtu konfirmon konsistencën e politikave të Bashkimit Demokratik për Integrim dhe realizimin e deritanishëm të tyre, prandaj dhe nuk ka asnjë dilemë në realizimin edhe të këtij synimi që arrihet me rritje ekonomike të shpejtë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse si model i zhvillimit ekonomik për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve, si dhe hap perspektiva për një nivel më të lartë të mirëqenies.

Bashkimi Demokratik për Integrim synon arritjen e standardit të jetesës të vendeve evropiane. Me një rritje ekonomike mesatare prej 4% deri 5% në nivel vjetor brenda një dekade, standardi i jetesës matur sipas bruto prodhimit të brendshëm për krye banori do të përmirësohet mbi 60%, gjegjësisht nga niveli aktual prej 37% të mesatares së BE-së, standardi jetësor do të arrijë në 55% të mesatares evropiane duke llogaritur edhe rritjen e BE-së për një dekadë.

Vazhdojmë të jemi për ekonomi të fortë dhe stabile e cila arrihet me stabilitet makroekonomik dhe politika për rritje ekonomike të bazuara në ekonominë e tregut të lire dhe të hapur. Jemi për buxhet stabil me deficit më pak se 3% të PBB, borxh të jashtëm që nuk kalon 60% të PBB. Politika fiskale që inkurajojnë investime, politika industriale dhe ekonomike që përkrahin konkurrencën vendase, si politika sociale dhe mundësojnë qasje më të mirë për kategoritë e ndjeshme të shoqërisë.

Vijojmë përforsimin edhe më të madh të besueshmërisë dhe efikasitetit të institucioneve që do të mundësojnë biznes klimë të përshtatshme për sektorin privat dhe investime të reja.

Kongresi thekson nevojën e përforsimit të kushteve për biznes të shkathët dhe konkurrues që do të arrihet nëpërmjet novacioneve, nxitjes së afarizmit, iniciativës private dhe investimeve. Reformat në sektorin privat të fokusohen në disa aspekte më të ndjeshme ekonomike si: tregtia dhe integrimi në zinxhirin e vlerave globale, ngritja e aftësive konkurruese të biznesit nëpërmjet afarizmit, novacioneve dhe teknologjive të reja, si dhe përmirësimi i qasjes në financa për bizneset e reja dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme.

Globalizmi dhe zhvillimi teknologjik bëjnë ekonominë globale gjithnjë e më komplekse dhe kjo ndikon që kapitali njerëzor të jetë edhe më i rëndësishëm për rritje ekonomike të shpejtë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Kapitali njerëzor cilësor i cili shpejt përshtatet në ndryshimet e tregut bën ekonominë më konkurruese, zvogëlon papunësinë, varfërinë dhe dallimet sociale. Politikat për avancimin e kapitalit njerëzor do të orientohen në rritje të cilësisë së arsimit dhe trajnimeve gjatë gjithë jetës, heqja e barrierave dhe rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës, si dhe kujdesi shëndetësor për kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë.

Modernizimi i arsimit do të i përfshijë të gjitha ciklet e sistemit arsimor duke filluar nga përkujdesja dhe edukimi parashkollor dhe shkollimi fillor me qasje dhe standarde të barabarta për të gjithë fëmijët dhe me plan-programe që nxisin kreativitetin, mendimin kritik dhe dashurinë ndaj shkencës, shoqërisë të pasuruar me vlera të larta etike dhe morale. Shkollim të mesëm cilësor të gjimnazit si bazë e fortë për studimet universitare dhe shkollim i mesëm profesional (trevjeçar) duke mundësuar edhe edukimin e dyfishtë me punë praktike. Ngritjen e standardit dhe cilësisë së studimeve universitare sipas trendeve globale për të qenë më konkurrues, duke promovuar optimizimin e kapaciteteve universitare dhe dizajnim të financimit që nxit cilësinë dhe rregullore që garantojnë standard të larta, por edhe modele për të garantuar financim dhe qasje pa kompensim për studentët e talentuar.

Promovojmë ekonominë Digjitale duke implementuar Agjenda Digjitale e promovuar në kuadër të Procesit të Berlinit për Ballkanin Perëndimor: Investim në 'Broadband'; rritje e sigurisë dhe besueshmërisë në internet, Digjitalizim i industrisë; forcim i ekonomisë dhe shoqërisë digjitale; dhe nxitje e kërkimit shkencor dhe inovacionit.



Bashkimi Demokratik për Integrim do të vazhdojë të përkrahë investimet për energji të qëndrueshme dhe liberalizim të sektorit energjetik, në bazë të direktivave të Bashkësisë Evropiane dhe parimeve të ekonomisë së tregut. Energjia është një nga resurset kryesore të zhvillimit ekonomik dhe e një standardi më të mire të jetesës. Do të rritet efikasiteti energjetik dhe përdorimi i resurseve të ripërtërishme energjetike, energjia e diellit, erës, ujit dhe bioenergji me qëllim që të ruajmë ambientin e jetesës.

Frymëzohet integrimin e diasporës në ekonominë e vendit sepse ajo paraqet një potencial të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik, ndërsa integrimi ekonomik rajonal, evropian dhe global do të ndihmojnë krijimin e tregjeve të reja duke krijuar politika të liberalizimit ekonomik dhe ndërtimit të projekteve strategjike të infrastrukturës së transportit, energjetikës dhe komunikimit informatik në korridorin tetë dhe dhjetë, si dhe lidhjes me vendet fqinje.

Vlerësojmë nevojën për përfshirje dhe kohezion nëpërmjet të qasjes së barabartë në financat publike, zhvillimit lokal dhe rajonal të balancuar, si dhe barazisë sociale, duke mundësuar arsim dhe shëndetësi cilësorë për të gjithë, por edhe zhvillim të sportit dhe kulturës që do të mundësojë kohezion ekonomik, social dhe territorial. Gjithashtu, zvogëlimi i papunësisë, duke hapur vende të reja të punës sidomos për rininë dhe lufta kundër varfërisë do të mundësojë rritje përfshirëse ashtu që dobitë e zhvillimit ekonomik t'i ndjejnë të gjithë.

Prioritetet programore të Kongresit në drejtim të rritjes ekonomike dhe ofertës së shtuar për vende pune për të gjithë do të mundësojnë mirëqenie shoqërore dhe përafrim të standardeve jetësore të vendit tonë me ato të vendeve të Bashkimit Evropian. Në këtë drejtim do të zhvillohen dhe implementohen politika për përshpejtim të rritjes ekonomike si dhe politika të duhura sociale për të parandaluar dhe balancuar pabarazitë dhe eliminuar përjashtimin që mund të krijohet nga forcat e tregut dhe përfundimisht të gjithë të ndjejnë të mirat e zhvillimit dhe përparimit socio-ekonomik dhe shoqëror.

## #4 JETESË CILËSORE

# Arsim, shëndetësi, kulturë, ambient cilësor

# Barazi shoqërore

# Balancë në raportin punë - jetë

# Përafrim standardesh me vendet e Bashkimit Evropian

# Shoqëri inkluzive dhe sociale



Delegatët e Kongresit të katërt zgjedhor të Bashkimit Demokratik për Integrim konstatojnë që pas realizimit të përpjekjeve për liri, drejtësi dhe barazi nëpërmjet të miratimit dhe zbatimit të pjesëve normative të Marrëveshjes së Ohrit dhe të arriturave në dy dekadat e kaluara si dhe trasimit të pakthyeshem të përcaktimeve të integritit dhe konsensualitetit, nevojitet fokus i tërësishëm në politikat zhvillimore dhe të mirëqenies individuale dhe familjare duke u përqendruar në cilësinë e jetesës për t'i adresuar pabarazitë dhe për të siguruar standarde cilësore të jetesës për të gjithë.

Ky synim ndikohet nga një numër përcaktuesish politik, social, ekonomik dhe mjedisor, siç janë: integrimi i brendshëm konsensual, rajonal, evropian dhe Euro-Atlantik, barazia e qytetarëve para ligjit, gjykimi i drejtë, transparenca dhe vetingu, arsimi cilësor, mjedisi i pastër, shëndeti fizik dhe mendor, liria e siguria, stabiliteti ekonomik dhe financiar i individit, të ardhura dinjitoze në paga dhe pensione, të drejtat njerëzore si themele të një jetese cilësore.

Ky kongres riafirmon besimin se vëmendja e qeverisjes duhet të jetë në politikat që gjenerojnë më shumë vite për jetën dhe më shumë cilësi viteve të jetës, dhe shpreh vullnetin dhe angazhimin e plotë për zhvillimin e një qasjeje të integruar dhe të mirë-koordinuar ndër-sektoriale në funksion të një jetese më cilësore.

Rrjedhimisht, delegatët e Kongresit të katërt të Bashkimit Demokratik për Integrim porosisin organet partiake që arsimi cilësor është prioritet absolut dhe faktor kyç i një jetese cilësore, si dhe nënvizojnë se arsimi cilësor mundëson jetesë cilësore, dhe shprehin vullnetin dhe mbështetje për të ecur në rrugën e ngritjes së menjëhershme të cilësisë së arsimit inkluziv si barazi sociale, arsimit profesional si patjetësueshmëri për t'u përputhur me tregun ekzistues dhe arsimit të dedikuar për t'u përputhur me kushtet e tregut të së nesërme. Edukim parashkollor për çdo fëmijë me qëllim që ato të jenë të barabartë në vijimin shkollimit të tyre.

Së këndejmi, ndarja e politikës nga arsimi, krijimi i mjedisit gjithëpërfshirës për mësim, klasa dhe shkolla që pranojnë dallimet dhe ku nxënësit mësojnë bashkë, ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm për mësim dhe trajnim profesional, programe të reja moderne mësimore, investimi në shkencë dhe inovacion, si dhe mësues e profesorë të kënaqur me rritje permanente të rrogave duke e nisur me rritjen mbi 21% nga janari i vitit të ardhshëm janë themelet e qasjes vijuese të Bashkimit Demokratik për Integrim.

Gjithashtu, Delegatët e Kongresit të katërt zgjedhor të Bashkimit Demokratik për Integrim angazhohen për ndërtimin e politikave që synojnë rumbullakimin e infrastrukturës shoqërore dhe përafrimin e standardeve jetësore me ato të vendeve të Bashkimit Evropian për të mundësuar jetesë me më pak ngarkesë (stres), që do të ndikojë në shëndetin mendor individual dhe shoqëror, do të mundësojë kushte më të mira sociale për ndërtimin e familjes dhe kohën e kaluar me familjen si dhe përfundimisht do të përafrojë cilësinë dhe jetëgjatësinë e qytetarëve tanë me ata të vendeve të perëndimit.

Shëndeti në përgjithësi është ndërlidhur me mirëqenien emotive, shoqërore dhe psikologjike, andaj politikat tona do të përqendrohen në përmirësimin e shëndetit fizik dhe mendor të individëve dhe të shoqërisë në përgjithësi nëpërmjet të promovimit të mirëqenies, jetesës cilësore, parandalimit të çrregullimeve, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kujdesin ndaj njerëzve dhe familjeve.

Shëndeti i qytetarëve dhe shërbimi cilësor shëndetësor është i patjetërsueshëm, prandaj dhe angazhohemi për një sistem funksional shëndetësor në harmoni me punonjës shëndetësor të motivuar dhe të trajnuar, me infrastrukturë të mirëmbajtur dhe të furnizuar me teknologji dhe ilaçe të besueshme dhe moderne, të përkrahura me buxhet adekuat, planifikim të fuqishëm shëndetësor dhe politika të praktikës së konfirmuar. Avancim të sistemit të sigurimit shëndetësor të plotësuar me komponentin e sigurimit shëndetësor vullnetar (krahas sigurimit të detyrueshëm) me qëllim të zgjerimit të gamës të shërbimeve shëndetësore dhe ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Kongresi gjithashtu thekson përparësinë dhe përkushtimin absolut të përpjekjeve për të garantuar një mjedis të shëndosh për qytetarët dhe shoqërinë në përgjithësi sepse e drejta për ajër dhe ambient të pastër është e drejtë njerëzore.

Delegatët e Kongresit të katërt të Bashkimit Demokratik për Integrim, konsiderojnë që mbrojtja e mjedisit jetësor dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm

i tij paraqet një detyrë të përbashkët për të gjithë, institucionet qendrore e lokale, qytetarët, organizatat joqeveritare, si dhe veprimtarët ekonomik, por njëkohësisht, nxisin institucionet kompetente që të përshpejtojnë projektin e gasifikimit, por edhe nxitjen e përdorimit të energjisë diellore, ujore dhe natyrore si dhe dhënien përparësi të ecjes, çiklizmit, transportit publik dhe subvencionimin e veturave elektrike, por edhe kontrollë të rrepta në djegien e elementeve ndotëse në ambiente publike dhe private si dhe krijimin e hapësirave të gjelbra në qytete për ta ndihmuar largimin e disa ndotësve. Synojmë zero emision të karbonit.

Kongresi përcakton objektivin e ndërtimit të administratës efikase dhe në shërbim të plotë të qytetarit nëpërmjet të forcimit të stabilitetit dhe parashikueshmërisë së institucioneve të cilat duhet të jenë mjaftueshëm fleksibile për t'u përputhur me sfidat shoqërore, të hapura për qytetarët, të gatshme për të përqaftuar mënyra moderne të veprimit dhe të mundësojnë shërbime më të mira.

Duke qenë të përputhshëm me të sotmen dhe të përgatitur për të nesërmen si dhe të vetëdijshëm që teknologjia informative, qeverisja dhe normat shoqërore ndikojnë cilësinë e jetesës, Delegatët e Kongresit të katërt të BDI-së, konsiderojnë që projektimi i e-shtetit për një e-shoqëri nëpërmjet të Digjitalizimit të të gjitha shërbimeve bazë është domosdoshmëri dhe nevojë e kohës.

Rrumbullakimi i infrastrukturës kulturore dhe arsimore si dhe shpërblimi i merituar janë parakushte për zhvillimin e artit dhe nxitjen e kreativitetit të artistëve, ndërsa mbështetja institucionale e përcaktuar në këtë Kongres nuk do të mungojë.

Përkujdesja për barazi sociale, familjet në nevojë, mbështetja e vazhdueshme financiare për fëmijën e tretë dhe rastet sociale, rritja dhe garantimi i pensioneve, përkujdesja cilësore në çerdhe moderne, përfshirja dhe ndarja meritore e ndihmesës sociale janë synime tona programore.

Vetëqeverisja lokale, si detyrim që rrjedh nga Marrëveshja e Ohrit, vijon të mbetet prioritet i jonë në drejtim të krijimit të njësive lokale më të fuqishme ekonomike, me orientim zhvillimor dhe inkluziv të vetëqeverisjes lokale drejt fuqizimit dhe aftëzimit të komunave që të sigurojnë një rritje dhe zhvillim gjithëpërfshirës, inovativ dhe të qëndrueshëm lokal në rajonin në të cilin veprojnë.

Në vijë me përcaktimet tona, Kongresi nënvijëzon rëndësinë e shanseve dhe mundësive të barabarta dhe angazhohet për përfaqësim të rritur, të drejtë dhe adekuat gjinor dhe moshor si parim esencial për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe drejtësisë sociale të vërtetë për të gjithë.

Gjithashtu, Kongresi angazhohet për tejkalim të asimetrisë perceptivë gjinore, që përveç diskriminimit në shanse dhe mundësi, rezulton edhe në dhunë fizike, verbale ose psikologjike, por edhe në abuzim. Padrejtësitë gjinore në barazinë e të ardhurave si dhe baraspeshës midis punës dhe jetës zgjidhen me politika që mundësojnë balancën midis punës dhe jetës familjare për të tejkaluar padrejtësitë gjinore.

Për të siguruar integritetin individual dhe kolektiv në kohë të vërshimit të pakontrolluar dhe të qëllimshëm të propagandës, shpifjeve dhe lajmeve të rreme, Kongresi riafirmon vendimin e Kryesisë dhe të Këshillit të Përgjithshëm të Bashkimit Demokratik për Integrim për veting, por edhe për transparencë dhe hetim të plotë institucional të të gjithë funksionarëve.

Përfundimisht, Kongresi i katërt zgjedhor i Bashkimit Demokratik për Integrim i inkorporon ndryshoret e paracaktuara nga Kombet e Bashkuara për të përkrahur mirëqenien individuale dhe shoqërore siç janë: të ardhurat, jetëgjatësia e shëndetshme, mbështetja sociale, liria, besimi dhe zemërgjerësia, si dhe perceptimi i korrupsionit dhe cilësia e institucioneve si udhërrëfytes për prioritetet tona programore.

## #5 RINIA NË VEND TË PARË

# Rini e përfshirë

# Rini e përfaqësuar

# Rinia prioritet

# Rini vendimmarrëse

# Ulja e papunësisë rinore dhe pavarësim ekonomik



Delegatët e kongresit të katërt zgjedhor të Bashkimit Demokratik për Integrim vlerësojnë që zbatimi i integritit konsensual që mundëson barazinë dhe një vend, rajon dhe kontinent të integruar, realizimi i vetingut dhe sundimi jo-selektiv i ligjit, të përcjella me ndërtimin e standardeve evropiane për jetesë cilësore që do të adresojnë çështjet e jetesës moderne nëpërmjet të krijimit të kushteve të përafërta me vendet anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe krijimi dhe garantimi i vendeve të reja të punës, përafrojnë standardet jetësore të vendit tonë me ato të vendeve të zhvilluara dhe paraqesin parakusht që rinia të gjen të ardhmen e vet në vend të vet si dhe për rikthimin e theksuar të qytetarëve të cilët përkohësisht jetojnë jashtë.

Ky Kongres përcakton rininë si prioritet absolut të veprimtarisë vijuese të Bashkimit Demokratik për Integrim duke i dhënë përparësi dhe hapësirë në ndërtimin dhe zbatimin e të gjitha politikave partiake dhe institucionale, si dhe duke e mbështetur në punësim dhe sipërmarrje rinore.

Duke vlerësuar miratimin e Strategjisë Shtetërore për të rinjtë si dhe masat tjera ekzekutive dhe legjislative, Delegatët e Kongresit shprehin vendosmërinë dhe përkushtimin për zgjidhje efektive të sfidave me të cilat ballafaqohen të rinjtë, në veçanti në përfshirjen e tyre në tregun e punës.

Delegatët e Bashkimit Demokratik për Integrim dhe organet partiake të dala nga ky Kongres do të punojnë me të gjithë të rinjtë në përpjekjet e tyre për t'u zhvilluar në të rritur produktiv, duke u fokusuar në përforsimin etributeve pozitive që mundësojnë përgatitje të plotë rinore për përballje me shkollën, punën dhe jetën.

Duke pasur perspektivën rinore të parën, Organizata jonë vihet në shërbim të tërësishtëm për të shërbyer si platformë për çdo të ri që të zhvillohet me potencial të plotë, tërësishtë të përfshirë, të shëndoshë dhe absolutisht të përgatitur për ballafaqim me jetën.

Kongresi thekson nevojën e fuqizimit të të rinjve nëpërmjet të përfshirjes së tyre në përgatitjen, zbatimin por edhe vlerësimin e veprimeve të përbashkëta. Pjesëmarrja nëpërmjet mbikëqyrjes në vend të ndihmesës mundëson zhvillimin e përvojave të nevojshme për t'u pavarësuar dhe këtë pjesëmarrje aktive do ta lehtësojmë dhe promovojmë.

Të rinjtë duhet të përfshirë dhe t'u jepet mundësia reale për pjesëmarrje në të gjitha programet dhe veprimet për rini, por edhe në politikën në përgjithësi duke dizajnuar programe më specifike që garantojnë përkrahje financiare, qëndrueshmëri dhe vazhdimësi.

Delegatët e Kongresit tonë të katërt zgjedhor theksojnë rëndësinë e arsimimit joformal që nga vitet e hershme për të mundësuar pjesëmarrjen dhe integrimin e rinisë. Zhvillimi i afiniteteve personale dhe shoqërore nëpërmjet të aktiviteteve si teknologjia e reja, sporti, kultura dhe të tjera janë të domosdoshme për një rini të shëndoshë.

Gjithashtu, mobiliteti është mjet kyç në fuqizimin e rinisë dhe integrimin shoqëror. Inkurajojmë lidhjet rinore në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar si dhe shkëmbimin e përvojave më të mira nga vendet dhe praktikën përkatëse.

Frymëzimi i udhëzimeve profesionale në sistemin arsimor është element i rëndësishëm në përfshirjen shoqërore, prandaj dhe vlera e arsimit të dyfishtë duhet të theksohet duke nënvizuar nevojën për të rinj të kualifikuar në tregun e punës që ndikon edhe në zhvillimin ekonomik.

Kongresi nxit integrimin e të rinjve në shoqëri dhe fton rininë për pjesëmarrje aktive në politikë nëpërmjet plotësimit të nevojave fillestare të tyre si partnerë të barabartë.

Bashkimi Demokratik për Integrim vihet në shërbim të plotë të rinisë dhe vë në dispozicion të gjitha asetet e veta organizative për të garantuar përfshirje të rinisë dhe ndërtim të politikave që mundësojnë të ardhme të mirëqenë për rininë e sotme dhe të nesërme.

**KOHA PËR  
KRYEMINISTRIN  
E PARË SHQIPTAR**



**ZOTIMET TONA**



## #1 INTEGRIM KONSENSUAL



- # Integrimi vendor
- # Integrimi rajonal
- # Integrimi në NATO
- # Integrimi në Bashkimin Evropian
- # Demokracia konsensuale

### Integrimi vendor

Konsensualiteti është forma më e përshtatshme për të funksionuar një shtet shumetnik ku të gjithë qytetarët do mund të i ndejnë në mënyrë të barabartë vlerat e demokracisë. Gjithashtu, konsensualiteti paraqet një shkallë të lartë të demokracisë, ku secili përfaqësues mban përgjegjësi në vendimmarrje dhe njëherazi përjashtohet mundësia e majorizimit dhe ekskluzivitetit, por promovohet pjesëmarrja dhe gjithë-përfshirja. Rrjedhimisht, zotohemi për të promovuar: shtet shumetnik dhe shoqëri të barabartë qytetare, vendimmarrje konsensuale, bashkëqeverisje dhe bashkëpërgjegjësi.

### Shtet shumetnik

Bashkimi Demokratik për Integrim e sheh Republikën e Maqedonisë së Veriut si shtet shumetnik ku bashkësitë janë bashkëthemelues dhe bashkëpërgjegjës për të sotmen dhe të ardhmen e këtij vendi. Ardhmëria e sigurt demokratike e këtij shteti duhet të kërkohet në rrualtjen dhe avancimin e 5 (pesë) shtyllave mbi të cilën bazohet shteti shumetnik, e ata janë: legjitimiteti, sundimi i ligjit, ndarja e pushtetit, vetëqeverisja dhe demokracia.

**Legjitimiteti.** që do ti merr parasysh dallimet kulturore, ndjenja për atdhe të përbashkët të shtetit shumetnik që do ti respektojë lojalitetin e shumëfishtë të komuniteteve.

**Sundimi i ligjit.** ku do të sundohet me të drejta të barabarta kundrejt të drejtës për të qenë i barabartë, garantimi i lirisë në gjitha dimensionet e saja, si dhe të luftojë çdo lloj diskriminimi dhe padrejtësia në funksion të paqes por pa e dëmtuar lirinë individuale dhe kolektive të komuniteteve.

**Ndarja e pushtetit.** Asnjë komunitet vet, nuk ka monopol etnik mbi shtetin dhe pushtetin, populli shqiptar është i definuar si komb shtet-formues në kushtetutë me të drejta dhe përgjegjësi të barabarta, dhe pushteti ndahet në mes të komuniteteve në mënyrë të drejtë.

**Vetëqeverisja.** që garanton autonomi funksionale për shqiptarët lidhur me çështjet që janë me interes jetik për identitetin kombëtar e kulturor, decentralizim të pushtetit me qëllim të kultivimit të diverziteteve për të eliminuar etnizimin e politikës në nivel qendror.

**Demokracia.** me vetë-përcaktim të individit me vullnet të lirë si parakusht i demokracisë, vlerat e konsensusit dhe kompromisit të kultivohen si alternativë e idesë që fituesit i takojnë të gjitha.

## Shoqëri e qytetarëve të barabartë

Forcimi i komponentit qytetarë të barabartë në shtetin shumetnik të Republikës së Maqedonisë, rrjedh nga preambula e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, ku thuhet: “...Kjo marrëveshje kornizë do ta promovojë zhvillimin e qetë dhe harmonik të shoqërisë qytetare, duke respektuar njëkohësisht identitetin etnik dhe interesat e të gjithë qytetarëve të Maqedonisë.” BDI, është e bindur se një shtet shumetnik që identifikohet me një shoqëri të barabartë qytetare, do të ndihmojë në përsheptimin e rrugëtimit evropian. Një Maqedoni në NATO dhe BE është garancia më e fuqishme për stabilizimin e shtetit.

## Kohezion shoqëror

Pajtimi ndëretnik, mirëbesimi midis komuniteteve dhe kohezioni shoqëror do të krijojnë ambient të përshtatshëm për integrim, trajtim dhe mirëqenie të barabartë të të gjithë anëtarëve të shoqërisë duke luftuar përjashtimin dhe marginalizimin.

## Integrimi rajonal

### Fqinjësi e mirë dhe bashkëpunim rajonal

Maqedonia e Veriut, pas zgjidhjes të kontestit shumëvjeçar me Greqinë dhe Marrëveshjes për marrëdhënie të mira ndër-fqinjësore me Bullgarinë,

përfundimisht mbyll pikat kontestuese me fqinjët dhe mund të shërben si shembull i një shteti i cili nuk ka çështje të hapura me asnjë nga shtetet fqinje, arritje kjo e madhe dhe e rrallë – sidomos në Ballkan – që u përshëndet nga shumë shtete demokratike mbarë botës. BDI si parti bashkë-qeverisëse (me ndërprerje të shkurtër viteve 2006-08) dha kontribut të madh, në sinergji me partnerët e komunitetit dashamirës ndërkombëtar, në këtë arritje.

Kontributi i politikës parimore të Bashkimit Demokratik për Integrim është i pakontestueshëm dhe i dukshëm në transformimin e politikës shtetërore të viteve 1990-ta ndaj fqinjëve, nga ekuidistanca në politikë të cilën do ta emërtonim si equi-reapproachment; nga droja nga fqinjët dhe mosbesimi në politikë miqësore, të hapur dhe të sinqertë: në bashkëpunim, bashkëveprim dhe përkrahje njëri tjetrit sipas parimeve të politikës ndër-fqinjësore të BE-së, përcaktimit strategjik të të gjitha shteteve të rajonit. Mbledhje të përbashkëta të qeverisë të RMV-së me qeveri të shteteve fqinje, këmbim i mallrave pa probleme madhore, lëvizje e lirë e qytetarëve në rajon, programe dhe projekte bashkëpunimi ndërkufitar dhe rajonal, janë vetëm disa shembuj të kësaj politike. Thellimi i mëtejshmë i marrëdhënieve me fqinjët sipas parimeve dhe shembujve më të mira të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, si shtetet Skandinave apo ato të Beneluksit, është një nga synimet kryesore të partisë e cila integrimin e ka si pjesë të emrit.

## Shqiptarët për paqe dhe prosperitet në rajon

Integrimi rajonal i lartpërmendur sigurisht që rezultoi edhe në ngritje në shkallën maksimale të marrëdhënieve të RMV me Kosovën dhe Shqipërinë, prioritet i vetë-imponueshëm, natyral, i BDI-së. Përveç dobive që sjell politika e fqinjësisë së mire e BE-së nën ombrellën e sigurisë së NATO-s për të gjitha shtetet e rajonit, ky proces integruar i pakthyeshëm paraqet edhe vetë-integrimin kombëtar nëpërmjet integritit evropian, përkatësisht bashkon shqiptarët e rajonit në një hapësirë kulturore, ekonomike dhe të sigurisë. Arritja e integritit të shqiptarëve në strukturat euro-atlantike u bë, sa u përket shqiptarëve të RMV-së falë kontributit madhor të BDI-së që po kurorëzohet me anëtarësimin në NATO dhe në një të ardhme jo të largët edhe në BE. Lëvizja e lirë me vetëm letërnjoftim, në një të ardhme të afërt do të jetë pa kontroll kufitar, pa kufi. Lidhjet infrastrukturore – si ato rrugore, hekurudhore, e të tjera, janë duke u shtuar dita ditës për të arritur shkallën, kualitetin dhe dendësinë e rrjetit dhe lidhjeve ekzistuese në mes shteteve të zhvilluara të BE-së. Shqiptarët e lirë, secili në vendin e vet, me të drejta të barabarta dhe të garantuara, në këtë hapësirë, tanimë kanë dhe

do të kenë edhe më shumë mundësi - dhe kjo është fusha e veprimit prioritar të BDI-së – që të aplikojnë kapacitete të plota në ngritjen e mirëqenies individuale, kombëtare, të shteteve ku jetojnë si dhe të rajonit në përgjithësi.

Politika e jashtme e Bashkimit Demokratik për Integrim, në kontinuitet, qysh nga themelimi i partisë, bazohet ne parimet e fqinjësisë së mire, bashkëpunimit rajonal dhe integritit të shqiptarëve dhe të shtetit në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Partneriteti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si mike e dëshmuar e shqiptarëve dhe e shtetit, si përkrahëse e palëkundur e Maqedonisë së Veriut në kohë të turbullta të shtet-formimit dhe tranzicionit si dhe në rrugëtimin e shtetit drejt integritit në strukturat euro-atlantike, përfordhet edhe më shumë dita-ditës.

## Integrimi në NATO

### Anëtare në NATO

Përcaktimi tjetër strategjik gjatë themelimit të partisë në vitin 2002, anëtarësimi i RMV-së në NATO, sot është realitet. BDI gjatë tërë kohës të qenit pjesë e qeverisë – dhe duke e udhëhequr Ministrinë e Mbrojtjes gjatë një periudhe – ka punuar për plotësimin e kriterëve dhe detyrimeve për anëtarësim. Vazhdimisht, si në fushata zgjedhore, po ashtu edhe në Parlament dhe kudo, BDI ka theksuar rëndësinë e madhe, jetike, të NATO-s për Shqiptarët dhe vendin. Anëtarësimi në aleancën ushtarake më të fuqishme dhe më të suksesshme në historinë e njerëzimit, për një shtet të ri dhe ende të brishtë, të vendosur në një rajon ende të pa-konsoliduar – si ekonomikisht, politikisht ashtu edhe nga aspekti i sigurisë - ka një rëndësi të veçantë dhe jetike.

### Partneritet strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Pas rënies së komunizmit dhe fundit të të ashtuquajturës “botë bipolare” të dominuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës me aleatët e saj (në mes të cilëve shtetet e Evropës Perëndimore të rreshtuara në Bashkimin Evropian) dhe Bashkimit Sovjetik (bashkë me shtetet vartëse), për rreth dy dekada, patëm dominim të pakontestuar të ShBA-ve. Me ngritjen e Kinës, ri-fuqizimin e Ruisë, rritjen ekonomike të Turqisë, Brazilit, Indisë e shteteve tjera të mëdha, dita ditës po profilizohet bota multipolare.

Ballkani, historikisht, ka qenë, dhe mbetet, territor ku përplasen interesat e fuqive rajonale dhe botërore. Bashkimi Demokratik për Integrim, ashtu siç u përcaktua në themelimin e saj, (kur ShBA-të ishin të pakontestuara në çdo aspekt), për partneritet strategjik me ShBA-të, edhe sot, në rrethanat e reja të botës multipolare, por edhe në të ardhmen, angazhohet maksimalisht për ruajtjen dhe përforcimin e partneritetin me Shtetet e Bashkuara, shtetin mik të dëshmuar të Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe shqiptarëve kudo që janë.

## **Integrimi në Bashkimin Evropian**

### **Anëtare në Bashkimin Evropian**

Bashkimi Demokratik për Integrim konsideron integrimin e plotë në Bashkimin Evropian si alternativë e vetme për RMV-në, si një ndër prioritetet kryesore të veprimit politik qysh nga themelimi i partisë, dëshmuar me kontributin e jashtëzakonshëm të dhënë duke udhëhequr me organe shtetërore kyçe e përgjegjëse si në qeveri po ashtu edhe në Parlament. BDI konsideron se nuk ka alternative tjetër për RMV-në jashtë BE-së. Vetë rrugëtimi drejt anëtarësismit të plotë, sado që i gjatë dhe i mundimshëm, mundëson demokratizim të shoqërisë dhe të shtetit.

Bashkimi Demokratik për Integrim do të bën përpjekjet maksimale, me të gjitha kapacitetet a saja, që të gjitha kriteret e *acquis communautaire* të plotësohen dhe jetësohen në tërësi. Angazhimi ynë në këtë drejtim, nuk do të trajtohet si detyrim i imponuar por si veprim i arsyeshëm për të gjitha dobitë që do të kenë qytetarët me zbatimin e normave dhe standardeve të BE-së në çdo lëmi, norma dhe standarde këto, më të larta në tërë botën. Arritja e nivelit demokratik dhe civilizues të shteteve të Bashkimit Evropian është prioritet i angazhimit tonë maksimal në afat të mesëm dhe të gjatë.

### **Marrëdhëniet ndërkombëtare**

BDI angazhohet për etablim dhe avancim të marrëdhënieve me të gjitha shtetet që respektojnë parimet themelore të marrëdhënieve bilaterale. Marrëdhëniet e vendosura në këto themele, sjellin vetëm përfitime për shtetin tonë dhe shtetin përkatës, qofshin ata ekonomike, kulturore, sportive apo të një natyre tjetër. Bashkimi Demokratik për Integrim konsideron se Marrëveshja e Prespës si dhe Marrëveshja për marrëdhënie të mira ndër-

fqinjësore me Bullgarinë janë të arritura të jashtëzakonshme në funksion të integritit konsensual dhe do të qëndrojnë si garanci që nga këto marrëveshje kthim prapa nuk mund të ketë. Bashkimi Demokratik për Integrim do t'i kundërvihet me vendosmëri çfarëdo përpjekjeje, të çfarëdo natyre qoftë, për ndërhyrje të padëshiruar në punët e brendshme të shtetit tonë. Do të punojmë, bashkë me partnerët tanë ndërkombëtarë, në parandalimin dhe eliminim e rreziqeve nga terrorizmi dhe kanosjet moderne asimetrike, si p.sh. sajber-terrorizmi dhe format tjera të përhapura nëpërmjet internetit. Në botën e sotme të globalizuar, problemet dhe kanosjet tejkalojnë kufijtë dhe rrjedhimisht, nuk mund të zgjidhen pa bashkëpunim, koordinim dhe ndërveprim në rrafsh ndërkombëtar.

BDI, me potencialin e vet diplomatik, angazhohet për bashkëpunim maksimal të mundshëm të shteteve dhe faktorëve tjerë ndërkombëtar, në organizata multilaterale si dhe forume ad hoc shtetërore apo joqeveritare, për trajtim dhe gjetjen e zgjidhjeve të mundshme të sfidave madhore kanosëse për njerëzimin.

## Demokraci konsensuale

### Vendimmarrje konsensuale

Konsensualiteti dhe përfaqësimi i drejtë dhe i barabartë në vendimmarrje është parakusht për funksionim stabil të vendit dhe qeverisje të mirë në një demokraci funksionale. Ne vlerësojmë se demokracia konsensuale është në përputhje të plotë me instrumentin e shumicës së dyfishtë që e parandalon majorizimin dhe mbivotimin, si dhe komplementare me aprovimin e politikave me konsensus midis dy komuniteteve më të mëdha në vend.

**Kryetari i shtetit.** Me qëllim që vendi të përforcojë kapacitetin demokratik, posti i kryetarit të shtetit duhet të jetë një institucion integruar. Kjo nënkupton sistem zgjedhor për zgjedhjen e Kryetarit të shtetit që do të motivojë dhe promovojë paraqitjen e kandidatëve për këtë post që kanë vlera dhe kapacitete integruar në mes të komuniteteve. Gjithashtu, modele dhe praktika të ndryshme do të shqyrtohen, siç janë: Kandidat i përbashkët (konsensual), Kryetar shteti me nënkryetar, që vijnë nga dy bashkësi të ndryshme etnike; Kryetar i zgjedhur në parlament me dy shumica; etj.

**Kuvendi.** Me qëllim të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve dhe thellimit të vendimmarrjes konsensuale, do të angazhohemi në rritjen

e efikasitetit dhe instalimin e mekanizmave përkatës për avancim të marrëdhënieve ndëretnike në organet e Kuvendit, duke filluar na Kryetari i Kuvendit, Komiteti për marrëdhënie ndëretnike dhe të tjera.

**Qeveria.** Me qëllim të avancimit të funksionimit të Qeverisë me pushtet më të balancuar mbi baza etnike dhe zgjerimit të konsensualitetit, do të angazhohemi për ngritjen e institucioneve dhe mekanizmave që do të sigurojnë konsensus në vendimmarrje dhe politikat qeveritare.

## **Bashkëqeverisje dhe bashkëpërgjegjësi**

**Politikat konsensuale.** Çështjet për të cilët do të kërkohet vendimmarrje me konsensus në pushtetin ekzekutiv dhe atë ligjvënës janë ato që kanë të bëjnë me çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndëretnike, integrimet euro-atlantike por edhe çështje që kanë të bëjnë me integrimin rajonal, fqinjësia e mirë, financat publike në nivel qendror dhe lokal.

**Siguria kombëtare.** Nisur nga eksperiencia e deritanishme e funksionimit të shtetit akoma ekziston mosbesim mbi baza etnike në veprimin e disa drejtorive dhe agjencive të sigurisë dhe inteligjencës. Me qëllim të rritjes së mirëbesimit në pushtetin dhe institucionet e rendit, shërbimeve sekrete dhe me interes shtetërorë do të insistojmë që në këto institucione të integrohen profesionistë dhe të reflektohet përfaqësimi i drejtë dhe adekuat si në numër ashtu edhe në pozicionet udhëheqëse.

## #2 VETING

- Vetingu si politikë dhe instrument
- Shtet i së drejtës
- Luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar
- Mbrojtja, rendi dhe siguria
- Qeverisje e mire
- Shoqëri Digjitale



### Vetingu si politikë dhe instrument

#### Veting

Politika më e sigurt për të për të adresuar drejtësinë selektive, parashikueshmërinë ligjore, sundimin e së drejtës dhe të ligjit në përgjithësi. Ligji duhet të jetë i njëjtë dhe i drejtë për çdo qytetar. Autoriteti dhe ndikimi i ligjit në shoqëri varet nga qasja e drejtë dhe jo-selektive e zbatuesit dhe ushtruesit të këtij autoriteti sepse liria në një shoqëri demokratike nënkupton nënshtrim ndaj ligjeve të cilat janë të zbatueshme tek çdo qytetar dhe e përcjellë me të drejtën e pacenuar individuale ndaj kufizimeve dhe ndalesave të lirisë. Sundimi i ligjit nënkupton nënshtrim ndaj ligjit edhe të ligjvënësit, edhe të ligj-zbatuesit edhe të gjykatësit dhe prokurorit dhe paraqet parakusht absolut për barazi, por edhe për zhvillim ekonomik dhe kushte të barabarta për zhvillim të biznesit.

Bashkimit Demokratik për Integrim do të imponon Vetingun si politikë që nënkupton kontrollin e dyfishtë të gjithsecilit që merr rolin e shërbyesit publik, çdo politikani, prokurori dhe gjykatësi në vend sepse integriteti i individit udhëheqës dhe i institucionit që udhëheq janë baza e një shoqërie të shëndoshë.

Kontrulli i parë siguron integritet dhe transparencë maksimale të secilit pretendent dhe ushtrues detyre publike duke mbledhur, analizuar dhe botuar të gjitha informacionet dhe të dhënat për secilin pretendent dhe bartës aktual të funksionit publik në mënyrë që qytetarët ose organi që e propozon, zgjedh apo emëron bartësin e funksionit, të vlerësojë integritetin



dhe dinjitetin e bartësit ose kandidatit duke ulur mundësinë për korrupsion, krim, keqpërdorim të detyrës dhe rrënim të autoritetit dhe imazhit të institucionit.

Kontrulli i dytë nënkupton zbatimin e vetingut nëpërmjet të marrjes së masave institucionale pas konstatimit të parregullsive, mospërputhjes midis të ardhurave dhe pronës si dhe diskrepancave në karrierë gjatë kontrollit të parë ndaj kandidatëve dhe bartësve të funksioneve publike, prokurorëve dhe gjykatësve.

Rrjedhimisht, prioriteti në qeverisjen vijuese do të jetë mbi përmbushjen e detyrimeve nga kapitujt 23 dhe 24 të Acquis që përfshijnë gjyqësorin dhe të drejtat themelore, drejtësinë, lirinë dhe sigurinë, si dhe në implementimin e rekomandimeve e grupit të ekspertëve të lartë mbi çështjet sistemore të sundimit të ligjit të drejtuar nga Rajnhard Pribe në lidhje me mediet, zgjedhjet, gjykatat dhe prokurorinë, avokatin e popullit dhe ndjekjen e komunikimeve.

Bashkimi Demokratik për Integrim do të insiston që institucionet gjyqësore të rishqyrtojnë dhe përkrahjen ndërkombëtare për rastet e kontestuara seriozisht në opinion që kanë dëmtuar rëndë besueshmërinë e gjyqësorit duke konstatuar zbatimin e drejtësisë selektive që destabilizon shoqërinë dhe pamundëson barazinë.

## Transparencë

Duke pasur parasysh rëndësinë e transparencës në sistemin gjyqësor, si mënyrë për të promovuar llogaridhënien, luftën kundër korrupsionit dhe eliminimin e arbitraritetit, do të insistojmë në arritjen e transparencës së plotë me qëllim të fitimit të besimit të qytetarëve në sistemin juridik. Do të promovohen praktikat për e-drejtësi dhe publikim i statistikave gjyqësore. Gjegjesisht, do të inkorporojmë sistem më të avancuar elektronik në të gjitha sferat e drejtësisë. Sigurimi i një infrastrukture të sofistikuar dhe trajnimi i gjykatësve dhe personelit ndihmës, për të zbatuar sistemin elektronik, do të jetë i vazhdueshëm. Ky sistem efikas do të implementohet që nga dorëzimi i shkresave dhe parashtrësive, e deri tek shpërndarja e lëndëve, duke përjashtuar keqpërdorimet dhe lidhshmërinë e palëve me gjykatësit.

Sistemi elektronik do të ndikojë edhe në rritjen e transparencës gjyqësore, duke mundësuar jo vetëm ndjekje të seancave nga largësia/distanca, por edhe mundësi që palët, në çdo moment të kenë qasje në vendime gjyqësore të shpallura dhe publikuara në ueb faqet e gjykatave. Publikimi i statistikave

gjyqësore do të bëjë të mundur mbikëqyrjen e performancës, identifikimin e arritjeve, detektimin e problemeve dhe definimin e strategjive për zgjidhjen e tyre.

## Integritet

Veting profesional dhe i drejtë me institucione do të garantojë integritet më të lartë të personave në detyrë me përgjegjësi publike dhe njëherit do të përforcojë besueshmërinë e qytetarëve të institucionet shtetërore dhe publike.

## Shtet i së drejtës

Zhvillimi i një shteti është i lidhur me parimin e sundimit të së drejtës. Kthimi i besimit në institucionet kërkon qasje serioze në zbatimin e reformave në drejtësi. Pa reforma të mirëfillta, nuk ka siguri juridike për qytetarët e as zhvillim ekonomik, por njëkohësisht as mundësi për integrim në Bashkimin Evropian. Qëllimi duhet të jetë etablimi i sundimit të së drejtës, mbi bazën e së cilës duhet të rregullohen raportet midis tre pushteteve, duke respektuar integritetin dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Kjo mund të arrihet jo vetëm duke harmonizuar dhe inkorporuar standarde më të avancuara bashkëkohore në sistemin juridik, por edhe duke respektuar dhe zbatuar në praktikë. E gjithë kjo kërkon angazhim dhe vetëdijesim të të gjithëve.

Shteti i së drejtës do të jetë funksional në një sistemi juridik objektiv, efikas dhe transparent, në të cilën do të besonin të gjithë. Qytetarët, konsumatorët dhe bizneset duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre brenda kornizave të përcaktuara juridiko normative. Kjo kërkon respektimin e plotë të sundimit të ligjit, të të drejtave themelore dhe të pavarësisë së gjyqësorit. krijimin e kushteve për gjyqësor të pavarur, të de-partizuar dhe efikas me qëllim drejtësi të jetë e arritshme për të gjithë pa marrë parasysh përkatësia etnike, fetare apo politike. Pa dyshim shumë me rëndësi në këtë drejtim është edhe unifikimi i praktikës gjyqësore. Mbi gjitha, konsiderojmë se është momenti i fillimit të riorganizimit të ri të gjyqësorit si në aspekt të kompetencave reale ashtu edhe kompetencave territoriale.

Bashkimi Demokratik për Integrim do të angazhohet për fushatë me qëllim vetëdijesimit të qytetarëve dhe pjesëmarrësve tjerë në sistemin e drejtësisë, transparencë midis institucioneve në sektorin e drejtësisë, rritja e numrit të

anëtarëve në luftë kundër korrupsionit, dhe në përgjithësi ndërgjegjësimin publik. Roli i shoqatave të ndryshme (përfitues të grandeve të ndryshme) është i pashmangshëm në realizimin e këtyre aktiviteteve.

## **Drejtësi jo-selektive dhe profesionalizëm në gjyqësor dhe prokurori**

Gjyqësor i pavarur dhe efikas, transparent dhe me besueshmëri në opinion e gjerë në vend dhe më gjerë, që do të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore, është një nga prioritetet e Bashkimit Demokratik për Integrim. Do të vazhdojmë të promovojmë këto kritere në funksionim të vazhdueshëm të gjyqësorit në Maqedoninë e Veriut. Pavarësia e gjyqësorit si parakusht për ruajtjen e shtetit të së drejtës dhe si garanci themelore për zhvillimin e procedurave gjyqësore të drejta të bazuara në fakte. Gjyqësori duhet të vendosë për çështjet, në përputhje me vlerësimin e paanshëm të fakteve pa ndikime direkte apo indirekte. Asnjë gjyqtar nuk mund të gjykojë siç duhet për shkak të frikës apo ndonjë përfitimi të pritshtëm. Ruajtja e pavarësisë së gjyqësorit është thelbësore për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e duhur të funksioneve të tij në një shoqëri të lirë duke respektuar shtetin e të drejtës. Pavarësia e gjyqësorit dhe e gjyqtarëve duhet të garantohet nga shteti.

**Zbatimit i sistemit elektronik.** Sistemi elektronik është një nga arritjet pozitive të gjyqësorit tonë. Si sistem i automatizuar mundëson shpërndarjen e lëndëve në gjykata, nga zbatimi i drejtë i së cilës ndikohet në paanshmërinë së gjyqësorit. Prandaj sigurimi i masave mbikëqyrëse për zbatim të drejtë janë të domosdoshme.

**Përforcim të kapaciteteve kadrovike.** Do të vazhdojmë të sigurojmë masa adekuate për përforcimin e kapaciteteve kadrovike në bazë të kritereve të përcaktuara ligjore të pavarura dhe profesionale që në momentin e pranimit të kandidatëve në akademinë e gjykatësve, përfundimin e akademisë, e deri në zgjedhjen e tyre si gjykatës ose prokuror. Përforcimi i kushteve në veçanti kushteve profesionale për anëtarë të Këshillit gjyqësor dhe Këshillit të prokurorëve. Rritja dhe përforcimi i monitorimit të gjyqësorit dhe krijimit të një sistemi efikas në lidhje me përgjegjësinë e gjykatësve në bazë të parimit të transparencës dhe efikasitetit. Përforcimi dhe avancimi i gjykatësve mbi bazën e sistemit merit, por gjithnjë duke zbatuar obligimin kushtetues për përfaqësim të drejtë dhe adekuat. Trajnimin e vazhdueshëm të tyre. Jemi për avokaturë, noteri dhe përmbarim cilësor. Profesionalizmi duhet të jetë kriter për vlerësimin e tyre në treg, e jo barrierat administrative.

Qëllimi kryesor është të përforcohen dhoma e avokatëve dhe institucionet tjera juridike-private duke përfshirë këtu edhe noterët dhe përmbaruesit, për të realizuar rolet e veta në një sistem juridik që respekton sundimin e së drejtës dhe të drejtën procedurale.

**Zgjidhje alternative të kontesteve.** Bashkimi Demokratik për Integrim do të angazhohet në promovimin e masave të ndryshme të cilat ndihmojnë zgjidhjeve jashtëgjyqësore të kontesteve. Në këtë drejtim do të zhvillohen mekanizma për zgjidhje alternative të kontesteve si ndërmjetësimi dhe arbitrazhi. Instituti i ndërmjetësimit jo vetëm që do të jetë i obligueshëm, por do të përcaktohen kriteret profesionale për të fituar licencë për ndërmjetës (mediator), me qëllim që të ndikohet në rritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit të ndërmjetësve (mediatorëve). Arbitrazhit duhet siguruar vendin adekuat në sistemin juridik.

**Zbatim i duhur i kornizës ligjore.** Në çdo raport të Komisionit Evropian për progresin e vendit, theksohet nevoja për zbatim të duhur të ligjeve të cilat janë në sistem. Ne do të angazhohemi në ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kornizës ligjore, por do të promovojmë edhe masat për ndëshkim në të kundërt.

**Bashkëpunimi ndërkombëtar.** Bashkimi Demokratik për integrim do të vazhdojë të angazhohet për zhvillim të bashkëpunimit ndërkombëtar, jo vetëm me fqinjët por edhe më gjerë. Qëllim kryesor është që në rajon të mos ketë barriera juridike për pengim apo ngadalësim të qarkullimit të lirë. Gjithashtu, do të vazhdojë harmonizimi i sistemit juridik me burimet juridike të së drejtës evropiane, si dhe lidhja dhe ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.

## Të drejtat dhe liritë e njeriut

Bashkimi Demokratik për Integrim do të angazhohet për sistem efikas dhe kualitativ për mbrojtjen e të drejtave dhe liritë të njeriut. Në këtë drejtim ne do të angazhohemi që institucioni kombëtar për të drejtat e njeriut të ketë kompetencë të promovojë, parandalojë dhe mbrojë të drejtat dhe liritë e njeriut.

## Luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Lufta kundër korrupsionit kërkon përpjekje sistematike dhe angazhim të plotë nga të gjithë dhe një qasje që adreson edhe parandalimin e këtij fenomeni. Në fokus të Bashkimit Demokratik për Integrim do të jetë konsolidimi i sistemit të drejtësisë në funksion të sigurisë juridike, pavarësisë, profesionalizmit, paanshmërisë, përgjegjshmërisë, efikasitetit dhe transparencës që do të mundësojë trajtimin e barabartë të gjithsecilit para ligjit dhe si rrjedhojë do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës.

### Zero korrupsion

Askush nuk mund të nxjerrë përfitim nga veprimi i tij/saj kriminal (nullum codum capare potest de sua propria iniuria). Do të ndërmarrim aktivitete për perfeksionimin e sistemit të konfiskimit të produkteve të veprave penale.

### Institucionalizim i vetingut

Miratimi i Ligjit për veting dhe themelimi i agjencisë së pavarur për zbatimin e vetingut duke përfshirë rolin për parandalim dhe kontroll të korrupsionit, me qëllim të rritjes së besueshmërisë së posteve dhe detyrave publike.

### Përforcim i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit

Bashkimi Demokratik për Integrim përkrah sjelljen e një strategjie kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konflikteve të interesit për të promovuar jo vetëm politikatat parandaluese por edhe ndëshkuese.

### Inkurajim për denoncime të rasteve

Miratuar Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve i cili parasheh raportimin e mbrojtur në institucionet e sektorit publik dhe privat, mbrojtjen e denoncuesve, përcakton procedurën e raportimit të mbrojtur të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe obligimet dhe detyrat e institucioneve dhe të personave juridik, në lidhje me raportimin e mbrojtur dhe sigurimin e mbrojtjes së denoncuesit.

## Mbrojtja, rendi dhe siguria

Mbrojtja, rendi dhe siguria që institucionet shtetërore iu ofrojnë qytetarëve të vendit janë një ndër faktorët kryesorë të mirëqenies së tyre në çdo shoqëri. Qeverisja demokratike e bazuar në sundimin e së drejtës, në interes të lirive dhe të drejtave të njeriut si kategori kushtetuese, kërkon që institucionet në vazhdimësi të punojnë në respektimin dhe zbatimin e ligjit, në mënyrë që çdo qytetar të ndihet i sigurt në ambientet ku jeton dhe vepron. Vazhdon përkushtimi për ngritjen e profesionalizmit dhe de-politizimin e strukturave të rendit, mbrojtjes dhe sigurisë.

### Mbrojtja nga kërcënimet globale

Kërcënimet globale paraqiten si sfidë dhe rrezik i kohës moderne. Përforsim i bashkëpunimit ndërshtetëror në luftën e përbashkët ndaj terrorizmit global. Inkuadrim në iniciativa rajonale dhe avancim i bashkëpunimit ndërkombëtar policor. Mbështetje e misioneve të përbashkëta paqeruajtëse me vendet aleate. Rritja e resurseve për ballafaqim efektiv dhe efikas nga krimi i organizuar. Avancim i bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje. Vazhdimi i menaxhimit të krizës së emigrantëve.

### Përmirësimi i rendit dhe qetësisë publike

Imperativ i sigurisë dhe mirëqenies së individit. Përforsim i legjislatives dhe zbatimi i praktikave më të mira. Puna policore në komunitet. Ngritja e nivelit të sigurisë së komunikacionit rrugorë. Ngritja e sigurisë në transportin publik. Ngritja e vetëdijes kundër përdorimit të armëve dhe mjeteve të ndryshme shpërthyes.

### Mbikëqyrje dhe kontroll efikas të zbatimit të ligjit

Sigurimi i kornizës së nevojshme institucionale dhe ligjore. Ngritje e mekanizmave të jashtëm institucional për mbikëqyrje dhe kontroll. Vullnet i palëkundur politik për parandalim dhe sanksionim të sjelljeve korruptuese. Promovim të politikave parandaluese dhe sanksionuese. Inkurajim për denoncim të rasteve.

## Qeverisje e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton mënyrën më të preferuar si institucionet publike udhëheqin me çështjet publike dhe menaxhojnë resurset publike. Qeverisja është procesi i vendimmarrjes dhe procesi me të cilin vendimet zbatohen, ndaj qeverisja e mirë do të përfshijë: qeverisje të përgjegjshme, administrate efikase dhe profesionale, shoqëri digjitale, luftë kundër korrupsionit, media të lira dhe shoqëri civile aktive.

## Qeverisje e përgjegjshme

Qeverisja e përgjegjshme do të bazohet në vendosjen e standardeve dhe praktikave më të mira evropiane në aspektet që vijojnë: administratë profesionale dhe kompetente, efikase dhe efektive, pjesëmarrëse, legjitime, sundimi i ligjit, transparencë, përgjegjësi dhe llogaridhënie.

## Administratë efikase dhe profesionale

**Shërbime cilësore.** Ne jemi të përkushtuar për të marrë hapa reformash që do të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe subjektet afariste, siç janë digjitalizimi i administratës, thjeshtësimi, standardizimi i procedurave administrative, me çka do të rritet transparencja dhe efikasiteti i shërbimeve, si dhe do të mundësohet përsheptimit i proceseve duke promovuar 'një pikë të vetme për shërbime'.

**Efikasitet i institucioneve.** Optimizimi i organeve të administratës shtetërore, agjencive dhe shërbimeve të inspektimit nga qeveria qendrore dhe lokale. Ne do të punojmë në zhvillimin e një strukture koherente institucionale të organeve të shërbimit civil, agjencive dhe shërbimeve të inspektimit nga qeveria qendrore dhe lokale, me struktura të përcaktuara qartë të llogaridhënies.

**Profesionalizmi i administratës.** Trajnime adekuate profesionale, promovim në karrierë të bazuar në meritë dhe performancë, regjistër të nëpunësve shtetëror dhe rritje në nivel të të gjitha institucioneve shtetërore dhe publike duke përfshirë llogaridhënien dhe përgjegjësinë publike edhe për pozicionet udhëheqëse të administratës në vendimmarrjen e tyre për politikën me interes publik.

**Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat në administratë dhe struktura udhëheqëse.** Ndryshimi i Ligjit për nëpunës administrativ si dhe ndryshimi i Ligjit për të punësuarit në sektorin publik; Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për evidentim amë:

- Me ndryshimin e Ligjit për nëpunës administrativ dhe Ligjit për të punësuarit në sektorin publik do të përcaktohet parimi i përdorimit të gjuhës shqipe dhe alfabetit gjatë dhënies së provimit në Agjencinë për administratë, do të saktësohen kushtet për avancime si dhe përfaqësimi i drejtë dhe adekuat në çdo institucion shtetëror dhe publik të RMV-së, duke përfshirë këtu edhe pozitave udhëheqëse në institucione.
- Me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për evidentim amë do të mundësohet saktësimi i përkatësisë etnike, duke e shtuar kolonën e përkatësisë etnike gjatë marrjes së vërtetimit për nënshtetësi. Me këtë ndryshim do të parandalohet keqpërdorimi i përkatësisë etnike gjatë procesit të aplikimit në konkurse dhe vende pune të cilat janë të parapara për etnitete të ndryshme (maqedonas, shqiptar, turq, romë, etj).

## Shoqëri Digjitale

Zhvillimi i një shoqërie digjitale duhet të bazohet në njohuri dhe novacione, domethënë në një shoqëri ku të gjithë qytetarët do të kenë qasje të lehtë dhe të lirë në informacion dhe njohuri përmes infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe teknologjive Digjitale. Në këtë drejtim do të punojmë në zhvillimin e një shoqërie digjitale që do të japë udhëzime për krijimin e një ambienti të ri për zhvillimin e ekonomisë së re Digjitale. Zhvillimi i shoqërisë digjitale në vend do të bazohet në një partneritet midis sektorit qeveritar, sektorit civil, sektorit privat, operatorëve, pushtetit lokal dhe të gjithë të autorët tjerë që janë të përfshirë. Zhvillimi i shoqërisë digjitale do të përfshijë programet në arsim për të fituar njohuritë e digjitalizimit, promovim të e-përfshirjes, e-biznes, e-qeverisje, zhvillim të infrastrukturës së teknologjisë informatike të përshtatshme për shoqërinë digjitale, si dhe promovimi i të dhënave të hapura dhe mbrojtja nga krimi kibernetik.

## Edukim dhe zhvillimin e njohurive Digjitale

Në periudhën e ardhshme, ne do të përqendrohemi tek të rinjtë tanë dhe do t'i afrojmë sa më shumë mundësisë për të marrë arsim cilësor në fushën e teknologjive të reja informatike, t'ju ofrojmë hapësirë mu për këtë lloj arsimi



dhe të shpërndajmë njohurit globale me ato, që një ditë edhe ato të jenë të përfshirë dhe mirënjohës për rikonstruimin global në fushën e TIK-ut. Do të punojmë në zhvillimin e vetëdijesimit digjital, e cila do të sjellë deri te krijimi i një shoqërie inkluzive e bazuar në njohuri në të cilën teknologjitë informatike dhe të komunikimit janë baza për zhvillim të mëtutjeshëm. Në korniza të këtij prioriteti, edukimi dhe sistemi i trajnimeve dhe mësimi i vazhdueshëm janë gjëra kyçe në procesin e ndërtimit njohurive digjitale.

## Shërbimet Digjitale

**E-Përfshirja.** Ne do të punojmë në reduktimin e ndarjes digjitale dhe krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse të informacionit për të gjithë qytetarët, duke siguruar përdorim më të mirë dhe më cilësor të teknologjisë informatike në jetën e përditshme të qytetarëve, duke krijuar kushte më të lehta për qasje në dhe rritjen e shkathtësive të teknologjisë informatike te qytetarët.

**E-Biznesi.** Do të ndihmojmë dhe inkurajojmë kompanitë tona të teknologjisë informatike që të avancojnë njohuritë e tyre dhe të përfitojnë nga mundësitë në tregun global. Me rëndësi të madhe është që sektori ynë i biznesit të ndjekë trendet teknologjike dhe të ruajë konkurrencën e saj në tregun global.

**E-Qeverisja.** Përmes aplikimit të proceseve moderne informatike do të rrisim kapacitetet e administratës, do të thjeshtojmë proceset dhe procedurat dhe do të minimizojmë ndikimin e faktorit njerëzor në ofrimin e shërbimeve të qytetarëve dhe komunitetit të biznesit. Ne do të stimulojmë përdorimin e teknologjisë së TIK në të gjitha nivelet e administratës në mënyrë që të shkurtojmë kohën për ofrimin e shërbimeve, por gjithashtu të optimizojmë kostot e shpërndarjes së tyre.

## Infrastruktura dhe siguria digjitale

Ne do të punojmë në ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës digjitale në administratën publike, ndërtimin e sistemeve të Interoperabilitetit (ndërveprimi) të administratës publike dhe zbatimin e standardeve të njohura ndërkombëtarisht, qasjen në rrjetet ndërkombëtare digjitale, qasje të lehtë dhe të lirë për të gjithë qytetarët.

**Të dhënat e hapura (Open data).** Publikimi dhe përdorimi i të dhënave të hapura do të inkurajohet për të kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve shtetërore, përmirësimin e cilësisë

së shërbimeve që ato ofrojnë dhe në të njëjtën kohë nxitjen e inovacionit. Kështu, do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e shoqërisë në tërësi.

**Siguria kibernetike.** Ajo do të punojë për të forcuar kapacitetet kombëtare për të trajtuar kërcënimet kibernetike dhe për të përmirësuar sigurinë kibernetike në nivel kombëtar. Ne do të marrim masa për të zhvilluar një mjedis të sigurt dhe të sigurt, të mbështetur nga mjedise të cilësisë, të cilat bazohen në besimin dhe bashkëpunimin në fushën e sigurisë kibernetike.

### #3 ZHVILLIM DHE VENDE PUNE



- Rimëkëmbje ekonomike pas krizës së COVID19
- Ekonomi stabile dhe e fortë
- Drejtësi në politikën tatimore
- Siguri juridike, parashikueshmëri ligjore dhe institucione efikase
- Biznes i shkathët dhe konkurrues
- Kapital njerëzor cilësor
- Vende pune për të gjithë
- Ekonomi digjitale
- Zhvillim i qëndrueshëm
- Infrastrukturë dhe urbanizëm
- Energji e sigurt
- Bujqësia dhe zhvillimi rural
- Zhvillim lokal dhe rajonal i barabartë
- Turizëm gjithëpërfshirës
- Mjedis jetësor i pastër dhe planifikim hapësinor
- Migrimi dhe diaspora

Bashkimi Demokratik për Integrim është për rritje ekonomike të shpejtë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse si model i zhvillimit ekonomik për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve, si dhe hap perspektiva për një nivel më të lartë të mirëqenies. Ky model nënkupton: ekonomi të fortë dhe stabile; institucione të besueshme dhe efikase; biznes të shkathët dhe konkurrues; kapital njerëzor cilësor dhe zhvillim të qëndrueshëm (digjitalizim, infrastrukturë, energji, mjedisi jetësor dhe zhvillim lokal e rajonal).

Ne synojmë që vendi të arrijë mesataren bruto prodhimit të vendit për banorë brenda dy dekadave me një rritje ekonomike mesatare prej 4-5% në nivel vjetor, d.m.th një rritje ekonomike ambicioze duke pasur parasysh nivelin aktual të BPV për kokë banori prej 34% të mesatares së BE-së, pra përmirësim trefish i standardit jetësor.

| Projeksionet ekonomike (2020-2024)             |           |
|--|-----------|
| Rritja ekonomike (vjetore, %)                  | 4 - 5     |
| Norma e inflacionit (vjetore, %)               | 2         |
| Deficiti buxhetor (% e PBB-së)                 | 2 - 3     |
| Investime bruto (% e PBB-së)                   | 36-38     |
| Investime të huaja (katër vite, miliardë euro) | 1.5 – 2.0 |
| Vende të reja pune (katër vite)                | 100,000   |
| Paga mesatare neto (mujore, euro)              | 600       |

## Rimëkëmbje ekonomike pas krizës së COVID19

Pandemia COVID19 shkaktoi krizë ekonomike në nivel global, por edhe në ekonominë vendore dhe e njëjta kërkon masa të veçanta ekonomike për të zvogëluar pasojat socio-ekonomike, por edhe më tepër për rimëkëmbje ekonomike dhe rritje dhe ristrukturim të ekonomisë për 'normalitetin e ri' pas COVID19. Meqenëse burimi i krizës është jo-ekonomik, gjegjësisht pandemia e virusit i cili shkaktoi ndërprerjen e aktiviteteve ekonomike, efekti u vërejt me rënie në dy anët e ekonomisë – oferta dhe kërkesa. Rrjedhimisht edhe plani ekonomik për rimëkëmbje dhe përsheptim i rritjes ekonomike përqendrohet në: përkrahje të qytetarëve dhe ndihma grupeve të ndjeshme sociale; përkrahje e biznesit dhe mbrojtja e vendeve të punës; politikë fiskale të qëndrueshme dhe stabilitet financiar; dhe rimëkëmbje dhe rritje ekonomike në 'normalitetin e ri' pas Covid-19.

### Përkrahje ekonomike qytetarëve dhe ndihma grupeve të ndjeshme sociale

- Lehtësim i masave për subvencione të papunësuarve
- Transfere financiare për kategoritë e ndjeshme socio-ekonomike, nxënës dhe student
- Përkrahje e konsumit privat

## **Përkrahje e biznesit dhe mbrojtja e vendeve të punës**

- Subvencione financiare dhe kredi pa kamatë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
- Garanci bankare dhe kreditimi i eksportit
- Trajnime dhe ristrukturime për menaxhmentin e ndërmarrjeve
- Përkrahje e ekonomisë vendore (produkte dhe shërbime vendore)

## **Politikë fiskale e qëndrueshme dhe stabilitet financiar**

- Racionalizim i kostove të buxhetit
- Rritje e investimeve kapitale infrastrukturore
- Lehtësime fiskale dhe përkrahje financiare për biznesin

## **Rimëkëmbje dhe rritje ekonomike në ‘normalitetin e ri’ pas Covid-19**

- Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i ekonomisë pa karbon
- Ekonomia digjitale, ulja e ekonomisë joformale dhe ndërkombëtarizimi i sektorit të biznesit (ri-integrimi në zinxhirin global të vlerës)
- Hulumtimi dhe inovacionet dhe rritja e aftësisë dhe konkurrencës në sektorin e biznesit;
- Investime në shkencë, arsim dhe zhvillim i kapitalit njerëzor
- Kujdesi shëndetësor, siguria sociale dhe zvogëlimi i pabarazisë sociale
- Rimëkëmbja ekonomike (rifillimi dhe ristrukturimi i bizneseve, investimet, infrastruktura)
- Rritje e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe e përshpejtuar (qeverisje e mire, ekonomia konkurruese, kapitali njerëzor dhe mjedisi i pastër)

## **Ekonomi e fortë dhe stabile**

Ekonomi e fortë dhe stabile do të arrihet me stabilitet makroekonomik dhe politika për rritje ekonomike të bazuara në ekonominë e tregut të lire dhe të hapur.

## Politika për rritje ekonomike

Përcaktimi jonë gjatë viteve të ardhshme do të jetë përsheptimi i rritjes ekonomike dhe respektimi i stabilitetit makroekonomik duke ngritur aftësinë konkurruese të ekonomisë vendore me qëllim të zgjerimit të tregut dhe rritjes së gamës ekonomike, e me këtë edhe standardit të jetesës. Kjo do të arrihet me politika fiskale që do të përkrahin investime në infrastrukturë dhe do të motivojnë iniciativa private, politika monetare që do të sigurojnë stabilitet të valutës vendore me çmime stabile dhe norma të ulëta të interesit, politikë industriale që do të sigurojë rritje të aftësisë konkurruese të ekonomisë duke promovuar afarizmin dhe novacione teknologjike, si dhe stabilitet i sistemit bankar dhe financiar në ekonominë vendore.

Rënia e deficitit tregtar dhe llogarisë rrjedhëse viteve të fundit janë tregues për forcimin e fundamenteve të ekonomisë dhe rezistencën më të madhe të sektorit të jashtëm ndaj goditjeve të jashtme. Deficiti i ulët i llogarisë rrjedhëse, si dhe shuma e investimeve të huaja të parapara në periudhën e ardhshme janë faktorë që do të rezultojnë me pozitë eksterne stabile dhe mbajtjen e rezervave valutore në nivel adekuat.

Rolin kryesor në rritjen ekonomike do marrin investimet dhe eksporti, me çka do të zëvendësohet struktura e deritashme në aspekt makroekonomik ku përbërës dominant në ekonominë vendore përbën konsumi. Politika fiskale do të promovojë tatime në përkrahje të investimeve, si dhe do të ndryshojë struktura buxhetore në favor të investimeve kapitale me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës ekonomike. Politika industriale do të mundësojë programe për nxitje të investimeve në përgjithësi, fillim i bizneseve të reja (start-up), si dhe në novacione dhe teknologji të reja që do të ndikojnë në rritje të produktivitetit dhe penetrim në tregje të reja.

## Konvergjencia ekonomike me Bashkimin Evropian

Në vijë me përcaktimin strategjik të vendit për integrim në Bashkimin Evropian do të respektohen kriteret e konvergjencës ekonomike. Në këtë drejtim do të realizohen reformat e nevojshme për të vendosur ekonomi funksionale të paraparë në Kriteret e Kopenhagës sa i përket tregut të lirë dhe të hapur me lëvizje të lire të mallrave, shërbimeve, kapitalit, punës dhe pronës intelektuale të paraparë gjithashtu në Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asocim me Bashkimin Evropian. Gjithashtu, do të respektohen të ashtuquajturat Kriteret e Mastrihtit për inflacion, gjegjësisht stabilitet të çmimeve (jo më lartë se 1.5 pikë përqindjes se tre vende anëtare të BE-së

me inflacion më të ulët), deficit buxhetor (jo më i lartë se 3% e BPV), borxh publik (jo më i lartë se 60% e BPV), norma të ulëta të interesit (jo më të lartë se 2 pikë përqindjes se tre vende anëtare të BE-së me inflacion më të ulët) dhe kurs valutor stabil ndaj euros.

## Politika fiskale të qëndrueshme

Në periudhën e ardhshme, fokusi i politikës fiskale mbetet në sigurimin e nivelit të konsiderueshëm të investimeve publike, të cilat janë parakusht për përmirësimin e perspektivës ekonomike, si dhe jetë më cilësore për qytetarët. Në këtë drejtim, është planifikuar sasi e konsiderueshme e investimeve kapitale në projekte infrastrukturore, përkatësisht investime në infrastrukturën hekurudhore, energjetike dhe infrastrukturën komunale, si dhe investime kapitale për përmirësimin e kushteve në sistemin shëndetësor, arsimor dhe atë social, në bujqësi, kulturë, sport, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe gjyqësi. Përdorimi efikas i mjeteve nga buxheti dhe mjeteve të siguruar nga huazime nga institucionet ndërkombëtare financiare dhe kreditorët bilateral do të jetë baza e një sërë aktiviteteve investuese dhe reformave të cilat do të mundësojnë krijimin e vendeve të reja të punës dhe një mjedis të favorshëm afarist. Gjithashtu, partneriteti private publik do të promovohet në projekte investuese me interes publik ku sektori privat gjithashtu do të gjeje interes për investim dhe menaxhim.

## Stabiliteti monetar dhe financiar

Politika monetare edhe në periudhën e ardhshme mbetet e orientuar kah rruajtja e stabilitetit të çmimeve dhe rruajtjes së kursit devizor stabil të denarit kundrejt euros. Sistemi bankar dhe financiar do të jetë stabil dhe do të rritet roli i tyre në përkrahje të ekonomisë duke ofruar kredi të volitshme për ekonominë vendore për të mundësuar investime të reja. Rritja e të ardhurave të disponueshme dhe pritshmërive të favorshme vlerësohet se në mënyrë shtesë të mbështesë kërkesën për kredi dhe aftësinë kreditore të subjekteve ekonomike. Afirmim i përdorimi i mjeteve të disponueshme të bankave dhe konzorciumeve bankare për realizimin e investimeve infrastrukturore publike.

Kursi valutor i denarit në raport me euron do të mbahet stabil në periudhën e ardhshme me qëllim ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si objektivi përfundimtar i politikës monetare, kështu që shkalla e inflacionit pritet të jetë e ulët në nivel prej rreth 2%.

## Drejtësi në politikën tatimore

Me qëllim që të sigurohet që secili të përmbush detyrimin e tij shoqëror dhe të ketë pjesëmarrje të drejtë në pagesën e tatimit, për periudhën e ardhshme, fokusi kryesor do të jetë vendosja e barazisë vertikale, e cila mund të shihet si një zgjidhje më e gjerë sesa progresiviteti i tatimeve, zbatimi i standardeve minimale për erozionin e bazës tatimore dhe bartjen e fitimeve (BEPS), çmimet transferuese, rishikimi i legjislacionit kombëtar për të përmbushur kërkesat e BE-së, si dhe zbatimi i stimuluesve për grupet e prekshme sociale.

## Grumbullim efikas i të ardhurave publike

Mbledhja më e mirë e të ardhurave, përmes zgjerimit të bazës tatimore, zvogëlimit të detyrimeve të mbetura tatimore, zbatimit të regjistrimit të pronarëve të vërtetë, luftën në mënyrë më efektive kundër aktiviteteve të paligjshme dhe evazionit të tatimit, si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. Disa nga masat e parashikuara për përmirësimin e efikasitetit dhe produktivitetit të sistemit të mbledhjes së tatimeve janë rishikim i rregullativës ekzistuese tatimore, vendosja e teknologjive të përparura, përforcimi i kapaciteteve të institucioneve, modernizimi dhe automatizimi i proceseve të punës, lehtësimin e komunikimit të ndërsjellë me Drejtorinë e të ardhurave publike dhe doganat, për personat fizik dhe juridik- shërbimi 24/7 plus këshillim.

## Rritja e transparencës tatimore

Transparenca tatimore përfshin përmirësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet organeve tatimore dhe subjekteve të tjera, të cilat në radhë të parë do të bazohen në shërbimet elektronike. Ky prioritet pritet të çojë në rritjen e edukimit fiskal dhe harmonizimit më të madh vullnetar.

## Përmirësimi i shërbimeve për taksapaguesit

Cilësia më e mirë e shërbimeve, të krijuara për të thjeshtëzuar dhe shpejtuar procedurat dhe zvogëlimin e barrës administrative. Rezultatet e synuara janë shkallë më e madhe e shërbimeve Digjitale, menaxhim më i mirë i lëshimit të lejeve për import-eksport, eliminim i barrierave jo tarifore të



panevojshme, kontroll i brendshëm më i mirë dhe kontroll tatimor. Revidimin e tarifave doganore në veçanti për lëndët e para dhe materialet që nuk janë në dispozicion në vendin tone si dhe harmonizimin gradual me Direktivat e Unionit Evropian, lehtësimin e shkëmbimit tregtar për kompanitë vendore.

## Shpërndarje e drejtë e ngarkesës tatimore

Rishikim dhe ri-dizajnim i sistemit të të hyrave tatimore për të balancuar ngarkesën tatimore sipas praktikave të vendeve të BE-së ku përpjesëtimi i të hyrave buxhetore është më i balancuar. Gjegjësisht, sipas buxheteve të vitit 2019, në vendet e BE-së përpjesëtimi mesatar i tatimeve nga të ardhurat dhe fitimi (34.3%), tatimeve nga konsumi (34.7%) dhe kontributeve sociale (31.2%) është më i balancuar krahasuar me gjendjen aktuale në Maqedoninë e Veriut (14.8%, 41.3%, dhe 30.5%), ku dominojnë të hyrat nga tatimet e konsumit. Rrjedhimisht, do të fillojmë një rishikim të strukturës dhe diferencimi të normës tatimore të TVSH-së ose një mekanizëm të kthimit të pjesshëm të saj.

## Buxhet konsensual dhe shpërndarje e drejtë e financave publike

Promovim i mekanizmave për transparence dhe shpërndarje të drejtë të buxhetit dhe financave publike. Instalim i praktikave dhe mekanizmave për konsensus në qeveri për propozim buxhetin, si dhe promovim të mekanizmit (balancuesit) për shpërndarje të shpenzimeve kapitale, dotacioneve për komunat, subvencioneve, si dhe programet në sektorë të ndryshëm, siç janë arsim, kulturë, shkencë, infrastrukture komunale, zhvillim rural, bujqësi, mjedisi etj.

## Sistem tatimor pro biznesit

Bashkimi Demokratik për Integrim do të angazhohet për ruajtjen e sistemit të përshtatshëm tatimor për biznes sektorin duke i mbajtur lartësinë e tatimeve më konkurruese krahas vendeve të rajonit, dhe në periudhën e ardhshme 2020-2024. Nëse vështrojmë vendet e Evropës do të vërejmë se edhe ata kanë politika miqësore për biznesin, me norma tatimore që lëvizin prej 15.1% në Greqi dhe 29.3% në Sllovaki. Norma mesatare e tatimit në fitim në BE është 16% ndërsa në eurozonë 16.2%.

## Transparenca e financave publike

Transparenca e financave publike është rritur dukshëm viteve të fundit, posaçërisht me promovimin e portalit Financat e hapura, ku janë bërë publike transaksionet financiare të kaluara, aktuale dhe të ardhshme të shfrytëzuesve buxhetor, gjë e cila në të ardhmen do të kontribuojë në uljen e korrupsionit dhe parregullsive në punën e institucioneve shtetërore.

## Siguri juridike, parashikueshmëri ligjore dhe institucione efikase

Institucione të besueshme dhe efikase, siguria juridike dhe parashikueshmëria ligjore do të mundësojnë biznes klimë të përshtatshme për sektorin privat dhe investime të reja.

## Gjyqësor dhe administratë profesionale dhe efikase

Reformat në sistemin juridik dhe gjyqësi do të fokusohen edhe më tutje në drejtim të rritjes së efikasitetit, sigurisë juridike dhe mbrojtjes së subjekteve ekonomike. Kjo do të mundësojë funksionim më efikas të biznesit në sistem barazie. Gjithashtu, do të promovohen reforma institucionale në drejtim të reduktimit të institucioneve joefikase duke i bashkuar në institucione më të forta. Kështu do të promovohet formimi i një agjencie për zhvillim që do të përfshijë më shumë agjenci aktuale për promovim dhe përkrahje të biznesit; do të shqyrtohen mundësitë e integritit të disa inspektorateve që janë të përafërta me punën, etj.

## Shërbime elektronike për biznes dhe parashikueshmëria ligjore

Regjistrim online i firmës do të bëhet vetëm me një hap pa kosto nëpërmjet agjentit në regjistrin qendror dhe do të hiqen forma e regjistrimit me letër. Thjeshtëzim të procedurave për leje ndërtimi, përsheptim dhe transparencë më e lartë në procedurë. Thjeshtësim dhe lehtësim të procedurave dhe rritje e efikasitetit në pagesa dhe tatime. Sistem më efikas për vlerësim të ndikimit të legjislacionit në biznes. Organizim të debateve sistemore të institucioneve shtetërore me komunitetin e biznesit dhe sektorin civil nëpërmjet formacioneve, si: Këshilli nacional për sipërmarrësi dhe

konkurrencë dhe Këshilli nacional për zhvillim të qëndrueshëm. Ligjet fiskale nuk do të kenë efekt të menjëhershëm, por do t'i jepet kohë biznesit të përgatitet për ndryshimet.

## Optimizim i institucioneve

Ligjvënira në parlament, politikë-bërja në ministrinë ndërsa implementimi i politikave dhe programeve në agjencitë dhe drejtoritë shtetërore, rregullatorët do të mbikëqyrin tregun dhe inspektoratet do të kontrollojnë implementimin e rregullativës ligjore në treg. Me qëllim të fuqizimit, rritjes së efikasitetit dhe racionalizimit në funksionim të institucioneve si dhe efektshmërinë e përdorimit të parasë publike do të promovohet konsolidimi dhe integrimi i disa institucioneve, si për shembull inspektoratet, agjencitë e zhvillimit ekonomik dhe trupat rregullatorë.

## Sistem një-sportel për investitorë

Investitor të vendit dhe të huaj do të mund të i sigurojnë të gjitha lejet për fillim dhe realizim të biznesit në një vend, si dhe vendosje e sistemit elektronik të aplikimit dhe dhënies së lejeve – Agjenci për zhvillim.

## Luftë kundër korrupsionit dhe ekonomisë joformale

Korrupsioni, paraqet “kancer” të ekonomive në zhvillim. Kryesisht më i shprehur është në sektorin publik dhe si e tillë duhet të luftohet me çdo kusht, pasi e kërcënon seriozisht etikën e biznesit dhe ‘ngulfat’ zhvillimin ekonomik. Ekonomia joformale është rezultat i sistemeve në zhvillim dhe ajo dëmton integritetin e sistemit tatimorë, si dhe pengon prosperitetin e mirëfilltë ekonomik të vendit në tërësi pasi krijon pozicione të pabarabarta për subjektet ekonomike në treg. Format më të shpeshta të ekonomisë joformale paraqiten si parregullsi në zbatimin e Ligjit të punës dhe evazion fiskal. Rrjedhimisht zyrtarizimi i ekonomisë joformale është veçanërisht i rëndësishëm për qytetarët më të cenueshëm në mënyrë që të përmirësojnë mbrojtjen dhe sigurinë e tyre sociale dhe të ju sigurohet atyre qasje në përfitime që lidhen me punësimin. Me Strategjinë për formalizimin e ekonomisë joformale në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 2018-2022 modeli i politikës u zhvendos nga masat që synojnë uljen apo reduktimin e ekonomisë joformale në masa që synojnë zyrtarizimin

e ekonomisë joformale. Mbikëqyrje e zbatimit të Ligjit për ndalimin dhe parandalimin e veprimtarisë së paregjistruar, i cili është veçanërisht i rëndësishëm për të kontribuar në reduktimin e konkurrencës së pandershme. Përmirësimin e ambientit për themelimin, rritjen dhe zhvillimin të kompanive, zvogëlimin e parave të gatshme dhe promovimin e pagesave digjitale dhe rritjen e mundësive për pagesa alternative fintech dhe insurtech.

## Biznes i shkathët dhe konkurrues

Biznes i shkathët dhe konkurrues do të arrihet nëpërmjet nxitjes së afarizmit, iniciativës private dhe investimeve. Reformat në sektorin privat do të fokusohen në disa aspekte më të ndjeshme ekonomike si: tregtia dhe integrimi në zinxhirin e vlerave globale, ngritja e aftësive konkurruese të biznesit nëpërmjet afarizmit, novacioneve dhe teknologjive të reja, si dhe përmirësimi i aksesit në financa për bizneset e reja dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme.

## Stimulim të investimeve private

Investimet private në periudhën e ardhshme afatmesme do të intensifikohen, si rezultat i mbështetjes së veprimtarisë investuese të ndërmarrjeve vendase dhe të huaja, rritjen e sigurisë në vend duke pasur parasysh anëtarësimin e vendit në NATO, ambientin më të favorshëm për të bërë biznes, në kushte të përmirësimit të perspektivave euroatlantike, si dhe duke përkrahur veprimtari inovative dhe zhvillimin teknologjik të ndërmarrjeve vendase. Për të siguruar kapital të freskët për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe mbështetjen e projekteve të reja investuese dhe punësimeve të reja, në vijim e sipër është realizimi i linjës së pestë kreditore nga Banka Evropiane e Investimeve në vlerë prej 100 milion euro. Disiplina financiare e shtetit do të përmirësohet duke bërë pagesat në kohë të borxheve shtetërore ndaj kompanive me çka do të rritet likuiditeti i sektorit privat.

**Reforma regullatore e gjelbër.** Subvencionimi i pajisjeve të industrive përpunuese që do të vendosin inovacionet të cilat do të bëhen industri përpunuese të gjelbra që d.m.th do të përdorin teknologji më të pasta në prodhimtari. Vetë industria mund të përdor cikël të mbyllur të prodhimtarisë përmes mënyrave të riciklimit, rinovimit dhe ripërdorimit të materialeve.

**Investment e gjelbërta.** Financimi i eko-etiketave për produkte që janë fituar në kapacitete përpunuese të investuara në industrinë e gjelbër ose në të ashtuquajturat zonat e gjelbra industriale.

## Internacionalizim i biznesit

Tregtia dhe integrimi në zinxhirin e vlerave globale do të zgjerojë përfshirjen e biznesit vendor në atë global. Infrastruktura bashkëkohore në transport, telekomunikim dhe energjetikë, si dhe heqja e barrierave doganore do t'i i kontribuojnë integrimin të biznesit vendor në atë rajonal dhe global. Zonat teknologjike industriale do të vazhdojnë të jenë pjesë e hartës promovuese për investitor të huaj dhe vendor që do ndikojnë në rritje të eksportit dhe hapje të vendeve të reja të punës si dhe bashkëpunim me bizneseve vendor. Do të rimburohet një pjesë e kostove të bizneseve për certifikimin e sistemit të cilësisë ISO. Mbështetje financiare për certifikimin e sistemit HALAL dhe për pjesëmarrje në panaire vendase dhe ndërkombëtare. Do të bashkë-financojmë disa prej kostove të ndërmarrjes për blerjen e pajisjeve, instrumenteve, mjeteve që do të përdoren dhe shfrytëzohen ekskluzivisht për trajnime, duke i mësuar njerëzit të marrin aftësi dhe kualifikime, si dhe një pjesë të kostove për arsimimin e punonjësve të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (MSME). Mbështetje dhe zhvillimi i shoqatave të klasterëve për të përmirësuar konkurrencën në tregjet e jashtme.

**Shërbimi faktoring.** Përpunimi i mekanizmave për shfrytëzimin e shërbimit faktoring për mbështetjen e eksportit. Kjo masë do t'i mbështes kompanitë që në moment nuk disponojnë me mjete financiare, përmes bankave ta shfrytëzojnë këtë lloj shërbimi ku pagesa e faturës bëhet përmes bankës për kompaninë përgjegjëse e cila do të mund të bëjë blerjen e lëndës së parë në mënyrë të fitojë produkt i cili do të jetë i prodhuar vetëm për eksport.

## Novacione dhe teknologji të reja

Ngritja e aftësive konkurruese të biznesit nëpërmjet afarizmit, novacioneve dhe teknologjive të reja. Përkrahje do të sigurohet për mikro ndërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me tendencë për rritje të shpejtë ('gazelë'), si dhe ndërmarrjet fillestare ('start-up' dhe 'spin-off') që të rrisin kapacitetet inovative duke investuar në komercializim të projekteve ideore dhe produkteve të tyre, si dhe investime në kërkime dhe zhvillim, teknologji të re dhe edukim e trajnim të stafit dhe menaxhmentit, por edhe implementim të standardeve të larta për siguri dhe cilësi të prodhimeve në treg.

**Digjitalizimi i NVM-ve.** Zhvillimi i shpejtë teknologjik në botë imponon nevojën që kompanitë të ndjekin këtë prirje. Digjitalizimi është realiteti ynë në një kohë kur aftësitë digjitale kanë një ndikim pozitiv në proceset e biznesit, uljen e kostos dhe rritjen e produktivitetit. Ato kompani që kanë realizuar transformimin digjital tregojnë rritje prej 26%. Vendosja e një sërë masash të digjitalizimit për kompanitë në formën e mentorimit, shërbimeve këshilluese - kuponë digjitalizimi dhe grante në vlerë prej 5,000-15,000 € për prezantimin e zgjidhjeve digjitale ose përdorimin e mjeteve digjitale në modelet e tyre të biznesit.

## **Përkrahje e bizneseve të vogla dhe të mesme**

**Qendra një-sportel për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.** Analizat tregojnë se NVM-të kanë probleme për të marrë shërbime mbështetëse për zhvillimin e biznesit, kanë mungesë informacioni në kohë dhe kanë mungesë të mentorëve. Themelimi i One stop qendrave për NVM në të 8 rajonet e planifikimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut që të ofrojë të gjitha shërbimet në një vend për NVM-të: mentorimin, shërbimin këshillëdhënës, qasjen në informacionin e financave etj. Shërbimet do të jenë pa pagesë dhe do të ofrohen nga profesionistë të kualifikuar të trajnuar në të gjitha mundësitë në dispozicion të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nga institucionet shtetërore, ndërkombëtare, përfshirë fondet e BE-së dhe organizata të tjera mbështetëse të NVM-ve. Qendra gjithashtu do të sigurojë shërbime mbështetëse për personat e interesuar për të filluar biznesin e tyre.

**Sturt-up qendra për NVM-të në 8 rajonet e planifikimit.** Për rritje dhe zhvillim më intensiv të sipërmarrjes në RMV është e nevojshme të përmirësohet infrastruktura e biznesit. Kjo infrastrukturë biznesi gjithashtu përfshin fillimin e ndërmarrjeve si qendra që do të zhvillojnë aftësitë e sipërmarrësve të rinj në mënyrë që të krijojnë me sukses dhe të rrisin biznesin e tyre. Hapja e Start Up qendrave në të 8 rajonet e planifikimit në RMV do të ofrojë një grup shërbimesh për NVM-të dhe të rinjtë që duan të drejtojnë bizneset e tyre: trajnim, mentorim, hapësira të përbashkëta pune, salla të përbashkëta takimesh, shërbime të kontabilitetit dhe të bërit biznes etj. Start Up qendrat do të jenë një kënd ku do të ndahen idetë, do të zhvillohen bizneset dhe do të inkurajohet shpirti sipërmarrës i të rinjve.

**Inkubatorëve të biznesit për ndërmarrjet e themeluara nga gratë.** Infrastruktura e ndërmarrësisë është thelbësore për nxitjen e ndërmarrësisë. Analiza tregon se një nga faktorët për fillimin e një biznesi është të kesh një

infrastrukturë të favorshme biznesi. Kostot e drejtimit të një biznesi janë veçanërisht të larta në fillimin e një biznesi, dhe kjo shpesh është një faktor kufizues për gratë që të fillojnë bizneset e tyre. Krijimi i inkubatorëve të biznesit në të cilin gratë do të marrin një paketë shërbimesh: hapësirë pune për infrastrukturë, hapësira e bashkëpunimit (co-working space), salla e mbledhjeve, shërbime të buta - programe përsheptuese, programe trajnimi dhe mentorimi.

## Lehtësim i qasjes në financa

Përmirësimi i qasjes në financa për bizneset e reja dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme do të plotësojë infrastrukturën e zhvillimit të afarizmit dhe dinamizmit të biznesit në vend. Kjo do të mundësohet nëpërmjet fondeve dhe agjencive të zhvillimit si dhe bankat dhe institucione tjera financiare, por edhe programet evropiane për përkrahje të afarizmit dhe novacioneve ekonomike. Me konsolidim të institucioneve dhe agjencive, siç janë agjencia për investime të huaja dhe përkrahje të eksporteve; agjencia për përkrahje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe agjencia e turizmit në një institucion të përbashkët dhe të fortë, gjegjësisht Agjenci për zhvillim. Kështu do të ndihmohen më mirë ndërmarrësia, eksporti, turizmi dhe investimet e huaja. Në bashkëpunim me Bankën e Maqedonisë për përkrahje të zhvillimit do të jetë një kornizë e mirëfilltë institucionale për përkrahje të biznesit. Banka e Maqedonisë për Përkrahje të Zhvillimit do të sigurojë linja kreditore të përshtatshme për investime dhe zhvillim si dhe garanci bankare për tregti ndërkombëtare. Gjithashtu, përkrahje e vazhdueshme do të sigurohet me programet e Fondit për inovacione dhe zhvillim teknologjik, i cili do bëjë kofinancim të star-up, spin-off ndërmarrjeve, komercializim të inovacioneve, por edhe të strukturave ekonomike që do të nxisin afarizmin dhe dinamizmin e biznesit, siç janë inkubatorët e biznesit fillestar, akseleratorët teknologjik të biznesit dhe parqet teknologjike.

## Kapital njerëzor cilësor

Kapital njerëzor cilësor do të sigurohet duke investuar në cilësi të arsimit, si dhe përmirësuar kushtet e punës dhe sigurinë shëndetësore që rrisin produktivitetin e punës dhe konkurrencën e ekonomisë. Globalizmi dhe zhvillimi teknologjik e bëjnë ekonominë globale gjithnjë e më komplekse dhe kjo ndikon që kapitali njerëzor të jetë edhe më i rëndësishëm për rritje

ekonomike të shpejtë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Kapitali njerëzor cilësor i cili shpejt përshtatet në ndryshimet e tregut ndihmon bën ekonominë më konkurruese, zvogëlon papunësinë, varfërinë dhe dallimet sociale. Politikat për avancimin e kapitalit njerëzor do të orientohen në rritje të cilësisë së arsimit dhe trajnimeve gjatë gjithë jetës, heqja e barrierave dhe rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës, si dhe kujdesi shëndetësor për kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë.

Do të ndërmerren veprime të menjëhershme për të përmirësuar sasinë e kapitalit njerëzor të tij (matur sipas regjistrimit në shkollë, përfundimin e shkollës dhe shkallët e vdekshmërisë së fëmijëve) dhe cilësinë e kapitalit njerëzor (matur me rezultatet të testeve të standardizuara ndërkombëtare). Përtej aftësive, është gjithashtu e rëndësishme për të zvogëluar dekurajimin dhe çmontimin e barrierave që e mbajnë çdo grup të shoqërisë larg tregut të punës. Gjithashtu, kapitali njerëzor do të mbrohet duke zvogëluar rreziqet shëndetësore dhe duke mbrojtur të varfrit dhe të prekurit nga goditjet socio-ekonomike.

## **Edukim dhe trajnim cilësor gjatë gjithë jetës**

Punëtorët kanë nevojë për aftësi përkatëse profesionale që të mundën t'i përshtaten me lehtësi dhe shpejtësi ndryshimeve në tregun e punës. Përmirësimi i cilësisë së arsimit do të varet nga përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies. Prandaj mësuesit do të aftësohen në metodat moderne të mësimdhënies dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë për të siguruar cilësinë dhe rëndësinë e asaj që mësohet. Së pari, investimet në zhvillimin e hershëm të fëmijëve dhe programet parashkollore janë të nevojshme për të siguruar gatishmërinë për shkollën, e cila është thelbësore për suksesin e ndërhyrjeve të mëvonshme. Arsimi fillor, i mesëm dhe i lartë do të ridizajnohen për të kaluar në ndërtimin e aftësive të të menduarit kritik, të cilat mund të promovohen duke përdorur matës të mirë për të monitoruar rezultatet e të nxënit dhe të sigurojnë cilësi. Cilësia më e mirë e mësuesve kërkon gjithashtu përvojë praktike dhe një sistem për avancimin e karrierës së mësuesve që do të shpërblejë performancë të jashtëzakonshme. Do të mundësohet një tranzicion i lehtë nga shkolla në punë që do të inkurajojë studentët marrjen e aftësive që lidhen drejtpërdrejtë me punën. Programet terciare duhet të përvetësojnë praktika moderne pedagogjike dhe përmbajtje të rëndësishme për vendin e punës, të zhvendosen nga arsimit teknik i ngushtë në shkollë më të përgjithshëm teknik, të angazhohen më ngushtë me punëdhënësit dhe të japin informacione për t'i ndihmuar studentët të



zgjedhin kurse me vlerë më të lartë të tregut. Ndërtimi i aftësive gjatë gjithë ciklit jetësor do të sigurojë që punëtorët të përfitojnë plotësisht nga potenciali i tyre prodhues.

## **Rritje e pjesëmarrjes dhe heqja e barrierave në tregun e punës**

Zvogëlimi i dekurajuesve dhe heqja e barrierave për pjesëmarrjen në tregun e punës do të orientohen në barazinë gjinore, ndihmat sociale dhe fleksibiliteti i orarit të punës. Lehtësimi i mbështetjes për gratë duke zgjeruar qasjen në kujdesin cilësor të fëmijëve si dhe lehtësime tjera dhe fushatë për barazinë gjinore. Ri-dizajnim i përfitimeve sociale në mënyrë që shfrytëzuesit që punojnë me të ardhura nën rrogën mesatare të mos penalizohen. Gjithashtu, ulja e kufizimeve në punën me kohë të pjesshme, të përkohshme dhe sezonale do t'i lejojte më shumë punëdhënësve të testojnë cilësinë e punëtorëve dhe t'i lejojnë punëtorët të fitojnë përvojë shumë të nevojshme, duke mbajtur në vëmendje nevojën për të balancuar me kujdes drejtësinë dhe fleksibilitetin.

## **Zvogëlim i varfërisë dhe kujdesi shëndetësor**

Mbrojtje e kapitalit njerëzor duke mbrojtur familjet e varfra dhe të rrezikuara nga goditjet dhe investimet në mjekësinë parandaluese dhe kujdesin parësor. Ndihma sociale e synuar, shërbime të zgjeruara sociale, qasje më e mirë në kujdesin shëndetësor dhe promovim e stilit të jetesës më të shëndetshëm do të ndihmojnë së bashku të mbrojnë familjet e varfra dhe të cenueshme nga goditjet.

## **Vende pune për të gjithë**

Megjithëse në tregun e punës ka përmirësim të vazhdueshëm në dekadën e fundit, gjegjësisht numri i të punësuarve ka arritur 800 mijë, ndërsa shkalla e papunësisë ka rënë në 17.1% në tremujorin e tretë të vitit 2019, papunësia ende është e lartë dhe karakterizohet me probleme strukturore.

## Krijimi i vendeve të reja të punës

Rritja e parashikuar e aktivitetit ekonomik pritet të shoqërohet me krijimin e vendeve të reja të punës, që do të mbështetet me masa të ndryshme aktive për punësim dhe duke stimuluar ndërmarrjet vendase dhe të huaja për punësime të reja. Përveç kësaj, përmes masës zhvillim të mëtejshëm të sistemit të kualifikimeve, parashihet të zvogëlohet papajtueshmëria midis arsimit dhe nevojave të tregut të punës në periudhën e ardhshme, që do të kontribuon në zbutjen e papunësisë strukturore në vend. Sipas projeksioneve, në këtë periudhë pritet një rritje mesatare vjetore e numrit të punonjësve prej 2.3%, që do të ndikon në zvogëlim e mëtutjeshëm të shkallës së papunësisë, e cila në vitin 2024 parashihet të arrijë 12.6%.

Sa i përket ofertës së fuqisë punëtore, masat do të kenë për qëllim kryesisht përmirësimin e aftësive të të papunësuarve, rikualifikimin dhe kualifikimet e mëtejshme, si dhe mbështetjen e personave të rinj të papunë për të fituar përvojë pune. Gjithashtu, profilizimi i personave të papunësuar dhe përgatitja e planeve individuale të punësimit nëpërmjet të cilave kategoritë më të prekshme synojnë pjesëmarrjen në masat aktive të punësimit.

## Integrimi i të rinjve në tregun e punës

Përmes Garancisë për të rinjtë, çdo person i ri nën moshën 29 vjeç, për një periudhë prej 4 muajsh regjistrimi si person i papunë në Agjencinë për punësim, duhet të marrë një ofertë të përshtatshme punësimi, mundësia për të vazhduar shkollimin ose për t'u përfshirë në ndonjë nga masat aktive për punësim. Duke ndjekur shembullin e vendeve evropiane, përcaktohen tri shtyllat e aktiviteteve (ndërhyrjen e hershme; identifikimi dhe përfshirja dhe aktivizimi me integrimin e tregut të punës). Agjencia për punësim do të rrit aktivitetet e tij dhe do të inkuadrojë metoda të reja të punës me qëllim të ndërhyrjes së hershme, në mënyrë parandalimin e pozitës së pafavorshme të të rinjve në tregun e punës dhe parandalimin e papunësisë afatgjatë dhe probleme të tjera që lidhen me të. Në këtë drejtim, aktivitetet do të fokusohen në: takime informuese me të rinjtë në shkolla / fakultete; orientimi profesional dhe këshillimi i karrierës së nxënësve fillor dhe të shkollave të mesme; panairë të punësimit me theks të veçantë në pjesëmarrjen e studentëve, dhe informim më i mirë mbi situatën në tregun e punës. Kompensim për punën e praktikantit në pajtim me Ligjin për praktikë.

## Zhvillimi i politikës të grave sipërmarrëse

Përforcimi ekonomik i grave duke krijuar klimë biznesore të përshtatshme dhe mbështetja për zhvillimin e potencialit sipërmarrës. Përmirësimi i qasjes në mënyra më të favorshme për financim. Politika që do të mundësojnë tranzicionin prej ndihmave sociale në vetëpunësim, tranzicionin prej punësimit në punëdhënës, përforcimin e prezencës së grave në hartimin e politikave për zhvillimin e sipërmarrësisë, sigurimin e kapaciteteve për përdorimin e inkubatorëve, përsheptuesve dhe parqeve teknologjike nga ana e grave sipërmarrëse, promovimin dhe rrjetëzimin e grave sipërmarrëse.

## Zonat industriale dhe të gjelbra

Ndryshime ligjore në Ligjin për Zonat industriale dhe të gjelbra me të cilat do të rregullohen lehtësimet, mundësitë dhe përfitimet për shfrytëzuesit e Zonave, unifikimin e dispozitave të cilat vlejné për subjektet që mund të themelojnë zonë që zbatohen në Zonat industriale me ata që zbatohen në zonat e gjelbra; përkufizim i qartë i rasteve kur subjekte të ndryshme publike mundet të themelojnë Zonë dhe definim i kushteve për kryerjen e veprimtarisë në Zonat e gjelbra. Zona e gjelbër do formohet në Vizbeg, Zhelinë dhe vende tjera.

## Ekonomi digjitale

Në tërësi do të implementohet Agjenda digjitale e promovuar në kuadër të Procesit të Berlinit për Ballkanin Perëndimor: Investim në 'Broadband'; rritje e sigurisë në internet, besim, digjitalizim i industrisë; forcim i ekonomisë dhe shoqërisë Digjitale; dhe nxitje e kërkimit dhe novacionit.

## Investimi në lidhjen 'Broadband'

Infrastruktura e mirë digjitale është thelbësore për përfshirjen e Broadband-it në Ballkanin Perëndimor për të mobilizuar investimet strategjike dhe për të nxitur rritjen e socio-ekonomike.

## Rritja e sigurisë në internet, besimi dhe digjitalizimi i industrisë

Ndërtim të kapaciteteve në besim dhe siguri dhe digjitalizimin e industrisë për të siguruar që të gjithë sektorët të përfitojnë nga inovacionet digjitale.

## Forcimi i ekonomisë dhe shoqërisë digjitale

Agjenda Digjitale do të mbështesë vendosjen e mjeteve të qeverisjes së mire dhe do të ndihmojë në rritjen e aftësive digjitale midis qytetarëve. Kjo do të bëhet duke mbështetur përfshirjen dhe përfaqësimin e vendit në nismat dhe ngjarjet e BE-së për t'u lidhur dhe rrjetë me qendrat kryesore evropiane.

## Nxitja e kërkimit dhe novacionit

Agjenda Digjitale do të ndihmojë në krijimin e lehtësirave kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit të e-infrastrukturave në Ballkanin Perëndimor dhe do t'i integrojë ato në një Zonë Evropiane të Kërkimit Digjital. Kjo përpjekje do të sjellë trajnime të klasit botëror për një gjeneratë të re studiuesish dhe inxhinierësh dhe do të promovojë bashkëpunimin ndërdisiplinor në të gjithë Evropën.

## Transport

Transporti është shtyllë mjaft e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të një vendi si dhe e lëvizjes së lirë të qytetarëve, shkëmbimit të mallrave nga një vend në vendin tjetër. Infrastruktura e transportit ndihmon në krijimin e një hapësire unike ekonomike, fillimisht brenda vendit, më pas në rrafshin rajonal e pan-evropian. Zhvillimi me ritme shumë të shpejta i sistemit të transportit është një ndër faktorët kryesorë të rritjes së nivelit ekonomik të vendeve evropiane, padyshim se këto rritje janë edhe synim i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me investime në transport do të arrijmë të krijojmë një rrjet unik transporti që do të shërbente si një strukturë komunikuese, që do realizonte gradualisht barazimin e niveleve ekonomike sepse: afrohen tregjet, bëhet lëvizje e sigurt për banorët dhe një organizim optimal i trafikut, që do të ulte nivelin e ndotjes dhe aksidenteve. Zhvillimi i barabartë i rrjetit të transportit është një shtytje e fortë drejtë zhvillimit të barabartë ekonomik të rajoneve

të ndryshme të vendit dhe më gjerë. Bashkimi Demokratik për Integrim do të angazhohet në drejtim të përmirësimit dhe përforcimit të transportit në përgjithësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

## Infrastruktura rrugore

**Korridor VIII.** Me ndërtimet serioze që po bëhen në Korridorin VIII, realizohet një hap i madh në rritjen e cilësisë së transportit rrugor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me Punimet serioze që bëhen në aksin Kërçovë - Ohër dhe Rankovcë - Deve Bair me shpejtësi përmbyllet Korridorin VIII si korridor që do të lehtësojë daljen në portin e Durrësit. Kjo do të ndikojë në bilancin tregtar dhe rritjen e ekonomisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe ekonomive rajonale. Lidhja e komunave, zhvillimi ekonomik, shkarkimi i komunikacionit, lidhja me zonat e lire ekonomike, afërsia me vendet turistike si dhe me kufirin me R. e Shqipërisë dhe dalja në det.

**Ndërtimi i autostradës Kërçovë – Ohër.** Ndërtimi i autostradës së re Kërçovë – Ohër, 57 km kap vlerë rreth 600 milion euro. Kjo autostradë në fund të muajit shkurt 2014 ka filluar të ndërtohet në seksionin Kërçovë – Ohër. Ky seksion është në gjatësi prej 56 km dhe realizohet përgjatë rrugës ekzistuese rajonale. Me ndërtimin e kësaj autostrade të re, do të ndikohet në rritjen e sigurisë së qytetarëve në komunikacion, uljen e shpenzimeve gjatë udhëtimit dhe shkurtimin e kohës së nevojshme. Deri tani traseja në tërësi është depërtuar 96%. Afati i përfundimit të punimeve është 30.06.2021. Në këtë seksion është edhe tuneli i Presekës i cili është tuneli më i gjatë në Republikën e Maqedonisë së Veriut me gjatësi prej 1,990 m, tuneli ka një realizim prej 70% ndërsa pritet të përfundohet brenda 2 viteve. Është shtruar shtresa e parë e asfaltit në 18km. Punët ndërtimore janë kryer me masë prej 76%.

**Ndërtimi i autostradës së re Gostivar – Kërçovë.** Lidhja rrugore e komunave, zhvillimi ekonomik, shkarkimi i komunikacionit, lidhja me zonat e lire ekonomike, afërsia me vendet turistike si dhe me kufirin me Republikën e Shqipërisë. Kjo autostradë do të jetë e gjatë 42 km dhe do të ndërtohet në tre seksione: a) Gostivar-Gjonovicë e epërme, janë aprovuar 2 milion euro nga WBIF për projekt dokumentacion, do të sigurohen mjete shtesë për realizimin e projektit; b) Gjonovica e epërme- Bujkocani, do të sigurohen mjete për realizimin e projektit; c) Bujkocani - Kërçovë – projekti është në fazën përfundimtare, pritet studimi ekologjik. Vlera totale e këtij seksioni do të arrijë në 100 milion euro. Tashmë janë siguruar fonde të pakthyeshme nga Fondi i Investimeve të Ballkanit Perëndimor të BE-së në shumën prej

rreth 20 milion euro, ndërsa fondet e mbetura në vlerë prej 80 milion euro do të sigurohen përmes burimeve të tjera dhe kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

**Ndërtimi i autostradës së re Trebenishtë – Strugë.** Gjatësia 8.5 km me vlerë prej 45 milion euro. Kjo autostradë është shumë e rëndësishme për Republikën e Maqedonisë së Veriut pasi me anë të saj bëhet vazhdimi i Korridorit VIII, që duhet të lidhë Maqedoninë e Veriut me Shqipërinë. Komuna e Strugës është angazhuar për të bërë ndryshimin e nevojshëm të planit urbanistik, për parashikimin e autostradës në plan urbanistik që në mënyrë të përsheptuar të plotësohen të gjitha kushtet për ndërtimin e saj.

**Autostrada Shkup – Bllacë.** në vlerë prej 110 milion euro: Lidhja rugore e shteteve përkatësisht lidhja me Republikën e Kosovës dhe vazhdimi i autostradës Arbër Xhaferi, zhvillimi ekonomik, lidhja me zonat e lire ekonomike. Kjo autostradë do të ndërtohet në dy faza. Së pari seksioni 2 km nga kufiri me Kosovën deri në fshatin Bllacë, ndërsa në fazën e dytë seksioni Bllacë- Stenkovec në gjatësi prej 10.5km.

**Ruga Tetovë – Prizren.** Ky projekt do të jetë në vlerë prej 40 milion-60 milion euro, mjete që do të sigurohen nga buxheti i shtetit dhe Banka Botërore. Realizimi i këtij projekti do të ketë një ndikim të madh në zhvillimin ekonomik të zonës, shkëmbimin tregtar në mes dy vendeve, qasjen më të shpejtë për dalje në det (porti i Lezhës dhe i Durrësit), zhvillimi i turizmit në Kodrën e Diellit, etj.

**Ruga e Arbrit.** Ndërtimi i rrugës së re regjionale Burim - Urra e Garit. Lidhja me Republikën e Shqipërisë dhe lidhja me autostradën që njihet si Ruga e Arbrit, një projekt në vlerë prej 20 milion euro.

**Zhvillim i rrugëve rurale.** Vazhdimi i rrugës Tetovë-Brodec në vlerë prej 3.5 milion euro. Lidhja e fshatrave Veshallë, Bozovcë dhe Brodec, nga gjithsej 9717m janë realizuar 6400m. Nyja lidhëse e urës Trebosh në vlerë prej 3 milion euro. Komunitatet Tetovë, Zhelinë, Jegunovcë dhe Tearcë. Nyja lidhëse e urës së Bërvenicës në vlerë prej 1 milion euro. Në anën Shkup-Tetovë janë lëshuar korsi të hyrëse dhe dalje ndërsa në anën tjetër do të zgjidhim problemet pronësore-juridike. Rehabilitimi i Rrugës Podmole-Strugë-Qafë Thanë në vlerë prej 3.5 milion euro, të siguruar nga buxheti dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Rehabilitimi i rrugës regjionale Kërçovë - Pllasnicë - M. Brod - në vlerë prej 4.4 milion euro të siguruar nga buxheti dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Fillimi i punimeve parashikohet në mars 2020. Është shpallur tenderim publik për ofertues më të volitshëm për përpunimin e projekt

dokumentacionit për rehabilitim. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është 28 shkurt 2019. Nënshkrimi i kontratës në mars 2019. Rehabilitimi i rrugës regjionale Karpallak-Zhelinë - në vlerë prej 2.5 milion euro. Është përfunduar njëra anë e korsisë dhe do të vazhdohet me anën tjetër.

| Projekti  | Komuna            | Vlera në €   |
|---|-------------------|--------------|
| Rruga Saraj-Radushë   | Saraj             | 260.000,00   |
| Rruga Çajle-Forinë-Çegran   | Gostivar          | 406.000,00   |
| Rruga Vratnicë-Jazhincë   | Tetovë            | 162.000,00   |
| Rruga Tetovë-Bogovinë   | Tetovë            | 81.300,00    |
| Nyja Tetovë-Poroj-Neproshten                                      | Tetovë            | 230.000,00   |
| fab. Jugohrom - stacioni hekurudhor Jegunovcë                     | Tetovë            | 100.000,00   |
| Lidhja A2 Kërçovë-Osllomej  | Kërçovë           | 245.000,00   |
| Bogomilla- Cërnilisht   | Dollnen           | 650.000,00   |
| Rruga Llazhani - Zhitoshë   | Dollnen           | 130.000,00   |
| F. Kazhan - Manastir  | Manastir          | 211.000,00   |
| Rikonstruim dhe zgjerim i rrugës Ropalc-Mateç                     | Likovë            | 1.120.000,00 |
| Rruga Jegunovcë- Zhelinë  | Jegunovcë/Zhelinë | 1.557.720,00 |
| Rruga Tanushë - Kufiri me Kosovën                                 |                   | 128.000,00   |
| Gostivar - Sërbinovë (segmenti Bellovishtë-Llakavicë - Sërbinovë) | Gostivar          | 128.000,00   |

## Infrastruktura hekurudhore

**Rikonstruimi i hekurudhës Shkup-Kërçovë.** Hekurudha Shkup-Kërçovë përfaqëson pjesën qendrore të Korridorit 8 që kalon nëpër Republikën e Maqedonisë së Veriut. Meqenëse Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut vitet e fundit është duke punuar në ndërtimin e Korridorit 8, është e nevojshme të rindërtohet pjesa që do të përshtatet në pjesët e ndërtuara rishtas të Korridorit 8 përmes Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me mjete të siguruara nga grante të BE-së është kryer një studim i fizibilitetit që do të sigurojë bazën për hartimin e një projekti themelor për të kryer rikonstruimin e kësaj pjese të hekurudhës. Rikonstruimi do të përfshijë pragje dhe shina të reja, sanimin e urave dhe tuneleve si dhe vendosjen e pajisjeve të reja të sigurisë së sinjalizimit për të arritur shpejtësinë 100 km/h. Projekti bazë është planifikuar të bëhet në 2021, ndërsa punimet në terren në 2022.

**Ndërtimi i hekurudhës Kërçovë-Lin.** Për pjesën perëndimore të Kërçovës deri në kufi me Republikën e Shqipërisë në një gjatësi prej 63 km, është bërë një projekt themelor në bazë të së cilës ndërtimi i këtij aksi do të kushtojë 500 milion euro. Kjo pjesë e linjës hekurudhore parashikon tre stacione Kërçovë, Mesheisht dhe Strugë, si dhe katër ndalesa. Shumica e linjës hekurudhore shtrihet mbi një zonë malore, duke kërkuar që të ndërtohen 10 tunele dhe 45 ura si mbikalime dhe nënkalime. Planifikojmë që ndërtimin e hekurudhës ta fillojmë në 2022 dhe e njëjta të përfundojë deri në fund të vitit 2026.

**Rikonstruimi i stacionit hekurudhor në Tetovë.** Rikonstruimi do të kapë vlerë prej 200.000 euro dhe do të realizohet nga buxheti vetanak i Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Maqedonisë –Infrastrukturë. Kjo do të rrisë nivelin e shërbimit për udhëtarët që përdorin stacionin për të udhëtuar me tren.

## Energji e sigurt

Energjia është një nga resurset kryesore të zhvillimit ekonomik dhe e një standardi më të mire të jetesës. Energjetika paraqet një segment të rëndësishëm ekonomik, prandaj, në periudhën që vijon, Bashkimi Demokratik për Integrim do të vazhdojë me ristrukturim, liberalizim dhe privatizim të sektorëve energjetikë, në bazë të direktivave të Bashkësisë Evropiane dhe parimeve të ekonomisë së tregut. Kjo qasje do të respektohet në tre sektorët energjetikë: elektrik, gaz dhe naftë.



Zhvillimi i sektorit energjetik do të bazohet në këto parime dhe prioritetë: liberalizimi i tregut, siguria energjetike, rritja e prodhimit të energjisë, diversifikimi i resurseve energjetike, rritja interkoneksioneve me vendet e rajonit, rritja e efikasitetit energjetik dhe rritja e kapaciteteve energjetike nga resurset ripërtëritëse energjetike. Bazuar në këto prioritetë do të promovohen politika dhe investime në rritje të kapaciteteve prodhuese energjetike ripërtëritëse (me erë, me diell dhe hidrocentrale), lidhjet interkonetuese në rajon dhe ato ndërkombëtare, si dhe zhvillim të rrjetit elektro-energjetik dhe të gazit në vend duke mundësuar gasifikimin e vendbanimeve që do të mundësonte një alternativë energjetike për amvisëritë dhe industrinë. Përveç, rritjes së sigurisë dhe diversifikimit me resurse energjetike, si dhe rruajtjes së mjedisit jetësor, gjithashtu, do të realizohen fushata dhe investime për përmirësimin e efikasitetit energjetik dhe mbrojtjes së kategorive më të ndjeshme sociale të shoqërisë.

## Rritja e kapaciteteve prodhuese dhe efikasitetit energjetik

**Kapacitete prodhuese.** Është një prej kushteve kryesore për një zhvillim të qëndrueshëm. Në fokus do të jetë posaçërisht ndërtimi i hidrocentraleve, duke pasur parasysh potencialin ujqor që ka vendi ynë. Me theks të veçantë, do të jenë hidrocentralet reversibile dhe centralet koogjeneruese me gaz, me qëllim të ruajtjes së energjisë për kohërat e shtrenjta të energjisë elektrike në treg, si dhe balancimin sa më efikas të energjive ripërtëritëse, të cilat në të ardhmen pritet të kenë një rol më të theksueshëm në prodhimin e energjisë elektrike dhe termike. Gjithashtu, do të angazhohemi dhe do të jemi të hapur edhe për iniciativa regjionale, sa u përket kapaciteteve prodhuese, siç do të ishte investimi i përbashkët me Republikën e Kosovës në termocentrale me lignit.

**Efikasitet energjetik.** Është më se i domosdoshëm për të kompletuar hallkën e sistemit të qëndrueshëm energjetik dhe kërkon një angazhim të madh. Me sanimin termik të ndërtesave të vjetra si dhe zbatimin e standardeve për ndërtesa eficiente në ndërtimet e reja do të arrihen efekte të shumëfishta si, konsum më i vogël i energjisë, d.m.th. reduktim të emisioneve të gazrave të dëmshme, shtytje ekonomike dhe harxhime më të vogla energjie për qytetarët. Projekt i Bankës Botërore për efikasitet në sektorin publik me qëllim të zvogëlimit të konsumit të energjisë në sektorin publik si dhe krijimin e një mekanizmi financiar të qëndrueshëm të sektorit publik. Projekti do të përfshijë dy komponentë edhe atë 23 milion euro do të ndahen për ndërtime të efikasitetit të energjisë në sektorin publik dhe

2 milion euro do të ndahen për asistencë teknike dhe zbatim të projektit. Vlera e projektit: 25 milion Euro; Burimi i financimit: Kredi nëpërmjet BERZH.

## Energji ripërtëritëse

Do të përkrahet si edhe deri më tani, mirëpo deri në atë masë, sa që rritja e çmimeve si shkak i energjive të rinovueshme të jetë e përballueshme për konsumatorët e fundit. Modelet e financimit dhe përkrahjes së energjive të rinovueshme do të përvetësohen aq shumë, sa që, do të ketë edhe rritje të kapaciteteve prodhuese nga energjitë e ripërtëritëse edhe ruajtje të stabilitetit social të qytetarëve. Do të bëhet edhe intervenim në kornizën ligjore me qëllim të mundësimit të orëve dy-kahesh, ku qytetarët do të kenë mundësinë e shitjes së energjisë së tepërt të prodhuar në pajisjet nga burimet e ripërtëritëse të energjisë, të instaluara nëpër amvisëri.

Do të bëhet një angazhim i madh për promovimin e njësive prodhuese të vogla multi-funksionale decentrale në vendet rurale, duke pasur parasysh karakterin agrar dhe blegtoral të fshatrave tona, të cilat do të garantonin edhe rritje të prodhimit edhe furnizim më të mirë me energji termike si dhe shtytje të projekteve. Me disa pilot-projekte qytetarët do të vetëdijësohen nga benefitet e stabilimenteve të kombinuara energji elektrike – energji termike me bazë biomase, posaçërisht në vendbanimet me popullatë shqiptare, ku dendësia në vendet rurale është e madhe.

Zhvillim i qëndrueshëm energjetik në harmoni të plotë me objektivat për një ambient të pastër jetësor dhe promovimi i burimeve të rinovueshme të energjisë dhe efikasitetit të energjisë.

**Promovim i burimeve të rinovueshme të energjisë dhe promovimin e efikasitetit të energjisë në amvisëri për çdo vit.** Rimbursimi i një pjese të kostove: për sistemet e kolektorëve termal; për dritare PVC ose alumin; për blerjen e sobave me peleta; për blerjen e kondicionerëve inverter.

**Ndihmë financiare për prodhimin e energjisë elektrike nga prodhuesit e zgjedhur që përdorin premiume.** Fondet e përcaktuara në këtë program do të përdoren për të paguar premiumet për energjinë elektrike të prodhuar dhe shitur nga prodhuesit preferencial që përdorin premium në vitin 2020-2024. Planifikohet ndërtimi i centraleve fotovoltaike në tokë private dhe shtetërore me fuqi 140 MW në të gjithë territorin e Maqedonisë së Veriut.

**Përkrahje e konsumatorët në nevojë.** Promovimi i burimeve të ripërtëritëse të energjisë dhe inkurajimin e efikasitetit të energjisë në amvisëri me gjendje sociale të ndjeshme.

## Gasifikimi

Do të vazhdojmë me zbatimin e Projektit për ndërtimin e sistemit të gazifikimit nacional, që do të sigurojë furnizim me energji të lirë dhe ekologjike për ndërmarrjet, sektorin publik dhe amvisëritë. Në vijim e sipër është ndërtimi i seksionit të sistemit të gazifikimit nacional Shkup - Tetovë - Gostivar. Gjithashtu, në periudhën e ardhshme afatmesme do të fillojmë me zbatimin e projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik, i cili përfshin realizimin e masave për rritjen e efikasitet energjetik nga ana e komunave në vend.

**Shkup – Tetovë – Gostivar.** Furnizimi me gaz i të gjitha komunave të rajonit të Pollogut, me gjatësi prej 78 km + 10 km degëzimi për Tetovë.

**Gostivar – Kërçovë.** Furnizimi me gaz natyror në Komunën e Kërçovës, në gjatësi prej 36 km. Vlera e projektit: 15 000 000 Euro; Burimi i financimit: BERZH (Banka Evropiane për Rikonstruim dhe Zhvillim).

**Negotinë - Prilep – Manastir.** Furnizimi me gaz i të gjitha komunave të rajonit të Pellagonisë, me gjatësi prej 92 km.

**Kërçovë-Strugë-Ohër-Manastir, dhe S. Nikole – Veles.** Furnizimi me gaz natyrorë.

**Interkonekcioni me Greqinë.** Diversifikimin e burimeve të furnizimit me gaz natyrorë, dhe qasjen në TAP (Trans Adriatik Pipeline), ashtu si edhe në терминалет LNG në Republikën e Greqisë. Me gjatësi 68 km - Negotinë-Gjevgjeli. Vlera e projektit: 50 milion Euro; Burimi i financimit: 10 milion Grant nga WBIF (West Balkan investment framework), dhe 40 milion Euro kredi EIB (European Investment Bank).

**Interkonekcioni me Kosovën.** Furnizimi i Kosovës me gaz natyror, me gjatësi 16 km; Vlera e projektit: 10 milion Euro; Burimi i financimit: BERZH (Banka Evropiane për Rikonstruim dhe Zhvillim).

**Rrjeti i distribuimit.** Ky projekt do të realizohet me partneritet publiko-privat, dhe do të mundësojë furnizimin me gaz natyrorë të çdo amvisërie, kompanie, institucioni dhe fabrike në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ne do të subvencionojmë familjet që shfrytëzojnë asistencë sociale dhe do të mundësojmë kredi me kushte të volitshme, për të adaptuar instalimet e brendshme për shfrytëzimin e gazit natyrorë si një energji shumë më i lirë dhe maksimalisht ekologjike. Vlera e projektit 300 milion euro; Burimi i financimit: BERZH (Banka Evropiane për Rikonstruim dhe Zhvillim), partneri privat.

## Bujqësia dhe zhvillimi rural

Bujqësia paraqet një sektor të rëndësishme në zhvillimin e vendit, por edhe për zhvillimin e zonave rurale, duke luajtur një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e mundësive për punësim, gjegjësisht krijimin e të ardhurave për familjet në vendbanimet rurale. Me zhvillimin e potencialit të këtij sektori në të ardhme, zëvendësimin e importit me produkte bujqësore vendase, si dhe me qasjen e lirë në tregjet rajonale dhe atë të BE-së, sektori i bujqësisë do të mundëson përmirësimin e të ardhurave kombëtare, rritjen e vendeve të reja të punës, rritje të prodhimtarisë bujqësore, rritje të fermave sipas standardeve moderne, rritje të numrit të kafshëve, përmirësimin e kushteve të bujqve dhe blegtorëve, përmirësimin dhe zhvillimin e industrisë agrare, si dhe rimëkëmbje të zonave rurale apo zhvillimin e fshatrave.

Me definimin e prioriteteve të sektorit të bujqësisë ne synojmë që të arrijmë nivelin e zhvillimit të sektorit të bujqësisë në vendet e BE-së. Por, për të arritur këtë duhet bërë disa reforma me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore, të bëjmë konsolidimin e tokës bujqësore, ti rrisim investime në bujqësi, në objekte të prodhimit, pajisje dhe teknologji moderne, sidomos riparimin dhe modernizimin e teknologjisë së vjetër që përdoret në industrinë përpunuese. Duke u nisur nga kjo është e domosdoshme krijimi i një vizioni për bujqësinë e së ardhmes dhe të një strategji afatgjatë mirë të planifikuar me qëllim të zhvillimit të këtij sektori.

**Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë.** Kryesisht do të përqendrohet në rritje të sipërfaqeve të tokës bujqësore me të mbjella; zhvillimi i pemëtarisë, perimtarisë dhe vreshtarisë; dhe zhvillimi i prodhimtarisë organike (bio-produktet).

**Zhvillimi i qëndrueshëm i blegtorisë.** Kryesisht do të përqendrohet në stimulimin e blegtorisë, gjedhtarisë, nxitjen e bletarisë dhe rritjen e prodhimit të mjaltit, si dhe nxitjen e shpeztarisë, prodhimit dhe eksporti të vezëve.

**Zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve të industrisë përpunuese.** Kryesisht do të përqendrohet në zhvillimin e industrisë agrare, industrisë së mishit, qumështit dhe produkteve qumështore, si dhe pikave grumbulluese.

**Zhvillimi dhe rimëkëmbja e zonave rurale.** Do të realizohen projekte kapitale për përmirësimin e infrastrukturës në fshat, që do të mundësoj zhvillimin e hovshëm të fshatrave, modernizimin e tyre, rritjen dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike si dhe mundësitë për investime në agro-industri.

## Bujqësia

**Rritja e sipërfaqeve të tokës bujqësore me të mbjella.** Objektiv i përgjithshëm i yni është që ti rrisim sipërfaqet e mbjella me kultura bujqësore, në këtë mënyrë do të kemi një bujqësi më të qëndrueshme, prodhim më të madh dhe rritje të cilësisë së kulturave bujqësore, përmirësim të tregut vendor për konsumim dhe përmirësim të industrisë agro-përpunuese, zvogëlimin e importit dhe rritjen e eksportit të prodhimeve bujqësore në tregun e jashtëm duke ndikuar në këtë mënyrë në mirëqenien e familjeve bujqësore. Me rritjen e sipërfaqeve të tokës bujqësore të punuar, do të rriten edhe subvencionet për bujqësi. Aktualisht nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 40 % ose 511.000 hektar janë tokë e punueshme.

**Zhvillimi i pemëtarisë, perimtarisë dhe vreshtarisë.** Prioritet për periudhën e ardhshme është zhvillimi i mëtejshëm i pemëtarisë, perimtarisë dhe vreshtarisë. Qëllimi ynë do të jetë që në pemëtari të bëhet rritja e sipërfaqeve të mbjella me: mollë, dardhë, qersh, vishnje, kajsi, pjeshkë, kumbulla, rrush, manaferra, dredhëza, gështenja, në veçanti me lajthi kulturë e cila gjithnjë e më tepër kërkohet në tregun e rajonit dhe atë të BE-së. Rritja e sipërfaqeve me perime do të ndikojë në zhvillimin e industrisë përpunuese dhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Gjithashtu, kjo vlen edhe për mbjelljen, rritjen dhe kultivimin e pemishteve me fidanë të arrës dhe aronisë, si pemë të cilat viteve të fundit më shumë do të kërkohen në tregun rajonal. Gjithashtu do të krijojmë kushte për zhvillimin e vreshtarisë si degë e jona strategjike si dhe në mënyrë aktive do të zgjidhen problemet me të cilat përballen vreshtarët. Subvencionimi në vitet në vijim do të vazhdojë në mënyrë të rregullt dhe në kohën e duhur.

**Kultivimi i duhanit.** Duhani është kulturë bujqësore e rregulluar me ligj, që më së tepërmi është i përfshirë në rajonin e Pellagonisë, në Dollnen, pjesërisht në rajonin e Shkupit etj. Mjetet për financim për kultivuesit e duhanit për vitin 2020 janë të parapara me vlerë prej 1.800.000.000,00 denarë. Çmimi mesatar i blerjes për këtë vit ka arritur në 221.9 denarë për kilogram, që është çmimi më i lartë i blerjes në gjashtë vitet e fundit. Me modelin e ri për rritjen e subvencioneve, subvencionet për duhanin e klasës së parë janë 80 denarë për kilogram, për klasën e dytë 70 denarë dhe për klasën e tretë 60 denarë. Në të njëjtën kohë, do të angazhohemi që në bashkëpunim me lidhjen e shoqatave të prodhuesve të duhanit dhe dhomës ekonomike, të zvogëlojmë diferencën e çmimit të klasave të duhanit, si dhe që edhe kultivuesit e duhanit të fitojnë të drejtën e shfrytëzimit për

subvencionimin e naftës së gjelbër, duke ua bërë të mundur që të zvogëlojnë harxhimet gjatë veprimtarisë së tyre.

**Zhvillimi i prodhimit organik (Bio produktet).** Me nxitjen e fuqishme si dhe me subvencionimin dhe përkrahjen e zhvillimit të prodhimit organik bujqësor, do të mundësohet rritja e sipërfaqeve të mbjella me kultura bujqësore organike, si dhe rritja e kapaciteteve prodhuese të produkteve bujqësore organike të cilat do të plasohen në tregun vendor dhe atë të jashtëm. Një nga prioritetet e sektorit të bujqësisë për periudhën e ardhshme është edhe zhvillimi apo inkurajimi i bujqve me qëllim që të orientohen kah prodhimi i produkteve organike si dhe arritja e standardeve të kërkuara nga BE-ja. Edhe në të ardhmen do të vazhdojë pajisja me certifikatë për prodhime organike, që lejon eksportin e tyre në tregun e BE-së, gjë që deri tani veç më është realizuar tek disa fermer shqiptar.

## Blegtoria

**Zhvillimi dhe stimulimi i blegtorisë.** Blegtoria është një nga pikat të cilat duhet ti kushtohet më shumë vëmendje në të ardhmen. Tradicionalisht familjet që jetojnë në zonat rurale merren me blegtori. Aktualisht në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipërfaqja e kullotave është evidentuar të jetë 751.000 hektar. Rritja e numrit të kopeve të dhenve dhe dhive do të ndikojë pozitivisht në rritjen e prodhimit të mishit, industrisë përpunuese të mishit, por edhe në përmirësimin e gjendjes ekonomike të familjeve që merren me bagëti. Për këtë arsye subvencionimi i blegtorisë gradualisht do të rritet. Synimi ynë do të jetë që edhe më tutje të vazhdojmë me ndarjen e kullotave dhe subvencionimin e deleve dhe dhive, në veçanti qengjave të gjinisë femërore me të cilat mundësohet rritja e numrit të kopesë, përmirësimin e kushteve të staneve, sigurimin e plasmanit të mishit në tregun e BE-së dhe atë ndërkombëtar.

Për periudhën 2020-2024 do të angazhohemi që me rritjen graduale të subvencioneve për blegtorinë të ndikojmë në rritjen e numrit të deleve për të pasur një blegtori më të zhvilluar, për të cilën kemi propozuar masat në vijim:

- Subvencione për kokë dele të parapara deri në 1500 den.
- Subvencione për qengj për shumim të parapara deri në 1500 den.
- Subvencione për qengj të therur në një thertore të regjistruar të parapara deri në 800 den.

- Stimulimi i masave të agro-mjedisit dhe ndërtimi i kapaciteteve për përfitimin e të drejtës për subvencione nga BE-ja.
- Rinovimi dhe pajisja e qendrave praktike të trajnimit për barinjtë me qëllim të përmirësimit të aftësive për të përmirësuar cilësinë, sigurinë dhe standardizimin e produkteve të deleve, duke rritur kështu përfitimin dhe qëndrueshmërinë e degës së blegtorisë.
- Mbështetja e planeve të veprimit për përforcimin e organizatave të prodhimit në realizimin dhe arritjen e standardeve dhe kritereve për tërheqjen e fondeve të BE-së në sektorin e blegtorisë.

Nëpërmjet këtyre masave do të rritet eksporti, punësimi, zhvillimi i turizmit malor dhe rural, rigjallërimi i plotë i fshatrave dhe fitimi i pozitës udhëheqëse në Ballkan dhe më gjerë në Bashkimin Evropian.

**Zhvillimi dhe stimulimi i gjedhtarisë.** Me stimulimin dhe subvencionimin e gjedhtarisë do të mundësojmë transformimin e prodhimit për nevoja familjare në prodhim për tregun vendas, rajonal dhe atë të BE-së. Qëllimi ynë është rritja e numrit të gjedheve, si dhe të fermave edhe atë në ferma moderne. Rritja e fermave familjare me orientim komercial, do të ndikojë në rritjen e numrit të gjedheve në përgjithësi dhe në rritjen e prodhimit të qumështit, produkteve të qumështit dhe mishit. Vitin e kaluar (2019) u shpall thirrje publike, e cila u mundësoi kompanive dhe kooperativave bujqësore të investojnë në hapjen e objekteve të përpunimit ku 50% e investimeve ishin të bashkë-financuara, d.m.th përkrahje financiare e pakthyeshme, e mundësuar IPARD Programet. Edhe në periudhën e ardhshme do të vazhdojmë me subvencionimin dhe stimulimin për ngritjen e fermave të reja për prodhim të mishit dhe qumështit duke rritur mbështetjen financiare me vlerë prej 91 milionë denarë për blerjen e bagëtive.

**Zhvillimi dhe nxitja e bletarisë, prodhimit dhe eksportit të mjaltit.** Bletaria ka një traditë të gjatë dhe potencial të lartë në vendin tonë pasi që kemi klimë të favorshme për kultivimin e saj, si dhe larmi të bimësisë, llojllojshmërisë të kulturave, që shquhen si burim i mirë i nektarit dhe polenit. Duke pasur parasysh rëndësinë ekonomike të bletarisë, Bashkimi Demokratik për Integrim ka një strategji të qartë për mbështetje maksimale për bletarinë, përmes masave të zhvillimit në kuadër të Programeve për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural si dhe përmes masave të programit IPARD 2, duke futur këtu furnizimin me pajisje për të cilat shteti ju mundësoi bletarëve mbulim të harxhimeve me 50% nga investimi i përgjithshëm. Gjithashtu edhe në vitet në vijim do të vazhdojë realizimi i këtyre programeve zhvillimore.

### **Zhvillimi dhe nxitja e shpeztarisë, prodhimit dhe eksportit të vezëve.**

Edhe pse nevoja e konsumit të brendshëm me vezë plotësohet 100% nga prodhimi vendor, synimi ynë është rritja e prodhimit dhe rritja e eksportit të vezëve në vendet e rajonit dhe ato të BE-së. Me subvencionimin e shpeztarisë ne synojmë rritjen e numrit të fermave për prodhimin e vezëve, si dhe rritje të industrisë përpunuese për prodhimin e produkteve nga mishi i pulave.

## **Pylltaria**

Objektiv i rëndësishëm i yni për vitet 2020-2024 është rritja e fondit të pyjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ruajtja cilësore e pyjeve dhe mbrojtja nga prerja e paligjshme. Aktualisht në Republikën e Maqedonisë së Veriut është evidentuar 1.159.600 hektar tokë e mbuluar me pyje. Strategjia për zhvillim të qëndrueshëm të pylltarisë do të zbatohet me pjesëmarrjen e të gjithë faktorëve relevant nga sfera e pylltarisë dhe gjuetisë, si dhe të qytetarëve në drejtim të udhëheqjes së përgjegjshme, zmadhimit të produktivitetit dhe rezultateve të konsiderueshme. Për arritjen e këtij qëllimi nga Programi i zhvillimit rural do të sigurohen mjete për investime në rritjen e sipërfaqeve të pyllëzuara. Në bashkëpunim me IPA fondet për vitin 2019, Bashkimi Evropian siguroi një ndihmë financiare prej 1.3 milion euro për të forcuar menaxhimin e pyjeve, për të luftuar prerjen dhe tregtinë e paligjshme të drunjve dhe për të zvogëluar rënien e vazhdueshme të Fondit të Pyjeve Botërore dhe zonave pyjore që është një nga problemet më të mëdha mjedisore në botë. Realizimi i kësaj iniciative do të fillojë në gjysmën e dytë të vitit 2020 dhe do të kontribuojë në harmonizimin e sektorit të pylltarisë me modelin evropian. Gjithashtu do të mundësojmë edhe krijimin e kushteve për mbrojtjen e investimeve në degën e gjuetisë që ka potencial të madh për zhvillim. Me Programet për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, do të mundësojmë mbështetje financiare për gjuetinë, e cila është e rëndësishme për zhvillimin e turizmit të saj.

## **Industria e përpunimit të ushqimit**

**Zhvillimi i industrisë agrare.** Një nga prioritetet kryesore është edhe zhvillimi i industrisë agrare. Paralelisht me zhvillimin e sektorit të bujqësisë do të investohet në zhvillimin e industrisë përpunuese agrare. Me përpilimin e programeve për zhvillim dhe programeve të financuara nga fondet evropiane do të mundësohet modernizimi i industrisë agrare, rritja e



kapaciteteve përpunuese, investimi në teknologji dhe pajisje moderne si dhe rritja e numrit të punëtorëve të angazhuar në këtë industri.

**Zhvillimi i industrisë së mishit dhe produkteve të mishit.** Industria e përpunimit të mishit ballafaqohet me çështjen e mungesës së lëndës së parë për këtë industri, gjegjësisht nevojat për mish gjedhi të cilat për momentin importohen. Trajtimi i kësaj çështje, gjegjësisht rritja e prodhimit vendorë të lëndës së parë do të bëhet me rritjen e subvencionimit dhe stimulimit të fermerëve nëpërmjet Programit për përkrahje financiare në bujqësi dhe absorbimi i mjeteve nga IPARD Programi, për pajisjen e fermerëve të cilët do të merren me kultivimin e gjedhit për mish.

**Zhvillimi i industrisë së qumështit dhe produkteve qumështore.** Republika e Maqedonisë së Veriut përballet me mungesën e madhe në furnizimin e tregut me qumësht dhe prodhime të qumështit. Për këtë arsye do të ndërmerren disa hapa në përmirësimin e kësaj gjendje, duke filluar me disa masa për plotësimin e kushteve dhe standardeve evropiane, siç janë masa për modernizimin e qumështoreve të vogla, avancimin e tyre sipas standardeve të BE-së, pajisjen me teknologji moderne për prodhimin dhe paketimin e qumështit dhe produkteve nga qumështi. Gjithashtu do të vazhdojë subvencionimi për litër qumësht si dhe për kokë të gjedhëve, rruajtjen e racave autoktone dhe rritjen e kualitetit të produkteve të qumështit. Përmes këtyre masave synojmë zvogëlimin e importit të qumështit dhe prodhimeve nga i njëjti. Këto qëllime do të mund të realizohen duke shfrytëzuar fondet e parapara nga IPARD Programi.

## Zhvillimi dhe rimëkëmbja e zonave rurale

**Projekte për përmirësimin e infrastrukturës në fshat.** Zhvillimi dhe rimëkëmbja e zonave rurale është një nga objektivat kryesore në strategjinë për zhvillimin afatgjatë të bujqësisë. Zhvillimi rural paraqet një nga pikat kryesore në rimëkëmbjen e fshatrave shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ai mundëson qasje bashkëkohore dhe të qëndrueshme në zhvillimin e vendbanimeve rurale duke përfshirë zhvillimin e bujqësisë bashkëkohore sipas standardeve të BE-së, zhvillimin e infrastrukturës rrugore, si dhe infrastrukturën e vendbanimeve rurale në përgjithësi, zhvillimin ekonomik, zvogëlimin e papunësisë te popullata e zonave rurale etj. Për këtë qëllim në të ardhmen do të kushtohet rëndësi më e madhe zhvillimit të fshatrave apo vendbanimeve rurale duke investuar në projekte kapitale, projekte infrastrukturore, ndërtimin e rrugëve lokale, rrugëve që lidhin fshatrat me qytetet, sheshet, shëtitorët, planet urbanistike, kanalizimet, ujësjellësit etj.

Me avancimin e politikave për zhvillim rural në periudhën e ardhshme sidomos me rritjen e masave nga Programi për zhvillim rural do të mundësohet zhvillimi më i hovshëm i vendbanimeve rurale. Qëllimi është rritja e masave investuese nga Programi për zhvillimin rural, gjegjësisht zhvillimin e fshatrave, modernizimin e tyre, rritjen dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike si dhe mundësitë për investime në agro-industri.

**Mirëmbajtja e kanaleve për ujitje dhe kullim.** Për periudhën 2020-2024 parashihet pastrimi i kanaleve dhe përmirësimi i infrastrukturës së kanaleve për ujitje dhe kullim, që do t'u mundësojë fermerëve qasje deri te uji për ujitje të tokave bujqësore dhe të mbrojtë vendbanimet rurale nga vërshimet.

**Subvencionet si zhvillim i qëndrueshëm në bujqësi.** Në të kaluarën, por edhe gjatë viteve në vijim, do të vazhdojë ndarja e subvencioneve në mënyrë transparente, si një mundësi për zhvillimin e bujqësisë në të gjitha pjesët e shtetit. Më këtë u është mundësuar të gjithë bujqve që të kenë qasje deri te subvencionet në mënyrë të drejte dhe të barabartë. Gjatë vitit 2019 është bërë pagesa e subvencioneve për vitin 2018 me vlerë prej 150 milion euro, nga këto rreth 37 milionë euro u parashikuan për vendbanimet shqiptare. Edhe për periudhën 2020-2024 do të vazhdojmë me politikat e subvencionimit duke avancuar ndarjen e subvencioneve, si dhe përkrahjen e industrisë agro-përpunuese, mbështetjen e fermerëve, përmirësimin e cilësisë së produkteve me qëllim që të zhvillojmë vendbanimet rurale, të arrijmë standardet e BE-së, rritjen e sipërfaqeve të tokës bujqësore si dhe rritje të cilësisë dhe sigurisë ushqimore.

**IPARD Programin 2014-2020.** Programi për shfrytëzimin e mjeteve nga EU për ndihmë për bujqësinë dhe zhvillimin rural ka në dispozicion 60 milion euro dhe mbështet pesë masat në vijim: Investime në mjete materiale për ekonomitë bujqësore; Investime në mjete materiale për përpunim dhe marketing në prodhimet bujqësore dhe prodhimet e peshkut; Investime në infrastrukturën rurale publike; Diversifikimin dhe zhvillimin e bizneseve në zonat rurale; Ndihmën teknike.

**Programi për investime për kullotat.** për vitin 2020-2024 për zbatimin e masave për përmirësimin e kushteve të kullotave do të parashihen: mjete për rikonstruimin dhe hapjen e rrugëve të reja tokësore deri te kullotat; rindërtimi i staneve; shpërndarja e paneleve diellore fotovoltaike për prodhimin e energjisë nëpër stane; shpërndarja e gypave për furnizimin me ujë në stane; hapja e puseve për ujë.

**Programi për zhvillim rural.** Qëllimi i këtij Programi është investimi në bujqësi dhe zhvillim rural, krijimi i kushteve për një prodhim modern dhe

konkurrues, si dhe zhvillim më i hovshëm i bujqësisë. Për vitin 2020, arrin buxhet të përgjithshëm prej 1 miliard denarë. Një pjesë e këtyre mjeteve financiare do të shfrytëzohet edhe për qëllimet në vazhdim: ndihmë për bujqit e rinj për fillimin e veprimtarisë bujqësore; furnizimin me bagëti; ngritjen e plantacioneve të reja; furnizimin me traktorë; furnizimin me sistemin Pik-Pik; investime në infrastrukturën për zhvillimin e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore.

**Programi për mbështetje financiare për peshkim dhe akuakulturë.** Për vitin 2020-2024 parashihen gjithsej 90 milion denarë. Qëllimi është zhvillimi i peshkimit dhe akuakulturës, popullimi me peshk të liqeneve, ndërtimi, zgjerimi dhe pajisja e objekteve për riprodhimin e peshkut etj.

## Ekstrakt

**Bujq të rinj.** Përkrahje financiare prej 20,000 euro për shfrytëzues; 10 % subvencione më të larta; Shtesë mujore prej 3,000 denarë; Lirim nga pagesa e qirasë për 3 vitet e para; Përparësi gjatë aplikimit për masat nga Programet e Bujqësisë.

**Qendra grumbulluese.** Hapjen e pikave për grumbullimin, përpunimin, paketimin dhe shitjen e produkteve bujqësore; Qendra grumbulluese në Rajonin e Prespës (për mollë); Rajonin e Pollogut (për perime dhe kultura të tjera kopshtare); Shkup dhe Rajonet e Shkupit; Likovë - Kumanovë dhe Pellagoni.

**Nafta e gjelbërt.** Ndarja e subvencioneve kartelave për naftën e gjelbër; 200 milion denarë subvencione; 55 mijë fermerë përfitues; deri më tani harxhime të mbuluara për 30% me tendencë rritjeje deri në 50% gjatë vitit 2020, duke vazhduar deri në mbulimin e përgjithshëm të harxhimeve për naftën e gjelbër (deri 100%).

**Gruaja fermere.** Përkrahje gruas aktive fermere; 3000 euro mjete të pakthyeshme (grant); Furnizim me makineri bujqësore.

## Projekte

| Nr. | Komuna                                      | Emërtimi i projektit  | Vlera (denarë) | Faza (Sqarimet)  | Buxheti            |
|-----|---|---|----------------|--|--------------------|
| 1   | Tetovë<br>Gostivar<br>Vrapçisht<br>Bogovinë | HS Raven -<br>Reçicë  | 975,000,000.00 | Hidrosistemi Raven - Reçicë, parasheh ujitjen e rreth 3.200 hektarë të tokës bujqësore në fushën e Pollogut. Me 31.09.2018 filloi faza e parë e ndërtimit të sistemit për ujitje Raven – Reçicë, që përfshin regjionin e Gostivarit, Vrapçishtit, Bogovinës dhe Tetovës.   | Buxheti<br>Qendror |
| 2   | Likovë                                      | Penda e lumit në fshatin Sllupçan, Likovë                                     | 799,370,000.00 | Penda e lumit në fshatin Sllupçan parasheh ujë të pijshëm si dhe ujitjen e 5.000 hektarë tokë bujqësore me vlerë prej 13 milion euro. Deri tani është përgatitur projekti themelor. Në fund të vitit 2018 u mbyll Marrëveshja për shërbime shtesë për përgatitjen e projektit kryesor, për devijimin e rrugës lokale Sllupçan - f.Runica, ndërsa për momentin është në përgatitje elaborati gjeodezik. | Buxheti<br>Qendror |
| 3   | Dibër                                       | Rehabilitimi i stacionit të pompimit, tubave dhe sistemit për ujitje në Dibër | 719,433,000.00 | Rehabilitimi i stacionit të pompimit, tubave dhe sistemit për ujitje në Dibër është projekt që ka për qëllim furnizimin me ujë të mjaftueshëm për ujitjen e tokave bujqësore. Për arsye të mos zgjedhjes së operatorit ekonomik gjatë vitit të kaluar d.m.th. vitit 2019, në vitin 2020 pritet të hapet përsëri tenderi për rehabilitimin e stacionit të pompimit në Dibër                             | Buxheti<br>Qendror |

|   |         |  |              |   |                 |
|---|---------|--|--------------|---|-----------------|
| 4 | Dollnen | Sistemi për ujitje në lumin Strohka – Dollnen (Cërnilishtë)        | 6,149,000.00 | Është përgatitur studimi i fizibilitetit për ndërtimin e sistemit për ujitje në lumin Strohka (Cërnilishtë) në Komunën e Dollnenit. Në vitin 2019-2020 pritet të hapet edhe tenderimi për projektin themelor. Me detyrën e projektit është planifikuar të zhvillohen të paktën tre zgjidhje të ndryshme nga të cilat investitori mund të zgjedhë më të përshtatshmen për hapin e ardhshëm për realizim. -Projekt i ri | Buxheti Qendror |
| 5 | Kërçovë | Përgatitja e projektit bazë dhe kanalit për ujitje Zajaz – Kërçovë |              | Projekti për studimin e fizibilitetit dhe projekti themelor ka përfunduar në vitin 2019, në vitin 2020 pritet të hapet tenderimi për realizimin e punimeve për këtë projekt-Projekt i ri.   | Buxheti Qendror |

## IPA FONDET

| Nr. | Komuna  | Emërtimi i projektit  | Vlera në total e projektit në denarë | Faza (Sqarimet)  | Buxheti    |
|-----|---------|---|--------------------------------------|--|------------|
| 1   | Kërçovë | Përgatitja e projektit bazë dhe kanalit për ujitje Kolibar, Cërvicë – Kërçovë |                                      | Projekti për studimin e fizibilitetit dhe projekti themelor kanë përfunduar. Pritet që tenderimi për realizimin e projektit të bëhet në vitin 2020. Qëllimi kryesor i projektit është ujitja e 170 hektar tokë bujqësore. Në procedurë është marrja e lejes për ndërtim nga Komuna e Kërçovës. Financimi mundësohet nga IPA fondet-Projekt i ri. | IPA fondet |

**Zhvillimi i infrastrukturës në zonat rurale**  
**Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural**

Në Programin për zhvillim rural për vitin 2019-2020 janë të miratuara mbi 200 projekte nga të gjithë 80 komunat për të cilat Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministria e Bujqësisë ka siguruar 38 milion euro. Për projektet në Komunat shqiptare vlera totale e miratuar për realizimin e këtyre projekteve infrastrukturale arrin përafërsisht 11 milion euro, të cilat do të implementohen nga Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural. Këto projekte do të ndihmojnë që të rregullohet infrastruktura në vendbanimet rurale.

**Masa 321 – Përmisimi i jetës në zonat rurale**

Projektet e masës 321 parashohin ndërtimin e infrastrukturës të rrugëve lokale ku përfshihen urat që mundësojnë lidhjen e dy ose më tepër vendbanimeve, ndërtimin e sistemeve për furnizimin me ujë, ndërtimin e kanalizimeve, ndërtimin e objekteve për shtëpi për fëmijë dhe rinisë si dhe shtëpi të kulturës në zonat rurale, modernizimin e tregjeve duke bërë të mundur kështu zhvillimin e një jete më të lehtë dhe më të begatshme për zonat rurale.

|   |        |                                      |  |            |
|---|--------|--------------------------------------|--|------------|
| 2 | Tearcë | Sistemi për ujitje në fshatin Tearcë | Sistemi për ujitje në fshatin Tearcë është në fazë të projektimit. Financimi i këtij projekti bëhet me mjete nga IPA fondet-Projekt i ri | IPA fondet |
|---|--------|--------------------------------------|--|------------|

| Nr. | Projekti  | Vlera (Eur) | Fillimi | Përfundimi | Komuna    | Buxheti         |
|-----|---|-------------|---------|------------|-----------|-----------------|
| 1   | Rekonstruktimi i rrugës së Strimnicës për lidhje me qytetin e Tetovës         | 357,719     | 2019    | 2020       | Zhelinë   | Buxheti Qendror |
| 2   | Rekonstruktimi i rrugës lokale nga fshati Vishticë deri te fshati Mateç       | 218,749     | 2019    | 2020       | Likovë    | Buxheti Qendror |
| 3   | Ndërtimi i rrugës prej fshatit Bogovinë deri në Sedllarcë të epërme           | 215,783     | 2019    | 2020       | Bogovinë  | Buxheti Qendror |
| 4   | Rekonstruktimi i rrugës komunale nga fshati Miletinë deri te fshati Bllacë    | 264,288     | 2019    | 2020       | Bërvenicë | Buxheti Qendror |
| 5   | Rekonstruktimi i rrugës komunale që lidhë fshatrat Banjishtë, Hame dhe Krifcë | 218,272     | 2019    | 2020       | Dibër     | Buxheti Qendror |
| 6   | Ndërtimi dhe rekonstruktimi i rrugës në Lisiçan                               | 270,000     | 2019    | 2020       | Pllasnicë | Buxheti Qendror |

## Masa 322 – Rindërtimi dhe zhvillimi i fshatrave

Projektet e Masës 322 parashohin përgaditjen e planeve urbanistike të fshatrave, ndërtimin, rekonstruimin dhe rehabilitimin e rrugëve lokale, ndërtimin e rrugëve komunale që mundësojnë transport më të lehtë dhe zhvillim ekonomik në këto zona.

|    |  |         |      |      |                |                 |
|----|--|---------|------|------|----------------|-----------------|
| 7  | Ndërtimi i rrugës prej fshatit Gradec deri në rrugën regjionale        | 392,842 | 2019 | 2020 | Vrapçisht      | Buxheti Qendror |
| 8  | Rekonstruktimi i rrugës lokale nga fshati Greshnicë deri në Baqishtë   | 296,196 | 2019 | 2020 | Kërçovë        | Buxheti Qendror |
| 9  | Ndërtimi i sistemit për mbledhjen e ujit në fshatin Mojançë            | 197,818 | 2019 | 2020 | Haraçinë       | Buxheti Qendror |
| 10 | Ndërtimi i sistemit të kanalizimit                                     | 151,156 | 2019 | 2020 | Gostivar       | Buxheti Qendror |
| 11 | Ndërtimi i rrugës prej fshatit Carevë deri në fshatin Simnicë          | 377,011 | 2019 | 2020 | Q.ZH.V, POLLOG | Buxheti Qendror |
| 12 | Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Bukoviç                          | 377,736 | 2019 | 2020 | Saraj          | Buxheti Qendror |
| 13 | Ndërtimi i rrugës lokale prej fshatit Studeniçan deri te fshati Moranë | 301,326 | 2019 | 2020 | Studeniçan     | Buxheti Qendror |
| 14 | Ndërtimi i rrugës prej në Tetovë deri në fshatin Brodec                | 383,609 | 2019 | 2020 | Tetovë         | Buxheti Qendror |
| 15 | Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në Desovë                           | 344,421 | 2019 | 2020 | Dollnen        | Buxheti Qendror |
| 16 | Rekonstruktimi i rrugës lokale mes fshatit Moroishtë dhe Misleshevë    | 534,486 | 2019 | 2020 | Strugë         | Buxheti Qendror |
| 17 | Rekonstruktimi i rrugës së fshatit Luboten                             | 370,000 | 2019 | 2020 | Butel          | Buxheti Qendror |
| 18 | Rekonstruktimi i rrugës afër fshatit Patishka Reka                     | 250,000 | 2019 | 2020 | Sopishte       | Buxheti Qendror |

| Nr. | Projekti   | Vlera (Eur) | Fillimi | Përfundimi | Komuna | Buxheti         |
|-----|--|-------------|---------|------------|--------|-----------------|
| 1   | Rekonstruktim dhe rehabilitim i rrugës lokale në fshatin Slupçan | 108,085     | 2019    | 2020       | Likovë | Buxheti Qendror |

## Masa 323 – Ruajtja dhe promovimi i vlerave tradicionale në zonat rurale

Projektet e Masës 323 parashohin ndërtimin e infrastrukturës rrugore, rregullimin e monumenteve natyrore dhe futjen e çiklizmit në zonat rurale, gjelbërimin e zonave përreth liqeneve, rregullimin e vendeve për piknik. Të gjithë këto bëjnë të mundur zhvillimin e turizmit rural duke pasur parasysh bukuritë e rralla natyrore, florën dhe faunën e pasur të këtyre zonave të banuara.

|    |  |         |      |      |  |                 |
|----|--|---------|------|------|--|-----------------|
| 2  | Plane urbanistike për fshatrat: Pirok, Siniçan, Sedllarcë e Epërme dhe Pallçishtë e Epërme | 384,072 | 2019 | 2020 | Bogovinë                                   | Buxheti Qendror |
| 3  | Rekonstruktimi i rrugës në fshatin Çollopek  | 412,380 | 2019 | 2020 | Bërvenicë                                  | Buxheti Qendror |
| 4  | Ndërtimi i rrugës lokale në fshatin Gradec   | 181,893 | 2019 | 2020 | Vrapçisht                                  | Buxheti Qendror |
| 5  | Ndërtimi i rrugës komunale në Dibër  | 129,856 | 2019 | 2020 | Dibër                                      | Buxheti Qendror |
| 6  | Ndërtimi dhe rekonstruktimi i rrugës Pllasnicë   | 119,983 | 2019 | 2020 | Pllasnicë                                  | Buxheti Qendror |
| 7  | Ndërtimi i rrugës në fshatin Llabunishtë   | 176,500 | 2019 | 2020 | Strugë                                     | Buxheti Qendror |
| 8  | Plane urbanistike për fshatrat Pallçishtë e Poshtme, Bogovinë                              | 369,707 | 2019 | 2020 | Qendra për zhvillim të rajonit të Pollogut | Buxheti Qendror |
| 9  | Ndërtimi i rrugëve 1 dhe 2 në fshatin Studeniçan   | 121,112 | 2019 | 2020 | Studeniçan                                 | Buxheti Qendror |
| 10 | Ndërtimi i rrugës me gjatësi prej 647 m në fshatin Rashtani                                | 79,463  | 2019 | 2020 | Kërçovë                                    | Buxheti Qendror |

| Nr. | Projekti  | Vlera (Eur) | Fillimi | Përfundimi | Komuna    | Buxheti         |
|-----|---|-------------|---------|------------|-----------|-----------------|
| 1   | Rekonstruktimi i rrugës lokale prej fshatit Çiflik deri në fshatin Llarcë | 274,132     | 2019    | 2020       | Zhelinë   | Buxheti Qendror |
| 2   | Rregullimi i vendit për piknik te kisha Shën Bogorodica në fshatin Mateç  | 213,236     | 2019    | 2020       | Likovë    | Buxheti Qendror |
| 3   | Rekonstruktimi i rrugës në fshatin Kamjan                                 | 140,538     | 2019    | 2020       | Bogovinë  | Buxheti Qendror |
| 4   | Ndërtimi i rrugës lokale prej Negotine deri në Senokos                    | 218,141     | 2019    | 2020       | Vrapçisht | Buxheti Qendror |
| 5   | Ndërtimi i rrugës lokale në Pregllovë                                     | 182,068     | 2019    | 2020       | Pllasnicë | Buxheti Qendror |



| Nr. | Projekti   | Vlera (Eur) | Fillimi | Përfundimi | Komuna              | Buxheti         |
|-----|--|-------------|---------|------------|---------------------|-----------------|
| 6   | Ndërtimi i rrugës lokale prej fshatit Dobrosht deri në fshatin Nerasht             | 367,851     | 2019    | 2020       | Tearcë              | Buxheti Qendror |
| 7   | Rekonstruktimi i rrugës komunale në fshatin Tërnovë                                | 202,232     | 2019    | 2020       | Bërvenicë           | Buxheti Qendror |
| 8   | Rekonstruktimi i rrugës lokale nga Draçeva deri në Kitkë                           | 233,281     | 2019    | 2020       | Studenica           | Buxheti Qendror |
| 9   | Rekonstruktimi i Shtëpisë së Kulturës "Bozhidar Mickoski" në fshatin Lumi i Hekurt | 65,244      | 2019    | 2020       | Gostivar            | Buxheti Qendror |
| 10  | Rekonstruktimi i rrugës lokale deri te fshati Krushopek                            | 285,792     | 2019    | 2020       | Saraj               | Buxheti Qendror |
| 11  | Ndërtimi i hapësirës së udhëtimit me lokalitet në Banjën e Tetovës                 | 368,595     | 2019    | 2020       | Tetovë              | Buxheti Qendror |
| 12  | Rekonstruktimi i rrugës lokale nga fshati Nerezit deri në Shën Spas                | 128,717     | 2019    | 2020       | Strugë              | Buxheti Qendror |
| 13  | Rindërtimi i qendrës së Kulturës   |             | 2019    | 2020       | Likovë              | Buxheti Qendror |
| 14  | Ndërtimi i rrugës lokale, fsh. Jagoll  | 90,000      | 2019    | 2020       | Kërçovë             | Buxheti Qendror |
| 15  | Ndërtimi i rrugës Llojan-Tabanovcë   | 240,000     | 2019    | 2020       | Qendra për zhvillim | Buxheti Qendror |

## Zhvillim lokal dhe rajonal i balancuar

Krijimi i njësive më të fuqishme ekonomike, me orientim zhvillimor dhe inkluziv të vetëqeverisjes lokale, të afta që të sigurojnë një rritje dhe zhvillim gjithëpërfshirës, inovativ dhe të qëndrueshëm lokal në rajonin në të cilin vepron.

| Maqedonia e Veriut  | 2018          |             |
|---|---------------|-------------|
| në % të PBB-së  | nivel qendror | nivel lokal |
| Tatimi në të ardhura, fitim dhe të ardhura kapitale           | 5.0           | 0.1         |
| Kontribute për sigurim social                                 | 8.6           | 0.0         |
| Tatimi në pronë   | 0.0           | 0.5         |
| Tatimet e brendshme për mallrat dhe shërbimet                 | 11.4          | 0.0         |
| Tatimet mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare (tarifa) | 0.9           | 0.0         |

|  |               |             |
|--|---------------|-------------|
| Taksa speciale të njëfishta                          | 0.0           | 0.0         |
| Tatimi i shërbimeve specifike                        | 0.0           | 0.7         |
| Taksa për shfrytëzim ose leje për ushtrim të detyrës | 0.2           | 0.0         |
| Të ardhura tatimore, gjithësej                       | 26.0          | 1.3         |
| 28 Vendet Anëtare të BE-së                           |               | 2018        |
| në % të PBB-së në 2018                               | nivel qendror | nivel lokal |
| Të ardhura tatimore, gjithësej                       | 40.1          | 3.9         |

## Zhvillimi lokal

**Prioritetet.** Prioritetet në periudhën në vijim vazhdojnë të jenë: përforcimi i mëtejshëm i kapacitetit financiar të komunave (rritja e TVSH nga 4,5% në 9%, tatimi personal nga 3% në 9%); sistemi i konsoliduar i vetëqeverisjes lokale; decentralizimi fiskal i zbatuar në mënyrë adekuate; rritja e efikasitetit të politikave për zhvillimin e qëndrueshëm lokal nëpërmjet koordinimit më efikas të politikave dhe institucioneve në nivel nacional dhe lokal; planifikimi më përfshirës dhe monitorimi i qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm; ofrimi më i madh i shërbimeve për qytetarët dhe subjektet afariste; menaxhimi më i përgjegjshëm dhe kontrolli i financave publike në nivel lokal; shfrytëzimi i burimeve alternative të financimit dhe tërheqjen e investimeve nga autoritetet lokale; rritja e kapaciteteve të pushtetit nacional dhe lokal për krijimin, zbatimin dhe vlerësimin e zhvillimit të qëndrueshëm; qytetarët të përfshihen dhe të marrin pjesë në krijimin dhe vlerësimin e politikave publike që kanë ndikim në jetën e tyre; dhe bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve në nivel kombëtar dhe lokal në krijimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave kombëtare që ndikojnë në kompetencat e autoriteteve lokale në lidhje me arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, kohezionit social dhe ekonomik.

Sot, krahasuar me vitin 2005 në të cilin filloi procesi i transferit të kompetencave dhe decentralizimit fiskal, të ardhurat e komunave janë rritur për më shumë se pesë herë (në vitin 2005 realizimi nga 5,9 miliardë denarë, në vitin 2018 mbi 31 miliardë denarë). Në të njëjtën periudhë, të ardhurat nga tatimet në të cilat komuna ka autonominë për pagesë u rritën për dy herë më shumë. Aspekt tjetër i rëndësishëm është interesi i shtuar për qasje deri tek tregu i kapitalit, në veçanti financimi i projekteve investuese të cilat për komunitat u bënë më të qasshme me ndryshimet e zgjidhjeve ligjore përmes definimit të kushteve më liberale dhe më transparente për huazim.

**Politikat dhe institucionet koherente për të arritur qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm.** Gjegjesisht, sfidat komplekse të synimeve të zhvillimit të qëndrueshëm nuk i adresohen ekskluzivisht pushtetit qendror në një vend. Arritja e tyre lidhet drejtpërsëdrejti me kompetencat e autoriteteve lokale, në veçanti rolin e tyre në ofrimin e shërbimeve bazë, por gjithashtu edhe aftësinë e tyre për të promovuar një zhvillim territorial të integruar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Qytetari është në qendër të politikave për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

**Rritja e kompetencave dhe burime financiare për komunat.** Në përputhje me parimet e subsidiaritetit të komunave duhet t'i kalohen kompetenca të tjera jo-shtetërore të cilat pushteti lokal si qeveri më e afërt me qytetarët mund t'i kryejë me më shumë sukses se sa institucionet e qeverisë qendrore. Forcimi i autonomisë fiskale dhe qëndrueshmërisë financiare të pushtetit lokal: rritja e pjesës së tatimeve qendrore që ndahen për komuna (tatim personal, tatim në fitim dhe tatimi në vlerë të shtuar), konsolidimi dhe rritja e efikasitetit në shpërndarjen e dotacioneve kapitale dhe bllok dotacioneve nga buxheti qendror. Nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut janë siguruar të ardhura stabile për komunat nga dotacionet e TVSH-së (dotacione të përgjithshme) të cilat paguhen në lartësi prej 4,5% (në fillin ishte 3%) nga tatimi i vlerës së shtuar i paguar në vitin e kaluar (përmes metodologjisë së përcaktuar). Dotacionet e TVSH-së për Komunat do të rritet nga 4,5% në 9%, ndërsa nga tatimi personal nga 3% në 9%.

**Rritja e bazuar në njohuri përmes forcimit të konkurrencës lokale dhe novacionit.** Në mënyrë që të arrihet rritja lokale në bazë të njohurive, duhet të sigurohet mbështetja konkrete dhe e vazhdueshme për hulumtime të aplikuara dhe inovacione në komuna, si në aspektin e aktiviteteve afariste ashtu edhe për shërbimet lokale. Fushëveprimi i kompetencave lokale lejon zbatimin e aktiviteteve plotësuese për zhvillimin e infrastrukturës kapitale, përmirësimin e klimës së biznesit, tërheqjen e investimeve dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë lokale bazuar në përparësitë krahasuese dhe specifikat e secilës njësi të vetëqeverisjes lokale. Qasje gjithëpërfshirëse, mirë e organizuar dhe e hapur në arsim dhe trajnim, me cilësi të lartë dhe vlerë aplikative në aspektin e zhvillimit ekonomik dhe tregut të punës në nivel lokal. Parakushtet e krijuara për të krijuar produkte /shërbime të reja që gjenerojnë rritje dhe vende pune dhe ndihmojnë në adresimin e sfidave shoqërore brenda bashkësisë lokale. Rritja e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve novatore dhe më efikase për qytetarët.

**Rritje gjithëpërfshirëse, përmes përmirësimit të cilësisë së jetës.** Në përputhje me standardet dhe praktikat e mira të BE-së, zgjidhjet ekzistuese normative mundësojnë përfshirjen plotësuese të vetëqeverisjes lokale në sistemin e mbrojtjes sociale, meqenëse janë krijuar kushte për krijimin e formave institucionale dhe jo-institucionale të orientuara drejt nevojave specifike të individëve dhe grupeve të cënueshme të qytetarëve. Nga këtu rrjedh nevoja për të forcuar rolin e autoriteteve lokale në luftën kundër varfërisë dhe dizavantazheve sociale, d.m.th. krijimin e kapaciteteve dhe burimeve lokale në funksion të ndërtimit të kohezionit social dhe nivelit të lartë të tolerancës dhe solidaritetit në bashkësinë lokale.

**Rritja e qëndrueshme përmes përdorimit të përgjegjshëm të burimeve natyrore.** Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm lokal nënkupton përdorimin e qëndrueshëm të burimeve lokale për qëllime ekonomike dhe zhvillimin e infrastrukturës së energjisë dhe transportit pa dëmtuar cilësinë e mjedisit dhe natyrës. Në parim, rritja e qëndrueshme synon të arrijë sa më shumë sinergji të jetë e mundur midis politikave të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit socio-ekonomik. Fusha e kompetencave të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë i mundëson komunave që të përmirësojnë transportin lokal dhe menaxhimin e ujit dhe mbeturinave, si dhe të zbatojnë masa konkrete për përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë, duke kontribuar në një mënyrë specifike për ruajtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës.

**Komuna të zgjuara.** Zhvillim i zgjuar ('smart') lokal dhe rajonal dhe transformimi gradual i një pjese të shërbimeve lokale në E-shërbime. Stimulimit të inovacioneve dhe konkurrencës përmes zgjidhjeve të përshtatshme të autoriteteve lokale për E-inkluzion, E-transparencë dhe E-qeverisje. Thjeshtëzimit të proceseve dhe procedurave për përgatitjen e shërbimeve lokale, si parakusht për transformimin e tyre në E-shërbime. Sigurimit të shkallës së lartë të inter-operabilitetit institucional, veçanërisht në lidhje me sigurimin e të dhënave për qytetarët nga regjistrat zyrtarë të cilët udhëhiqen në nivel qendror dhe lokal. Formimin e qendrave funksionale komunale për shërbime, si pika të vetme për kontakt me qytetarët sa u përket shërbimeve lokale por edhe shërbimeve të tjera të organeve të administratës shtetërore. Zhvillimit të E-komunave dhe stimulimit të përdorimit të teknologjive Digjitale në nivel lokal (internet-portale, platforma për shkëmbimin e të dhënave – dashboards, krijimin dhe azhurnimin e katalogëve elektronikë dhe katalogëve të qasshëm publik të të dhënave, të cilët i gjenerojnë komunat, koncepti - big/open data aplikacione për telefona mobil të lidhur me shërbimet lokale dhe shfrytëzimin e

medieve sociale për ofrimin e përmirësuar të shërbimeve lokale). Stimulimi i mekanizmave inovativ për sigurimin e shërbimeve publike në nivel lokal dhe rajonal, përmes. Rritjes së vetëdijes për rëndësinë dhe rolin e inovacioneve në krijimin e mënyrave të reja inovative për sigurimin/ofrimin e shërbimeve lokale.

## Zhvillimi i balancuar rajonal

Vendosja e praktikave Evropiane për rritjen e mjeteve vjetore për zhvillim të barabartë regjional, mekanizmave transparente për shpërndarjen e barabarte të mjeteve të 1% të BPV për regjionet planore, nga mjetet e buxhetit sipas shkallës së zhvillimit të regjioneve planore me qëllim që të stimulohet zhvillim ekonomik dhe për tu zvogëluar dallimet në regjionet planore. Mekanizmat shpërndarës do të jenë kontrollori i shpërndarjes së mjeteve dhe do të rrisë pavarësinë e Këshillave të regjioneve planore në vendimet dhe financimet e projekteve prioritare të qendrave planore, përforcimet e kapaciteteve administrative dhe financiare të Qendrave planore. Rritja e rolit të qendrave planore në thithjen e mjeteve nga Fondet e Bashkimit Evropian për realizimin e projekteve prioritare të qendrave planore.

## Projekte

|   | Projekti   | Lokacioni i projektit | Vlera e projektit (euro) | Burimi i financimit                        | Kohëzgjatja e realizimit |
|---|--|-----------------------|--------------------------|--|--------------------------|
| 1 | Rekonstruktim i rruges. Boris Kidric, rruge e re fsh. Greshnic - fsh. Dlapkindoll, rekonstruktim i rrugës fsh. Strogomishte e epërme dhe rrugë tjera | Kërçovë               | 1,232,449.00 €           | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024              |
| 2 | Rruge e re për lagjen Ambar dhe rruge  | Kumanovë              | 1,997,055.00 €           | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024              |
| 3 | Rekonstruktim i rrugës lokale per fsh. Gradec, Rekonstruktim i zonës industriale Gradec - Negotinë   | Vrapcisht             | 711,035.00 €             | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024              |

|    |   |           |                |  |             |
|----|---|-----------|----------------|--|-------------|
| 4  | Rekonstruktum i rrugës kolake Zdunje - Debresh, rekonstruktum i rrugës lokale Banjice e poshtme - Banjice e epërme, rekonstruktum i rrugës Ilindenska | Gostivar  | 1,156,537.00 € | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| 5  | Rekonstruktum i rrugës Serava, rekonstruktum i rrugës Xhon Kenedi, rekonstruktum i rrugës Sevastopolska/Krimska                                       | Cair      | 689,960.00 €   | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| 6  | Rekonstruktum i rrugës lokale Jellovjane - Uvic, rekonstruktum i rrugës lokale Novo Sellë, rekonstruktum i rrugës lokale Bogovinë                     | Bogovinë  | 721,875.00 €   | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| 7  | Rekonstruktum i rrugës lokale Sfillare e poshtme - eperme, rikonstruim i rrugës lokale fsh. Krushopek   | Saraj     | 697,191.00 €   | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| 8  | Rrugë e re C2 ne Y.E.1, rrugë e re C2 ne Y.E.8, rrugë e re rruga turistike prej Eurotel deri te Tirz  | Strugë    | 1,157,019.00 € | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| 9  | Rekonstruktum i rrugës lokale fsh. Ciflik, rekonstruktum i rrugës lokale ne fsh. Dobarce, rekonstruktum i rrugës lokale fsh. Terbosh                  | Zhelinë   | 742,449.00 €   | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| 10 | Rekonstruktum i rrugës lokale fsh. Orizare - fsh. Sllupcan  | Likovë    | 951,189.00 €   | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| 11 | Rekonstruktum i rrugës ne Venec 1, rekonstruktum i rrugës Petre Popovski dhe Zdravko Cocovski, Rekonstruktum i rrugës ne fsh. Otishan                 | Dibër     | 697,021.00 €   | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| 12 | Rrugë e re lidhëse në Pllasnicë - Dvorci - Pregllovë  | Pllasnicë | 547,633.00 €   | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |

|         |  |            |                 |  |             |
|---------|--|------------|-----------------|--|-------------|
| 13      | Rrugë lokale ne Dollnen  | Dollnen    | 707,552.00 €    | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| 14      | Rekonstruktim i rrugëve Braça Miladinovci, rruga Shtipska dhe rruga Karaorman              | Tetovë     | 1,091,428.00 €  | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| 15      | Rruge e re rruga 1 ne fsh. Studeniçan, rrugë e re rruga 8, rruge e re rruga 7 pjese e urës | Studeniçan | 633,192.00 €    | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| 16      | Rekonstruktim i rrugës Çellopek, Bërvenicë, Ko M   | Bërvenicë  | 657,291.00 €    | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| 17      | Rekonstruktim i rrugës lokale Kópance - Tudence, Rekonstruktim i rrugës lokale Shemshovë   | Jegunovcë  | 656,262.00 €    | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| 18      | 7 rrugë të propozuara  | Tearcë     | 682,618.00 €    | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| 19      | Rrugë e re lokale në Orlanci, rrugë e re rruga 4 Haraçinë, rrugë e re rruga 14 Haraçinë    | Haraçinë   | 554,858.00 €    | Kredi nga Banka botërore-grant për komunat | 2020 - 2024 |
| TOTALI: |  |            | 16,284,614.00 € |  |             |

| <b>Projektet MSIP 2 (Përmirësim i shërbimeve komunale) 2020-2021</b> |           |   |  |                        |
|--|-----------|---|--|------------------------|
| nr.  | komuna    | Sfera (infrastruktura rrugore, arsim, sport, energjetik, gazsjellës, kulture, bujqësi etj -e potenconi) | emertimi i projektit   | vlera ne total ne euro |
| 1  | Kërçovë   | MSIP  | Grant  | € 75,756.00            |
| 2  | Çair      | MSIP  | Grant- ndërrimi i pullazit të shf. Ismail Qemali   | € 48,258.00            |
| 3  | Likovë    | MSIP- financim shtese   | Nxehje qendrore me kotel të naftës në shf. Faik Konica   | € 50,055.00            |
| 4  | Tetovë    | MSIP2   | Ndërtimi i bulevardit Vidoe Smilevski Bato   | € 996,958.00           |
| 5  | Vrapçisht | MSIP2   | Stacion filtrues për ujë të pijshëm në f.Negotinë Pollog dhe stacion filtrues për ujë të pijshëm ne f.Dobërdoll  | € 505,967.00           |
| 6  | Dollnen   | Projekti i dytë MSIP2   | Rekonstruktim i rrugëve ekzistuese 3, 4 dhe 5 ne Cërnilishte dhe Rekonstruktim i shtratit ekzistues te Lumit Cërnilisht ne Cërnilishtë bashkë me rrugët për këmbësorët | € 370,326.00           |
| 7  | Likovë    | Projekti i dytë MSIP2   | Rregullimi i një pjese të Lumit Matejc   | € 227,570.00           |
| 8  | Saraj     | Projekti i dytë MSIP2   | Adaptim dhe ndërtim i ndërtesës komunale të Komunes së Sarajit   | € 206,245.00           |
| 9  | Bogovinë  | Projekti i dytë MSIP2   | Finalizimi i pjesës së shtuar të ndërtuar në objektin komunal dhe furnizimi me vetura të rënda dhe makina për NPK Shari  | € 507,814.00           |
| 10   | Tetovë    | Projekti i dytë MSIP2   | Furnizimi me autobusë për transport publik   | € 1,180,000.00         |
| 11   | Kerçovë   | MSIP  | Grant- rreth-rotullim  | € 75,999.63            |
| 12   | Bërvenicë | MSIP-financim shtesë  | Makinë e kombinuar për ngarkim   | € 49,679.00            |
| 13   | Gostivar  | MSIP- financim shtesë   | Furnizimi me mobilie dhe pajisje për kopshte fëmijësh  | € 146,550.00           |



|          |          |       |  |             |
|----------|----------|-------|--|-------------|
| 14       | Kumanovë | MSIP2 | 1. Rindërtimi i rrjetit të ujësjellësit në rrugën 11 nëntor; 2. Rindërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Rrugën Nikolla Tesla; 3. Furnizimi i makinës ndërtuese të kombinuar për mbajtësen e karrocave; 4. Prokurimi i pajisjeve të depozitimit dhe depozitimit të mbeturinave; 5. Prokurimi i kamionëve me pajisje mirëmbajtjeje dimri; 6. Prokurimi i automjetit të specializuar - merimangë për largimin e automjeteve të parkuar në mënyrë të paligjshme në vendet publike; 7. Furnizimi i automjeteve dhe pajisjeve për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të gazit shpërndarës në territorin e Komunës së Kumanovës | € 1,565,922 |
| Totali : |          |       | € 6,007,099  |             |

## Turizëm gjithëpërfshirës

Zhvillimi i turizmit për të rritur impaktin e turizmit në ekonomi dhe në krijimin e vendeve të punës. Promovimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut si një destinacion i njohur turistik, konkurrues në tregun e huaj dhe vendas me produkte të reja turistike me cilësi të lartë, si dhe promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të turizmit, me qëllim që vendi të shndërrohet në një destinacion turistik rajonal, e konkretizuar me 8 rajone turistike te cilat përfshijnë më shumë se 50 destinacione në të gjithë vendin, respektivisht nga 10 në tre drejtime bazë dhe atë: turizmin natyror, kulturor e sezonal. Krahas mjeteve nga buxheti i shtetit do të shfrytëzohen edhe mjete nga fondet evropiane IPA si instrument në dispozicion për mbështetje para aderuese.

**Implementimi i programeve për zhvillim të turizmit.** Brendimi i vendit dhe krijimi i një imazhi pozitiv të vendit si destinacion turistik ndërkombëtar. Sinjalizimi turistik. Subvencionimi dhe përkrahja e manifestimeve nacionale dhe rajonale në lëmin e turizmit që kanë të bëjnë me zhvillimin e turizmit.

Revitalizim i Çarshisë së vjetër në Shkup. Promovim i autenticitetit të Çarshisë duke investuara në revitalizim, riparim si dhe promovim i përmbajtjeve të ndryshme kulturore për aktivitete gjatë gjithë vitit.

**Online platformë turistike globale.** Lidhja me aplikacionet ndërkombëtare si Booking, TripAdvisor etj.

**Kuadri ligjor.** Ndryshime ligjore për turizëm me qëllim lehtësimin e punës së sektorit të turizmit dhe zvogëlimin e konkurrencës jo-lojale. Ndryshime në ligjin për Turizëm në drejtim të rritjes së numrit të të punësuarve për marrjen e licencës A; vendosjen e garancisë bankare; përpilimin e akteve nënligjore si dokument për sigurimin e aranzhmaneve turistike; vendosjen e komisionit për kontroll të agjencive turistike. Ndryshime ligjore në Ligjin për hotelieri në drejtim të ndryshimit të modelit për kategorizim të hoteleve; vendosjen e më shumë komisioneve për kategorizim; ndryshimin e licencave për hotelieri; formimin e komisionit për mbikëqyrje.

**Subvencionimi dhe përkrahja e manifestimeve lokale për artizanate.** Përkrahja e artizanateve do ndikojë në tërheqjen e turistëve dhe zhvillimin e turizmit rural. Promovim i produkteve lokale turistike. Rregullim i fasadave të objekteve me arkitekturë të vjetër qytetare dhe fshatare.

**Kodra e Diellit.** Dhënien e kapaciteteve hotelerike dhe ski-lifteve në menaxhim publiko-privat që do të mundësojë investime te reja në Kodrën e Diellit. Çdo investim në kapacitetet hotelerike do të ketë për qëllim sjelljen e brendeve botërore dhe ngritjen e kapaciteteve të shërbimit. Projekti në vlerë prej 1.8 - 2 milion Euro për ndërtim të parkingut me kapacitet për 350 automjete, i ndriçuar dhe me rrugë qasëse, me çka do të tejkalohen problemet e deritanishme me të cilat ballafaqohen turistët e Kodrës së Diellit. Ndërtimi i sistemit për borë artificiale (2-2.2 milion euro). Plotësimi i kushteve të nevojshme për skijim gjatë sezonit të dimrit, kur ka mungesë të borës natyrale. Instalim në ski shtigjet: Aerodrom, Teteks 1 dhe Teteks2, Ceripashin, 6 Ulëse. Gondola që lidh Tetovën me Kodrën e Diellit. Projektimi i gondolës në vlerë prej 300 mijë euro. Pas kësaj faze do të sigurohet buxheti i nevojshëm për ndërtimin e së njëjtës.

**Mali Sharr - Park Nacional.** Mali Sharr është pasuri e vlefshme kombëtare dhe shpallja e tij park nacional do të mbrojë pasuritë e ndryshme natyrore dhe në të njëjtën kohë do të rrisë numrin e turistëve që e vizitojnë atë.

**Zona turistike zhvillimore Treska - Saraj.** Zona turistike zhvillimore Treska-Saraj është një ndër projektet më me rëndësi për zhvillimin e turizmit në qytetin e Shkupit. Projekti është në fazën përfundimtare sa i përket përgatitjes së dokumentacionit. Komuna e Sarajit ka të përgatitur

të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shpalljen e Zonës turistike në Saraj. Projekti do të jetë një investim publiko privat i cili parasheh investim dhe ndërtimin të një qendre moderne turistike me liqen artificial, akua-park dhe hotele luksoze.

**Struga, qendër verore turistike.** Zonë turistike e cila do të ofroj investime të reja në sferën e turizmit. Nga komuna e Strugës është përzgjedh lokacioni dhe punohet ne përgatitjen e dokumentacionit përkatës për shpalljen e zonës turistike.

**Perla e Ohrit.** Rruajtja e vlerave kulturore dhe arkitektonike si qytet i mbrojtur na UNESCO.

**Zhvillimi i turizmit shëndetësor.** Qendra Klinike Universitare, në aspektin e kompleksitetit ofron shërbime të nivelit më të lartë dhe atë në aspekt regional duke mbuluar edhe shtetet fqinje. Rritja e numrit të pacientëve që vijnë nga fonde private brenda dhe jashtë shtetit, sjell deri te rritja e të ardhurave publike të institucioneve shëndetësore si dhe të mjekëve bartës të veprimtarisë, gjë me të cilën rriten mundësitë për përmirësimin e kushteve nëpër spitalet tona dhe rritet cilësia e shërbimit shëndetësor. Qasje serioze në promovimin dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe paramedicinale sa më kualitative, me qëllim të stimulimit të turizmit medicinal, si një ndihmesë objektive për sistemin tonë shëndetësor.

## Mjedis jetësor i pastër dhe planifikimi hapësinor

Cilësia e jetës së qytetarëve është thellësisht e gërshetuar me cilësinë e mjedisit që na rrethon, ekosistemet, uji i pijshëm, ajri i pastër, menaxhimi me mbeturina si dhe ndryshimet klimatike. Ne kemi përgjegjësi t'ju lëmë pas natyrën tonë në gjendje sa më të mirë të mundshme brezave të ardhshëm. Qëndrueshmëria afatgjate e kapitalit natyral, social dhe njerëzor, mbetet detyrim ndaj brezave të ardhshëm. Aktualisht, ne përballemi me sfida shumë të mëdha si në vend ashtu edhe në nivel global. Pa ndryshime thelbësore në prodhimin e energjisë, proceset ekonomike, transportit, sjelljen e konsumatorit, përdorimin e tokës dhe bujqësia, ndryshimet klimatike kërcënojnë të ketë pasoja të mëdha. Efektet e ndryshimeve klimatike tani më janë të dukshme, gjë që kërkon përshtatje në të gjitha temat e ardhshme. Qëllimi është ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i cilësisë së mjedisit dhe cilësisë së jetës së qytetarëve për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm, i cili do të kontribuojë në arritjen e standardeve në nivel Evropian.

## Menaxhimi me ujërat

Qasja në ujë të pijshëm për të gjithë qytetarët është prioritet kryesor. Do të sigurohet kontinuitet dhe cilësi e ujit për pije dhe kanalizime për menaxhim me ujërat e zeza në të gjitha vendbanimet.

## Menaxhimi me mbeturinat

Zhvillimi i qasjeve moderne në menaxhimin e mbeturinave me qëllim të një impakti real mbi mjedisin dhe shoqërinë: ndjekja e praktikave më të mira të vendeve të zhvilluara; zhvillimi i një ekonomie të gjelbër ku forca më e madhe socio-ekonomike mund të fitohet nga industria e menaxhimit të mbeturinave paraqet një efekt të rëndësishëm që lidhet ngushtë me zhvillimin e mjedisit të udhëhequr përmes praktikave më të mira të trajtimit të mbeturinave; një ekzaminim dhe përmirësim i praktikave të operatorëve për klasifikimin e mbeturinave dhe në industrinë e paketimit është më se e nevojshme për të zhvilluar një ndërhyrje sistematike që zvogëlon në mënyrë efektive deponimin e mbeturinave; dhe edukimi dhe ndërgjegjësimi shoqëror mbi përfitimet e menaxhimit progresiv modern të mbeturinave është thelbësore.

## Cilësia e ajrit

Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe rezultatet pasuese mbi shëndetin e njerëzve: do të shfrytëzojmë evidencat që kemi në dispozicion mbi qasjet dhe sukseset e shteteve tjera me qëllim që të informojmë dhe avancojmë iniciativat tona; edukimi dhe ngritja e vetëdijes për të ndihmuar qytetarët me qëllim që të zotojnë të ardhmen e mjedisit jetësor në shtet, si dhe për të kuptuar kërcënimet nga ndotja e ajrit; dhe rritja e efikasitetit energjetik dhe shfrytëzim i burimeve ripërtëritëse të energjisë. Përparimi drejt gjenerimit të energjisë së gjelbër për të zvogëluar emetimet e karburanteve fosile është thelbësore për një të ardhme të ajrit të pastër për Maqedoninë e Veriut. Reduktimet në emetimet e bazuara në industri dhe infrastruktura e përmirësuar e transportit publik është thelbësore për uljen e grimcave dhe ndotësve në ajrin tone.

## Ndryshimet klimatike

Përcaktimi strategjik në fushën e klimës është: përshtatja e legjislacionin kombëtar me atë të BE-së në fushën e klimës, si dhe sigurimi i kushteve për implementimin e tij; sigurimi i kushteve për uljen e emetimit të karbonit; rritja e rezistencës së sektorëve më të ndjeshëm në ndryshimet klimatike; kryerjen e detyrimeve të dala nga konventat ndërkombëtare në përputhje me dokumentet e ratifikuara si ndërkombëtare ashtu dhe rajonale; dhe ndërtimi i politikave të mençura dhe të bazuara në shkencë në partneritet me komunitetin e biznesit dhe sektorin civil. Pëmirësimi i kapaciteteve për NATURA 2000 dhe CITES. Vendet Natura 2000 janë caktuar posaçërisht për të mbrojtur zonat thelbësore për një nën-specie specie ose llojet e habitatit të listuara në Direktivat e Habiteteve dhe Zogjve.

## Përgjegjësia shoqërore

Përforcimi i përgjegjësisë shoqërore të ndërmarrjeve, inkurajimi i organeve të administratës publike të mbështesin praktikat e përgjegjësisë shoqërore që ndikojnë mjedisin jetësorë dhe vetë të demonstrojnë nivel të lartë të sjelljes së përgjegjshme dhe promovimi i kornizave udhëzuese evropiane dhe ndërkombëtare për promovimin e përgjegjësisë shoqërore.

**Tatim i gjelbër (ekologjik).** Vendosja e tatimit të gjelbër (ekologjik) në mënyrë që të stimulohen tatimpaguesit për të zvogëluar sjelljen e tyre dhe / ose aktivitetet që kontribuojnë në ndotje. Qëllimi është përballja me ndotjen dhe mbrojtja e burimeve natyrore, si dhe rritja e të ardhurave për shtetin.

**Fushatë ndërgjegjësimi.** Qëllimi i kësaj iniciative është ndërgjegjësimi dhe vetëdijësimi i qytetarëve në përgjithësi në lidhje me mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike. Inkuadrimi i kurrikulës ekologjike nëpër shkolla me qëllim që edukimi ekologjik të fillojë prej moshës më të re. Linjë telefonike 24/7 për denoncimin e ndotësve pranë Inspektoratit shtetëror të mjedisit jetësor. Personat të cilët me veprimet ose mosveprimet do të ndikojnë në ndotjen e mjedisit, do të mbajnë përgjegjësi financiare, duke përballur jo vetëm kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për dëmtimet e mjedisit, por edhe dënime dhe gjopa.

**Reduktim i përdorimit të qeseve të plastikës.** Qeset plastike paraqesin sfidë ekologjike dhe kërcënim ndaj rrethinës natyrore. Reduktimi gradual i përdorimit të tyre do të arrihet nëpërmjet inkuadrimit të çmimit më të lartë për përdorimin e qeseve për një përdorim dhe tatime dhe ngarkime financiare deri në ndalimin e prerë për përdorim të tyre.

## Projekte

|   |
|---|
| <p>Ndërtimi i sistemit kolektor në Qytetin e Shkupit</p> <p>Ujërat e zeza që derdhen në këtë moment përmes sistemit ujësjellës drejtpërdrejtë në Vardar, fillimisht do të përfundojnë nëpër sistemin kolektor që tani është duke u ndërtuar, do të shkojnë në stacionin e filtrimit, ku të pastruara do të lihen dhe do të derdhen në lum.</p> <p>Vlera e projektit: 9.680.140 EUR</p> <p>Financohet nga programi-IPA</p> <p>Realizimi i projektit ka filluar në vitin 2018 dhe do të përfundojë këtë vit(2020)</p> |
| <p>Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në komunën e Kërçovës</p> <p>Ky projekt ka për qëllim rehabilitimin e rrjetit ekzistues për kanalizim në komunën e Kërçovës dhe njëkohësisht përmirësimin e infrastrukturës aktuale.</p> <p>Vlera e projektit: 13.600.000 EUR</p> <p>Financohet nga programi-IPA</p> <p>Realizimi i projektit do të fillojë brenda këtij viti(2020) dhe pritet të përfundojë në vitin 2021</p>   |
| <p>Ndërtimi i stacionit filtrues në komunën e Manastirit</p> <p>Vlera e projektit 14.100.000 EUR</p> <p>Financohet nga programi-IPA</p> <p>Realizimi i projektit do të fillojë brenda këtij viti(2020) dhe pritet të përfundojë në vitin 2021</p>   |
| <p>Ndërtimi i stacionit filtrues në komunën e Tetovës</p> <p>Vlera e projektit 15.100.000 EUR</p> <p>Financohet nga programi-IPA</p> <p>Realizimi i projektit do të fillojë brenda këtij viti(2020) dhe pritet të përfundojë në vitin 2021</p>  |
| <p>Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në komunën e Tetovës</p> <p>Vlera e projektit 13.700.000 EUR</p> <p>Financohet nga programi-IPA</p> <p>Realizimi i projektit do të fillojë brenda këtij viti(2020) dhe pritet të përfundojë në vitin 2022</p>  |
| <p>Vendosja e një sistemi të integruar dhe financiarisht të qëndrueshëm të administrimit të mbetjeve të ngurta në rajonin Lindor dhe Veri-Lindor</p> <p>Vlera e projektit 25.700.000 EUR</p> <p>Financohet nga programi-IPA</p> <p>Realizimi i projektit do të fillojë brenda këtij viti(2020) dhe pritet të përfundojë në vitin 2022</p>   |

Furnizimi me automjete dhe pajisje për mbledhjen e mbeturinave në rajonin Lindor dhe Veri-lindor  
 Vlera e projektit 5.500.000 EUR  
 Financohet nga programi-IPA  
 Realizimi i projektit ka filluar në vitin 2019 dhe do të përfundojë brenda këtij viti (2020)

Rehabilitimi i deponisë Rusino Gostivar  
 Vlera e projektit 5.000.000 EUR  
 Projekti do të financohet me kredi nga Banka Botërore  
 Periudha e planifikuar për realizim 2020-2024

Rehabilitimi i deponive në Manastir, Strugë dhe Ohër  
 Vlera e projektit 15.000.000 EUR  
 Projekti do të financohet me kredi nga Banka Botërore  
 Periudha e planifikuar për realizim 2020-2024

Implementimi i masës për efikasitet energjetik në ndërtesat publike  
 Vlera e projektit 5.500.000 EUR  
 Financohet nga programi-IPA  
 Periudha e planifikuar për realizim 2020-2022

Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në komunën e Zhelinës  
 Projekti do të financohet me kredi nga Banka Evropiane për Investime  
 Periudha e planifikuar për realizim 2020-2024

Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në komunën e Dibrës  
 Projekti do të financohet me kredi nga Banka Evropiane për Investime  
 Periudha e planifikuar për realizim 2020-2024

Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për vendbanimet: Sellarcë e Poshtme, Bllacë, Stençe, Vollkovijë dhe Bërvenicë në komunën e Bërvenicës  
 Projekti do të financohet me kredi nga Banka Evropiane për Investime  
 Periudha e planifikuar për realizim 2020-2024

Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për vendbanimet Kamjan, Bogovinë, Kallnik, Pirok, Pallçisht, Zherovjan, Sellarcë, Siniçan në komunën e Bogovinës

- Kamjan-2.004.445 EUR
- Bogovinë-2.349.671 EUR
- Kallnik-673.000 EUR
- Pirok-1.870.800 EUR
- Pallçisht-1.278.000 EUR
- Zherovjan-1.047.000 EUR
- Sellarcë-1.046.000 EUR
- Siniçan-756.926 EUR

Projekti do të financohet me kredi nga Banka Evropiane për Investime  
 Periudha e planifikuar për realizim 2020-2024

|   |
|---|
| Rikonstruimi i rrjetit për ujë për pije në Novosellë<br>Vlera e projektit -146.350 EUR<br>Projekti do të financohet me kredi nga Banka Evropiane për Investime<br>Periudha e planifikuar për realizim 2020-2024                             |
| Rikonstruimi i rrjetit për ujë për pije në Rakovec<br>Vlera e projektit -293.000 EUR<br>Projekti do të financohet me kredi nga Banka Evropiane për Investime<br>Periudha e planifikuar për realizim 2020-2024                               |
| Shtimi i sasisë së ujit dhe rikonstruimi i rrjetit të ujësjellësit Kallnik<br>Vlera e projektit -244.000 EUR<br>Projekti do të financohet me kredi nga Banka Evropiane për Investime<br>Periudha e planifikuar për realizim 2020-2024       |
| Trasimi i ujit nga burimi kryesor deri në rezervuarin e ujit për pije në Siniçan<br>Vlera e projektit -163.000 EUR<br>Projekti do të financohet me kredi nga Banka Evropiane për Investime<br>Periudha e planifikuar për realizim 2020-2024 |
| Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në komunën e Tearcës<br>Projekti do të financohet me kredi nga Banka Evropiane për Investime<br>Periudha e planifikuar për realizim 2020-2024   |
| Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në komunën e Tearcës<br>Projekti do të financohet me kredi nga Banka Evropiane për Investime<br>Periudha e planifikuar për realizim 2020-2024  |

| Asistencë teknike për përafrimin e legjislacionit mjedisor dhe veprimeve klimatike   |           |               |     |
|--|-----------|---------------|-----|
| Planifikimi dhe zbatimi i përafrimit në zonat me përparësi mjedisore   | 2020-2021 | 2.300.000 EUR | IPA |
| Zhvillimi dhe implementimi i një fushate ndërgjegjësimi në lëmin e mjedisit  | 2020-2022 | 750.000 EUR   | IPA |
| Përmirësimi i kapaciteteve për NATURA 2000 dhe CITES   | 2020-2023 | 2.700.000 EUR | IPA |
| Zbatimi i përmirësuar i Direktivës së BE-së për Përmbytjet përmes harmonizimit të legjislacionit kombëtar dhe përgatitjes së planeve të rrezikut nga përmbytja | 2020-2022 | 2.500.000 EUR | IPA |
| Mbështetje për zbatimin e sistemeve rajonale të administrimit të mbeturinave në rajonin Lindor dhe Veri-lindor   | 2020-2022 | 2.500.000 EUR | IPA |
| Përgatitja dhe rishikimi i dokumenteve kombëtare të planifikimit të mbeturinave  | 2020-2021 | 300.000 EUR   | IPA |



|  |           |               |     |
|--|-----------|---------------|-----|
| Mbështetje në zbatimin e legjislacionit për administrimin e mbeturinave dhe skemën e zgjeruar të përgjegjësisë së prodhuesve | 2020-2022 | 1.000.000 EUR | IPA |
| Mbështetje e mëtutjeshme në zbatimin e reformave në sektorin e ujërave   | 2020-2023 | 2.500.000 EUR | IPA |
| Mbështetje në zbatimin e direktivave për cilësinë e ajrit dhe legjislacionin horizontal                                      | 2020-2022 | 2.000.000 EUR | IPA |
| Zhvillimi i një sistemi informativ për monitorimin e mjedisit jetësor  | 2019-2021 | 1.400.000 EUR | IPA |

#### Planet Hapësinore

|  |           |             |                  |
|--|-----------|-------------|------------------|
| Plani hapësinor për rajonin Shkupit    | 2020-2024 | 180.000 EUR | Buxheti i RMV-së |
| Plani hapësinor për rajonin e Pollogut | 2020-2024 | 353.000 EUR | Buxheti i RMV-së |
| Plan i ri hapësinor për RMV-në         | 2020-2024 | 506.000 EUR | Buxheti i RMV-së |

## Migrimi dhe diaspora

### Migrimi

Globalizimi dhe proceset integruese janë veçori kryesore dhe e pashmangshme e rrjedhave të gjithëmbarshme në çdo kënd të botës së sotshme. Liberalizimi i tregut dhe lëvizja e lirë e kapitalit, punës dhe dijes imponojnë migracionin si temë e kyçe në zhvillimin global. Çdo komb, vitalitetin e vet do të duhet ta verifikojë mbi bazën e përshtatjes dhe përfitimeve që do të mund të realizon në këtë kontekst gjithëpërfshirës. Ky dimension i ri i raporteve globale krijon kushte që disa fenomene sociale nga e kaluara, si që është migrimi me elemente de-integruese, tani më të shfaqet në një dimension të ri, të bëhet aseti kombëtar i lehtësimit të rrugës së integritimeve dhe të përshtatë më lehtë kombin në rrjedhat globalizuese. Migrimi dhe sidomos trendi i shpërnguljes së të rinjve të arsimuar të cilët janë resurs i rëndësishëm i zhvillimit do të jenë në epiqendër të definimit të politikave dhe programeve për të krijuar mundësi për punësim dhe kyçje të tyre në iniciativa dhe projekte ekonomike me çka do të ndikohet edhe në rritjen ekonomike dhe të mirëqenies në vendin tonë.

## Diaspora

Gjithashtu, rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe integrimin e vendit në trendet globale do të luaje edhe diaspora nëpërmjet të rritjes së bashkëpunimit të institucionalizuar në aspekt ekonomik, kulturor, social, po ashtu edhe në atë politik, arsimor dhe shkencor. Gjegjësisht, përkrahje dhe nxitje e investimeve nga diaspora, tërheqje e kapitalit njerëzor nga diaspora dhe në këtë mënyrë të ndihmohet në rritjen ekonomike duke u bazuar në përvojën dhe dijen nga vendet që vijnë. Inkuadrim i diasporës në jetën shoqëro-politike në vend duke formalizuar integrimin në organet legjislativ (deputetë), qeverisës (ministër) dhe institucione tjera shtetërore. Duke përdorur teknologjitë e komunikimit medial duke ndërtuar një portal të komunikimit interaktiv midis komuniteteve dhe aktorëve lokalë me diasporën. Nëpërmjet këtij portali do të këmbëjmë eksperience, dije dhe dituri për çështje të zhvillimeve të përgjithshme sociale, ekonomike, politike, arsimore, kulturore etj.

**Stimulum i investimeve nga diaspora si faktor i zhvillimit ekonomik të vendit.** Rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe integrimin e vendit në trendet globale do të luaj edhe diaspora nëpërmjet të rritjes së bashkëpunimit të institucionalizuar në aspekt ekonomik, kulturor, social, po ashtu edhe në atë politik, arsimor dhe shkencor. Gjegjësisht, përkrahje dhe nxitje e investimeve nga diaspora, tërheqje e kapitalit njerëzor nga diaspora dhe në këtë mënyrë të ndihmohet në rritjen ekonomike duke u bazuar në përvojën dhe dijen nga vendet që vijnë. Duke përdorur teknologjitë e komunikimit medial duke ndërtuar një portal të komunikimit interaktiv midis komuniteteve dhe aktorëve lokal me diasporën.

Nëpërmjet këtij portali do të këmbëjmë eksperiencë, dije dhe dituri për çështje të zhvillimeve të përgjithshme sociale, ekonomike, politike, arsimore, kulturore etj. Me ligjin për përkrahje financiare të Investimeve të aprovuar në Mars të vitit 2018, në nenin 33 të këtij ligji parashikohet që investimet e bëra nga ana e qytetarëve të RMV-së pjesë e diasporës që përkrahja financiare nga ana e shtetit të dyfishohet nga ajo ekzistuese. Nëse për çdo investitor tjetër, kthimi i investimit është 10% për investimet e diasporës ajo rritet për 10% shtesë.

**Fondi për (mikro)investime (Financial Facility for Remittances).** Maksimalizimin e efektit zhvillimor të remitencave të diasporës tonë. Këto remitenca duhet të kanalizohen në fusha të ndryshme të ekonomisë (ndërmarrje të vogla dhe të mesme, turizëm, ndërtimtari, agrobiznes, etj). Ne do të mbështesim institucionalisht krijimin e “Fondit për (mikro)investime”,

në formën e fondeve të ngjashme të krijuara në shumë vende të botës, të quajtura Instrumente financiare për remitencë - FFR (Financial Facility for Remittances), me strukturë multidonore (nga qeveri të ndryshme, organizata ndërkombëtare, anëtare të diasporës si dhe odat ekonomike të vendit (të interesuarat). Ky fond do të ketë dy funksione kryesore, edhe atë: 1) të krijojë një instrument financiar për mikrokreditime të investimeve inovative dhe produktive si dhe të lehtësojë transferin dhe përdorimin e remitencave dhe mjeteve tjera për këto qëllime dhe; 2. të furnizojë me ide (këshilla) dhe projekte për maksimalizimin e remitencave me vështrim të posaçëm për NVM dhe agrobiznesin në ambiente rurale. Ky fond si strukturë multidonore, do ketë bordin e vetë të përbërë nga përfaqësuesit e donatorëve dhe do të jetë pjesë e rrjetit të IFAD (Fondit ndërkombëtar për zhvillim bujqësor) dhe e Institucionit financiar ndërkombëtar - MFIC (Microfinance International institutions).

**Shfrytëzimi i kapitalit njerëzor të diasporës në favor të zhvillimit ekonomik të vendit.** Krijimi i hapësirës për zhvillimin e mobilitetit të ekspertëve të fushave të ndryshme për të kontribuar në RMV si dhe ekspert nga vendi të kontribuojnë në të mirë të Diasporës jashtë. Diaspora të jetë bartëse e promovimit të kapaciteteve ekonomike në RMV. Në emër të atashëve ekonomik të planifikuar të caktohen nga Qeveria e RMV-së 50% e pozitave të atashëve ekonomik ti takojnë personave të cilët vijnë nga diaspora. Themelimin e Qendrave të Ekselencës për rikualifikimin e fuqisë punëtore: ku Diaspora do të jetë bartëse e transferit të njohurive. Qendrat e Ekselencës janë institucione që kanë për qëllim organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive trajnuese dhe kualifikuese për kategori dhe profesione të ndryshme. Persona nga Diaspora (ekspert të dëshmuar të fushave të caktuara) të cilët pas një analize të bërë të nevojave të tregut të punës në RMV e sidomos nevojës për fuqi punëtore të kompanive nga Diaspora të cilët janë të interesuar ose veç më kanë investuar në RMV, do t'ua sigurojë fuqinë adekuate të kualifikuar. Këto qendra, në fakt do jenë vendet ku fuqia e pakualifikuar punëtore do të aftësohet në shërbim të kompanive në vend por edhe në rajon. Ligjërues dhe bartës në lëndët deficitare në Universitetet në RMV të jenë persona nga Diaspora.

## #4 JETESË CILËSORE



- Arsim cilësor dhe modern
- Shëndetësi profesionale dhe moderne
- Kulturë përfaqësuese
- Shoqëri solidare dhe politika sociale
- Mediat dhe shoqëria civile

### Arsim cilësor dhe modern

#### Arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe i orientuar drejt “nxënësit”

Në vitin 2018 u miratua Ligji i ri për arsimin e lartë, i cili u hartua në bashkëpunim me universitetet, profesorët dhe studentët, me të cilin përmirësohet dhe avancohet sistemi i akreditimit dhe evaluimit të arsimit të lartë në mënyrë të konsiderueshme. Në vitin 2019, në bashkëpunim me një numër të madh të institucioneve kredibile ndërkombëtare dhe ekspertëve miratuam Ligjin e ri për arsim fillor, që filloi të zbatohet prej vitit shkollor 2019/2020. Paralelisht, kemi punuar në reformimin e arsimit të mesëm profesional dhe harmonizimin e të njëjtit me nevojat e tregut të punës, ndërsa në gusht të vitit 2019 miratuam Ligjin e ri për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore dhe të mesme, me të cilin e rregulluam zhvillimin profesional dhe të karrierës të mësimdhënësve. Në vazhdimësi kemi punuar edhe për përmirësimin infrastrukturës arsimore duke ndërtuar dhe rinovuar shkolla dhe duke ndërtuar salla sportive, konvikte studentore e kështu me radhë.

Gjatë mandatit të fundit qeverisës në kontinuitet kemi punuar edhe për çështjen e rritjes së pagave të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore dhe të mesme (për më shumë se 21%), të profesorëve në institucionet publike të arsimit të lartë (mbi 15%) dhe të punonjësve shkencorë në institutet publike shkencore (mbi 30%). Njëkohësisht, kemi fuqizuar nga aspekti kadrovik, organizativ dhe funksional Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve.

Për Bashkimin Demokratik për Integrim arsimi cilësor është prioritet absolut dhe faktor kyç për zhvillimin e gjithëmbarshtëm shoqëror dhe i një jetese cilësore, andaj shprehim vullnet dhe mbështetje për të ecur në rrugën e

ngritjes së menjëhershme të cilësisë së arsimit në përgjithësi dhe të arsimit inkluziv si barazi sociale, arsimit profesional si domosdoshmëri për t'u përputhur me tregun ekzistues dhe arsimit të dedikuar për t'u përputhur me kushtet e tregut të së nesërme. Së këndejmi, ndarja e politikës nga arsimi, krijimi i mjedisit gjithëpërfshirës për mësim, klasa dhe shkolla që pranojnë dallimet dhe ku nxënësit mësojnë bashkë, ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm për mësim dhe trajnim profesional, programe të reja moderne mësimore, investime në shkencë dhe inovacion, si dhe mësues e profesorë të kënaqur në ushtrimin e profesionit fisnik të tyre janë themelet e qasjes vijuese të Bashkimit Demokratik për Integrim. Krijimi i një sistemi arsimor nacional konkurrues i bazuar në programet bashkëkohore të cilat mundësojnë përvetësimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave në përputhje me nevojat e shoqërisë demokratike multikulturore, tregut të punës dhe sfidave të reja në ambientin global shkencor-teknologjik. Asnjë shkollë nuk do të ketë me dy ndërrime.

Arsimi cilësor fillor, i mesëm dhe i lartë mbetet në fokusin tonë, i orientuar më shumë drejt: të mësuarit dhe matjes sistemore të rezultateve nga të mësuarit; arsimit inkluziv për nxënësit me aftësi të posaçme arsimore; qasjes së drejtë në arsim për të gjithë; barazisë gjinore në arsim; fuqizimit të sistemeve arsimore dhe rezultateve më të larta arsimore; të mësuarit digjital dhe zhvillimit të mendimit kritik; mbështetjes së kuadrit mësues dhe profesional dhe avancimit të infrastrukturës arsimore; rrjetëzimit në shkencë, hulumtimeve dhe inovacioneve si bazë për përsheptimin e tempos së zhvillimit ekonomik.

## Edukim parashkollor

**Edukimi parashkollor i obligueshëm prej 4-6 vjet.** Ndërtimi dhe përshtatja e institucioneve parashkollore në të gjitha komunat në përputhje me numrin e fëmijëve. Forcimi dhe trajnimi i stafit përkatës për përgatitje cilësore të fëmijëve në këtë fazë të edukimit. Socializimi dhe adaptimi i fëmijëve në moshën më të hershme në mjedis të ri shoqëror. Njoftimi të fëmijës në mjedis të ri social, aftësim për vijim në mësimin e rregullt shkollor dhe parapërgatitje për marrje të obligimeve dhe detyrave shkollore

## Arsimi fillor dhe i mesëm

**Askush nuk duhet të përjashtohet.** Secili fëmijë ka të drejtë në arsimin inkluziv, duke përfshirë edhe fëmijët me nevoja të posaçme arsimore dhe, gjatë kësaj, duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijës. Duke zbatuar modelin e ri të vlerësimit të mbështetjes shtesë arsimore, shëndetësore dhe sociale të fëmijëve dhe të rriturve, bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit – KNF, fokusi do të vendoset në atë që fëmija mund të arrijë. Me zgjidhjet e reja ligjore për arsimin fillor dhe të mesëm, shkollat e posaçme do të shndërrohen në shkolla me qendra resursesh që do të sigurojnë mbështetje të fuqishme për të gjitha shkollat për përfshirje më të madhe të fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore. Do të investojmë në trajnime të vazhdueshme për mësimitdhënësit dhe për krijimin e kushteve të barabarta për të gjithë, duke marrë parasysh nevojat individuale të secilit nxënës.

**Arritja e rezultateve më të larta arsimore, duke vlerësuar nxënësit.** Do të krijojmë standarde nacionale mësimore si mënyrë se si t’u ndihmohet mësimitdhënësve të formojnë bindje për vlerësimin e nxënësit, që është konsekuente dhe më e kompletuar. Me këtë mundësohet të ndiqen një sërë aftësi tek nxënësit, ndërsa edhe vetë nxënësit të kenë një baraspeshë adekuate të mbështetjes, informatave kthyesë dhe mirënjohje që të inkurajohen gjatë të mësuarit. Nëpërmjet arsimit inicial dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional do të investojmë në zhvillimin e kompetencës së mësimitdhënësve për vlerësim, me fokus të posaçëm të vlerësimit formativ që është pjesë e rëndësishme e procesit mësimor, dhe që ka disa efekte shumë të rëndësishme pozitive në suksesin e nxënësve.

**Vlerësimet nacionale dhe ndërkombëtare të arritjeve të nxënësve.** Paralelisht me vlerësimin në klasa nga ana e mësimitdhënësve, do të zhvillojmë edhe sistemin e vlerësimit nacional që do të japë informacione relevante për të mësuarit të nxënësit, pa asnjë pasojë në progresin e tyre dhe progresin e mësimitdhënësve. Në vendet e OECD-së, shumica dërmuese kanë vlerësime nacionale që të sigurojnë të dhëna më të besueshme rreth rezultateve të nxënësve që janë të krahasueshme në grupe të ndryshme të nxënësve dhe gjatë kohës. Do të vazhdojmë të marrin pjesë në mënyrë aktive edhe në testimet ndërkombëtare, si: PISA, TIMS, PRLS.

**Fleksibilitet më i madh në realizimin e programit mësimorë.** Do të sigurojmë fleksibilitet më të madh në realizimin e programit mësimor. Kjo do t’u mundësojë mësimitdhënësve të ndjekin programin nacional mësimor, por në mënyrë fleksibile, për të përmbushur nevojat mësimore të nxënësve të tyre.

Një ndryshim i tillë do të inkurajojë shkollat dhe mësime të jenë fleksibël në lidhje me zbatimin e programit mësues, duke krijuar kështu një hapësirë për vlerësimin formativ dhe mësimin e përshtatur.

**Modernizim i maturës shtetërore.** Modernizimi i maturës shtetërore përmes përshtatjes së vlerësimit për të bërë diferencë më të madhe të aftësisë së nxënësve, përmirësimin e vlerësimit të detyrës projektuese, përforcimit të komponentit për arsim profesional dhe trajnimeve lidhur me maturën shtetërore.

**Revidim i përmbajtjes së teksteve shkollore (librave).** Do të kryejmë redakturë profesionale të teksteve shkollore që përdoren në procesin arsimor në shkollat fillore dhe të mesme, në drejtim të modernizimit të përmbajtjes së tyre, eliminimin e gabimeve, paragjyqimeve dhe stereotipeve. Të gjitha tekstet shkollore, tek të cilat do të hasen gabime, do të korrigjohen dhe/ose ndërrohen me tekste të reja shkollore.

**Rishikimi i programeve mësimore.** Në bazë të Standardeve nacionale për të arriturat e nxënësve, do të kryejmë rishikimin e programeve mësimore, duke pasur për qëllim final që të njëjtat të nxisin nivele më të larta të mësimit dhe mendimit kritik të nxënësve. Do të vazhdojmë me reformën e programeve mësimore të matematikës dhe shkencave të natyrës në arsimin e mesëm, me qëllim që të sigurohet vazhdimësi në të mësuarit e këtyre lëndëve në arsimin fillor.

**Pajimi i kabineteve në shkolla.** Do t'i pajisim kabinetet në shkollat fillore dhe të mesme me materiale didaktike dhe pajisje/laboratori për realizimin cilësor të mësimit për lëndët shkollore nga sfera e shkencave natyrore.

**Miratimi i Ligjit të ri për arsimin e mesëm.** Bazuar në konceptin e Ligjit të ri për arsimin fillor, do të miratojmë Ligjin të ri për arsimin e mesëm. Ligji do të përmbajë dispozita që nënkuptojnë: avancimin e procesit mësues dhe mënyrën e organizimit të mësimit; përforcimin e vlerave themelore kushtetuese në procesin arsimor, siç është mos-diskriminimi, ndalesa për sjellje degraduese ndaj nxënësve dhe punonjësve në shkollat, vendosja e parimit të përfshirjes së plotë të nxënësve me nevojë të posaçme arsimore, profesionalizimi i drejtorëve të shkollave, eliminimi i çfarëdo mundësie për ndikime politike, vendosja e sistemit të organizimit të nxënësve dhe pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje.

**Arsimi i të rriturve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.** Krijimi i mundësi për vazhdimin e të mësuarit të të rriturve dhe përmirësimi i shkathtësisë dhe kapaciteteve të tyre është me rëndësi vitale për secilin vend, duke ndikuar në zhvillimin ekonomik të tij, pjesëmarrjen aktive të njerëzve në komunitete

dhe shoqëri civile, kultivimin e mbështetjes dhe respektit ndaj dialogut kulturor, fuqizimin e statusit të të mësuarit dhe diturive dhe në kultivimin e vlerave të kulturës së të jetuarit. Prandaj, do të vazhdojmë të punojmë në harmonizimin e mëtejshëm të sistemit të arsimit të të rriturve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës me standardet që zbatohen në vendet e BE-se dhe adaptimin e të njëjtit me to.

**Fuqizim i kuadrit mësimorë dhe profesional në shkolla.** Stafimësimdhënës dhe profesional janë hallka më e rëndësishme në realizimin e procesit edukativo-arsimor të nxënësve.

Prej tyre varet cilësia e gjeneratave që do të marrin rolin e të rriturve si në planin profesional, ashtu edhe në atë shoqëror. Prandaj, fokusi ynë kryesor në periudhën e ardhshme do të jetë përmirësimi i statusit të mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorit profesional në shoqëri, duke ndërmarrë një sërë masash dhe aktiviteteve:

- ***Pranimi në profesion dhe avancimi në karrierë të bazohet në kompetencën profesionale.*** Do të avancojmë modelin e përzgjedhjes së kandidatëve më të kualifikuar për mësimdhënësit dhe sigurimi i mbështetjes adekuate gjatë stazhit të praktikës, duke vendosur standarde të larta për akreditimin e programeve të studimit për arsimin inicial të mësuesve, përzgjedhje më e madhe për pranim në fakultetet për mësimdhënës dhe ndarja e bursave për studentët e këtyre fakulteteve të vitit të parë studimeve, sigurimi i mbështetjes cilësore mentoriale gjatë stazhit të praktikës.
- ***Zhvillim i sistemit për zhvillim të vazhdueshëm profesional.*** Do të sigurojmë mbështetje të plotë të jashtme për përsosjen profesionale të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional nëpërmjet: përsosjes profesionale që do t'u përgjigjet nevojave të mësimdhënësve, akreditimit të programeve për trajnim në bazë të prioriteteve të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional dhe shtetit, sigurimit të financimit të mjaftueshëm për përsosje profesionale të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional, përpilimit të më shumë resurseve Digjitale në mbështetje të përsosjes profesionale, zhvillimit të rrjeteve online të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional.
- ***Zhvillimit i sistemit të ngritjes në karrierë.*** Për t'u avancuar në karrierë (si mentor apo këshilltar), vlerësimi i mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional do të përqendrohet në grumbullimin e dëshmimeve autentike të përgatitjes së tyre, përmes portfolios, vëzhgimit në klasa, intervistave etj. Vlerësimi me qëllim të avancimit



do të orientohet në përgatitjen e mësimitdhënësive, respektivisht, bashkëpunëtorit profesional që të kalojë në nivelin tjetër në karrierën e tij. Avancimi në karrierë do të jetë i ndërlidhur edhe me rritjen e pagës, për t'u shpërblyer për punën e kryer me sukses.

- **Aktivi i Mësimitdhënësive.** Do të inkurajojmë shkollat të themelojnë aktivin e mësimitdhënësive me atë që do t'u jepet rol formal në përsosjen dhe ngritjen profesionale të mësimitdhënësive, që përfshin: vëzhgimin e ndërsjellë gjatë orëve dhe dhënia e informatave kthyesë, organizimin e aktiviteteve për trajnim në shkolla përmes zgjedhjes së programeve që u përgjigjen më shumë nevojave të mësimitdhënësive dhe bashkëpunëtorëve profesional nga katalogu i BZHA; kryerjen e hulumtimeve në formë të bashkëpunimit etj.
- **Rishikimi i rolit të shërbimit profesional në shkolla.** Mandati i shërbimit profesional duhet të qartësohet për të dhënë mbështetje më të fortë mësimitdhënësive rreth asaj se si të krijohet një mjedis më efektiv dhe gjithëpërfshirës për të mësuar.

**Avancimi i sistemit të evaluimit të shkollave.** Qëllimi kryesor i evaluimit të shkollave është që t'u ndihmohet që t'i përmirësojnë praktikën e veta më të mira dhe të japin llogari për cilësinë e arsimit që ua ofrojnë nxënësve. Prandaj, do t'i zbatojmë këto masa dhe aktivitete:

- **Përforsim i kadrovikëve të Byrosë për zhvillimin e arsimit dhe Qendrës për arsim profesional dhe trajnim.** Në drejtim të përbushjes së aktiviteteve të parapara për zhvillim profesional dhe të karrierës të mësimitdhënësive dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore dhe të mesme, do t'i përforsojmë me kuadro, sidomos këto dy institucione të rëndësishme në sistemin arsimor, edhe atë: Byronë për Zhvillimin e Arsimit dhe Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim. Këshilltarët e këtyre institucioneve do t'u japin mbështetje të vazhdueshme mësimitdhënësive dhe bashkëpunëtorëve profesional në realizimin e mësimitdhënies, do të kujdesen për zhvillimin e tyre profesional dhe do të kenë rol të rëndësishëm në zhvillimin e karrierës.
- **Avancimi i sistemit të vetë-evaluimit të shkollave.** Mbështetje dhe trajnim për aktorët shkollorë në lidhje me vetë-evaluimin, duke përfshirë çështje orientuese dhe listë të thjeshtëzuar me indikatorë, duke përfshirë shembuj të praktikave të mira për vetë-evaluim, krijimin e modulit obligues praktik për vetë-evaluim në arsimin inicial të drejtorëve, trajnim i rregullt për personelin e shkollës të përfshirë në vetë-evaluim, trajnim

të këshillave të shkollës, sigurim i ndihmës teknike për shkollat që kanë vështirësi në realizimin e procesit të vetë-evaluimit të plotë.

- **Avancimi i sistemit të evaluimit integral të shkollave.** Respektim të integritetit dhe kompetencës profesionale të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit. Evaluimi integral i shkollave gjithnjë do të përqendrohet në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke rishikuar kornizën për evaluimin integral për t'u fokusuar në sferat kryesore të mësimdhënies, përmirësimi i cilësisë së informacioneve kthyesë për shkollat, përpilimi i udhëzimeve për vëzhgimin e praktikave të mësimdhënies dhe ndërveprimit mes nxënësve dhe mësimdhënësve, krijimi i një procesi më të plotë të monitorimit, me fokus mbi shkollat me nevoja më të mëdha për përmirësimin, zëvendësimin e vizitës me më shumë mbështetje të vazhdueshme.
- **Zhvillimi i liderizmit arsimor për drejtorët e shkollave.** Vendosja e standardeve për kompetencë të drejtorëve të shkollave, aplikimin e programeve për mentorim, rishikimi i provimit për licencim që të përfshihet vlerësimi i shkathtësive për udhëheqje dhe liderizëm të drejtorëve, trajnim i vazhdueshëm për zhvillim profesional të drejtorit. Emërimi i drejtorëve në shkolla në mënyrë transparente në bazë të meritave.

**Arsim i mesëm profesional.** Programe mësimore që i përgjigjen kërkesave të kohës dhe që janë kompatible me nevojat e tregut të punës.

- **Modernizim i programeve mësimore për arsim profesional.** Do të aplikojmë programe mësimore modulare të bazuara në kompetenca, me rezultate nga të mësuarit dhe ECVET kredive për lëndët mësimore të përgjithshme dhe profesionale në arsimin e mesëm profesional. Programet mësimore të përgatitura në bashkëpunim me sektorin e biznesit dhe të njëjtat do t'i përgatitin të rinjtë për punësimin e tyre. Prandaj, fokusi ynë do të jetë trajnimi praktik i nxënësve tek punëdhënësit.
- **Qendrat rajonale për arsim profesional dhe trajnim.** Do të hapim tre qendra rajonale për arsim profesional dhe trajnim, edhe atë në rajonin jugperëndimor, verilindor dhe në rajonin e Pollogut. Qendrat rajonale do të pajisen tërësisht për sigurimin e kushteve cilësore në sferën e arsimit të mesëm profesional, validimi i arsimit joformal, bashkëpunimi me sektorin e biznesit në drejtim të krijimit të programeve për trajnimin e personave të rritur dhe ngjashëm.

- **Arsim profesional i dyfishtë.** Do të vazhdojmë me implementimin e arsimit të dyfishtë profesional në shkollat e mesme profesionale, në ato vende ku do të ketë interes nga sektori i biznesit dhe odat ekonomike. Në bashkëpunim me kompanitë do të zhvillojmë programe mësimore dhe do të hapim paralele për arsim të dyfishtë.
- **Ligj i ri për arsim profesional dhe trajnim.** Në bashkëpunim me komunitetin e biznesit dhe të gjitha institucionet relevante do të punojmë në hartimin e Ligjit të ri për arsim profesional dhe trajnim, qëllimi kryesor i të cilit do të jetë avancimi i cilësisë së arsimit të mesëm dhe përsosjes profesionale.
- **Ndryshim i modelit për financimin e arsimit profesional dhe trajnimit.** Në bashkëpunim me institucionet relevante ndërkombëtare dhe sektorin e biznesit do të punojmë në hartimin e një analize profesionale për gjendjen e tanishme rreth financimit të arsimit profesional dhe trajnimit e cila do të shërbejë si bazë për dizajnimin e modeleve të mundshme për financim. Në bazë të debateve publike me të gjitha palët e interesuara, do të miratohet model i ri për financimin e arsimit profesional dhe trajnimit

## Arsim i lartë, veprimtaria kërkimore-shkencore

Kryefjala e reformave në arsimin e lartë është një sistem cilësor dhe inovativ. Forcimi dhe fuqizimi i organeve/ trupave për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë (Agjencia e Cilësisë dhe Këshilli Nacional i Arsimit të Lartë dhe Veprimtarisë Hulumtuese-Shkencore).

**Ndryshimi i modelit të financimit të arsimit të lartë dhe veprimtarisë shkencore.** Do të reformojmë edhe sistemin e financimit të arsimit të lartë dhe veprimtarisë shkencore, në drejtim të sigurimit të mjeteve të mjaftueshme për zhvillimin e plotë të potencialit të institucioneve të arsimit të lartë, por edhe për të siguruar transparencë dhe përgjegjësi më të madhe nga institucionet e arsimit të lartë. Modeli i ri i financimit do të sigurojë fonde shtesë për institucionet e arsimit të lartë, por në të njëjtën kohë do të monitorojë rezultatet dalëse të institucioneve të arsimit të lartë. Modeli i ri do ta marrë në konsideratë edhe komponentin për shkencë dhe hulumtim.

Optimizim i resurseve në arsimin e lartë. Vendosja e standardeve të larta cilësore, synimi i pozicionimit udhëheqës në rajon nëpërmjet me programeve konkurruese studimore, si dhe harmonizimi me kërkesat e tregut. Do të bëhet rishikim i organizimit të arsimit të lartë dhe mundësitë e optimizimit

te resurseve të financimit të universiteteve shtetërore dhe publiko private. Investime në Universitetet dhe mirëenien e studentëve. Do të vazhdojmë me mbështetjen e fuqishme për të dy universitetet publike në gjuhën shqipe “Universiteti i Tetovës” dhe Universiteti “Nënë Tereza”. Për Universitetin “Nënë Tereza”, do të sigurojmë mjete për ndërtimin e kampusit universitar sipas trendeve bashkëkohore botërore. Paralelisht do të punojmë edhe në përmirësimin e kushteve në konviktet shtetërore të nxënësve dhe studentëve. Për nevojat e Universitetit të Tetovës do të ndërtohet një konvikt shtetëror i studentëve. Për Universitetin e Evropës Juglindore do të vazhdojmë me trendin rritës të mbështetjes financiare.

**Miratimi i Ligjit të ri për veprimtari hulumtuese-shkencore.** Në bashkëpunim me komunitetin akademik dhe shkencor do të hartojmë tekst të ri të Ligjit për veprimtari shkencore-hulumtuese, me të cilin do të fokusohemi më shumë në mbështetjen e shkencës, hulumtimit dhe inovacioneve si nga shteti po ashtu edhe nga sektori privat, si dhe do të zhvillojmë konceptin për “shkencë të hapur”.

**Mbështetja e projekteve nacionale për shkencë dhe hulumtim.** Në drejtim të mbështetjes së veprimtarisë shkencore-hulumtuese, do të financojmë projekte nacionale për shkencë dhe hulumtim, në të cilat do të punojnë institutet shkencore publike dhe private, institucionet e arsimit të lartë dhe studiuesit/hulumtuesit individualë.

**Projekte bilaterale për shkencë dhe hulumtim.** Do të vazhdojmë me mbështetjen dhe financimin e projekteve bilaterale shkencore-hulumtuese me vendet me të cilat Maqedonia e Veriut ka nënshkruar marrëveshje për financimin e projekteve. Njëkohësisht, do të punojmë edhe për lidhjen e marrëveshjeve të reja me shtetet e tjera, në drejtim të rritjes së mobilitetit dhe ndërkombëtarizimit të veprimtarisë shkencore-hulumtuese.

**Programet ndërkombëtare për shkencë, hulumtime dhe inovacione.** Do të vazhdojmë me mbështetjen dhe financimin e kuotizacionit për pjesëmarrje në Programin ndërkombëtar për shkencë, hulumtime dhe inovacione “Horizont 2020” (Horizont Evropë), COST dhe ngjashëm, me çka do t’u ndihmojmë subjekteve shkencore-hulumtuese dhe institucioneve të arsimit të lartë të aplikojnë për projekte dhe grante në kuadër të këtij programi. Do të vazhdojmë me anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare, si IAEA, CERN, me çka punonjësve shkencorë, hulumtuesve dhe profesorëve u ofrohet mundësi për lëvizje (mobilitet). Njëkohësisht, do të mbështetim edhe pjesëmarrjen në Konzorciumin Evropian për Infrastrukturë Hulumtuese (ERIC) si dhe CESSDA ERIC, European social survey- ESS ERIC dhe të tjera.

**Qasja në bazat ndërkombëtare shkencore.** Mbështetje dhe financim të aksesit/qasjes në bazat ndërkombëtare me punime shkencore, për profesorët dhe studentët e institucioneve të arsimit të lartë dhe shkencorë.

**Financim i punimeve shkencore-kërkimore.** Mbështetje dhe ndarje të mjeteve financiare për punimet e publikuara shkencore-hulumtuese nga autorë vendas në revistat ndërkombëtare shkencore me faktor të ndikimit (faktor impakti).

**Mbështetje financiare për pjesëmarrje në ngjarje shkencore.** Do të vazhdojmë me mbështetjen dhe ndarjen e mjeteve financiare për pjesëmarrjen e studiuesve shkencorë vendas në takime ndërkombëtare shkencore dhe për organizimin e takimeve.

**Brain Gain.** Me qëllim të kontributit në vendlindje nga ana e kuadrove që tani më janë shkolluar dhe kanë angazhim në institucione të ndryshme në vende të ndryshme (Evropë, Amerikë, Australi, Azi etj), Bashkimi Demokratik për Integrim do të krijojë platformë informimi dhe ofertë bashkëpunimi për të mundësuar kontributin e këtyre kuadrove në institucion dhe proceset që zhvillohen në Maqedoni. Këtë synim do ta arrijmë duke mbështetur konceptimin dhe implementimin e projektit të njohur me emrin “Brain Gain” për Republikën e Maqedonisë së Veriut, respektivisht projekt dedikuar “diasporës akademike” dhe bartësve të biznesit me prejardhje nga vendi dhe rajoni.

## Projekte kapitale në arsim

| Projekti                           | Vlera (Eur)    | Fillimi | Përfundimi | Vendbanimi            | Përshkrim   |
|------------------------------------|----------------|---------|------------|-----------------------|---|
| Ndërtimi i objektit të ri shkollor | 1.153.000 euro | 2020    | 2022       | Reçicë e Vogël        | Ndërtim i objektit të ri Shkollor për SH.FK „ Naim Frashëri, Reçicë e Vogël |
| Ndërtimi i objektit të ri shkollor | 300.000 euro   | 2020    | 2022       | Fsh. Bllacë e Poshtme | Ndërtim i objektit të ri Shkollor   |
| Ndërtimi i objektit të ri shkollor | 1.153.000 euro | 2020    | 2022       | Vizbeg                | Ndërtim i objektit të ri Shkollor   |
| Ndërtimi i objektit të ri shkollor | 166.000 euro   | 2020    | 2022       | Klukovec              | Ndërtim i objektit të ri Shkollor   |
| Ndërtimi i objektit të ri shkollor | 1.153.000 euro | 2020    | 2022       | Fsh. Sellcë           | Ndërtim i objektit të ri Shkollor për SHF„Rilindja „, Fsh. Sellcë           |

|   |                |      |      |              |  |
|---|----------------|------|------|--------------|--|
| Ndërtimi i objektit të ri shkollor        | 1.235.000 euro | 2020 | 2021 | Çair         | Ndërtim i objektit të ri Shkollor për SHFP,,Idnina,, Çair                            |
| Rikonstruksioni i tualeteve dhe dysHEMEVE | 106.000 euro   | 2020 | 2020 | Kumanovë     | Rikonstruksioni i tualeteve dhe dysHEMEVE në SHFK "Bajram Shabani" në Kumanovë       |
| Rikonstruksioni i dritareve dhe dysHEMEVE | 106.000 euro   | 2020 | 2020 | Strugë       | Rikonstruksioni i dritareve dhe dysHEMEVE për SHFK "Josip Broz Tito" në Strugë       |
| Rikonstruksioni i sistemit për ngrohje    | 106.000 euro   | 2020 | 2020 | Fsh.Zhitoshë | Rikonstruksioni i sistemit për ngrohje për SHFK "Liria" Fsh. Zhitoshë                |
| Rikonstruksioni i fasadës                 | 150.000.00     | 2020 | 2021 | Fsh. Mogorçë | Rikonstruksioni i fasadës për SHFP "Riçko Ristevski" në Fsh.Mogorçë- Komuna e Dibrës |
| Rikonstruksioni i fasadës                 | 150.000.00     | 2020 | 2021 | Kumanovë     | Rikonstruksioni i fasadës për SHF "Tollu Zordumis" në Kumanovë                       |
| Rikonstruksioni i fasadës                 | 120.000.00     | 2020 | 2021 | Fsh. Kamjan  | Rikonstruksioni i fasadës për SHF "Sabedin Bajrami" në Fsh.Kamjan Komuna e Bogovinës |
| Rikonstruksioni i fasadës                 | 100.000.00     | 2020 | 2021 | Fsh. Forinë  | Rikonstruksioni i fasadës për SHF "Përparimi" në Fsh. Forinë Komuna e Gostivarit     |
| Rikonstruksioni i fasadës                 | 250.000.00     | 2020 | 2021 | Saraj        | Rikonstruksioni i fasadës për SHF "Dituria" në Saraj                                 |
| Rikonstruksioni i fasadës                 | 80.000.00      | 2020 | 2021 | Fsh.Vrutok   | Rikonstruksioni i fasadës për SHF "Liria" në Fsh.Vrutok Komuna e Gostivarit          |
| Rikonstruksioni i fasadës                 | 250.000.00     | 2020 | 2021 | Dibër        | Rikonstruksioni i fasadës për SHF "Bratstvo Edinstvo" në Dibër                       |

|  |              |      |      |                 |  |
|--|--------------|------|------|-----------------|--|
| Rikonstruksioni i fasadës                            | 180.000.00   | 2020 | 2021 | Fsh. Çegran     | Rikonstruksioni i fasadës për SHF "Përparimi" në Fsh. Çegran Komuna e Gostivarit           |
| Rikonstruksioni i fasadës                            | 250.000.00   | 2020 | 2020 | Fsh. Labunishtë | Rikonstruksioni i fasadës për SHF "Murat Labunishti" në Fsh.Labunishtë Komuna e Strugës    |
| Rikonstruksioni i fasadës                            | 250.000.00   | 2020 | 2020 | Kumanovë        | Rikonstruksioni i fasadës për SHF "Bajram Shabani" në Kumanovë                             |
| Rikonstruksioni i fasadës                            | 150.000.00   | 2020 | 2020 | Fsh.Çerkez      | Rikonstruksioni i fasadës për SHF "Jeronim De Rada" në Fsh. Çërkez Komuna e Kumanovës      |
| Rikonstruksioni i fasadës                            | 300.000.00   | 2020 | 2020 | Kumanovë        | Rikonstruksioni i fasadës për SHF "Naim Frashëri" në Kumanovë                              |
| Rikonstruksioni i fasadës dhe çatisë                 | 250.000.00   | 2020 | 2020 | Strugë          | Rikonstruksioni i fasadës dhe çatisë për SHF "Josip Broz Tito" në Strugë                   |
| Rikonstruksioni i tualeteve                          | 60.000.00    | 2020 | 2021 | Gostivar        | Rikonstruksioni i tualeteve për SHMK "Gostivar" në Gostivar                                |
| Rikonstruksioni i sistemit për ngrohje dhe dyshemeve | 100.000.00   | 2020 | 2021 | Fsh. Stençe     | Rikonstruksioni i sistemit për ngrohje dhe dyshemeve për SHF. "Goce Dellçev" në Fsh.Stençe |
| Rikonstruksioni i tualeteve fasadës, çatisë          | 280.000.00   | 2020 | 2021 | Çair            | Rikonstruksioni i tualeteve fasadës, çatisë në SHF "Jane Sandanski", në Çair               |
| Ndërtimi i sallës sportive                           | 390.244 euro | 2020 | 2020 | Kumanovë        | Ndërtimi i sallës sportive në SHMK "Nace Bugjoni", në Kumanovë                             |
| Ndërtimi i sallës sportive                           | 390.244 euro | 2020 | 2020 | Fsh. Hotël      | Ndërtimi i sallës sportive në SHF "Anton Zako Çajupi", Fsh.Hotël                           |

|                            |              |      |      |                 |  |
|----------------------------|--------------|------|------|-----------------|--|
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2021 | Fsh. Greshnicë  | Ndërtimi i sallës sportive në SHF "Faik Konica", Komuna e Kërçovës, f. Greshnicë |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2020 | Fsh. Dobrosh    | SHF "Faik Konica", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Dobrosh                    |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2020 | Fsh. Debresht   | SHF "Vera Ciriviri Trena", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Debresht           |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2020 | Fsh. Mateç      | SHF "Kultura", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Mateç                          |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2021 | Fsh. Dobridoll  | SHF "Sali Lisi", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Dobridoll                    |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2021 | Çair            | SHF "Kongresi i Manastirit", ndërtimi i sallës sportive në Çair                  |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2020 | Fsh. Opaj       | SHF "7 Marsi", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Opaj                           |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh. Sllatinë   | SHF "Eqrem Çabej", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Sllatinë                   |
| Ndërtimi i sallës sportive | 650.000 euro | 2020 | 2024 | Tetovë          | SHF "Bratstvo Migjeni", ndërtimi i sallës sportive në Komunën e Tetovës          |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh. Moranë     | SHF "Naim Frashëri", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Moranë                   |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Tetovë          | SHF "Andrea Saveski Kikish", ndërtimi i sallës sportive në Tetovë                |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh. Ladorishtë | SHF "Asim Agushi", ndërtimi i sallës sportive në Strugë                          |



|                            |              |      |      |                         |  |
|----------------------------|--------------|------|------|-------------------------|--|
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh. Dollogozhdë        | SHF "Zihni Hani", ndërtimi i sallës sportive në Strugë                     |
| Ndërtimi i sallës sportive | 650.000 euro | 2020 | 2024 | Fsh. Bogovinë           | SHF "Abdyl Frashëri" ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Bogovinë           |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh. Pallçisht          | SHF "Dervish Cara", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Pallçisht           |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh. Pirok              | SHF "Sami Frashëri", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Pirok              |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh. Krushopek          | SHF "Boris Kidriq", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Krushopek           |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh. Koliçani i Poshtëm | SHF "Kemal Atatürk", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Koliçani i Poshtëm |
| Ndërtimi i sallës sportive | 650.000 euro | 2020 | 2024 | Tetovë                  | SHF "Kirili dhe Metodi", ndërtimi i sallës sportive në Tetovë              |
| Ndërtimi i sallës sportive | 650.000 euro | 2020 | 2024 | Tetovë                  | SHF "Liria", ndërtimi i sallës sportive në Tetovë                          |
| Ndërtimi i sallës sportive | 650.000 euro | 2020 | 2024 | Tetovë                  | SHF "Naim Frashëri", ndërtimi i sallës sportive në Tetovë                  |
| Ndërtimi i sallës sportive | 650.000 euro | 2020 | 2024 | Tetovë                  | SHF "Istikball", ndërtimi i sallës sportive në Tetovë                      |
| Ndërtimi i sallës sportive | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh. Sellcë             | SHF "Rilindja", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Sellcë                  |
| Ndërtimi i sallës sportive | 650.000 euro | 2020 | 2024 | Fsh. Xhepçishtë         | SHF "Gjergj Kastrioti", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Xhepçishtë      |
| Ndërtimi i sallës sportive | 650.000 euro | 2020 | 2024 | Kërçovë                 | SHF Kuzman J. Pitu", ndërtimi i sallës sportive në Kërçovë                 |

|  |              |      |      |                  |   |
|--|--------------|------|------|------------------|---|
| Ndërtimi i sallës sportive                                       | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh.Vranisht     | SHF "Josip Broz Tito", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Vranishtë |
| Ndërtimi i sallës sportive                                       | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh.Podgorcë     | SHF "Goce Dellçev", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Podgorcë     |
| Ndërtimi i sallës sportive                                       | 650.000 euro | 2020 | 2024 | Fsh. Vrapçishtë  | SHF "Vrapçisht", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Vrapçishtë      |
| Ndërtimi i sallës sportive                                       | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Strugë           | SHF "Josip Broz Tito", ndërtimi i sallës sportive në Strugë         |
| Ndërtimi i sallës sportive                                       | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh.Bukoviç      | SHF "Emin Duraku", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Bukoviç       |
| Ndërtimi i sallës sportive                                       | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh.Çellopek     | SHF "7 Marsi", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Çellopek          |
| Ndërtimi i sallës sportive                                       | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh. Dollogozhdë | SHF "Nuri Mazari", ndërtimi i sallës sportive në Fsh. Dollogozhdë   |
| Ndërtimi i sallës sportive                                       | 390.244 euro | 2020 | 2024 | Fsh.Çajle        | SHF "Çajle", ndërtimi i sallës sportive në Fsh.Çajle                |
| Ndërtimi i konviktit të ri studentor                             | 160,000,000  | 2020 | 2021 | Tetovë           | Ndërtimi i konviktit të ri studentor në Universitetin e Tetovës     |
| Ndërtimi i objektit të ri për Universitetin „Nënë Tereza,, Shkup | 3,500,000    | 2020 | 2024 | Shkup            | Ndërtimi i objektit të ri për Universitetin „Nënë Tereza,, Shkup    |
| Ndërtimi i objektit për gjimnazin „Sami Frashëri,,               | 1,000,000    | 2021 | 2022 | Kumanovë         | Ndërtimi i objektit për gjimnazin „Sami Frashëri,, Kumanovë         |

## Shëndetësi profesionale dhe moderne

Dimensioni i shëndetit nuk nënkupton vetëm mungesë të sëmundjes ose dobësisë, po një gjendje të plotë fizike, mendore dhe mirëqenie sociale, siç e përcakton edhe Organizata Botërore e Shëndetësisë. Të qenit i shëndoshë është parakusht për të gjitha aktivitetet tjera shoqërore. Andaj në sferën e jetesës cilësore, në fokus e kemi edhe zhvillimin e shëndetësisë.

Karakteristikë e sektorit shëndetësorë është se çdo ndryshim, ka pasoja afatgjate, respektivisht rezultatet e ndryshimeve shihen në staza më të gjata. Për këtë arsye, çdo ndryshim dhe reformim në sektorin e shëndetësisë duhet të kalojë përmes procesit të vlerësimit dhe ndikimit të reformave të planifikuara. Komplexiteti i sektorit edhe më shumë rritet kur e shtojmë edhe faktorin e humanizmit, që paraqet një dimension që profilet tjera profesionale shumë më pak e kanë të potencuar në veprimtarinë e tyre.

Përmirësimet në sektorin e shëndetësisë do të kenë një qasje shumë-dimensionale si investimi në pajisje të specifikuar paralelisht me edukimin e kuadrit profesional mjekësor, investime në infrastrukturë bashkë me zgjerimin e gamës së shërbimeve dhe qasjes në shëndetësi, politika shëndetësore të përqendruara tek pacienti dhe mjeku.

### Organizimi i sistemit shëndetësor

Sistemi shëndetësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut edhe në aspektin organizativ hapëron me trendet perëndimore. Ai është kryesisht publik, respektivisht shërbimet më të mëdha popullatës i ofrohen nga institucionet shtetërore si në fushën e promovimit të jetesës së shëndetshme, po ashtu edhe në parandalimin, diagnostikimin dhe kurimin e sëmundjeve. Sektori privat në shëndetësi mbulon pjesën më të madhe të shëndetësisë primare, shërbimit farmaceutik dhe atij stomatologjik, si dhe disa klinika diagnostikuese-terapeutike të të gjitha niveleve dhe llojeve të specialiteteve. U realizua sigurimi shëndetësor për të gjithë qytetarët e R.M-së që numërojnë afro 1.8 milion. Kjo nënkupton mbulimin e plotë me sigurim shëndetësor të qytetarëve të RMV-së, mbrojtjen e tyre shëndetësore nga sëmundjet dhe pasojat individuale e sociale të tyre, pakësimin e papunësisë fiktive, si dhe pakësimin afatmësëm e afatgjatë të shpenzimeve shëndetësore në kontingjentin e sotëm të pasiguar. Me këtë program nëpërmjet zbatimit të masave dhe aktiviteteve për sigurim shëndetësor të përgjithshëm u siguroa qasje universale në shfrytëzimin e mbrojtjes shëndetësore për gjithë popullatën.

Shëndetësia në vend është e organizuar në formë piramide në bazë të shtrirjes dhe nivelit të shërbimit shëndetësorë në tri nivele, edhe atë: niveli parësor, dytësor dhe terciar. Niveli parësor ka shtrirje më të gjerë në popullatë dhe ofron nivel më elementar në aspektin e shërbimeve shëndetësore, përderisa në nivelin terciar është e kundërta, respektivisht ofrohen shërbime shumë të specializuara ndaj një numri shumë më të vogël të pacientëve. Shërbimet në të tria nivelet ofrohen nga kuadër profesional shëndetësor, të cilët vazhdimisht trajnohen nga institucione të profesionalizuara brenda dhe jashtë vendit. Krahas këtyre institucioneve, shërbime shëndetësore ofrojnë edhe disa institute të cilat në mënyrë aktive merren me mbikëqyrjen, parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve, si p.sh. Instituti për shëndet publik është institucioni më i lartë teknik në fushën e shëndetit publik, i cili është një institucion shtetëror në lidhshmëri direkte me Ministrinë e Shëndetësisë. Detyrat e tij përfshijnë studimin dhe monitorimin e faktorëve të rrezikut, ndjekjen e sëmundjeve ngjithëse, referencën laboratorike si dhe menaxhimin e programeve të vaksinimit. Zbatimi i mjaft programeve afatshkurtra me natyrë studimore apo promovuese të shëndetit është gjithashtu pjesë e aktivitetit të tij. Instituti luan një rol të rëndësishëm lidhur me trajnimin në fushën e shëndetit publik.

Në kuadër të sistemit shëndetësor funksionojnë edhe disa organe si organe te veçanta juridike si Agjencia për barna i cili realizon kontrollin e barnave, mban regjistrin e barnave, licencimin e barnatoreve, pastaj Agjencia për akreditimin e institucioneve shëndetësore, Inspektorati sanitar i cili vazhdimisht vëzhgon situatën në institucionet shëndetësore në përgjithësi si në ato private ashtu edhe në ato publike, në aspektin e kontrollit të hapësirave, kontrollin higjienik dhe me para-shkresë të palëve bën kontrollin e personelit.

## Kujdesi shëndetësor parësor - “Mjeku 24 orë afër qytetarit”

**Ambulancat.** Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pjesa kurative e shëndetësisë primare thuajse është privatizuar tërësisht. Andaj qasja jonë ne përkrahjen e këtij sektori shumë të rëndësishëm të shëndetësisë do të jetë si vijon:

- Përkrahje financiare e ambulancave dhe poliklinikave në nivel primar, me analogji të përkrahjeve të bizneseve të vogla dhe të mesme.
- Zbutja e politikave ndëshkuese, për shkak se dënimi duhet të jetë masë disiplinore për rritjen e kualitetit të shërbimit shëndetësor.
- Rritje e kapitacionit për ambulancat private

- Lehtësime në punët e përditshme të mjekut në mjekësi primare, duke e thjeshtëzuar dhe shkurtuar transferin e pacientëve kur mjeku amë e lëshon institucionin ku punon, gjithsesi duke e ruajtur të drejtën e pacientit si dhe preferencat e tija në zgjedhjen e mjekut amë.
- Ndërtimi ose rikonstruimi i ambulancave në vende rurale
- Përforcimi i ekipeve me personel mjekësor, aparatura mobile si dhe medikamente të nevojshme, me qëllim që qytetarët të marrin shërbime sa më të shpejta dhe cilësore në vendbanimet rurale në të cilat nuk ka mjek amë.

**Shtëpitë e shëndetit.** Shtëpia e shëndetit kryen veprimtari shëndetësore të paktën në: Ndhimë emergjente mjekësore dhe kujdesin shtëpiak, ndihmë emergjente dentare, kujdesin preventiv shëndetësor për arsimin parashkollor dhe fëmijët e shkollës, patronazhin polivalent, kujdesin dentar për fëmijët deri në moshën 14 vjeç dhe statistikën në shëndetësi, si dhe ofron shërbime specialistike në kabinetet specialistike. Ne do të mundësojmë investime serioze në shtëpitë e shëndetit, me qëllim të rritjes së kualitetit të shërbimit shëndetësor, edhe atë përmes investimeve infrastrukturore, investimeve në aparatura, si dhe duke investuar në resurse njerëzore, edhe atë si vijon:

- Rritjen e kapaciteteve infrastrukturore, pajisjeve, si dhe të resurseve humane të shtëpisë së shëndetit në Likovë, e cila është në formim e sipër, me çka do të zgjerojmë shërbimet shëndetësore për banorët e kësaj komune
- Ndërtimin dhe renovimin e poliklinikave në komunat Saraj, Bllace, Studeniçan dhe Haraçinë, me çka do të jemi prezent në vendet rurale të banuara kryesisht me popullatë shqiptare duke ofruar shërbime shëndetësore kualitative
- Rehabilitimi i objekteve ekzistuese dhe ndërtimi i objekteve të reja sipas nevojës në të gjitha komunat, si dhe blerja e aparaturave të nevojshme.
- Rritjen e numrit të personelit mjekësor në shërbimin e patronazhit polivalent më qëllim që vizitat në shtëpi të jenë më të shpeshta dhe përveç të porsalindurve dhe grave shtatzëna, të mund të vizitohen edhe të sëmurët kronik si dhe personat e moshuar.

**Shërbimi i ndihmës së shpejtë.** Shërbimet shëndetësore për rastet urgjente, përmes Ndhmës së shpejtë, janë arritur maksimalisht në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Mirëpo, në regjionet rurale, për shkak të qasjes joadekuate, deficitit të infrastrukturës rrugore si dhe objekteve dhe deficitit të resurseve njerëzore nuk mund të arrihen nevojat adekuate shëndetësore të popullatës.

- Vazhdojmë me furnizim me makina të ndihmës së shpejtë, si dhe sofistifikimin e tyre me pajisje të reja moderne, si parakusht për aplikimin e tele-mjekësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Hapjen e punkteve të ndihmës së shpejtë në periferitë e qyteteve në tërë territorin e RMV-së, që sa më shumë ti afrohem vendëve rurale dhe të rrisim shtrirjen në territor që të ofrojmë shërbim sa më të shpejtë, respektivisht të shkurtojmë kohën e arritjes së ekipit të ndihmës së shpejtë te personat në nevojë.
- Formimi i një qendre monitoruese dhe komunikuese (call and monitoring centre), për rritjen e efikasitetit të ndihmës së pare.
- Zgjidhja e çështjes me resurset njerëzore, respektivisht punësime ose angazhime honorar të mjekëve që nuk janë të punësuar në institucionet përkatëse. Gjithashtu do të përkushtohemi në rritjen e numrit të specialistëve të mjekësisë urgjente, si parakusht për një shërbim më kualitativ në këtë lëmi.
- Programe edukimi ALS (advanced life support), ATLS (Advanced trauma life support), CLS (Cardiac Life support) si dhe PLS (Pediatric life support) për ekipe profesionale që punojnë në ekipet e ndihmës së parë si në sektorin prespitalor, ashtu edhe në atë spitalor.
- Përmirësim të evidencës mjekësore, duke ngërthyer këti edhe përpilimin dhe respektimin e protokolleve për transport dhe trajtim të pacientëve që kanë nevojë për trajtim urgjent.

**Vaksinimi.** Do të inkuadrojmë edhe mbulimin e ndërrimit të dytë në të gjitha punktet e vaksinimit aty ku ka nevojë të cilët do të shërbejnë edhe si këshillimore. Do të vazhdojnë edhe projektet për edukim të vazhdueshëm të personelit mjekësor. Organizimi i ligjëratave të ndryshme edukuese për prindërit si dhe kampanja mediatike, me qëllim ruajtjen e përqindjes së realizimit të vaksinimit si dhe vetëdijesimin e prindërve për dobitë e vaksinave polivalente. Furnizimi me vakcina polivalente.

**Shëndeti publik.** Shëndeti publik i referohet “shkencës dhe artit të parandalimit të sëmundjeve, zgjatjen e jetës dhe promovimin e shëndetit përmes përpjekjeve të organizuara, informacioneve shëndetësore ndaj shoqërisë, organizatave publike dhe private, komuniteteve dhe individëve. Me qëllim të rritjes së interesit në shëndetësinë preventive primare në këtë degë shumë deficitare të mjekësisë, do të mundësojmë punësim sa më të shpejtë në këtë lëmi dhe njëkohësisht do të sigurojmë specializim në fushat e mjekësisë preventive, me mundësi të mëdha për zhvillim të shpejtë profesional si dhe akademik.

Do të vazhdojmë me implementimin e masave preventive përmes mjekëve amë për parandalimin e sëmundjeve vdekjeprurëse të sëmundjeve kronike kardiovaskulare, nefrologjike dhe diabetit për moshën 35-56 vjeçare, si dhe për karcinomën në gji, prostatë, zorrën e trashë, zbulimin e hershëm të çrregullimit të të parit, të folurit dhe të dëgjuarit të dëmtuar për fëmijët e moshës 3-6 vjeçare si dhe zbulimin e hershëm të deformimit të boshtit kurrizor për fëmijët e moshës 6-14 vjeçare. Fushatë ndërjegjësimi për benefitet e aktivitetit fizik, pasojat e konsumit të alkoolit, duhanit, ushqimeve hiper-kalorike në bashkëpunim me Sekretariatit për Arsim dhe Punonjësve mjekësorë.

## Kujdesi shëndetësor dytësor

Në piramidën e organizimit të shëndetësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mjekësia dytësore zë vend shumë të rëndësishëm. Ajo absorbon numrin më të madh të pacientëve të udhëzuar për trajtim spitalor nga mjekësia parësore, duke përfaqësuar një barrierë të madhe që e kursen mjekësinë terciare nga fluksi i madh i pacientëve. Rritja e kualitetit të shërbimit në nivel dytësor, cilësisë dhe sasisë në të njëjtin, i lejon mjekësisë terciare që të merret me çështje zhvillimore, edukative dhe arsimore.

**Spitali klinik i Tetovës.** Edhe më tej do ta zhvillojmë Spitalin Klinik të Tetovës përmes rikonstruimit dhe shtimit të kapaciteteve logjistike, duke i plotësuar nevojat e theksuara për pajisje bashkëkohore. Vazhdojmë në rritjen e sasisë dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore në nivel dytësor, duke absorbuar një numër të konsiderueshëm të shërbimeve që ofrohen në Qendrën Klinike Universitare “Nënë Tereza” – Shkup. Vazhdojmë me investime milionëshe me qëllim të përmirësimit të kualitetit të shërbimit shëndetësor. Implementojmë metoda të reja dhe zhvillojmë degë të reja të mjekësisë edhe atë në drejtim të përgatitjes për Qendër Klinike Universitare në Tetovë, ku do të ofrohen shërbime shëndetësore të mjekësisë terciare.

- Vazhdimi i rikonstruimeve në spitalin klinik të Tetovës dhe furnizim me pajisje mjekësore, me çka do të sigurojmë kushte në bazë të standardeve evropiane, hapësira pune për personelin si dhe për studentët e mjekësisë mundësi për kryerjen e praktikës mjekësore në kushte të barabarta me shtetet e rajonit.
- Ndërtimi i objektit të ri në të cilin do të vendosen: terapia fizikale, infektologjia, onkologjia, dermatovenerologjia, etj.
- Zhvillim i Qendrës Klinike Universitare, duke ofruar shërbime të mjekësisë terciare

**Spitali i Kumanovës.** Në spitalin e Kumanovës do të angazhohemi për t'i përmirësuar kushtet e përgjithshme si dhe për rritjen e numrit të shërbimeve që u ofrohen qytetarëve, edhe atë duke rrugëtuar në drejtim të transformimit në Spital Klinik.

- Rikonstruimin e hapësirave në Spitalin e Përgjithshëm të Kumanovës.
- Ndërtimi i qendrës së ekselencës për sëmundje kirurgjikale geriatrike.
- Ndërtimi i objektit të terapisë fizikale, qendrës për trajtimin e dhembjes/onkologjisë, dispanzerit të TBC-së
- Përgatitje e studimit të fizibilitetit – analizës për lokacionin, kapacitetin dhe patologjinë që do të trajtohet, për ndërtimin e një spitali pulmologjik /internist në Komunën e Likovës.

**Spitali gjinekologjik – Çair.** Rikonstruimi i pjesës së mbetur të spitalit, ku përfshihen: pavijonet e gjinekologjisë operative, intensive, sallave të operacionit, patologjisë së barrës dhe urgjencës gjinekologjike.

**Spitali i përgjithshëm në Kërçovë.** Përfundimi i objektit i cili do të ofrojë shërbime cilësore dhe do të pajiset me aparaturë moderne e të sofistikuar, do të përfshijë qendra diagnostike për trajtim stacionar, stacionar për te sëmur në kirurgji, medicinë interne, gjinekologji dhe obstetrikë si dhe pjesën e ambulancës.

**Spitali i përgjithshëm – Gostivar.** Planifikohet të startohet me shërbimet kirurgjike në oftalmologji, laparoskopia në urologji, kolonoskopia dhe gastroskopia.

- Rikonstruimi i çatisë.
- Rikonstruimi dhe ndërtimi mbi 80% të dritareve.
- Rikonstruimi dhe rinovimi i hapësirave nëpër reparte.



- Rikonstruimi dhe riadaptimi i objektit të mëparshëm të hemodializës në ambulanca interniste (poliklinike).
- Formimi i repartit të ri për urologji në hapësirat ekzistuese të ambulancave interniste të cilat janë në brendësi të spitalit dhe të cilat planifikojmë t'i dislokojmë te objekti i vjetër për hemodializë).
- Rikonstruimi i katit të V për personelin e administratës dhe drejtorisë.

**Spitali i përgjithshëm në Strugë.** Do të shqyrtojmë mundësinë për zgjidhje afatgjate duke dislokuar objektet e spitalit në hapësira të tjera.

Spitali i nefrologjisë në Strugë.

- Kthimin e shërbimit të dializës ambulatorë dhe aparate të reja për HD (hemodializë).
- Pajisja me aparatura diagnostike të nefrologjisë.
- Rikonstruimi i dhomave (dritare dhe dysheme).

**Spitali i Dibrës.** Përforcimi i kapaciteteve profesionale me mjek specialist të profileve të ndryshme me qëllim të dhënies kualitative të shërbimeve shëndetësore.

- Rikonstruimi i fasadës.
- Rikonstruimi i kulmit (çatisë).

## Kujdesi shëndetësor klinik – Terciar

Kujdesi shëndetësor terciar paraqet majën e piramidës së shëndetësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në të ofrohen shërbime sub-specialistike dhe është stacioni i fundit për çdo pacient në kufijtë e shtetit tonë. Niveli i shëndetësisë është më i larti në shtet dhe në të trajtohen të gjitha rastet komplekse si dhe të gjitha komplikimet që vijnë nga të gjitha institucionet shëndetësore pa marrë parasysh a janë private apo shtetërore.

Kujdesi shëndetësor terciar ofrohet në Qendrën Klinike Universitare “Nënë Tereza” në Shkup. Në oborrin e kompleksit është i vendosur edhe Dekanati i Fakultetit të Mjekësisë të Shkupit. Si të tilla të dyja së bashku zhvillojnë veprimtari arsimore në edukimin e studentëve, specializantëve si dhe sub-specialistëve. Po ashtu, në kuadër të Qendrës Klinike Universitare bëhet punë e bujshme shkencore, ku edhe formohen shkencëtarët e rinj, duke mbrojtur titujt shkencor si magjistraturat, po ashtu edhe doktoraturat.

**Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore.** Investime për përmirësimin e gjendjes së objekteve ekzistuese, si dhe ndërtime të reja të objekteve shëndetësore. Rritja e mjeteve buxhetore në mënyrë transparente për investime kapitale në sferën e shëndetësisë, kryesisht si investime infrastrukturore në ndërtime të objekteve shëndetësore si dhe renovime të hapësirave ekzistuese, meqë e njëjta ndikon në rritjen e kualitetit të shërbimit shëndetësor.

- Në nivel terciar do të ndërtohet një objekti në të cilin do të vendosen mbi 25 klinika dhe institute, me kushte dhe standarde të klinikave të Bashkimit Evropian. Projekti është në fazën fillestare dhe përafërsisht planifikohet të kushtojë rreth 70 milion euro. Përveç këtij projekti madhor i cili do të mbulojë shumicën e Klinikave, në të gjitha institucionet në nivel terciar të cilat nuk janë të inkuadruara në projektin e lartpërmendur, do të angazhohemi të përmirësojmë kushtet e punës për punonjësit shëndetësorë si dhe të sigurojmë kushte më të mira për pacientët.
- Investime në aparaturë mjekësore. Investime serioze buxhetore në pajisje bashkëkohore mjekësore, si një ndër parakushtet për diagnostikim dhe trajtim adekuat, kualitativ dhe modern të sëmundjeve dhe si vazhdimësi e investimeve të cilat i kemi bërë edhe në të kaluarën.

**Bashkëpunimi me Kosovën dhe Shqipërinë.** Falë angazhimit tonë, mes R. së Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë ekziston bashkëpunim intensiv në fushën e shëndetësisë. Në periudhën e ardhshme ne do të angazhohemi për thellimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit sidomos në këto fusha:

- Trajtimi i pacienteve – Do të mundësohen lehtësime financiare mbi bazën e reciprocitetit për trajtimin e pacientëve nga Kosova në Maqedoninë e Veriut dhe të pacientëve nga Maqedonia e Veriut në Kosovë;
- Legjislacioni – Për arsye të ngjashmërive historike të sistemeve shëndetësore të të dyja vendeve, do të këmbehen përvojat në fushën e legjislacionit shëndetësor;
- Shkëmbimi i përvojave. Shfrytëzimi i përvojave të vendit tonë nga ana e sistemit shëndetësor të Kosovës në përpjekjet e tyre për formimin e Fondit të Sigurimit Shëndetësor.

**Implementimi i përvojave të reja dhe shpërndarja e dijes.** Zhvillimi i shëndetësisë është i kushtëzuar nga implementimi i metodave të reja, me qëllim të ofrimit të një kualiteti më të lartë të shërbimit shëndetësorë. Sjellja e metodave të reja mundëson zvogëlimin e udhëzimit të pacientëve nëpër shtete të tjera me qëllim të trajtimit të sëmundjeve. Procesi i implementimit të metodave të reja është ngushtë i lidhur me investime të rëndësishme hapësinore dhe me pajisje mjekësore, por gjithashtu është shumë i varur edhe nga investimet në resurse humane me qëllim të edukimit të tyre në implementimin e këtyre metodave.

- Shpërndarja e veprimtarisë dhe e dijes nëpër spitalet e nivelit më të ulët. Nisur nga nevoja për rritjen kuantitative të personelit mjekësorë dhe përforcimin e cilësisë së shërbimeve do të stimulojmë disperzimin e kuadrit mjekësor të profesionalizuar në lëmi të ndryshme që punon në Qendrën Klinike Universitare dhe nëpër spitalet tjera, që të ofrojnë shërbime shëndetësore nëpër spitalet tjera ku ka nevojë, por në të njëjtën kohë të bëjë edhe edukimin e kuadrit ekzistues, që të rrisë cilësinë e shërbimit në vendin amë. Shembull për të përshëndetur janë zhvillimi i onkologjisë në Spitalin Klinik të Tetovës. Në të njëjtën formë planifikojmë të realizojmë zhvillimin e onkologjisë në Kumanovë, Traumatologjisë dhe kirurgjisë abdominale në Tetovë dhe Kumanovë, po edhe më gjerë, oftalmologjisë në Tetovë, Gostivar, Kumanovë, Kërçovë, etj.

## Stomatologjia

Stomatologjia paraqet një degë të rëndësishme mjekësore ku përfshihen shërbime të nivelit parësor, dytësor, si dhe të atij terciar. Stomatologjia preventive kryesisht është veprimtari që trajtojnë shtëpitë e shëndetit si dhe Klinika për Stomatologji preventive pran Qendrës Klinike Stomatologjike “Shën Pantelejmon”. Përmes kontrolleve shëndetësore të popullatës, bëhet parandalimi i sëmundjeve të shëndetit oral. Shërbime të nivelit dytësor po ashtu trajtohen në Qendrën Klinike Universitare Stomatologjike në Shkup, si dhe në shumë ambulanca specialistike në territorin e R.MV-së.

- Zgjerim i rrjetit të ambulancave specialistike, si ato private ashtu edhe ato me kontrata me fondin shëndetësorë në komuna shqiptare.
- Rritje e kapitacioneve në nivelin që ka qenë më herët, në drejtim të ngjashëm me mjekët e praktikës së përgjithshme, duke marr parasysh harxhimet reale për funksionim të një ordinance.
- Kthimin e organizatave shëndetësore ku në kuadër të një subjekti juridik

kanë funksionuar më tepër subjekte, me çka zvogëlohen harxhime të konsiderueshme për drejtuesit.

- Mundësimi i kushteve për inkorporim të RTG aparateve në kuadër të ambulancave stomatologjike, duke i shkurtuar procedurat dhe harxhimet.
- Përkrahje të fuqishme Shoqatës Stomatologjike Shqiptare gjatë veprimit të saj, në të njëjtën kohë duke i shfrytëzuar kapacitetet e tyre profesionale.
- Implementim i tërësishëm i marrëveshjes mes USHT-së dhe Klinikës Universitare Stomatologjike në Shkup, ku do të mundësohet shfrytëzimi i hapësirave dhe mjeteve që disponon Klinika që studentëve të stomatologjisë tu mundësohet njoftim me aparaturën dhe metodat më të avancuara stomatologjike në shtet.

## Fondi për sigurim shëndetësor

Rritja e buxhetit për Institucionet shëndetësore publike është motivuese me qëllim që të rritet vëllimi dhe kualiteti i shërbimeve shëndetësore. Rritja e mjeteve është e kushtëzuar me rritjen e numrit të intervenimeve kirurgjikale tek Klinikat dhe Spitalet e përgjithshme, duke synuar zvogëlimin e udhëzimeve që jepen drejt Klinikave të kryeqytetit.

**Rritja e kualitetit të shërbimeve mjekësore dhe nivelit të shërbimeve shëndetësore.** Angazhim permanent në drejtim të futjes së shërbimeve të reja shëndetësore, me qëllim rritjen e buxheteve të institucioneve shëndetësore.

Gjatë përpilimit të buxheteve për Institucionet shëndetësore publike dhe private të merret parasysh kriteri i numrit të siguruesve (banorëve) për të cilët Institucionet shëndetësore ofrojnë shërbime shëndetësore.

- Rritja e barnave në listën pozitive për sëmundjet e rralla.
- Rritja e numrit të pajisjeve ortopedike për siguruesit me nevoja të veçanta (specifike).
- Korrigjim laserik me qëllim heqjen nga përdorimi i mbajtjes së syzave si dhe thjerrëzave për studentët nga moshën 18 – 26 vjeç me dioptri mbi +/- 2 të cilët vijnë nga familje me të ardhura vjetore deri në 115,080 denarë.

**Shërbime shëndetësore më afër të siguruarve.** Mundësia e zgjerimit të rrjetit nga ana e Ministrisë së shëndetësisë me qëllim dhënien e lejeve për ambulanca specialiste, konsultative, për barnatore si dhe për laborator, LU1 dhe LU2.

- Hapja e sporteve të FSSHM-së në Tearcë, Bërvenicë, etj.

**Përmirësim i shëndetit publik të popullatës.** Implementimi i masave preventive përmes mjekëve amë për parandalimin e sëmundjeve vdekjeprurëse dhe të sëmundjeve kronike kardiovaskulare, nefrologjike dhe diabetit për moshën 35-56 vjeçare, si dhe për karcinomën në gji, prostatë, zorrën e trashë, zbulimin e hershëm të çrregullimit të të parit, të folurit dhe zërit të dëmtuar për fëmijët e moshës 3-6 vjeçare si dhe zbulimi i hershëm i deformimit të boshtit kurrizor për fëmijët e moshës 6-14 vjeçare.

**Bashkëpunimi rajonal.** Marrëveshje me Shqipërinë për sigurim social, është nënshkruar më 17 Mars të vitit 2015 në Shkup. Ratifikimi i marrëveshjes është bërë nga të dy palët dhe pritet të hyn në fuqi. Marrëveshja rregullon të drejtat nga sigurimet sociale, të drejtat e sigurimit shëndetësor, sigurimit pensional dhe invalidor, të drejtat prej lëndimeve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Fondi për Sigurimin Shëndetësor, si organ ndërlidhës, është përgjegjës për zbatimin e dispozitave të fushës së sigurimit shëndetësor. Në bazë të marrëveshjes, personat e siguruar të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë në fushën e sigurimit shëndetësor ushtrojnë këto të drejta:

- E drejta për të mbledhur periudhat e sigurimit,
- E drejta për të përdorur shërbime shëndetësore gjatë qëndrimit të përkohshëm,
- E drejta për të përdorur shërbimet shëndetësore gjatë referencës në punë të përkohshme,
- E drejta e referimit-dërgimit për mjekim,
- E drejta për të përdorur shërbimet shëndetësore në kohën e qëndrimit të përhershëm.

RMV-ja ka dërguar iniciativë deri te Republika e Kosovës për të nisur procedurën për nënshkrimin e marrëveshjes për sigurim social, me të cilën gjithashtu do të realizohen të drejtat e lartpërmendura të personave të siguruar nga të dy shtetet kontraktuese.

## Resurset njerëzore – “Mjek i lumtur – pacienti i lumtur”

Vitet e fundit vërehet i ashtuquajti fenomeni i “ikjes së trurit” (braindrain), respektivisht largimi i një numri të konsiderueshëm të kuadrit të profesionalizuar mjekësor, kryesisht mjekëve, në kërkim për kushte më të mira të punës si dhe për paga më të mira, gjë që shkakton vështirësi në organizimin e sistemit shëndetësorë. Edhe pse lëvizja e lirë e qytetarëve

është e drejtë elementare e njeriut, ne jemi të bindur se me përmirësimin e kushteve të përgjithshme të jetesës dhe veçanërisht të kushteve në sferën e shëndetësisë mundemi ta reduktojmë këtë fenomen. Duke e pasur parasysh faktin se mjeku është shtylla kryesore e sistemit shëndetësor, në bashkëpunim me odat dhe shoqatat e mjekëve, si dhe duke marrë parasysh nevojat dhe kërkesat e mjekëve, do të realizojmë projekte konkrete për avancimin e statusit të mjekut dhe personelit përcjellës mjekësor dhe teknik. Përmes rritjes së satisfacionit të mjekut dhe personelit përcjellës, edhe atë duke i përmirësuar kushtet e punës, duke implementuar sistem të sigurtë dhe mirë të kontrolluar të shpërblimit sipas punës, si dhe duke mundësuar beneficione tjera për mjekun, do të përmirësojmë kualitetin e shërbimit shëndetësorë për pacientët, gjithnjë duke respektuar parimin kryesor “mjek i lumtur, pacient i lumtur”.

**Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i punëtorëve shëndetësor.** Qëllimi ynë është të mos ketë asnjë mjek pa punë. Implementimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat në sistemin shëndetësor, si kategori kushtetuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është një nga sfidat më të mëdha që kemi pasur në të kaluarën dhe kërkon qasje serioze edhe në të ardhmen për respektim të këtij parimi edhe në institucionet arsimore shëndetësore, institutet në kuadër të Fakulteteve, të gjitha trajnimet, specializimet, etj.

**Përkrahje e kadrove profesionale shëndetësore.** Beneficimi i mjekëve të posa diplomuar. Angazhimi i mjekëve të posa diplomuar dhe stimulimi i tyre financiar është i një rëndësie të veçantë për vet ata, me qëllim orientimit dhe profilimit të tyre profesional.

- Beneficimi i specialistëve të të gjitha lëmenjve shëndetësorë. Duke e pasur parasysh faktin se specialistët janë perspektiva e shëndetësisë, te të njëjtit do të implementojmë politika stimuluese, edhe atë: duke i legalizuar specialistët privat dhe ata që paguhen nga vetë shteti, do të përmirësojmë kushtet e punës duke i trajtuar si punëtorë shëndetësor gjatë gjithë periudhës së specializimit me të gjitha të drejtat si në aspektin e orarit të punës, ashtu edhe në aspektin financiar; do të angazhohemi të subvencionojmë sa më shumë nga numri i përgjithshëm i specializimeve private, përderisa në të njëjtën kohë të zvogëlohet numri i përgjithshëm i specializimeve private.
- Rritja permanente e pagave të mjekëve. Rritja e të ardhurave të mjekëve, ka qenë dhe do të mbetet një ndër qëllimet tona më të rëndësishme.
- Specializim në fushën e shëndetësisë preventive. Me qëllim të rritjes së interesit në shëndetësinë preventive, në këtë degë shumë deficitare të mjekësisë, do të mundësojmë punësim sa më të shpejtë në këtë lëmi,

duke i siguruar kuadrot e reja që sa më shpejtë që të jetë e mundur do të sigurojmë specializim në fushat e mjekësisë preventive, me mundësi të mëdha për zhvillim të shpejtë profesional si dhe akademik.

- Trajnimet jashtë shtetit. Kemi qenë të fokusuar në mënyrë të veçantë në fuqizimin e potencialeve njerëzore në shëndetësi, e për këtë qëllim është iniciuar një reformë rrënjësore në sistemin e edukimit, në riedukimin profesional të kuadrit në shëndetësinë publike, përkatësisht implementimin e specializimeve dhe të trajnimeve profesionale jashtë vendit. Do të vazhdojmë me tempo më të sforcuar të edukimeve jashtë shtetit dhe në të njëjtën kohë t'i bëjmë të njëjtat të specifikuar edhe më efektive, që të rezultojnë me një numër më të madh të metodave të reja në mjekësinë tonë.
- Trajnimi i kuadrit mjekësor nga ana e eksperteve cilësorë nga jashtë, nëpërmjet rrjetit të Universiteteve të njohura botërore dhe nëpërmjet memorandumit për bashkëpunim të të gjitha Klinikave dhe Instituteve.
- Modernizim i shërbimit të infermierisë sipas modeleve të legjisllacionit evropian dhe në përshtatje me nevojat reale.

## **Balancim ekonomik - “Të shëndetshëm, jemi të gjithë të barabartë”**

Shfrytëzimi racional i resurseve, distribuimi i të njëjtave si dhe sigurimi i mjeteve shtesë për sektorin e shëndetësisë janë prioritet i yni dhe me përkushtim do të përcaktojmë metodologjinë më të mirë që cost-benefit-i të jetë më i mirë. Standard shëndetësor të barabartë për çdo qytetarë në çdo cep të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke mos mënjanuar disparitetin nëpër institucionet shëndetësore.

**Shpërndarja e drejtë, fer dhe transparente e mjeteve financiare.** Shpërndarja e drejtë dhe proporcionale, pa diskriminime është obligim për ofrimin e balancuar të shërbimeve shëndetësore në nivel shtetëror. Do të revidojmë kriteret për përcaktimin e buxheteve të institucioneve shëndetësore.

**Integrim i barabartë i operatorëve ekonomik (institucioneve shëndetësore).** Në të tre nivelet e shëndetësisë, në sektorin e stomatologjisë dhe farmacisë, i ashtuquajtur i integrimi ekonomik. Kushte të njëjta ekonomike, si dhe respektimi efektiv i ligjeve, do të ofrojnë ambient

të barabartë të biznesit para ligjeve dhe institucioneve vendore, qasje të barabartë në fonde të ndryshme.

**Stimulim i biznes klimës në sferën e shëndetësisë.** Stimulimi të investimeve të investitorëve të huaj duke përgatitur legjislativë për koncesionim ose PPP (private-public partnership); Zvogëlim të dënimeve si dhe vendosjes së vërejtjeve para dënimeve; Klasifikim të dënimeve në bazë të potencialit financiar të kompanisë; përkrahje institucionale për hapjen e institucioneve shëndetësore.

**Mjeku rural.** Subvencionim dhe stimulim për mjekët që punojnë në vendet rurale me çka përmbushet dhe obligimi ligjor që çdo banorë të ketë mbrojtje primare shëndetësore.

## E-Shëndetësia – kompjuterizimi i sistemit shëndetësor

Elektronizimi dhe Digjitalizimi në shëndetësi si domosdoshmëri e kohës paraqet një proces të gjatë dhe plot sfida. Por duhet nënvizuar se elektronizimi në shëndetësinë tonë është një nga projektet më të avancuara dhe një ndër të parat në Ballkan. Do të mbi-ndërtojmë dhe zgjerojmë kompjuterizimin e sistemit shëndetësorë.

**Zhvillimi i Drejtorisë për shëndetësi elektronike.** Me themelimin e Drejtorisë për shëndetësi elektronike, u hapen dyert për instalimin e një sistemi të ri informacioni të integruar dhe të kompjuterizuar, i shtrirë në të gjitha hallkat, nivelet dhe institucionet e tij. Në të njëjtën kohë u ofrua mundësia e kalimit të mënyrës së deritanishme të mbledhjes, regjistrimit dhe raportimit të të dhënave shëndetësore individuale të pacientëve dhe ato të institucioneve dhe shëndetit publik, nga forma në letër në atë Digjitale dhe elektronike. Gjithashtu, ofrohet unifikimi i definicioneve, klasifikimit të sëmundjeve, akteve dhe mënyrave të matjes të proceseve e rezultateve me kriteret e përbashkëta; etablimin e Dosjeve shëndetësore elektronike me një bazë qendrore të të dhënave, duke përfshirë këtu edhe recetat, udhëzimet, etj. Elektronizimi dhe Digjitalizimi i plotë lehtëson, precizon dhe rritur performancën e mjekut në të gjitha nivelet e mbrojtjes shëndetësore.

- Aplikimi i listës elektronike për pacientë. Do ta përkrahim dhe do ta konservojmë listën elektronike të pritjes për shërbime, intervenimeve dhe operacioneve me qëllim të sinqeritetit ndaj pacientëve të siguar. Me respektimin e listave të pritjes, rrisim lojalitetin ndaj pacientëve dhe mundësojmë që të funksionojë puna shtesë si koncept të cilin ne e përkrahim në tërësi.



- Avancim i sistemit Termini im. Sistemi elektronik për caktimin dhe evidentimin elektronik të vizitave të mjeku dhe intervenimeve mjekësore aplikohet në tërë territorin e vendit. Shfrytëzimi i tij dhe kartelës elektronike kontribuon për zvogëlimin e radhëve të pritjes së pacienteve para ambulancave, e me këtë edhe për shërbime shëndetësore më cilësore dhe zvogëlimin e shqetësimeve të pacientëve dhe personelit mjekësor. Sistemit i duhet avancim dhe përsosje e mëtutjeshme që të mund të jetë sa më efikas në realizimin e qëllimeve për të cilat është i destinuar.
- Rritja e numrit të inxhinierëve teknik. Fokus të veçantë do të kemi në punësime të inxhinierëve klinik, për mirëmbajtjen e aparaturave medicinale.

## Kulturë përfaqësuese

Kultura është një veçori dhe bindje e përbashkët e një shoqërie ku përfshihen shumë aspekte, të tilla si: gjuha, zakonet, vlerat, normat, rregullat e të tjera. Në një vend shumë-etnik si Maqedonia e Veriut e cila përbëhet nga më shumë grupe etnike e që pasqyron kultura të ndryshme, bindshëm mund të themi se krenohemi me vlerat të cilat i posedojmë dhe kjo e potencon rëndësinë se pse kulturës duhet t'i kushtohet vëmendje më e madhe. Kultura në vete përfshin të gjitha aspektet që i tangojnë njerëzit dhe këtu komunitat luajnë rol të rëndësishëm dhe në bashkëpunim me ta shihen mundësitë e bashkëpunimit rreth krijimit të institucioneve të reja që i përkasin sferës së kulturës dhe të cilat për këtë rajon janë të domosdoshme. Afirmimi i veprimitarisë kulturore-folklorike, që kryesisht bëhet nga sektori civil është shumë me rëndësi për përfaqësimin e traditave tona shekullore me çka vëmendje e veçantë do ti kushtohet edhe formësimit institucional të shumë veprimitarive tjera të kulturës.

## Politikat afatgjate dhe strategjike të BDI-së në kulturë

- Rritjen e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë dhe në rritjen e cilësisë artistike
- Hartimin dhe zbatimin e një platforme arsimore përmes Institucioneve të Artit dhe Trashëgimisë kulturore në sistemin para-universitar

- Ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë materiale dhe jo materiale
- Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet personave me aftësi të kufizuara, në krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës
- Nxitjen dhe përfaqësimin e vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë (materiale dhe jo materiale) shqiptare, në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare si dhe prezantim të përvojave më të mira
- Mbështetjen e krijimtarisë së artistëve shqiptarë dhe shtim të veprave kulturore artistike
- Trajnimin e artistëve që kanë profesione deficitare në lëmin e kulturës (etnolog, arkeolog, historian arti, kulturolog, muzeolog, skenograf, kostumograf, dizajn dritash, fonistë, garderobier dhe grim).

## Prioritetet për mandatin 2020-2024

**Investime kapitale në kulturë, kultivimi dhe ruajtja e trashëgimisë së patundshme kulturore.** Ndërtimi i Teatrit dhe bibliotekës në Tetovë; Ndërtimi i objektit të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut; Ndërtimi i Pallateve të Kulturës në komunën e Tearcës, Zhelinës, Haraçinës, Çairit, Sarajit dhe Pllasnicës; Revitalizimi i Çarshisë së Vjetër; dhe Restaurimi dhe rinovimi i objekteve të kulturës, përfshi këtu ato kombëtare dhe fetare, tradicionale dhe moderne. Investime në Kalanë e Tetovës ku do të bëhet rikonstruimi, konzervimi, restaurimi dhe revitalizimi i saj; rikonstruimi, konzervimi, restaurimi i kompleksit Harabati Baba Teqe; përfundimi i Muzeut së Mehmet Pashë Derallës si dhe konzervimi, restaurimi dhe konstruimi i xhamisë së Tabanovces; gjurmime arkeologjike, sistematike në lokalitetin e fshatit Kamjan i quajtur Kalaja, gjurmime arkeologjike sistematike dhe konzervuese të mozaiqeve në lokalitetin e fshatit Gërdec, gjegjësisht, në qytetin e njohur antik Draudakum; në Uskanë, qytetin e famshëm antik që gjendet nën rrënojat e Kalasë së qytetit të Kërçovës, do të bëhen gjurmime dhe mbledhje të të dhënave elementare në Kalanë Kitino ndërsa në Kalanë e fshatit Leshkë e cila është e periudhës së vonshme antike, do të bëhen gjurmime arkeologjike sistematike; në fshatin Shipkovicë do të bëhen gjurmime arkeologjike dhe sistematike në rrënojat e qytetit antik Isar Banishtë, i periudhës antike si dhe në fshatin Jegunovcë do të bëhen gjurmime arkeologjike sistematike; krijimi i një harte të monumenteve të kulturës të cilat do të vihen në shërbim të komunitetit artistik, qytetarëve dhe vizitorëve të ndryshëm.

## Themelimi i Institucioneve kulturore

- Themelimi i Institucionit Nacional, Teatër Muzikor i Shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qendër në Tetovë. Në kuadër të këtij institucioni do të funksionojnë sektorët si: Orkestra e Teatrit, Kori profesional, Sektori i solistëve, Sektori i baletit si dhe Sektori për fëmijë. Në këtë Teatër muzikor, do të krijohen mundësi të panumërta për artistët, kompozitorët, instrumentistët, dirigjentët, koreografët, kërcimtarët dhe një rëndësi e posaçme do të ju kushtohet fëmijëve.
- Themelimi i muzeut historik kombëtar Ilirio-Dardan, ku do të vendosen artefakte Ilirio-Dardane – Shkup:
- Themelimi i një teatri për fëmijë dhe për të rinjtë në qytetin e Tetovës.
- Themelimi i institucionit nacional teatri i Kumanovës: duke marrë parasysh funksionimin e suksesshëm të deri tanishëm, dikasteri i dramës shqipe pranë Qendrës për Kulturë në Kumanovë duhet të shndërrohet në drejtori në vete – e shkëputur nga Qendra Kulturore në Kumanovë.
- Themelimi i dikastereve të dramës dhe arteve vizuele brenda qendrave për kulturë në Kërçovë, Dibër dhe Strugë si dhe themelimin e institucioneve nacionale, galeri të arteve në qytetet e Kërçovës, Gostivarit dhe Strugës.

**Përforcimi i kapaciteteve të institucioneve ekzistuese të kulturës.** Do të kontribuohet në përforcimin dhe funksionimin e plot të bibliotekave, pallateve të kulturës, galerive, muzeve etj. Bibliotekat dhe pallatet e kulturës janë objekte kulturore esenciale për çdo grupmoshë dhe funksionimi i tyre me kapacitet të plotë do të ndikojë pozitivisht në ngritjen dhe edukimin e gjeneratave të reja.

**Manifestimet kulturore – institucionalizimi i tyre.** Përkrahje të vazhdueshme manifestimeve kulturore dhe nxitje të aftësive krijuese të artistëve dhe artdashësve në përgjithësi. Duke u nisur nga kjo, do të ndërmerren hapa konkrete, si vijon më poshtë:

- Institucionalizimi i festivalit “Vera kulturore tetovare” që në vitin 2020 numëron edicionin e tetë ku do të përfshihet muzika klasike, xhez muzika, rok grupe. Ky festival përfshin edhe letërsinë, dramën, filmin dhe artet e aplikuara. Ky festival duhet të ketë kontinuitet dhe të renditet në një nivel me “Verën e Ohrit”. Festalet shtetërore të cilat do të institucionalizojnë në mënyrë të plotë jetën tonë muzikore: “Akordet e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut” për muzikën e popullarizuar, festivali ndërkombëtar i folklorit “Nëntori”, “Festivali i muzikës

klasike shqiptare” dhe festivali ndërkombëtarë për solo këngëtarë dhe instrumentistë “Artisti i ri”.

- Institucionalizimi i festivalit mbarëkombëtar i këngës për fëmijë. Ky festival përfshin fëmijë të moshës 8-12 vjeçare dhe ka për qëllim të radhitet në një festivali me nivel shtetëror sikurse “Zlatno Slavejçe”. Ky festival do të mbledh autorët më të mirë të këngës për fëmijë nga festivalet e të gjitha qyteteve “Ylberi” Shkup, “Bletëzat” Tetovë, “Tingujt e artë” Gostivar, “Peshku i artë” Strugë, “Fluturat” Kumanovë dhe “Bilbilat e Korabit” Dibër, si dhe festivaleve në Kosovë dhe Shqipëri.
- Festivali Teatror dhe Festivali i filmit me karakter shëtitës që do t'i përfshijë të gjitha qytetet shqiptare. Ideja kryesore e kësaj është që prodhimet artistike të mund të disperzohen në çdo qytet me shumicë shqiptare përmes një festivali përkatës, një për projektet teatrore dhe një për ato filmike.

## Afirmimi dhe ndërkombëtarizimi i kulturës dhe artit shqiptar jashtë vendit

I rëndësishëm për ne është edhe bashkëpunimi institucionalo-kulturor me institucionet simotra në qendrat rajonale dhe evropiane, në bazë të shkëmbimit të projekteve, kuadrit, programit dhe përvojave të suksesshme ku do të përfshihen projekte partneriteti, vizita dhe shfaqje të ndryshme, anëtarësim në rrjete dhe organizata të rëndësishme ndërkombëtare që do t'i fuqizojnë institucionet tona. Në kuadër të marrëveshjes ndërshtetërore mes Republikës së Maqedonisë së Veriut, Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës do të insistohet në një orar dhe program të përbashkët kulturor mes institucioneve kombëtare siç janë Teatrot, Galeritë, Bibliotekat, Filharmonitë, Opera dhe Baleti si dhe Ansamblet Folklorike.

Përcaktimi i emrave eminentë të kulturës për ambasadorë gjegjësisht përhapës të kulturës në vende të ndryshme në botë, në qendrat e kulturës që i ka Republika e Maqedonisë së Veriut nëpër vende të ndryshme të botës, të realizohen projekte kulturore.

**Kujdesi për diasporën në fqinjësi dhe në botë.** Në kuadër të Programit për financimin e projekteve nga sfera e diasporës do të financohen projekte/aktivitete programore të shoqatave, të personave juridik dhe fizik për sferat: thellimin e bashkëpunimit kulturor mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe diasporës; promovimin e gjuhës amtare, traditës dhe kulturës; ekzistencën e medieve elektronike dhe të shkruara në gjuhën amtare për nevojat e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në diasporë.

## Shoqëri solidare dhe politikat e mirëqenies sociale

Rritja ekonomike gjithëpërfshirëse nënkupton standard më të lartë të jetesës dhe garanton një shoqëri më stabile dhe prosperitet ekonomik. Të mirat e zhvillimi shoqëror dhe ekonomik do të i ndiejnë të gjithë shtresat e shoqërisë. Solidariteti është forca që zhvillon shoqërinë. Politikat sociale dhe të punësimit do të fokusohen kryesisht në drejtim të arritjes të një barazie sociale, zvogëlimit të varfërisë, rritjes së punësimeve.

### Paga dinjitoze dhe standard më të lartë jetësor

**Nxitja e pagesës së rrogave më të larta.** Përmes aktiviteteve të ndryshme, siç janë: rritja e rrogës minimale në vend, rritja e pagave në administratën publike, posaçërisht në sektorë kyç sikur shëndetësia, arsimi dhe sfera e shërbimeve sociale, profileve deficitare IT, teknologji etj, si dhe nxitjen e kompanive në sektorin privat për të paguar rroga më të larta do të kontribuohet në rritjen e nivelit të rrogave në vend dhe përmirësimin e standardit jetësor.

**Paga minimale.** Për periudhën e mandatit 2016–2019 kemi një rritje të pagës minimale prej 43.85%. Do të angazhohemi që paga minimale të jetë në nivel që garanton një jetë dinjitoze dhe do të ndjekë trendin e çmimeve, produktivitetit ekonomik dhe do jetë në lidhshmëri me pagën mesatare. Rroga minimale do arrijë 50% nga rroga mesatare neto, kështu që rroga minimale neto duhet të lidhet në lartësinë e rrogës mesatare neto, me qëllim të nxitjes së rritjes së rrogave në vend dhe përmirësimin e standardit jetësor të qytetarëve.

**Paga mesatare.** Do të përqendrohemi që të jetë në nivel të mesatares evropiane duke përcjellur edhe nivelin e produktivitetit të punës dhe deri në 2024 të arrijë nivelin neto prej 500–600 euro.

Paga të barabarta (equal pay). Ndryshime në Ligjin për marrëdhënie pune në drejtim të harmonizimit të tij me të ashtuquajturën Direktivë gjinore e konsoliduar (Direktiva 2006/54/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit, 5 korrik 2006). Punëdhënësi është i detyruar t'i paguajë punëtorët në mënyrë të barabartë për punë të barabartë dhe punë me vlerë të barabartë.

## Zvogëlim i varfërisë

Në angazhimin tonë për reduktim të varfërisë, politikat tona do të ngërthejnë elementin e parandalimit dhe jo vetëm të trajtimit të pasojave të saj.

**Kujdesi shëndetësor.** Mbrojtje e kapitalit njerëzor duke mbrojtur familjet e varfra dhe të rrezikuara nga goditjet, investime në mjekësinë parandaluese dhe kujdesin parësor. Ndiurma sociale e synuar, shërbime të zgjeruara sociale, qasje më e mirë në kujdesin shëndetësor dhe promovimin e stilit të jetesës më të shëndetshëm do të ndihmojnë së bashku të mbrojnë familjet e varfra dhe të cenueshme nga goditjet. Zero pagesë për fëmijët deri në moshën 5 vjeçare dhe zero pagesë për qëndrimin spitalor të njërit prind me fëmijët deri në moshën 5 vjeçare.

**Pension social për të gjithë qytetarët me moshë 65 vjet.** Kjo masë do të mundësojë që të gjithë qytetarët që nuk janë shfrytëzues të pensionit social duke përfshirë të dy bashkëshortët si e drejtë e veçantë dhe e pavarur për çdonjërin prej tyre. Me këtë masë do të përfshihen rreth 65 000 qytetarë të cilët nuk e plotësojnë kushtin për realizimin e të drejtës për pension dhe të cilëve do t'ju sigurohen mjete për jetë më të mirë.

**Subvencionimi i rrymës elektrike.** Kjo masë do të mundësojë lehtësimin e gjendjes sociale-ekonomike për familjet që shfrytëzojnë ndihmë sociale, duke e rritur vlerën e saj momentale në të ardhmen për 100%.

**Subvencionimi i pushimit për punëtorët me të ardhura të ulëta.** Buxhet i planifikuar: 100 milion denarë (25 milion denarë për çdo vit fiskal)

**Mbështetje për punësim.** Vazhdim dhe avancim i masave për punësim dhe vetëpunësim.

- Disperzim të zyrave të Agjencisë për punësim nëpër komuna;
- Krijimin e qendrave për kualifikim dhe rikualifikim të fuqisë punëtorë në tregun e punës;
- Dhënia e granteve për kompanitë/sipërmarrjet që do të punësojnë punëtorë nga rajonet e pa zhvilluara;
- Mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
- Trajnimi në vendin e punës për një punëdhënës të shquar;
- Trajnim profesional siç kërkohet nga punëdhënësi;
- Trajnim i avancuar i aftësive informatike;
- Programi për angazhim pune;
- Shtesa e rinisë në 12 muaj

## Mirëqenia sociale

**Decentralizimi i qendrave për punë sociale në nivel komunal.** Transferimi i ingerencave të qendrave sociale prej pushtetit qendror në komunat përkatëse me qëllim të menaxhimit të transfereve sociale nga ana e komunave si dhe shërbim më cilësor për qytetarët. Me këtë mundësohet që qytetarët të jenë më afër institucioneve sociale dhe mënjanim të shpenzimeve të kostos familjare gjatë realizimit të drejtave të tyre.

Blej shtëpi, blej banesë. Deri në 20.830-euro subvencione përmes projektit “Blej shtëpi, blej banesë”. Me modelet e reja, projekti ofron asistencë financiare të rinjve deri në moshën 35 vjeçare por edhe atyre mbi 35 vjeç, qofshin të martuar apo jo.

**Përkujdesja ndaj fëmijëve - Çerdhe në çdo vendbanim.** Mundësim i të gjithë fëmijëve pa dallim të statusit të tyre shoqërorë qëndrim ditorë nëpër objekte të reja më afër vendbanimit të tyre. Ndihmë për prindërit që janë në marrëdhënie pune dhe jetojnë larg çerdheve ekzistuese për fëmijë.

**Hapja e qendrave ditore për fëmijë me nevoja të ndryshme.** Rekretim, socializim, edukim, trajnim dhe aftësim nga ana e kuadrove profesionale si një ndihmë dhe lehtësim të fëmijëve me nevoja të posaçme dhe kyçja e tyre në jetën e përditshme sociale. Barazi për të gjithë fëmijët.

**Hapja e qendrave ditore për të moshuarit.** Përmirësimin e jetesës së të moshuarve duke ofruar ndihmë të përditshme, mbështetje ushqimore dhe shëndetësore si dhe shërbime tjera sociale si dhe shoqërimi i tyre.

**Subvencionimi deri më 40% nga buxheti shtetëror i shtëpive private për të moshuarit.** Akomodimin e të moshuarve në shtëpi private, me qëllim të përkujdesjes së veçantë, mbështetje shëndetësore, shoqërim dhe socializim.

## Balancë në raportin punë – jetë

Bilanci i punës dhe jetës është një aspekt i rëndësishëm i një ambienti të shëndetshëm të punës. Ruajtja e ekuilibrit të punës dhe jetës ndihmon në zvogëlimin e stresit dhe ndihmon në parandalimin e djegies (burnout) në vendin e punës. Duke krijuar një ambient pune, që i jep përparësi ekuilibrit të jetës dhe punës, do të ndikohet në ngritjen e shëndetit, mirëqenies dhe produktivitetit.

**Direktiva e BE për balancin punë-jetë.** Transponim i direktivës së Bashkimit Evropian (BE) për balancën punë-jetë të miratuar nga Parlamenti Evropian në prill të vitit 2019, në Ligjin për marrëdhënie pune.

**Orar fleksibil të punës.** Zgjerim i kohës fleksibël të fillimit dhe mbarimit të orarit të punës.

**Vikend i zgjatur.** Përcaktimi i orarit të plotë të punës nga dyzet (40) orë në javë në 36 orë në javë, me atë që çdo e premte të punohet me orar të shkurtuar, gjegjësisht deri në 12:00 ose 13:00 varësisht nga fillimi i orarit të punës.

**Pushimi prindëror.** Inkuadrimi i mundësisë së shfrytëzimit të pushimit prindërorë të paguar në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh të njërit prind pas përfundimit të pushimit prindërorë të shfrytëzuar nga prindi tjetër, ose mundësimi i shfrytëzimit të përbashkët të pushimit prindëror të të dy prindërve për 1-3 muajt e parë (pas mbarimit të 3 muajve, nëna ose babai vazhdon deri në fund të pushimit të lindjes).

**Pushimi i atësisë.** Babai i fëmijës së porsalindur ose birësuar do të ketë të drejtën e 5 ditë pushim të paguar pas lindjes ose pas birësimit të fëmijës me kompensim të plotë të pagës së paguar nga punëdhënësi.

## Pensionet

Shërbime cilësore dhe të shpejta për qytetarët për realizimin e të drejtës të SPI-së. Pagesë të rregullt, në kohë dhe të saktë të pensioneve në vend dhe jashtë vendit në mbështetje të Ligjit të SPI-së dhe Ligjit të sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital. Bazë të saktë dhe cilësore të të dhënave për të gjithë të siguruarit - obligues për pagesën e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor. Shërbimi profesional cilësor dhe përsosmëria e tij e vazhdueshme profesionale. Përdorimi i sistemit modern të informatikës i cili ofron mbrojtjen maksimale të të dhënave të klientëve; Sigurimi i kushteve cilësore për jetesë në shtëpitë e përfituesve të pensionit; pjesëmarrja e Fondit të SPIMV-së në procesin e harmonizimit të dispozitave nga fusha e sigurimit social me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe përforcimin e kapaciteteve të Fondit të SPIMV-së në koordinimin e sistemit të sigurimit social.

**Rritje graduale të pensioneve.** Duke marrë për bazë parametrat zhvillimore ekonomike dhe rritjen e bruto prodhimit vendor.

**Shtëpitë e përfituesve të pensionit.** Krijimi dhe sigurimi i kushteve cilësore për jetesë më të mirë për gjithë përfituesit e pensionit. Ndërtimi i shtëpive të reja për pensionistët në këto komuna: Dibër, Tetovë dhe Manastir.

**Shërbimi i rekreacion klimaterik në banjë.** Këtë shërbim falas mund ta shfrytëzojnë personat – përfitues të pensionit të pleqërisë, invalidor dhe



familjarë të realizuar sipas rregullativës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe dispozitave të marrëveshjeve për sigurim social që Republika e Maqedonisë së Veriut i zbaton, ndërsa të cilët jetojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**Ditë të hapura me qytetarët “Ditë për Ju”.** Me këtë aktivitet qytetarë informohen për të drejtat e tyre nga sigurimi pensional dhe invalidor, informim i drejtpërdrejt për evidencën amë. Institucioni më afër qytetarit.

**Marrëveshje për sigurim social mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës.** Do të angazhohemi për konkludim të një marrëveshjeje me Kosovën me qëllim të realizimit të drejtës së pensionit.

**E-qasje në të dhënat e siguresit për stazhin e realizuar.** Qasja elektronike mundëson që çdo person i siguruar të ketë qasje në çdo kohë në të dhënat e tij duke mbrojtur kështu të drejtat që burojnë nga sigurimi pensional dhe invalidor.

## Pension i parakohshëm dhe stazhi i sigurimit

- **Pension i pleqërisë me moshë dhe stazh të sigurimit.** Pension i parakohshëm i pleqërisë për të siguarit me moshë 62 vjeç dhe stazh të sigurimit prej 40 vite (mashkull) dhe me moshë 60 vjeç dhe stazh të sigurimit prej 35 vite (femër). Pensioni i parakohshëm do të jetë i zvogëluar për 0.3% për çdo muaj të shfrytëzimit të parakohshëm të pensionit dhe do të jetë me zgjatje të përhershme të pensionit (Model i sistemit pensional gjerman).
- **Pension i pleqërisë në bazë të stazhit të sigurimit.** Pension të parakohshëm për të siguarit me stazh të sigurimit prej 40 vite pa marr parasysh moshën e të siguarit dhe gjininë me zbatim të përkohshëm të ligjit prej 5 viteve 2020-2025.
- **Rregullimi i stazhit të sigurimit që mungon.** Rregullimi i stazhit për periudhat e sigurimit që mungojnë në Evidencën amë, për të cilat nuk ka dëshmi të nevojshme as nga ana e të siguarit, as nga ana e obliguesve për shkak të falimentimit të ndërmarrjeve e as në Arkivin shtetëror.
- **Pagesë e kontributeve të sigurimit pensional dhe invalidor** në raste kur i siguarit ka qenë në marrëdhënie të rregullt të punës dhe i paraqitur në sigurim social të detyrueshëm (shtyllë e parë), të ketë Fletëparaqitje M1/2 në Evidencën amë të Fondit, por nga ana e

punëdhënësit (obliguesit) nuk është bërë pagesa e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidior në kohë. Me këtë do të jepet mundësi që i siguruari (ose anëtar i familjes i cili ka të drejtë për realizimin e të drejtës familjare) të bëjë pagesën.

## Mediat dhe Shoqëria civile

### Media të lira dhe të besueshme

Mediet janë një ndër shtyllat kryesore të funksionimit të një shoqërie demokratike. Mbështetja e publikut, mbetet motivimi ynë dhe forca jonë lëvizëse për realizimin e qëllimeve për arritjen e vlerave evropiane të qytetarët, të cilat në një masë të konsiderueshme tashmë janë pjesë e përditshmërisë tonë. Liria e besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, fjalës, paraqitjes publike dhe informimit publik mbeten parime themelore tona, me qëllim të përfshirjes së publikut të gjerë në procesin e përgjithshëm integruar të vendit.

**Transparenca.** Liria e shprehjes, informimi në kohë dhe profesional i qytetarëve për aktivitetet e organeve shtetërore janë fundament, domosdoshmëri dhe segment themelor për funksionim demokratik të shoqërisë. BDI është parti e përgjegjshme dhe në të ardhmen ashtu siç deri më sot, në mënyrë të pakursyeshme do të vazhdojë të përpiqet për respektimin e parimeve themelore të informimit profesional dhe të paanshëm të opinionit.

### Mediet në kohën tonë

**Media të pavarura dhe profesionale.** Do të vazhdojmë të promovojmë përmbushjen e standardeve ndërkombëtare në funksionimin e medieve në vend duke pasur parasysh konkurrencën mediatike, duke respektuar kështu të drejtën e publikut të marrë informacione nga burime të ndryshme dhe qëndrime të ndryshme, duke mundësuar dhënien e fakteve në mënyrë objektive dhe të balancuar.

**Liberalizim i tregut për TV sinjal.** Në periudhën e ardhshme do të krijojmë mundësi të barabarta për liberalizimin e tregut për TV sinjal, patjetër duke i respektuar normat dhe standarde ligjore të përcaktuara, me qëllim të konkurrencës dhe profesionalizmit në sferën mediatike.

**Rritja e profesionalizmit të gazetarëve.** Në bashkëpunim me OSBE dhe misionet e huaja në vend, do të kontribuojmë në ngritjen e profesionalizmit të gazetarëve nëpër mediet e vendit si dhe gazetaret e sapo diplomuar qoftë në Maqedoninë e Veriut apo jashtë vendit.

**Shërbimi publik dhe mediat me koncesion nacional.** Në kontekst të Shërbimit publik (RTVM – Programi në gjuhën shqipe), apo shërbimi i dytë i programit të RTVM, do të mundësojmë Program 24 orësh në gjuhën shqipe me qëllim informimin në kohë të qytetarëve si dhe ruajtjen e gjuhës amtare dhe kulturës. Korniza ligjore për këtë çështje është e apsolvuar dhe në periudhën e ardhshme do të angazhohemi ti avancojmë kushtet e patjetërsueshme për implementimin e pandalshëm. Kjo nënkupton rritjen e numrit të të punësuarve, produksion (rritje për 30 % në vitin e parë), shënim i ngjarjeve të rëndësishme nga sfera e popullit dhe kulturës shqiptare dhe Digjitalizim në video materialin veçse të xhiruar me teknologji analoge.

**Komunikim institucional.** Komunikimi me mediet është një vegël e rëndësishme në informimin e opinionit. Bashkimi Demokratik për Integrim, si parti e përgjegjshme shoqërore edhe në të ardhmen do të vazhdojmë me marrëdhënie transparente me punonjësit në media duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesit të mas-medieve edhe atë nëpërmjet mbajtjes së konferencave të rregullta për shtyp, brifingjeve dhe qasje për çështje kyçe për mediet dhe opinionin.

**Komunikim me komunitetin mediatik.** Angazhim i yni do të ketë në fokus zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit me shoqatat mediatike si: SHGM, MAN, Këshilli për etikë në media, por edhe me shoqatat e tjera në interes të punës mediatike.

## Mediet sociale dhe portalet

**Portalet e internetit.** Rregullativë ligjore për rregullimin e internet hapësirës, gjegjësisht për portalet apo subjektet të cilat bëjnë krijimin dhe/ose shpërndarjen e lajmeve nëpërmjet internetit. Qëllimi i kornizës ligjore do të jetë parandalimi i shpërndarjeve të lajmeve të paverifikuara, të rrejshme si dhe parandalimi i gjuhës së urrejtjes, dhunës dhe diskriminimit mbi çfarëdo lloj baze.

**Mediet sociale.** Qasja në informacionin me interes publik do të mirëmbahet edhe më tej përmes mbajtjes funksionale të faqeve zyrtare të institucioneve publike, por duke shfrytëzuar trendët e fundit të komunikimit, vëmendje të veçantë do të ju kushtohet edhe rrjeteve sociale në komunikimin me

qytetarët dhe opinionin e gjerë. Kjo do të konsiderohet një nga mjetet kryesore për informim dhe plasimin e rezultateve të punës së institucioneve si dhe do të shërbejë për krijimin e komunikimit të ndërsjellë me publikun me qëllim të përmirësimit të qasjes dhe cilësisë në(së) shërbime(ve).

**Lajmet e rreme (Fake News).** Lajmet e rreme paraqesin një fenomen dhe sfidë në nivel global, të cilët dëmtojnë besimin e qytetarëve dhe shoqërohen me polarizimin në rritje në një shoqëri. Lufta kundër lajmeve të rreme është shpërkëje e të gjitha shoqërive demokratike. Me këtë sfidë përballen edhe vendet më të zhvilluara se vendi ynë. Prandaj ne, si BDI, do të sjellim Strategji për luftë kundër lajmeve të rreme, strategji të cilën do të kërkojmë të mbështetet nga të gjitha partitë politike.

### Shoqëri civile aktive

Shoqëria civile e përforcuar është komponenti kyç për çdo sistem demokratik e cila promovon pjesëmarrje dhe kontribuon për zhvillim gjithëpërfshirës të shoqërisë si dhe në përmirësimin e kualitetit dhe standardit të jetesës.

**Shoqëri civile aktive.** Arritja e nivelit të shoqërisë civile të mirë informuar për të mundësuar ndikim, ndërlihdje dhe mundësi të zhvillimit të shoqërisë në vend. Do të inkurajohet pjesëmarrje e shoqërisë civile në të gjitha segmentet e jetës shoqërore.

**Bashkëpunim institucional.** Do të vazhdojnë aktivitetet për përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e krijimit të politikave, dialogut dhe zhvillimit të shoqërisë civile në mënyrë të rregullt dhe efikase.

## #5 RINIA NË VEND TË PARË

- Rini aktive dhe vendimmarrëse
- Pavarësimi ekonomik i rinisë
- Vende të reja pune për rininë
- Vullnetarizmi rinor për zhvillim
- Investime në sport dhe sportistë



Rinia është e ardhmja e shoqërisë, resurs i progresit dha garanci e perspektivës së ndritur. Ne jemi për rini të arsimuar, me vlera të larta etike dhe morale, si dhe e pasuruar me dije të reja në shkencë dhe teknologji. Një rini aktive në shoqëri dhe politikë që do t'i kultivojë vlerat më të mira të demokracisë dhe lirisë. Një rini e guximshme dhe inovative, e aftë të përballet me sfidat e globalizmit, konkurrencën dhe ndryshimet klimatike do të jetë ingranazhi i prosperitetit të shoqërisë. Ndaj jemi për shoqëri me pjesëmarrje aktive të rinisë në proceset e vendimmarrjes dhe politikë-bërjes, si dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve në procesin e integritimit drejt strukturave euroatlantike, duke krijuar një klimë për zhvillimin e të rinjve në vendin tonë. Bashkimi Demokratik për Integrim vihet në shërbim të plotë të rinisë dhe vendos në dispozicion të gjitha asetet e veta organizative për të garantuar përfshirje dhe fuqizim të rinisë.

**Strategjia nacionale për të rinjtë 2016-2025.** Me strategjinë vendosen parimet dhe orientimet themelore për veprim të të gjithë faktorëve në shoqëri të cilat do të çojnë në përmirësimin e pozitës së pavarur ekonomike të të rinjve dhe në krijimin e ambientit i cili do tu mundësoj të rinjve ti realizojnë të drejtat, nevojat, dhe interesat e tyre.

**Ligji për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore.** Ligji përcakton kategorinë e të rinjve në vend, përcakton format e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të rinjve, regjistrin e formave të organizimit të rinisë, pjesëmarrjen e të rinjve, politikat dhe shërbimet e të rinjve me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e hartimit të politikave rinore, informimin aktiv, promovimin dhe mbrojtjen e interesave të të rinjve, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e të të rinjve dhe rolin e tyre shoqëror. Për të zbatuar të gjitha masat dhe aktivitetet, parashihet që komunat dhe Qyteti i Shkupit të krijojnë zyra rinore si dhe të bëjnë ndarjen e 0.1 dhe 0.3% të buxheteve të tyre për këto zyra.

## Rini aktive dhe vendimmarrëse

**Rinia vendim-marrëse.** Rritja e përfaqësimit të strukturave rinore në pozicione ekzekutive dhe pushtetin lokal. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i të rinjve për pjesëmarrjen në procesin zgjedhor.

**Rini aktive.** Rritja e Aktiviteteve Sportive. Ngritja e nivelit kulturor të rinisë. Rinia në mbrojtje të pasurive natyrore. Krijimi i qendrave rehabilituese për të rinj. Shprehi të shëndosha ushqyese tek të rinjtë e moshës 15 deri 19 vjet. Rritja e vetëdijes tek të rinjtë për përgjegjësitë gjatë pjesëmarrjes në komunikacion rrugor. Krijimi i kushteve për rehabilitim të papenguar dhe risocializim të kategorive të prekura të të rinjve.

**Edukim dhe arsim cilësor.** Krijimi i mundësive të qasjes për të gjithë të rinjtë për të pasur kompetenca të cilat kërkohen në tregun e punës. Rritja e standardit të mësimdhënies. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore. Aktivitete edukativo-arsimore. Kushte më të mira për studim. Avancim të programeve mësimore dhe teknikat në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë. Përmirësim i ofertës të arsimit joformal në grupe speciale të fëmijëve dhe të rinjve. Përfshirje përkatëse në procesin e arsimit të fëmijëve me nevoja dhe interes të veçantë (fëmijë të talentuar).

## Pavarësimi ekonomik i të rinjve

**Pavarësimi ekonomik i të rinjve.** Hapja e qendrave për kualifikimin profesional dhe menaxherial të të rinjve. Nxitja e vetë-punësimit. Nxitja e interesit për zejet tradicionale. Fuqizimi i mekanizmave për kërkimin dhe aksesin në punë.

**Fondi për dijen e të rinjve.** Programe nacionale për zgjidhjen gjithëpërfshirëse të krijimtarisë, inovacionit, sipërmarrjes dhe aftësinë të të rinjtë. Programet do të financohen nga Fondi i Inovacionit dhe Zhvillimit Teknologjik në bashkëpunim me bashkësinë e donatorëve.

**Krijim i lehtësirave fiskale për kompani/shoqëri të themeluara nga të rinjtë.** Pako të lehtësirave tatimore.

## Ulja e papunësisë rinore

**Integrim i të rinjve në tregun e punës.** “Garanci për të rinjtë”, që do të sigurojë që në një periudhë prej katër muajve pas mbarimit të shkollimit ose mbetjes pa punë, çdo i ri të fitojë një ofertë punësimi, mundësi për vazhdimin e shkollimit, të kyçet në praktikë ose trajnim për përgatitje për punësim.

**Punë praktike me pagesë.** Masë për integrimin e të rinjve (deri në moshën 34 vjeçare) në tregun e punës, duke përcaktuar edhe kufizimin që një praktikant mund të kryejë praktikë vetëm një herë me të njëjtin punëdhënës si mbrojtje ndaj abuzimeve potenciale nga ana e punëdhënësve të kësaj mundësie ligjore.

**Shtesa rinore.** 3,000 denarë shtesë përveç pagës dhe kontributeve për të rinjtë deri në moshën 23 vjeçare që kanë kryer shkollimin e mesëm, e që janë të angazhuar në ndonjë kompani prodhuese në prodhim dhe bujqësi.

**Informimi i të rinjve.** Informimi rinor më shpesh shihet si sistem i aktiviteteve nëpërmjet të cilave transmetohen informata deri te të rinjtë. Qasje dhe transparencë në informacione me interes për të rinjtë për realizimin e interesave të tyre; krijimi i strategjisë së komunikimit për koordinim ndër-institucional të të rinjve.

**Puna lokale e të rinjve.** Puna lokale rinore paraqet procesin e organizuar sistematik të edukimit dhe mbështetjes së zhvillimit autentik të të rinjve me qëllim realizimi të potencialit të tyre personal, social dhe shoqëror të tërësishëm. Identifikimi i punës rinore si instrument kryesor për të ndihmuar zhvillimin pozitiv personal dhe social të të rinjve; identifikimi dhe rregullimi formal i implementimit dhe ofertës së punës rinore si pjesë integrale të sistemit edukativ-arsimor në vend; realizimi i ofertës cilësore dhe të kashmre të punës rinore në territorin e çdo komune.

## Vullnetarizmi rinor për zhvillim

**Promovimi i vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive.** Vullnetarizmi dhe shkëmbimet vullnetare rajonale. Bashkëpunim rajonal drejt një zhvillimi demokratik dhe social-ekonomik.

**Rinia për shoqëri të barabartë.** Hapja e qendrave rinore në nivel lokal. Forcimi i strukturave dhe kapaciteteve të organizatave rinore. Qasje e barabartë e të rinjve në ofertën kulturore cilësore dhe mundësitë për

bashkëpunim kulturor. Bashkëpunim ndërkombëtar dhe brenda vendit midis organizatave rinore. Integrimi dhe përfaqësimi i barabartë në shoqëri.

**Mbështetje financiare.** Sigurim i mbështetjes financiare nga ana e autoriteteve lokale dhe nacionale në drejtim të nxitjes së pjesëmarrjes së të rinjve, iniciativave dhe shoqatave rinore.

**Kartela Rinore Evropiane.** Kartelë falas për të rinjtë e moshës 15 deri 29 vjeç, me të cilën të rinjtë do të kenë lirime të caktuara në subjektet me të cilat Agjencia për rini dhe sport ka nënshkruar memorandum për bashkëpunim në vend dhe shtetet evropiane.

## Investime në sport dhe sportistë

Sporti dhe rekreacioni janë të rëndësishme për shëndetin dhe kohezionin e shoqërisë dhe ndikon drejtpërdrejtë në lumturinë e qytetarëve. Burime stabile për financim të veprimtarisë së sportit nga buxheti qendror dhe lokal, si dhe mundësi për mbështetje të drejtpërdrejtë të sportit me mjete nga ekonomia. Gjithashtu, do të vazhdohet me promovimin dhe hapjen e sallave dhe terreneve të sportit edhe në shkollat fillore, të mesme dhe universitete. Promovimin e organizatave sportive dhe perkrahjen e sportistëve profesionist në garat sportive ndërkombëtare.

**Vauçere sportive.** Thjeshtëzim të procedurave administrative në pajtim me Ligjin për sponsorizime dhe donacione. Përmes vauçerëve sportiv, kompanitë private 50 % nga tatimi i fitimit kanë mundësi ta investojnë drejtpërsëdrejti në sport. Gjegjësisht, kompanitë, një pjesë nga detyrimi i tyre për tatim të fitimit, në vend se t'ia paguajnë shtetit, do të kenë mundësi ta investojnë në klubet sportive apo sportistë.

**Infrastruktura e sportit.** Ndërtimi i pishinave të mbyllura shkollore (Tetovë, Kërçovë, 82 milion denarë); Rikonstruimi i pishinave (Strugë, 30 milion denarë); Ndërtimi i sallës për mundje (Çair, 15 milion denarë); Ndërtimi i fushave të basketbollit (Çair, Dibër, 6.5 milion denarë); Rikonstruimi i infrastrukturës së sportit në komuna (Çegran, 5 milion denarë; Forinë, 5 milion denarë; Likovë, 3 milion denarë; Dollnen, 3 milion denarë; Strugë, 4.5 milion denarë).



| Projektet |   | Mjetet e nevojshme (në denarë) |
|-----------|---|--------------------------------|
| 1.        | Projekti "Stop për veset tek popullata e të rinjve"   | 100.000,00                     |
| 2.        | Realizimi i aktiviteteve-financimi i projekteve të sektorit të OJQ-së të cilat janë në interes për të rinjtë, me qëllim për realizimin e qëllimeve strategjike të SNR | 5.000.000,00                   |
| 3.        | Projekti "Poetët e rinj"  | 250.000,00                     |
| 4.        | Projekti "Artistët e rinj"  | 533.000,00                     |
| 5.        | Sipërmarrës të rinj   | 1.000.000,00                   |
| 6.        | Punim të hulumtimit për trendet e të rinjve   | 1.000.000,00                   |
| 7.        | Proces për krijimin e Strategjisë nacionale për të rinj   | 1.000.000,00                   |
| 8.        | Muaji i karrierës   | 300.000,00                     |
| 9.        | Zyra regjionale për bashkëpunimin e të rinjve të Ballkanit perëndimor   | 9.821.000,00                   |
| 10.       | Mbështetje të rinjve të talentuar dhe shkencëtar  | 2.000.000,00                   |
| 11.       | Kartelë rinore  | 2.100.000,00                   |
| 12.       | Zbatim i ligjit për pjesëmarrje të rinjve dhe politikat e të rinjve-Regjistër i organizatave për të rinjtë  | 1.000.000,00                   |
| 13.       | Shënimi i ditës Ndërkombëtare të të rinjve  | 250.000,00                     |
| 14.       | Përmes lojërave sportive deri te kohezioni ndëretnik në mesin e të rinjve   | 500.000,00                     |
| 15.       | Participim në organizatat ndërkombëtare-anëtarësimi   | 700.000,00                     |
| 16.       | Bazë për trajnerët  | 300.000,00                     |
| 17.       | Qendra për të rinj  | 2.500.000,00                   |
|           | <b>GJITHSEJ:</b>  | <b>35.400.000,00</b>           |

**KOHA PËR  
KRYEMINISTRIN  
E PARË SHQIPTAR**



**PROJEKTET TONA**

## #1 INTEGRIM KONSENSUAL

### Demokraci konsensuale

- Kryeministër i pare shqiptar në Qeverinë e Maqedonisë së Veriut
- Një prej tre funksioneve të para të shtetit (President, Kryetar Parlamenti dhe Kryeministër)
- Zëvendës kryeministër i parë që i takon bashkësisë etnike ndryshe nga Kryeministri
- Promovim i vendimmarrjes konsensuale në Qeveri për temat etnike, integritet, siguri, buxhet dhe financat publike
- Institucionet kyçe me dy udhëheqës me nënshkrim të lidhur: Fondi shëndetësor, Ndërmarrja për rrugët shtetërore, Agjencia pagesore rurale, Fondi i inovacionit, Enti statistikës, DAP, Dogana, ELEM, Agjencia për rini dhe sport, etj.

### NATO

- Buxhet për NATO
- Përfaqësim i drejtë në çdo gradë dhe çdo njësi
- Shkollim dhe përgatitje profesionale për çdo ushtarë dhe ushtarak
- Pjesëmarrje adekuate në misionet paqësore dhe përfaqësitë e NATO-s
- Armatë më afër qytetarëve (gjendje të emergjencës)

### Bashkimi Evropian

- Udhëheqje me negociatat me Bashkimin Evropian
- Anëtarësim i plotë në BE – 2025

### Administrata Publike

- Mbulim i shpenzimeve të rrugës për administratorët që udhëtojnë më shumë se 10 km nga vendi i punës
- Avancim vertikal obligativ i çdo nëpunësi administrativ i cili kalon vitet e

parapara për atë kategori

- Ndalim ligjor i mundësisë për të konkurruar për vend pune në administratë pa certifikatë për përkatësinë etnike të siguruar nga organet kompetente
- Hapja e mbi 6,500 vendeve të reja te punës për përkthyes dhe lektor me qëllim të implementimit të tërësishëm të ligjit të gjuhës në të gjitha Institucionet
- Ndërtimi i kapaciteteve infrastrukturore për implementimin e dygjuhësisë nëpër institucione

## #2 VETING

- Veting institucional për çdo bartës të funksionit publik: Politikan, Zyrtar, Prokuror, Gjykatës, Punëtor të uniformuar
- Jo gjyqësorit selektiv
- Zero tolerancë për korrupsionin
- Rishqyrtim për rastet në gjyqësor të kontestuara seriozisht në opinion

## #3 ZHVILLIM DHE VENDE PUNE

### Rimëkëmbje ekonomike pas COVID-19

- Pagesa e të gjitha obligimeve në tre-mujorin e parë nga institucionet shtetërore ndaj sektorit privat për punë të realizuara
- Kthimi i TVSH brenda 30 ditëve për sektorin privat
- Rishikim i buxhetit dhe rialokim i mjeteve në projekte infrastrukture kapitale që janë në realizim (autostrada Shkup-Bllacë, autostrada Kërçovë-Ohër, shkolla, spitale dhe infrastrukturë komunale)
- Nivelizim i TVSH hyrëse dhe dalëse për sektorin e gastronomisë dhe hotelieri
- Mjete shtesë për kredi pa kumatë dhe garanca bankare për NVM
- Lirimi i akontacioneve nga tatimi personal dhe tatimi në fitim për realizues të veprimtarive vetanake (zejtari)

## Ekonomi dhe Financa

- Rritje ekonomike 4-5%,
- Zvogëlim i papunësisë në 10% në 2024,
- Rritja e rrogave 5% (deri 600 euro)
- Investime te huaja 1.5 – 2 miliardë euro
- Buxhet konsensual, i drejtë dhe transparent

## Decentralizim Fiskal, Zhvillim Lokal dhe Rajonal i Balancuar

- Rritja e të hyrave tatimore për komunat: TVSH nga 4.5% në 9%, Tatim personal nga 3% në 9%
- Rishikim i metodologjisë për shpërndarje të tatimeve dhe dotacioneve për komunat
- Rruge lokale (rikonstruim, ndërtim, rikonstruime dhe rehabilitime të rrugëve në të gjitha komunat në vend 270 km rrugë lokale në vlerë prej 70 milion euro)
- Projekte për efikasitet energjetik për komunat në vlerë prej 25 milion euro të financuar përmes bankës botërore (sipas formulës)

## Ndërmarrësia

- Qendër për informim, për ndihmë dhe mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
- 5,000.00-15,000.00 € për përdorimin e mjeteve digjitale në biznes
- Ulja e shpenzimeve për biznes të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
- Nga ideja në biznes - Qendra për themelimin e bizneseve të reja me trajnim, mentorim, hapësira të përbashkëta pune, salla të përbashkëta takimesh dhe shërbime të kontabilitetit.
- Qendra për hapësira falas pune, trajnime, mentorim dhe shërbime për ndërmarrjet e themeluara nga gratë
- Grante (mjete të pakthyeshme) për eko prodhimtari
- Mbulimi i harxhimeve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare
- Qendra këshillëdhënëse për eksportim të mallrave nga RMV në Evropë

- Zero shpenzime për themelimin të biznesit
- 5,000-10,000 euro për furnizim të pajisjeve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe zejtarëve
- Ulja e tarifave para-fiskale për NVM-të
- Heqja e plotë e tarifave para-fiskale për ndërmarrjet në zonat rurale

## Turizëm

- Investime të huaja në turizëm me fokus të veçantë në revitalizimin e objekteve të vjetra hotelerike dhe destinacione të reja turistike
- Zona të reja zhvillimore turistike me lehtësime tatimore
- Subvencionimi i zgjidhjeve me efikasitet energjetik për objektet turistike dhe hotelerike.
- Digjitalizim në turizëm
- Struga - qendër verore turistike - rritja e kapaciteteve hotelerike në Strugë
- Sigurim i aranzhmaneve turistike
- Themelimi i zonës së lirë turistike në Strugë (Treska)
- Subvencionim i pushimeve për të rinj deri në 25 vjet (përparësi studentët e shkëlqyeshëm)
- Ndërtimi i teleferikut Tetovë - Kodra të Diellit

## Investime

- Financimi i etiketave eko për produkte që janë fituar në kapacitete përpunuese, të investuara në zonat e gjelbra industriale
- Mbulimi i shpenzimeve për pajisje në industrinë përpunuese të gjelbër (teknologji të pastër në prodhimtari), me prodhimtari përmes riciklimit, rinovimit dhe ripërdorimit të materialeve
- Subvencionim deri në 30% të investimit për kompanitë vendore prodhuese.

## Energjetikë

- Mundësojmë përdorimin e gazit natyror në çdo shtëpi dhe biznes te vogël dhe te mesëm si dhe industri
- Mbulimi i një pjese te shpenzimeve për çdo amvisëri për blerjen e shporetit me peleta, ndërrimin e dritareve te drurit me të PVC, vendosjen e inverter klimatizuesve dhe vendosjen e sistemeve diellore për ujë te nxehtë
- Mbulimi i një pjesë të harxhimeve për fasada dhe izolime efikase energjetike për çdo shtëpi, institucione publike
- Ndërtimi i kapaciteteve te reja energjetike që prodhojnë energji të pastër duke përdorur energjinë diellore, të erës, dhe te ujit

## Mjedisi Jetësor

- Çdo shtëpi me ujë të pijshëm
- Sisteme kanalizimi në çdo komunë rurale
- Stacione pastrimi të ujërave të zeza në vendbanime urbane
- Vendbanime pa mbeturina
- Infrastruktura për seleksionim dhe mbledhje të mbeturinave
- Subvencione për pajisje dhe filtra të cilat ndikojnë në uljen e ndotjes së ajrit
- Pastrim të të gjithë shtretërve të lumenjve në vend
- Mbulim i shpenzimeve deri 50% për lidhje me gaz të çdo shtëpie
- Mali Sharr - Park Nacional
- Fshat turistik në çdo komunë

## Transport

- Përfundim i Autostradës Kërçovë – Ohër dhe Trebenishtë – Qafë Thane
- Ndërtim i Autostradës Gostivar – Kërçovë
- Përfundim i Autostradës Shkup – Bllacë
- Përfundim i Rrugës së Arbrit (aksi rrugor Burim – Urra e Boshkut)
- Projektim themelor dhe sigurim i financimit të Rrugës Tetovë – Prizren
- Rikonstruim dhe riparim i rrugëve regjionale dhe magjistrale

- Riparim i rrugëve lokale në të gjitha vendbanimet
- Standarde të sigurisë në trafik
- Modernizim i hekurudhës dhe stacioneve hekurudhore Tetovë, Gostivar, Kërçovë
- Financim i Hekurudhës Kërçovë – Lin

## Bujqësi

- Subveniconet për kokë bagëtie (50% më shumë)
- Grant 20,000 euro për çdo bujk të ri
- Grant 5,000 euro për çdo grua fermere
- Hapje e qendrave të reja të grumbullimit të produkteve ushqimore (Shkup, Pollog, Prespa)
- Subvencionim i naftës së gjelbër për bujqit deri 100%
- Subvencionim i naftës së gjelbër për kultivuesit e duhanit
- Subvencione për bio-prodhime (50% më shumë)
- Rritja e sipërfaqeve bujqësore për 20% (me sistem të ujitjes)
- Grant për modernizim të fermave bujqësore dhe industrisë agrare
- ‘Rruga e bletëve’ – subvencionim i bletarisë dhe eksportit të mjaltit
- Rrugë të asfaltuara në fshat
- Rrjeti i shpërndarjes për ujitje Raven-Reçicë (5 milion euro)
- ‘Nga ara në tavolinë’ – pika shitëse të produkteve vendore bujqësore
- Grant për modernizimin e fermave bujqësore dhe industrisë agrare.

## #4 JETË CILËSORE

### Arsim

- Qendra ditore për fëmijët me nevoja të posaçme në çdo shkollë
- Laborator në çdo shkollë
- Paga minimale në arsim 600 euro



- Numri i nxënësve nxënës për paralele në shkolla fillore 20
- Promovim i mësimit tërë-ditor
- Më shumë shkolla profesionale për punësim më të lehtë
- Salla dhe terrene sportive në çdo shkollë
- Më shumë financa për projekte në shkencë dhe novacione
- ‘Shkencëtari i ri’, grante për projekte shkencore për nxënësit në shkolla fillore dhe të mesme
- Bursa për nxënësit e shkëlqyeshëm në fakultetet për mësimdhënës
- Ndërtim i Kampusit Universitar ‘Nena Terezë’, Shkup
- Ndërtim i shkollave të reja në Reçicë të Vogël, Bllacë e Poshtme, Vizbeg, Klukovec, Sellcë (Tetovë), Çair dhe vende tjera, si dhe rikonstruim dhe riparim i vazhdueshëm i shkollave

## Shëndetësi

- Qëndrim pa pagesë në spital për nënat e fëmijëve të sëmurë deri në moshën 8 vjeçare
- Kufizim legal i pritjes për incizime të ndryshme në spitale deri në 7 ditë
- Shkollim zyrtarë për fëmijët me sindrom dhe sëmundje klinike
- Rritja e kapitacionit për mjek dhe stomatolog për 20%
- Rritja e pagesës për 20% të stafit medicinal me shkollë të mesme
- Klinikë universitare në Tetovë
- Spital i ri në Strugë
- Shtëpi shëndeti në Zhelinë, Vrapçisht dhe Bogovinë
- Qendra të ndihmës së shpejtë në çdo vendbanim
- Barna më të lira për qytetarët
- Mjek në çdo fshat

## Kulturë

- Themelim i Teatrit Muzikor Kombëtar Shqiptar
- Themelimi i një teatri për fëmijë dhe për të rinj në Tetovë
- Themelim i Teatrit Kombëtar në Kumanovë
- Institucionalizimi i festivalit “Vera Kulturore Tetovare”

- Themelimi i sektorëve të dramës dhe arteve vizuale në çdo qendër për kulturë
- Institucionalizimi i festivalit mbarëkombëtar i këngës për fëmijë
- Revitalizimi i Çarshisë së vjetër
- Rrjeti kulturor mbarëshqiptar me qendër në Shkup

## Mirëqenie Sociale

- Shërbimet sociale nën kompetencë të komunave
- Mbulim i shpenzimeve për blerjen e banesave dhe shtëpive deri në 20 000 euro për të rinjtë me të ardhura nën 30 000 denarë
- Edukim parashkollor i obliguar për fëmijët nga 4-6 vjet
- Çerdhe në çdo vendbanim
- Maksimum deri 20 fëmijë ne paralele ne çerdhe
- Qendra ditore për të moshuarit në çdo komunë
- Mbulimi i shpenzimeve deri në 40% nga buxheti i shtetit për shtëpitë private për të moshuarit
- Orar fleksibil i punës
- Orar i përgjysmuar i punës të premtën
- Pushim prindëror për të dy prindërit në 3 muajt e parë pas lindjes
- Pension minimal 12 000 denarë
- Rritja e të gjitha pensioneve për 20%
- Ndërtimi i shtëpive të reja për pensionistët
- Pushim një javor në banjë falas për çdo pensionistë
- Marrëveshje për sigurim social mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës
- Sigurim online i të dhënave për stazhin e realizuar
- Pensionim para kohe me dëshirë deri dy vjet
- Pensionim me 40 vjet stazh pune, pavarësisht moshës
- Pension social për çdo të moshuar që nuk ka pension të rregullt
- Blerja e stazhit për plotësimin e kushtit për pension
- Rritje e ndihmës sociale
- Rrogë minimale prej 600 euro për edukatorët në çerdhe
- Sportele që do të shndërrojnë idenë tuaj në biznes – ndihmë për

- ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me start-up dhe inkubatorë
- 5 000 deri 15 000 euro ndihmë për digjitalizimin e bizneseve tuaja
- Nga ideja në biznes - qendra për themelimin e bizneseve nga gratë
- Mjete të pakthyeshme për eko- prodhimtari
- Mbulimi i shpenzimeve deri në 100% të ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për pjesëmarrje nëpër panaire ndërkombëtare
- Zero euro për themelim të biznesit
- 5 000 deri 10 000 euro mjete të pakthyeshme për pajisje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme zejtare
- Kycje e çdo shtëpie në rrjetin e gazit natyror
- Kycje e biznesit dhe industrisë në rrjetin e gazit natyror
- Mbulim i shpenzimeve deri 50 % për fasade dhe izolime efikase energjetike për shtëpitë private
- Mbulim i shpenzimeve për fasade dhe izolime efikase energjetike për institucionet publike
- Vend pune të garantuar për familjet me asnjë të punësuar

## #5 RINIA NË VEND TË PARË

- Përfaqësim i rinisë në pozicione vendimmarrëse në pushtetin qendror dhe lokal
- Hapja e qendrave për kualifikimin profesional dhe menaxherial të të rinjve
- Fondi për dijen e të rinjve, përkrahje të novacionit, sipërmarrjes dhe aftësinë të të rinjtë
- ‘Garanci për të rinjtë’, ofertë punësimi për çdo të ri për një periudhë prej katër muajve pas mbarimit të shkollimit ose mbetjes pa punë
- Shtesa rinore prej 3,000 denarë për të rinjtë deri në moshën 23 vjeçare që kanë kryer shkollimin e mesëm që punojnë në prodhim dhe bujqësi.
- Kartela Rinore Evropiane. Kartelë falas për të rinjtë e moshës 15 deri 29 vjeç, me të cilën të rinjtë do të kenë lirime të caktuara në subjektet me të cilat Agjencia për rini dhe sport ka nënshkruar memorandum për bashkëpunim në vend dhe shtetet evropiane.
- Vauçere sportive, për subvencionim të sportistëve të ri.

- Modernizim i infrastrukturës së sportit. Ndërtimi i pishinave të mbyllura shkollore (Tetovë, Kërçove, 82 milion denarë); Rikonstruimi i pishinave (Strugë, 30 milion denarë); Ndërtimi i sallës për mundje (Çair, 15 milion denarë); Ndërtimi i fushave të basketit (Çair, Dibër, 6.5 milion denarë); Rikonstruimi i infrastrukturës së sportit në komuna (Çegran, 5 milion denarë; Forinë, 5 milion denarë; Likovë, 3 milion denarë; Dollnen, 3 milion denarë; Strugë, 4.5 milion denarë).


# REALIZO ËNDRRËN

**100 DITËT E PARA TË  
KRYEMINISTRIT SHQIPTAR**



# ZOTIMET

## *Vendi i barazisë*




1. Vendimmarrje konsensuale, përgjegjësi e përbashkët: **10 institucione shtetërore strategjike të udhëhequra së bashku nga një maqedonas dhe një shqiptar**, me të drejta të përbashkëta nënshkrimi (Agjencia për Siguri Kombëtare, Agjencia Kombëtare e Inteligjencës, Byroja e Sigurisë Publike, Zyra e Statistikave Shtetërore, Fondi Shëndetësor, Fondi Pensional, Banka e Zhvillimit të Maqedonisë së Veriut, Fondi I Inovacionit dhe Zhvillimit Teknologjik, Fondi I Zhvillimit Rajonal, IPARD, Rrugët Shtetërore, Hekurudha, ESM, MEPSO, Burimet e Energjisë së Maqedonisë).
2. **Respekt për të gjithë**: zhvillimi i orëve të detyrueshme të gjuhës shqipe në çdo shkollë, duke filluar nga klasa e 5-të.
3. **Shpërndarje e barabartë e investimeve publike**: vendimet madhore ekonomike (buxheti, investimet, taksat) nga Qeveria nuk mund të kalojnë pa mbështetjen e shumicës së anëtarëve shqiptarë të kabinetit.
4. **Shpallja e 13 gushtit**, dita e nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, si festë Kombëtare.
5. Himni do të pasqyrojë **realitetin multietnik** dhe multikulturor të vendit.



## ***Drejtësi për të gjithë***

6. **Gjykata e Lartë e Barazisë:** hetimi i diskriminimit në nivel shtetëror.
7. **Veting i detyrueshëm** për çdo politikan, gjyqtar dhe funksionar shtetëror – një mjet i fuqishëm kundër korrupsionit dhe nepotizmit. Krijimi i një komisioni të pavarur për të kontrolluar aftësinë dhe integritetin e secilit që është i emëruar në poste publike.
8. **Raport publik i obligueshëm** 6 mujor i Këshillit gjyqësor dhe Këshillit të prokurorisë për luftën kundër korrupsionit të bartësit e funksioneve publike

## ***Rilindje ekonomike për të gjithë***



9. Fillim i programit me masa ekonomike për të krijuar të paktën një rrogë për çdo familje.
10. Zero tatim personal për tre vjet për çdo person të punësuar për herë të parë, nën moshën 35 vjeç.
11. Zero tatim në fitim për tre vjet për çdo të vetëpunësuar nën moshën 35 vjeç.
12. Qeveria do të subvencionojë 50% të kontributeve sociale për tre vite të ardhshme për çdo punësim të ri që do të përmirësojë përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të të gjitha bashkësive etnike në ndërmarrjet private.
13. Çdo biznes do të marrë një subvencion prej një rroge bruto mujore në tre vitet e ardhshme për çdo punonjës të ri nën moshën 35 vjeç me garanci pune tre vjeçare.
14. 5,000-10,000 € për të blerë pajisje të nevojshme për ndërmarrje të vogla, të mesme dhe zeytari.

## Jetë më të mirë për të gjithë



15. **Vendosja e orarit fleksibël** të punës gjatë javës dhe mundësi për gjysmë-orari pune ditën e Premte: për të siguruar më shumë kohë familjare dhe private, shëndet më të mirë mendor dhe produktivitet më të lartë.
16. **Pagë minimale 600 euro** për çdo infermier, mësues dhe arsimtar.
17. Fillimi i ndërtimit të **“shtëpive të shëndetit”** në çdo komunë.
18. **Pension social** për ato gra që nuk përfitojnë pension pune.
19. Nisja e **Programit Kombëtar** të ekozhvillimit: një projekt ambicioz për modernizim që mundëson që çdo familje të ketë ujë të pijshëm dhe çdo komunë të ketë sistem kanalizimi.
20. Miratimi i një ligji që **ndalon kazinot dhe lojërat e fatit** në një distancë prej 1 kilometër nga shkollat, kopshtet, kishat dhe xhamitë.

## Mundësi për familjet e reja



21. **Grante në kohë prej 20,000 €** për secilin fermer të ri nën moshën 35 vjeç.
22. **Programi i shtëpisë së parë:** hua shtetërore deri në 20,000 euro për të rinjtë për të blerë apartamente dhe shtëpi.
23. **Arsimi parashkollor i detyrueshëm** dhe kopsht për çdo fëmijë.
24. **Shkolla profesionale** në çdo komunë.
25. **Fond për dijen e të rinjve**, përkrahje të inovacioneve, sipërmarrjes dhe aftësive të të rinjtë.



## Rimëkëmbje ekonomike pas COVID-19:

- ◆ **pagesa e të gjitha obligimeve**  
në tre-mujorin e parë nga institucionet shtetërore ndaj sektorit privat për punë të realizuara
- ◆ **kthimi i TVSH** brenda 30 ditëve për sektorin privat
- ◆ **rishikim i buxhetit** dhe rialokim i mjeteve në projekte infrastrukture kapitale që janë në realizim (autostrada Shkup-Bllacë, autostrada Kërçovë-Ohër, shkolla, spitale dhe infrastrukturë komunale)
- ◆ **nivelizim i TVSH** hyrëse dhe dalëse për sektorin e gastronomisë dhe hotelieri
- ◆ **mjete shtesë për kredi** pa kamatë dhe garanca bankare për NVM
- ◆ **lirimi i akontacioneve nga tatimi personal** dhe tatimi në fitim për realizues të veprimtarive vetanake (zejtari)



**KOHA PËR  
KRYEMINISTRIN**

**E PARË  
SHQIPTAR**

**VOTO**



Bashkë



# KOHA PËR KRYEMINISTRIN E PARË SHQIPTAR

[www.bdi.mk](http://www.bdi.mk)